

RAPORTI VJETOR
Për veprimtarinë e institucionit të
Avokatit të Popullit
Viti 2019



PËRMBAJTJA

Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit.....	3
KREU 1.....	4
Kudri ligjor dhe institucional.....	4
KREU II.....	7
Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2018 nga institucioni i Avokatit të Popullit	7
KREU III.....	23
Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike	23
3.2 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit	27
3.3 Parandalimi i dhunës dhe tortures	36
3.4 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria	48
3.5 E drejta për një proces të rregullt ligjor	52
3.6 Ndihma juridike falas	54
3.7 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative	57
3.8 Respektimi i të drejtës së pronës	60
3.9 Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës.....	67
3.10 Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor	74
3.11 Respektimi i të drejtës për arsimim	76
3.12 Respektimi i lirisë së shprehjes	78
3.13 Respektimi i të drejtës për kujdes social	80
3.14 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar	81
3.15 Barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGTBI.....	85
3.16 Respektimi i të drejtave të personave të moshuar	87
3.17 E drejta e minoriteteve (pakicave) kombëtare	88
3.18 Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore	92
KREU 4.....	96
Angazhime të tjera institucionale.....	96
4.1 Raporti i veçantë për “Astirin”	96
4.2 Liria e tubimit	108

4.3 Hapat e ndërmarra nga Avokati i Popullit për evidentimin e problematikave të evidentuara gjatë situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për përballimin e tyre	119
4.4 Ushtrimi i rolit të vëzhguesit në procesin e përzgjedhjes me short të anëtarëve Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), si dhe pjesëmarrësit në mbledhjet dhe veprimtarinë këtij Këshilli.....	122
4.5 Monitorimi i disa aspekteve të zbatimit të procesit kalimtar të verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë	129
4.6 Raporte sintezë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve	145
4.7 Raporti i monitorimit për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe respektimin e të drejtave të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.....	150
4.8 Konferenca vjetore	152
KREU 5.....	156
Bashkëpunimi.....	156
5.1 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së.....	156
5.2 Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	161
5.3 Bashkëpunimi ndërkombëtar	163
5.4 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve.....	168
KREU 6.....	170
Shërbimet mbështetëse	170
6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative	170
6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet	174
6.3 Funksionimi i zyrave rajonale	180
KREU 7.....	183
Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre	183

Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit

Raporti që merrni sot në dorë përmbledh punën e një viti të institucionit më të madh të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Mbi të gjitha, ai është një dëshmi e besimit të qytetarëve te ky institucion, teksa përgjatë një viti një mori ankesash që kanë të bëjnë me pakënaqësinë e qytetarëve tanë ndaj institucioneve publike janë adresuar te Avokati i Popullit.

Prej këtyre ankesave, mësojmë shumë. Mësojmë prej tyre jo vetëm rreth rrugës ende të gjatë që institucionet tona duhet të përshkojnë për t'i respektuar të drejtat e njeriut në plotësinë e tyre. Por sidomos marrim prej këtyre ankesave një informatë të saktë mbi nivelin e lirisë së shprehjes së qytetarëve tanë.

Një qytetar që ankohet është një qytetar i lirë. Një njeri që e dëshmon pa frikë pakënaqësinë e tij dhe që kërkon llogari prej institucioneve të shtetit të vet është një qytetar që ishfrutëzon atributet e lirisë së shprehjes. Liria për t'u ankuar është një formë e lirisë së shprehjes.

Liria e shprehjes implikon në vetvete dy parakushte. Së pari duhet të ekzistojë mundësia për t'u shprehur e së dyti duhet të ekzistojë edhe mundësia që kjo shprehje të manifestohet në liri.

Nuk mund të ketë as liri e as shprehje në mungesë të njërit prej dy elementëve. Nëse nuk do të ketë liri nuk mund të ketë shprehje të vërtetë dhe njëherazi nuk mund të ketë shprehje të një mendtë po mungoi liria.

Përgjatë historisë, krijohet gabimisht perceptimi se regjimet diktatoriale urrejnë lirinë e prandaj e kufizojnë shprehjen. Mirëpo, liria në vetvete është një mjet, një aksesori që mundëson artikullimin e pakënaqësisë.

Autokracia e urren shprehjen e pakënaqësisë, andaj ajo e kufizon lirinë me qëllimin fundor të pamundësimin të shprehjes së lirë të pakënaqësisë. Në autokraci nuk duhet të ketë të pakënaqur. Ose edhe nëse ka, ata nuk duhet ta kenë lirinë për ta shprehur pakënaqësinë e tyre.

Kësisoj në demokracinë që mëtojmë të ndërtojmë duhet të kemi një sy gjithmonë të çelët për të mbajtur nën vëzhgim çdo tendencë të cilit do pushtet për të kufizuar liritë e gjithsecilit për t'u hequr vlerën e thelbin të drejtave për t'i bërë ato pjesë të një retorike populiste apo për të mos lejuar diskutimin konstruktiv mbi shqetësimet tona!

Këto nuk janë gjë tjetër pos parathënie e prirjeve të tyre për të pamundësuar shprehjen e lirë përmes së cilës manifestohet pakënaqësia ndaj çdo pushteti në demokraci. Forca e demokracive nuk qëndron në heshtjen e zërit kritik por në adresimin me argument e thelb të mendimit të tjetrit që mund të jetë edhe i ndryshëm nga yni.

Liria e shprehjes është e brishtë në demokraci të brishta si kjo e jona, ndaj na duhet që edhe përpjekjet për ta ruajtur atë duhet t'i kemi të shumëfishta.

KREU 1

Kuadri ligjor dhe institucional

Në demokracisi formë e qeverisjes, parimi i rëndësishëm i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që krijojnë Kushtetuta ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra në thelb në bazë të këtij parimi, tre pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur por edhe në mënyrë të balancuar.

Në funksion të kësaj qasjeje, Kushtetuta parashikon edhe krijimin e organeve të tjera qendrore me pozicion neutral ose të ndërmjetëm, vendi dhe roli i të cilëve është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e shtetit demokratik si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Edhe këto organe të rëndësishme në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese, gëzojnë pavarësi që garantohet me dispozita të veçanta të Kushtetutës. Përmes dispozitave kushtetuese sanksionohet kujdesi për të mbrojtur dhe siguruar sa më mirë pavarësinë e organeve dhe institucioneve kushtetuese, veçanërisht nga ndikimet apo ndërhyrjet e mundshme të politikës ose të ekzekutivit të cilat mund të cenojnë veprimtarinë e tyre në ushtrimin e funksioneve kushtetuese përkatëse.

Një nga komponentët e demokracisë është qeverisja e mirë që nënkupton një administrim të mirë. Demokracia shkon përtej zgjedhjeve. Ajo përfshin praktikën e përditshme në procesin e qeverisjes. Nuk mund të ketë qeverisje të mirë kur administrata publike nuk i respekton të drejtat e njeriut. E drejta për administrim të mirë tani është pjesë e të drejtave të qytetarëve. Po ashtu është marrja e çdo vendimi të administratës shtetërore dhe ligjberesit me qasjen nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut¹. Institucionet e krijuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë aktorë të rëndësishëm shtetformues në sistemet demokratike. Ombudsmeni, qoftë në ushtrim të mandatit të tij klasik, ashtu edhe të zgjeruar si njëri prej tyre luan rol të pazëvendësueshëm, duke qenë më së pari tregues i shkallës së pjekurisë të klasës politike dhe të mentalitetit të shoqërisë që e krijon atë.

Institucionit të Avokatit të Popullit në përputhje me legjislationin kombëtar (Kushtetuta dhe Ligji nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar) por edhe atë ndërkombëtar (veçanërisht Parimet e Parisit dhe parimet e Komisionit të Venecias), i është përcaktuar një mandat i gjerë, i bazuar në standardet ndërkombëtare si institucioni më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky mandat jetësohet në

¹Parimi i mirënjohur tashmë i “human rights approach”

juridiksionin dhe kompetencat që këtij institucioni i parashikohen në Kushtetutë, ligjin “Për Avokatin e Popullit” si dhe detyra të tjera të caktuara në ligje të veçanta.

Avokati i Popullit gjithnjë e më shumë po bëhet jo vetëm një institucion i zëshëm por edhe një institucion i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe nxitjen e llogaridhënies nga organet qeveritare. Ai është duke vënë gjithnjë e më shumë theksin në ushtrimin e mandatit të tij si një pararojë të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe nxitjen e llogaridhënies nga organet qeveritare. Kjo është bërë më e dukshme duke patur parasysh nevojën për një qeveri të hapur dhe të përgjegjshme. Gjithnjë e më në rritje është kërkesa e qytetarëve për të pasur e kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit apo qëndrimin e tij institucional në lidhje me çështje me interes të lartë publik. Kjo është një përgjegjësi të cilën mundohemi ta ushtrojmë e realizojmë me sa të mundemi pavarësisht kapaciteteve tepër të kufizuara që kemi.

Është në tagrin kushtetues të institucionit të Avokatit të Popullit që në përmbushje të funksioneve të tij të jetë në gjendje ta bëjë administratën publike më të ndjeshme ndaj opinionit publik dhe më të përgjegjshme ndaj kërkesave për drejtësi dhe besueshmëri. Me fjalë të tjera, Avokati i Popullit gëzon të drejtën dhe detyrimin që në bashkëpunim me zyrtarët publikë në nivel qendror apo vendor të përpiqet për krijimin e një kulture demokratike dhe standardeve më të larta të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në vend.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar rezolutën 48/134, datë 20.12.1993, ku parashikohen standardet që shtetet anëtare duhet të zbatojnë për të garantuar një sistem efektiv të mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut. Kjo rezolutë e njohur gjerësisht me emërtimin Parimet e Parisit është dokumenti ku parashikohen standardet për funksionimin e Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Me qëllim që Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të konceptohen dhe të veprojnë në përputhje me këto parime dhe të veprojnë si institucione udhërrëfyes në promovimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ato i nënshtrohen procesit të akreditimit, i cili kryhet çdo 4 vjet. Ky proces zhvillohet nga Aleanca Globale e Institucioneve të të Drejtave të Njeriut (GANHRI) që ushtron aktivitetin e saj si një organizatë e pavarur nën mbështetjen e Kombeve të Bashkuara. Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë vepron si sekretariat për procesin e këtij akreditimi.

Duhet të theksohet se standardet ndërkombëtare të krijuara për institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut ("Parimet e Parisit") përcaktojnë kompetencat, përgjegjësitë, përbërjen dhe garancitë e pavarësisë dhe pluralizmit. Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (NHRI) në përgjithësi njihen si kompetente:

- ✓ për të monitoruar çdo situatë të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe për të ndërmarrë veprime kundër tyre;
- ✓ të këshillojë Qeverinë, Parlamentin dhe çdo organ tjetër kompetent për shkeljet specifike për çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin dhe pajtueshmërinë dhe zbatimin e përgjithshëm me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;

- ✓ për të bashkëpunuar me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare;
- ✓ për të edukuar dhe informuar në fushën e të drejtave të njeriut.

Edhe vetë Komisioni i Venecias, duke njohur dhe pranuar parimet themelore të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut të tilla si pavarësia, objektiviteti, transparenca, drejtësia, paanshmëria si dhe duke e konsideruar se këto institucione janë një element i rëndësishëm në një shtet të bazuar në demokraci, sundim të ligjit, respektim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe qeverisje të mirë ka miratuar *Parimet mbi mbrojtjen dhe promovimin e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut*.

Duke qenë se institucionet kombëtare të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut kanë në fokusin e tyre ndërtimin i një shoqërie ku institucionet shtetërore janë llogaridhënëse ndaj qytetarëve dhe veprojnë në mënyrë transparente, efektive dhe eficientë dhe e domosdoshme mbështetja njerëzore dhe financiare për të garantuar që institucionet publike të veprojnë në përputhje me standardet dhe aktet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është certifikuar edhe nga institucionet kompetente ndërkombëtare për standardet e larta që përmbush. Më konkretisht, institucioni i Avokatit të Popullit të Shqipërisë është akredituar me Statusin “A” për herë të parë në vitin 2004 dhe është riakredituar në vitet 2008 dhe 2015 me të njëjtin status. Në përfundim të këtij procesi, Komiteti lë rekomandime për Institucionin e të Drejtave të Njeriut për të përmirësuar punën e tij dhe/ose për të garantuar standardet e përcaktuara nga Parimet e Parisit. Me rastin e ri-akreditimit në vitin 2015, institucionit tonë i është tërhequr vemendja që duhet të advokojë pranë parlamentit për të rritur kapacitetet e tij si në burime njerëzore, ashtu edhe ato financiare. Një pjesë e mirë e rekomandimeve të këtij Komiteti i drejtohen Kuvendit dhe Qeverisë pasi vetëm duke mbështetur financiarisht e garantuar kapacitetet njerëzore për institucionet që bëjnë kritikën e tyre mund të demonstron rritja e qëndrueshmëria e nivelit të demokracisë në vend.

Një ndër kriteret vlerësuese që udhëheq procesin e akreditimit, ndërmjet shumë të tjerëve të tillë si: autonomia nga qeveria; pavarësia e garantuar në statut ose Kushtetutë; pluralizmi, etj është edhe mbështetja e përshtatshme financiare nga buxheti i shtetit në një shkallë të tillë që të mundësojë realizimin gradual dhe progresiv të aktiviteteve të këtyre institucioneve kombëtare në funksion të përmbushjes së mandatit të tyre. Tashmë, institucioni ka hyrë (që nga muaji gusht 2019) në procesin e ri-akreditimit të statusit A, vlerësim që do të kryhet në muajt në vijim të vitit 2020.²

² Për shkak të gjendjes së pandemisë Covid 19, procedura e riakreditimit të institucionit të Avokatit të Popullit u shty nga marsi 2020 në shtator 2020.

KREU II

Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2018 nga institucioni i Avokatit të Popullit

Në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2018, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar, më datë 30.5.2019, rezolutën përkatëse ku, ndërmjet të tjerash, i ka rekomanduar institucionit të Avokatit të Popullit marrjen e një sërë masave që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore. Në zbatim të kësaj rezolute, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

➤ **Të rrisë angazhimin në ndjekjen e përmbushjes së objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Agjenda 2030, me fokus të veçantë buxhetimin gjinor, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e konsumatorëve, detyrime që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushat përkatëse dhe/ose rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë**

Në lidhje me buxhetimin gjinor si një element thelbësor drejt përmbushjes së objektivit të arritjes të barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson, se politikat dhe planet strategjike të cilat nuk janë të kostuara dhe të buxhetuara saktë nga perspektiva gjinore janë të pazbatueshme dhe nuk sigurojnë “*de facto*” garantimin e të drejtave të grave dhe vajzave në Shqipëri.

Në këtë kontekst dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara shprehimisht në Rezolutën e Kuvendit për vitin 2018, përgjatë vitit 2019, kemi shprehur angazhimin institucional në 2 (dy) drejtime kryesore:

- institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion që zbaton parimet e buxhetimit gjinor dhe ka një staf të ndërgjegjësuar për rëndësinë e respektimit të këtyre parimeve në planifikimin e Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA-së) të vetë institucionit;
- institucioni i Avokatit të Popullit monitoron dhe nxit institucionet e tjera qëndrore dhe vendore për respektimin e parimeve të buxhetimit gjinor në zbatim të Konventës CEDAE dhe Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore.

Lidhur me angazhimin parësor të cituar më sipër për herë të parë, PBA-ja e institucionit të Avokatit të Popullit për vitet 2020-2022, u përgatit me elementë të buxhetimit gjinor në përputhje me kërkesat e parashikuara shprehimisht në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe të zbërthyer më tej në vendimin nr.465, datë 18.7.2012 të Këshillit të Ministrave “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”.

Në këtë program buxhetor është mbajtur në vëmendje dhe është deklaruar qartë politika e institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me barazinë gjinore, politikat që prekin direkt apo indirekt çështjet gjinore, duke i adresuar ato në mënyrë efektive drejt synimit final, atij të arritjes dhe mbajtjes së barazisë gjinore. Parimi i buxhetimit gjinor është i shprehur qartë në treguesit e performancës në nivel qëllimi. Më tej, do të krijohen baza solide që politikat me bazë gjinore të programuara nga institucioni të mund të monitorohen rigorozisht gjatë zbatimit të buxhetit si dhe të mund të vlerësohen dhe auditohen konform ciklit të menaxhimit të shpenzimeve publike.

Përsa i përket monitorimit dhe nxitjes së institucioneve të tjera në nivel qendror dhe vendor për respektimin e parimeve të buxhetimit gjinor, institucioni i Avokatit të Popullit ka iniciuar në vitin 2019 punën për hartimin e një raporti monitorimi mbi buxhetimin për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Shqipëri.

Një sërë institucionesh qendrore dhe njësitë e vetqeverisjes vendore kanë detyrime të përcaktuara qartë në lidhje me adresimin e dhunës në familje të cilat gjenerojnë nga ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020, qëllimit strategjik nr.3 “Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje” janë parashikuar një sërë aktiviteteve që duhet të zbatohen nga këto institucione të shoqëruara me kostot përkatëse financiare.

Një faktor shumë i rëndësishëm për adresimin efektiv të dhunës me bazë gjinore është planifikimi i mjaftueshëm në buxhetet e autoriteteve shqiptare në nivel qendror dhe vendor të shpenzimeve që kanë të bëjnë me zbatimin e detyrimeve ligjore dhe objektivave strategjike.

Për të vlerësuar nivelin e buxhetimit në këtë fushë, Avokati i Popullit, me mbështetjen e zyrës së UN WOMEN në Shqipëri, filloi punën për hartimin e këtij raporti monitorues që startoi me identifikimin/hartëzimin e detyrimeve që burojnë nga ligji dhe strategjia e sipërpërmendur për çdo institucion në nivel qendror dhe vendor. Më pas, institucioneve kryesore në nivel qendror dhe 5 (pesë) bashkive në të cilat është përqendruar pjesa më e madhe e popullsisë në vend, institucioni i Avokatit të Popullit u kërkoi informacion të detajuar për planifikimin buxhetor në Programin Afat-Mesëm të Buxhetit (2018-2020), përsa i përket shpenzimeve të vitit 2018.

Gjithashtu, sa i përket fushës së buxhetimit gjinor në **datat 30-31 Tetor 2019**, u zhvillua një trajnim i stafit të AP me temë: “*Parimet e Barazisë Gjinore dhe Buxheti i Përgjithshëm Gjinor*”. Trajnimi i stafit është i nevojshëm për arsye se hartimi i PBA-së së institucionit të Avokatit të Popullit me elementë të Buxhetimit të Përgjithshëm Gjinor është një detyrim jo vetëm për stafin që punon në sektorin e financës dhe buxhetit por edhe për stafet e Seksioneve të AP në mënyrë që të bëjmë një lidhje sa më të mirë mes Planeve të punës dhe buxheteve. Ky trajnim u realizua falë mbështetjes së UN WOMEN dhe në bashkëpunim edhe me stafin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2019 në **lidhje me mbrojtjen, garantimin dhe promovimin të drejtave të fëmijëve** është angazhuar në drejtim të:

- ndërmjetësimit dhe promovimit të rregullave të reja për mbrojtjen e fëmijëve;
- kryerjes së inspektimeve për të përgatitur raporte dhe për të bërë rekomandime për administratën, me qëllim ndryshimin e praktikave të gabuara administrative ose përmirësimin e legjislacionit.

Më konkretisht, Avokati i Popullit për vitin 2019 ka trajtuar:

- **46 ankesa**, objekti i të cilave ka qenë shkelja e të drejtave të fëmijës si rezultat i varfërisë. Ky faktor është pengues për një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme e pa privime në interesin më të lartë të fëmijës dhe sjell më pas edhe shkeljen e të drejtave të tjera të fëmijës;
- **8 (tetë) raste me iniciativë**, objekti i të cilave ka qenë shkelja e **të drejtës së fëmijës për të përfutur shërbime të kujdesit shëndetësor** për trajtimin e sëmundjeve dhe riaftësimin e shëndetit³.
- **1 (një) ankesë**, me objekt shkeljen e **të drejtës së fëmijës për ushqim të shëndetshëm** në të tre komponentët kryesorë: sigurimi i ushqimit, siguria ushqimore dhe ushqyerja e shëndetshme. Për të garantuar sigurinë ushqimore tek fëmijët e grupmoshës nga 0-6 vjeç, institucioni i Avokatit të Popullit u ka adresuar rekomandimin përkatës, organeve të administratës shtetërore⁴. Ende për këtë çështje nuk kemi marrë përgjigje zyrtare për zbatimin ose jo (në mënyrë të plotë ose të pjesshëm) të këtij rekomandimi.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka hartuar edhe tre raporte sintezë të cilat janë të shtjelluara në krerët e mëposhtëm, konkretisht në kreun IV “Angazhime të tjera institucionale”. Një ndër problematikat e kahershme të ndjekura nga institucioni i AP, parashikuar edhe në Rezolutën e KRSH-së “Për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve “Miq të Fëmijëve” për vitin 2018 dhe për planin e veprimit për vitin 2019” është **përfundimi i reformës së deinstitutionalizimit të fëmijëve** si dhe marrjen e masave për gjetjen dhe mbështetjen e familjeve të origjinës ose alternative si dhe të lehtësimin e procedurave të birësimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë, Komiteti i Birësimeve. Edhe për vitin 2019 rezultoi, se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk e ka miratuar ende Planin e Veprimit të Deinstitutionalizimit.

Në fushën e **mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit** nëpërmjet fushatave sensibilizuese ka vënë në zbatim udhëzuesin “Për bashkëpunimin e institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe me shoqërinë civile”, ku instrumentat e propozuar nga vetë fëmijët, kanë mundur rritjen e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me ta dhe

³Në zbatim të legjislacionit në fuqi për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, Avokati i Popullit i ka kërkuar në vijimësi MSHMS mbulimin e shpenzimeve të kurimit (të plotë ose të pjesshme) nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor për trajtimin e rasteve në fjalë. Përtej komunikimit zyrtar, ndërmjet institucionit të AP dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, asnjë nga rastet e referuara nga institucioni ynë nuk është trajtuar nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor në përputhje me legjislacionin në fuqi.

⁴Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Tiranë.

shoqërinë civile. Në kuadër të veprimtarive ndërgjegjësuere me institucionet e edukimit nëshkolla të ndryshme të vendit për promovimin e rolit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve janë zhvilluar disa veprimtari. Më konkretisht:

- Në kuadër të projektit “*Për fëmijët nga fëmijët*” në datën **18 prill 2019** në bashkëpunim me organizatën Save the Children Albania, Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve zhvilloi takime në mjediset e shkollës “Qemal Mici” në Durrës, ku prezantoi udhëzuesin “Për bashkëpunimin e institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe me shoqërinë civile”.
- Në datën **24 prill 2019**, u zhvillua një takim me nxënës e mësues të shkollës 9-vjeçare “Qamil Guranjaku” në qytetin e Elbasanit.
- Në kuadër të Agjendës 2030 në datën **12 Prill 2019**, përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit morën pjesë në veprimtarinë me temë “*Të gjithë bashkë për realizimin e Objektivit 8.7 për Zhvillim të Qendrueshëm në Shqipëri*”, organizuar nga MSHMS në bashkëpunim me OSBE dhe ILO. Aleanca 8.7 është një partneritet global për të identifikuar prioritetet dhe nismat e ndryshme, me qëllim arritjen e progresit për OZHQ 8.7, drejt realizimit të një bote pa punë të detyruar, skllavërim modern, trafikim njerëzor dhe punë të detyruar të fëmijëve.
- Në datën **24 Prill 2019**, përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën Kombëtare “*Në mbështetje të punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve*”, organizuar nga MSHMS - ASHMDf, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë: UNICEF, OSBE, Save the Children, World Vision Albania dhe Terre Des Hommes Shqipëri.
- Avokatit të Popullit në datën **3 Maj 2019**, mori pjesë në Samitin e 1-rë të të Rinjve në vendin tonë.
- Në datën **14 maj 2019**, pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit në prezantimin e raportit “Fëmijët mbi të drejtat e Fëmijëve” në Kuvendin të Shqipërisë, përgatitur nga CRCA, me pjesëmarrjen e mbi 500 fëmijëve nga e gjithë Shqipëria në kuadër të projektit që zhvillohet nga Save the Children në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
- Lancimi në **maj 2019**, i Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2019-2022 të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve. Kjo strategji, pjesë përbërëse e Planit Strategjik 2019-2022 të Institucionit të Avokatit të Popullit ka për qëllim të ofrojë një plan të gjerë dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Gjatë këtij aktiviteti u prezantua edhe faqja e internetit miqësore për fëmijët, e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, pjesë e faqes zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.

- Hartimi i strategjisë dhe Planit të Veprimit, ndërtimi i faqes miqësore së internetit për fëmijët dhe organizimi i aktivitetit u zhvilluan në kuadër të projektit “Fëmijët për fëmijët”, zbatuar nga Save the Children në bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit. Gjithashtu për një qasje sa më miqësore si dhe për të rritur aksesueshmërinë tek vetë fëmijët (por jo vetëm) në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme është krijuar për herë të parë faqja online (website) për Seksionin e Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, pjesë e faqes zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.
- Institucioni i Avokatit të Popullit si pjesë e Rrjetit European të Ombudsmanëve për Fëmijët të Europës Juglindore (CRONSEE) në kuadër të 30 vjetorit të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijës”, organizoi më datë **17 Tetor 2019**, konferencën rajonale, me temë: “*Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve migrantë*”. Misioni i këtij rrjeti është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Shkëmbimi i ideve dhe mendimeve, ndarja e praktikave më të mira të punës ndërmjet Ombudsmanëve të Rajonit, anëtarë të CRONSEE dhe shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, përfaqësuesve të institucioneve shtetërore e OJF-ve, bënë të mundur evidentimin e problematikave, sfidave dhe adresimin e rekomandimeve kryesore për garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve, me fokus kryesor mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve migrantë në interesin më të lartë të tyre si dhe përmirësimin e procedurave ligjore të përshtatshme, duke përfshirë integrimin efektiv të fëmijëve migrantë dhe refugjatë si dhe familjeve të tyre. Gjatë takimit, bazuar në të dhënat cilësore dhe sasore të mbledhura nga vendet pjesëmarrëse të këtij rrjeti si dhe mbështetur në eksperiencat e tyre u përgatitën 15 rekomandime të përbashkëta.

Ombudsmanët për të Drejtat e Fëmijëve të Europës Juglindore u rekomandojnë qeverive të vendeve respektive, përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit institucional ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor si dhe fuqizimin e burimeve njerëzore të pushtetit lokal për t’iu përgjigjur nevojave që kanë fëmijët në lëvizje, kryesisht, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme të stafëve, alokimit të buxheteve të nevojshme dhe përfshirjes në mënyrë periodike në konsultime dhe monitorime. Këto rekomandime do të ndiqen nga Avokati i Popullit dhe anëtarët e rrjetit CRONSEE për të zbatuar një prespektivë të të drejtave të fëmijëve në lëvizje si dhe duke u marrë në mënyrë specifike me rastet e fëmijëve në lëvizje, promovimin e të drejtave të tyre dhe monitorimin për zbatim nga shtetet respektive.

- Përfaqësues të Avokatit të Popullit morrën pjesë aktive në veprimtarinë për lancimin e Qendrës Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve nga Dhuna Seksuale të zhvilluar më datë **23 tetor 2019** nga CRCA/E CPAT, e cila përmbush një ndër rekomandimet e adresuara nga AP për ofrimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët dhe të rinjtë e dhunuar seksualisht.

- Kontributi i dhënë në kuadër të raportit të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut “**On Child Rights &SDGs**”ku përfshiheshin *sfidat për realizimin e të drejtave të fëmijëve-Zgjidhjet ose praktikat më të mira për të mos lënë pas asnjë fëmijë*.
- Zhvillimi i aktivitetit përmbyllës në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF në Shqipëri, më datë **30 tetor 2019** në kuadër të përfundimit të punës për monitorimin e kushteve dhe trajtimit në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit të të miturve në konflikt me ligjin dhe të privuar nga liria, ku u prezantuan gjetjet nga inspektimet e kryera në organet kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.Për këtë qëllim dhe në zbatim të marrëveshjes me UNICEF, gjatë periudhës *maj-qershor 2019* janë inspektuar institucionet kryesore që trajtojnë të mitur në kushtet e privimit të lirisë si: Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe 6 komisiaritet që përfshin kjo drejtori në nivel vendor si dhe IEVP Shën Koll (Lezhë) dhe IEVP Kavajë në nivel kombëtar.

Në lidhje me mbrojtjen **e të drejtave të konsumatorëve**, gjatë kësaj periudhe fokus të veçantë kanë marrë ankesat për cilësinë dhe ofrimin e shërbimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë në vështirësi dhe pamundësi ekonomike; për pagesën e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike; për mungesën e shërbimeve të ofrimit të ujit të pijshëm, sigurisë ushqimore etj. Vlen të sjellim në vëmendjen se mandati i institucionit tonë në rastet e trajtimit të ankesave shtrihet vetëm mbi shërbimet e ofruara nga sektori publik ose të tretë që ushtrojnë një shërbim publik. Mandati ynë nuk shtrihet në sektorin privat për sa i takon trajtimit të ankesave, gjithsesi ne e kemi konsideruar këtë çështje në kuadër të mandatit tonë promovues por edhe të rekomandimeve ndaj organeve shtetërore që mbikqyrin këtë sektor. Jemi të bindur që pritshmëritë e publikut janë që mandati ynë në këtë fushë të jetë dhe në sektorin privat. Për sa më sipër, kemi kryer veprimet e mundshme brenda mandatit tonë dhe në frymën e rezolutës së Kuvendit.

E drejta për të pasur disa shërbime jetësore si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe furnizimi me energji elektrike është një nevojë thelbësore njerëzore, një e drejtë themelore, mungesa e së cilës përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Në mjaft raste rezultojnë detyrime financiare të akumuluar ndërmjet vite, ku edhe pse palët kanë lidhur akt-marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të konsumit të energjisë elektrike, përsëri subjektet familjare janë ndodhur në kushtet e pamundësisë financiare, qoftë edhe pagesës së një shume minimale prej 1000 lekësh për shlyerjen e detyrimeve të tyre.

Në këto rrethana, i kemi sugjeruar Entit Rregullator të Energjisë gjetjen e mundësive sa më të përshtatshme për konsumatorët vulnerabël, me qëllim përfshirjen e politikave të mbrojtjes sezonale, ku të mund të mbahen si referencë kushtet atmosferike, temperaturat ekstreme të ftohta në dimër dhe shumë të nxehta në verë.Në të gjitha këto raste kemi rekomanduar të ndalohet ndërprerja e energjisë elektrike për konsumatorët, kryesisht në orarin 08:00 - 23:00 të ditës.

Pavarësisht hartimit të rregullores “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë” nga Enti Rregullator i Energjisë në të cilën përcaktohen një sërë masash lidhur me detyrimet e Furnizuesit Universal apo procedurat që duhet të ndiqen për ndërprerjen e energjisë elektrike (në rast mospagese të energjisë elektrike për më shumë se katër muaj si dhe në rast të mosrespektimit të akt-marrëveshjes për pagesën e energjisë, sipas një plan pagese të dakordësuar me furnizuesin), gjykojmë se mbrojtja sociale dhe ekonomike e këtyre grupeve të cënueshme nuk është e mjaftueshme dhe duhet të konsiderohet si prioritet për shkak se familjet në nevojë ekstreme nuk arrijnë dot të sigurojnë mbijetesën dhe jo më të përballen me pagesat e shërbimeve publike në fjalë.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit kjo duhet të shoqërohet me një paketë ndryshimesh ligjore për ofrimin e zgjidhjeve të menjëhershme me qëllim që këto familje të mos privohen nga e drejta për akses në furnizimin e nevojshëm me energji elektrike për t’u siguruar atyre minimumin e mundshëm brenda një sasive limit kilovatësh me energji. Gjithashtu është e nevojshme të shmanget absolutisht ndërprerja e furnizimit me energji elektrike për këto grupe, me qëllim që gjithkush të marrë shërbimet bazike pavarësisht statusit social dhe ekonomik që mund të gëzojnë qytetarët e këtij vendi.

Një problematikë tjetër ka të bëjë me **reformën në sektorin e ujit**. Pavarësisht se treguesit e fundit dëshmojnë se reforma në sektorin e ujit në lidhje me kthimin e ligjshmërisë të pagesat e faturave është në rrugë të mbarë për më tepër shërbime cilësore dhe më shumë investime në të ardhmen edhe ajo ka problemet e saj. Një pjesë e territorit të Shqipërisë, e sidomos zonat rurale nuk furnizohen me ujë të pijshëm apo furnizohen pjesërisht, duke përbërë kështu një vështirësi të madhe të jetesës dhe shërbimeve bazë të nevojshme për banorët.

➤ **Të rrisë veprimtarinë e tij informuese dhe sensibilizuese lidhur me fushën e veprimtarisë së tij dhe rolin e institucionit**

Duke qenë se institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut veprojnë si institucione udhëheqës në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar maksimalisht e në vijimesi promovimin, informimin apo sensibilizimin e qytetarëve lidhur me të drejtat e njeriut si dhe rolin e institucionit në këtë drejtim.

Thënë kjo, vijon të këtë një kuptim të zgjeruar nga qytetarët të mandatit të institucionit të Avokatit të Popullit. Pavarësisht shpjegimeve në mjaft intervista apo paraqitjeve publike të Avokates së Popullit në lidhje me mandatin e institucionit tonë, vijojmë të përceptohemi në publik si ushtrues së ndihmës juridike falas dhe kemi mjaft kërkesa ende që na kërkojnë e presin prej nesh përfaqësim në gjykatë për çështje konkrete për grupet në nevojë. Mendojmë se zbatimi i ligjit për ndihmën juridike falas dhe promovimi më i mirë edhe i mekanizmave të vëna në dispozicion nga shteti nëpërmjet atij ligji do të përmirësojë përceptimin e publikut në lidhje me këtë çështje. Problem mbetet edhe mandati i kufizuar në lidhje me sektorin privat dhe kohëzgjatja e afateve të veprimtarisë administrative. Gjithësesi, më konkretisht, gjatë periudhës raportuese, institucioni ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Në fushën e barazisë gjinore, Avokati i Popullit në bashkëpunim me UNDP ka organizuar në datën **25 Qershor 2019**, Tryezën e parë të konsultimit për hartimin e ligjit të integruar kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave. Diskutimi u fokusua mbi nevojën e hartimit të një ligji të integruar kundër dhunës ndaj grave e vajzave sipas Standardeve të Konventës së Stambollit për ndalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe masat përkatëse që duhet të merren nga të gjithë institucionet shtetërore, institucionet e pavarura që monitorojnë të drejtat e njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile në vijim të punës së tyre të përbashkët për përmirësimin e masave legislative kundër dhunës me bazë gjinore.
- Më datë **11 korrik 2019**, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe UNDP Shqipëri, organizuan një tryezë konsultimi me përfaqësues të administratës publike, sektorin privat, shoqërinë civile dhe sindikatat me temë: *“Parimet, politikat dhe standardet e një mjedisi të sigurtë pune”*. Diskutimi mbi hartimin e dokumenteve politike dhe proceduriale nga ana e institucioneve të ndryshme publike dhe entiteteve private kundër ngacmimit dhe ngacmimit seksual është garanci me qëllim sigurimin e një mjedisi të sigurtë pune. Çështjet që lidhen me ngacmimin, ngacmimin seksual dhe që lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë ose për shkak të veprimtarisë janë një shqetësim i evidentuar tashmë në raporte e studime të ndryshme. Në këtë tryezë konsultimi u diskutua dhe u dhanë propozime për të arritur në përfundime lidhur me nevojat për rregullime ligjore, politike dhe proceduriale kundër dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual për të garantuar një mjedis të sigurt pune në sektorin publik dhe privat.
- Gjatë periudhës raportuese, institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë promovimit dhe mbrojtjes të të **drejtave të grupeve vulnerable**. Në këtë aspekt vlen të përmenden aktivitetet e kryera në kuadër të Projektit *“Monitorimi dhe përmirësimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale në nivel vendor”*, financuar nga GIZ dhe i shtrirë në bashkitë Elbasan, Librazhd, Pogradec dhe Kukës. Në kuadër të këtij projekti janë realizuar një sërë aktivitetesh, ku vlen të përmenden takimet konsultuese me Njësitë e Qeverisjes Vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet në nevojë mbi metodologjinë e monitorimit dhe vlerësimit për shërbimet sociale të ofruara nga njësitë e pushtetit vendor (qershor 2019): seminare të organizuara me përfaqësues të njësisë së qeverisjes vendore dhe organizatat e shoqërisë civile në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qendrushëm në nivel kombëtar dhe lokal (prill 2019); takime konsultative dhe advokuese për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të *“Raportit të monitorimit për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe respektimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara”* (qershor-korrik 2019); aktiviteti përmbyllës me temë: *“Sfidat në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave sociale të grupeve në nevojë dhe veprimet që do të ndërmerren në vijim”* (korrik 2019).

Gjatë **muajit shtator**, ky projekt u shtri edhe 4 qytete të tjera (Pogradec, Berat, Fier dhe Tiranë) ku u zhvilluan aktivitetet përkatëse në të cilën përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit prezantuar Raportin e monitorimit dhe rekomandimet e hartuara në bazë të problematikave të konstatuara. Takimi përmbyllës *“Sfidat në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave sociale të grupeve*

në nevojë dhe veprimet që do të ndërmerren në vijim”, u zhvillua më datë **18.12.2019**. Në këtë takim u prezantuan:

- ✓ Iniciativa “Monitorimi dhe përmirësimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale për grupet në nevojë në nivel kombëtar dhe vendor (Pogradec, Fier dhe Berat)”;
- ✓ Masat e ndërmarra të institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave sociale të grupeve në nevojë;
- ✓ Konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të monitorimit dhe masat e marra nga AP për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Në këtë kuadër, institucioni i Avokatit të Popullit u ka dërguar Kryetarëve të Bashkisë Berat, Elbasan, Fier, Kukës, Librazhd dhe Pogradec, Raportin e Monitorimit për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe respektimin e të drejtave të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara (PAK) dhe u ka kërkuar përgjigje lidhur me masat që do të merren për zbatimin e rekomandimeve.

Ndërkohë, bazuar në problematikat e prezantuara janë hartuar edhe rekomandimet të cilat u janë dërguar zyrtarisht më datë **02.12.2019**, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim përmirësimin e skemës së ndihmës ekonomike dhe të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

- Përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë, më datë **05.07.2019** në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë Komisionit të Punës, Çështjes Sociale dhe Shëndetësisë pranë Kuvendit të Shqipërisë për projekt-ligjin “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Sugjerimet e dhëna nga Avokati i Popullit morën në konsideratë dhe janë reflektuar tashmë në ligjin nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Në **korrik 2019**, u zhvillua takimi përmbyllës në kuadër të projektit “*Transparenca në sistemin shëndetësor në Shqipëri*”, mbështetur nga USAID (mars 2017-korrik 2019). Qëllimi i këtij projekti ishte krijimi i një mjedisi më të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor duke rritur rolin e institucioneve të pavaruara dhe duke angazhuar përfituesit në komunitet. Ky projekt ofroi asistencë teknike për institucionin e Avokatit të Popullit, Kontrolline Lartë të Shtetit dhe ILDKP, me synim rritjen e mekanizmave të transparencës dhe angazhimit të qytetarëve në mënyrë efektive në luftë ndaj korrupsionit në shëndetësi.
- Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve, më datë **01.10.2019**, përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit organizuan një takim me të moshuarit të cilët janë të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, takim cili u fokusua në nevojat që ata kanë në rrijtjen e standardeve të shërbimit.
- Gjatë **muajve shtator-nëntor** Avokati i Popullit ka organizuar në bashkëpunim me Strehën LGBTI, disa seminare për informimin dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve të komunitetit LGBTI, Romë dhe Egjiptianë dhe gra e vajza nga grupe vulnerabël për të drejtat e tyre, institucionet ku mund të drejtohen në rastet kur këto të drejta ju shkelen apo mohohen, legjislacionin në fuqi

në mbrojtje të tyre, etj, aktivitete të cilat u zhvilluannë qytetin e Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Korçës dhe Gjirokastrës.

- Avokati i Popullit zhvilloi në datën **31 Tetor 2019**, një forum diskutimi me shoqatat e grave në qytetin e Vlorës, mbi legjislacionin për parandalimin dhe luftën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe zbatimin e tij në praktikë.
- Në datën **14 Nëntor 2019**, institucioni i Avokatit të Popullit organizoi në Bashkinë Korçë një "Ditë të Hapur" për promovimin, mbrojtjen dhe parandalimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit.
- Institucioni i Avokatit të Popullit organizoi në qytetin e Korçës në datën **15 nëntor 2019**, takimin me rrjetin e organizatave joqeveritare Rome dhe Egjptiane që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Qarkun Korçë për të njohur të drejtat e minoriteteve në kuadër të drejtave të njeriut.
- Në bashkëpunim me UNËOMEN në datën **25 nëntor 2019**, institucioni i Avokatit të Popullit zhvilloi forumin me studentët i cili kishte në fokus të tij dhunën me bazë gjinore dhe atë seksuale, njohjen e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar në fushën e dhunës me bazë gjinore.
- Institucioni i Avokatit të Popullit, zhvilloi në **datën 17 Dhjetor 2019**, seminarin me temë "Njohja, roli, funksioni dhe kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit", me mësuesit e edukimit shoqëror dhe qytetar të shkollave 9 vjeçare publike të Tiranës që kishte si qëllim informimin e tyre mbi rëndësinë e veprimtarisë dhe funksioneve të institucionit të AP-së.

Promovimi i **të drejtave të fëmijëve ka** qenë një nga angazhimet kryesore të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë kësaj periudhe. Më konkretisht:

- Përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit më datë **3 Qershor 2019** ishin pjesë e aktivitetit të organizuar nga Terres des Hommes për zbatimin e një programi të dedikuar për fëmijët në konflikt me ligjin, i cili synon në modelimin e shërbimeve për riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin si dhe në forcimin dhe rritjen e kapaciteteve të organeve kompetente për zbatimin e këtij modeli. Kjo u konsiderua si një tryezë e përbashkët aktorësh të çështjes së riintegritit në shoqëri të fëmijëve në konflikt me ligjin, angazhimit dhe rolit të secilit sektor/institucion në modelimin e shërbimeve të riintegritit dhe në zbatimin e tyre me sukses.
- Më datë **7 qershor 2019**, u realizua aktiviteti promovues në shkollën 9 vjeçare "Mësonjëtorja e Parë Shqipe", Korçë.
- Institucioni i Avokatit të Popullit (Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve) në datat **18-19 qershor 2019** në bashkëpunim me grupin e të rinjve "Zëri 16+", realizoi takimin me fëmijët e qytetit të Peshkopisë, me qëllim promovimin e të drejtave të

fëmijëve për të bërë të mundur që zëri i tyre të dëgjohet duke ushtruar të drejtën e tyre për t'u ankimuar me mbështetjen e institucionit të Avokatit të Popullit.

- Në partneritet me fëmijët dhe shoqërinë civile, më datë **14 maj 2019**u organizua në Kuvendin e Shqipërisë takimi lobues dhe informues, ku u prezantuan gjejtjet e raportit “Zëri i të rinjve në Shqipëri”, i cili përbën një studim mbi vlerësimin e pikëpamjeve të fëmijëve lidhur me problematikat e tyre sipas përcaktimeve të KDF-së.
- Konkretizimi i *Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet UNICEF-it dhe institucionit të Avokatit të Popullit (Qershor 2019)*, në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve 2019-2021 për promovimin, parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi erdhi në një datë të rëndësishme, siç është 1 qershori, festa e fëmijëve.
- Zhvillimi i një takimin me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, më datë **5 nëntor 2019** për rolin e institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut në mbrojtjen, garantimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti.
- Pjesëmarrja në Samitin e dytë të vajzave në Shqipëri që u zhvillua në Tiranë, më datë **18 Nëntor 2019** në Ditën Europiane kundër dhunës dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Në vitin e dytë të organizimit si dhe të fushatës #Girl2Leader, ky Samit u organizua nga Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN), CRCA/ECPAT Shqipëri, Qendra Kombëtare Burimore për të Rinjtë në Shqipëri (YRCA), Child and Youth Policy Hub dhe Koalicioni për Arsimin në Shqipëri. Motoja e Samitit për këtë vit ishte: “*Vajzat për ndryshim: Sfidojnë realitetin dhe projektujmë të ardhmen e tyre*”.
- Avokati i Popullit si anëtar i ENOC (European Network of Ombudspersons for Children), përgatiti një video deklaratë për **20 nëntorin 2019**, me mesazhet kyç për të drejtat e fëmijëve dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Kjo video u publiku me rastin e 30 vjetorit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në të gjitha vendet anëtare të këtij rrjeti.
- Në kuadër të 30 vjetorit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, më datë **21 nëntor 2019** në mjediset e institucionit të Avokatit të Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve priti një grup fëmijësh të klasave të VI dhe të VII të shkollës jopublike “Tirana Jonë”.

Gjatë periudhës së raportimit, institucioni i Avokatit të Popullit ka organizuar dhe marrë pjesë edhe në disa aktivitete të tjera ***në fushën e edukimit ligjor të publikut si*** më poshtë:

- Pjesëmarrje në një emision televiziv pranë Radiotelevizionit publik shqiptar, më datë **09.04.2019**, lidhur me projektligjin “*Mbi nismën ligjore*”, ku publiku u njoh me qëllimin e

këtij projektligji mbi të drejtën e nismës ligjore për të cilin institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë edhe opinion ligjor.

- Pjesëmarrjeaktive në akvititetin e organizuar nga Universiteti Beder dhe Ambasada e SHBA në Tiranë më datë **29.05.2019** në kuadër të forcimit të Demokracisë, Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Shqipëri, me fokus njohjen e vlerave të harmonisë fetare në Shqipëri, ku morën pjesë studentë nga të gjitha universitetet shtetërore dhe private.
- Organizimi në bashkëpunim me OSBE-në, më datë **11 Nëntor 2019**, i aktivitetit me temë “*Roli i Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut*”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte diskutimi dhe adresimi i sfidave dhe pengesave aktuale në integrimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për trajtimin e rasteve individuale të shkeljeve të të drejtave të njeriut, veçanërisht përmes mandatit të Avokatit të Popullit.

Sa më sipër kanë qenë vetëm disa nga veprimtaritë e zhvilluara nga institucionit gjatë periudhës së raportimit.

Në fund vlen të theksohet puna që është bërë gjatë kësaj periudhe në hartimin, prodhimin, publikimin dhe shpërndarjen e raporteve të ndryshme, raporteve të veçanta, materialeve të ndryshme promovuese, pjesëmarrjes në emisione të ndryshme televizive etj, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit mbi të drejtat e njeriut dhe rolin e Avokatit të Popullit si një Institucion Kombëtar për të Drejtat e Njeriut. Në lidhje me përgjigjen e kësaj pike, lutemi, referohuni edhe pikës 1.

➤ **Të rrisë angazhimin e tij në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duke rritur bashkëpunimin me organizatat homologe.**

Mbrojtja e interesave të shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është pjesë e punës dhe angazhimit permanent të institucionit të Avokatit të Popullit në rastet kur konstatohen shkelje të të drejtave të njeriut apo kërkohet ndërhyrja e institucionit për të adresuar një problematikë të caktuar. Duke qenë se bëhet fjalë për qytetarë shqiptarë që banojnë jashtë territorit të Shqipërisë, Avokati i Popullit ka kërkuar mbështetjen e institucioneve homologe (Ombudsmanet) për të ndërhyrë pranë institucioneve përkatëse në varësi të problematikave të hasura, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë të privuar nga liria.

Nga aktivitetet e zhvilluara në kuadër të rrjeteve të homologeve tanë në gjithë botën, kemi konstatuar se Ombudsmanët janë mjaft të ndjeshëm në lidhje me shtetasit e tyre që kanë probleme ligjore jashtë vendit të origjinës, ndaj edhe Avokati i Popullit është interesuar për të propozuar mekanizma konkrete veprimi.

Bazuar në nenin 8/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilës: “*Republika e Shqipërisë mbron të drejtat e shtetasve shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm*

jashtë kufijve të vet”, Avokati i Popullit vlerëson se është detyrë e institucioneve shqiptare të interesohen në mënyrë të vazhdueshme edhe për shtetasit shqiptar që ndodhen jashtë territorit në mënyrë të veçantë të qytetarëve shqiptarë të privuar nga liria në shtete të tjera.

Për sa më sipër më datë 14.10.2019, me shkresën nr. 442 prot., Avokati i Popullit znj. Erinda Ballanca u është drejtuar katër Ministrive (më konkretisht: znj. Etilda Gjonaj - Ministër i Drejtësisë, z. Sander Lleshaj – Ministëri Brendshëm, z. Pandeli Majko – Ministër Shteti për Diasporën dhe z. Gentian Cakaj – Ministër në detyrë i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme), me objekt: *Organizimin e një takimi përçështjet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së shtetasve shqiptarë të privuar nga liria në shtete të tjera*.

Në këtë shkresë shprehej nisma e institucionit të Avokatit të Popullit për krijimin e një rrjeti mes këtyre institucioneve për adresimin, diskutimin dhe zgjidhjen e çështjeve të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së shtetasve shqiptarë që ndodhen jashtë vendit tonë. Kjo nisur edhe nga fakti se lëvizja e lirë si dhe kërkimi i mundësive të ligjshme për një jetë më të mirë i shtetasve shqiptarë në shtete të tjera, kanë qenë shpesh histori suksesi që i kanë shërbyer njohjes apo konsolidimit të marrëdhënieve mes shteteve të tjera dhe vendit tonë por për fat të keq ka pasur edhe raste të shtetasve shqiptarë që kanë kryer vepra penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe ndodhen në burgje jashtë vendit.

Për fat të keq me përjashtim të Ministrit të Shtetit për Diasporën z. Majko, mungoi reagimi i tre Ministrive të tjera (nga Ministria e Brendshme pas shumë telefonatash nga ana jonë, u kthye një përgjigje ku në vend të përcaktimit të datës së takimit me titullarët e institucioneve u informuam se për këtë çështje duhet të merrnim kontakt me një specialiste, ndërkohë që nga dy Ministrinë e tjera (për Europën dhe Punët e Jashtme dhe ajo e Drejtësisë) nuk ka patur fare përgjigje (kujtojmë që Ministrinë e Drejtësisë i është nisur edhe një shkresë e dytë në muajin janar 2020 për këtë çështje).

Duke qenë se institucioni ynë e konsideron si mjaft të rëndësishme këtë çështje si dhe duke pasur parasysh faktet që rastet e humbjes së jetës së shtetasve shqiptarë në ambjentet e heqjes së lirisë së shteteve të ndryshme vazhdojnë, Avokati i Popullit do të vazhdojë përpjekjet për realizimin e këtij takimi, me qëllim krijimin e strukturave përkatëse reaguese në raste të tilla.

Pavarësisht sa më sipër, gjatë periudhës raportuese, institucioni i Avokatit të Popullit është angazhuar maksimalisht në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Më konkretisht:

- Pranë institucionit është paraqitur rasti i shtetases M. V., e cila shkruante për rastin e vajzës së saj A. V., e cila ndodhej në një institucion të Ekzekutimit të Vuajtjes së Dënimit në Serbi. Gjatë qëndrimit në burg ajo ishte diagnostikuar me **“Kancer malinj të nyjeve limfatike”**. Për shkak të

sëmundjes por edhe të sjelljes së mirë të saj gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, ajo kërkonte ndihmën e institucionit të Avokatit të Popullit për të ndërmjetësuar me Mbrojtësin e Qytetarëve të Republikës së Serbisë me qëllim bërjen prej tij të kërkesës institucioneve kompetente serbe për të mundësuar faljen e 1/3 së dënimit të vazhës.

Me marrjen në dijeni të kësaj situate Avokati i Popullit iu drejtua zyrtarisht Mbrojtësit të Qytetarëve të Republikës së Serbisë, i cili informoi në lidhje me mundësitë që ekzistonin për të adresuar këtë çështje

- Nisur nga lajmi në median e shkruar mbi vdekjen e shtetasit Shqiptar F.B. në kushtet e mbajtjes në qendrën e mbyllur të emigrantëve në Canet të Marsejës, Francë, lajm i cili ngjalli një reagim të madh publik në Shqipëri, Avokati i Popullit e regjistroi këtë rast me iniciativë dhe i dërgoi zyrtarisht një letër Ombudsmanit francez duke i kërkuar interesimin e tij për ndjekjen e kësaj çështjeje. Në përgjigje të kësaj letre, Ombudsmani francez u përgjigj se rasti është në hetim nga Prokuroria e shtetit francez dhe përfundimi i hetimeve dhe vendimmarrja e prokurorisë do të na vihej në dispozicion. Disa herë është kontaktuar me personat e kontaktit të Ombudsmanit francez por pa një përgjigje përmbyllëse lidhur me çështjen.

- Në institucionin e Avokatit të Popullit është paraqitur ankesa e shtetases L.T, më datë 04.10.2019, ku referon se djali i saj I.T. ka qenë në Zvicër dhe ka kërkuar azil në këtë shtet. Pretendohet se atij i janë cenuar disa të drejta nga organet ligjzbatuese të këtij shteti si e drejta e jetës dhe e drejta e lirisë si dhe që nuk ka pasur asnjë interesim nga ambasadajonë në Zvicër. Kjo çështje është regjistruar dhe po ndiqet nga institucioni i Avokatit të Popullit.

- **Në prill 2019**, pranë institucionit të Avokatit të Popullit është paraqitur ankesa e shtetasit E.N., i cili ankohej ndaj autoriteteve të drejtësisë greke, pasi prej tre vitesh ndodhet në burg për një akuzë të padrejtë që lidhet me vrasjen e shtetasit shqiptar B. T., ngjarje e ndodhur në Igumenicë të Greqisë. Ankuesi pretendonte se shtetasi K.T., kushëri i viktimës i cili ndodhet në burg në IEVP Penale Kosovë Lushnje ka dijeni për ngjarjen dhe për këtë kërkonte ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për të marrë deklaratimet e tij dhe më pas informacioni t'i dërgohej atij në vendin e vuajtjes së dënimit.

Pas regjistrimit të kësaj ankese/kërkese, institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori të gjithë veprimet e nevojshme administrative përmes komunikimeve zyrtare me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, ku nga verifikimet e kryera nga ky institucion rezultonte se në IEVP-të e Shqipërisë nuk kishte person të dënuar sipas gjeneraliteteve të dhëna. Po ashtu nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit u kryen verifikime dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë nga ku u informua se ky institucion nuk ka patur në hetim çështje penale për personin e pretenduar. Në fund të procedurave administrative, institucioni i Avokatit të Popullit i dërgoi ankuesit një informacion sqarues duke e orientuar gjithashtu në lidhje me hapat dhe procedurat ligjore që duhet të ndiqte më tej.

- Në kuadrin e përpjekjeve për çështje të mbrojtjes së të drejtave të shtetasve shqiptarë të privuar nga liria në shtete të tjera, një ndër aktivitetet që institucioni ynë ka ndjekur jashtë vendit gjatë vitit 2019 ka qenë edhe ai në kuadër të një projekti të Këshillit të Europës për krijimin e grupit “Nafplon” (Rome – Itali tetor 2019 - takim në të cilin merrnin pjesë përfaqësues nga Zyra e Këshillit të Europës, Mekanizmat Kombëtarë të luftës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor të mjaft vendeve të Europës, etj.) Ky projekt krijoi një grupim/shokatë të Mekanizmave Kombëtarë të Parandalimit të Torturës, i cili do të monitorojë respektimin e të drejtave të njeriut në rastet e operacioneve të kthimit të detyruar të drejtuar nga Frontex (pra riatdhesimit nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen në vendet e tyre të origjinës).

Po në kuadër të takimit që u mbajt në Romë, Itali në muajin tetor 2019, përfaqësuesit e institucionit tonë vizituan edhe qendrën më të madhe të privimit të lirisë në Romë (Rebibia), ku patën rastin të takoheshin edhe me shtetas shqiptarë që vuanin dënimin në këtë burg dhe u njohën me problematikat e tyre. Një ndër ankesat e tyre kryesore ishte mungesa e interesimit nga autoritetet shqiptare në këtë vend (pra ambasada jonë në Romë) për kërkesa që ata mendonin se ishin në kompetencë të personelit të ambasadës. Si rezultat i moszgjidhjes së problemit, u kërkua edhe ndërhyrja e institucionit tonë pranë strukturave tona diplomatike.

Gjatë takimit të Romës nga ana e përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit u vendosën kontaktet edhe me homologet në Itali (Garante Nazionale Italiane) dhe vetëm një javë më pas, pati një kërkesë për ndihmë nga *Garante delle persone sottoposte a misure restrittive della liberta personale della Regione Piemonte* për një shtetas shqiptar që ishte futur në greve urie në një burg në Torino.

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEX ka vazhduar të monitorojë në mënyrë konstante operacionet e riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllim transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riatdhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT ka qenë pjesë e grupit e rreth 26 operacioneve të riatdhesimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC26 të Parlamentit Europian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta në monitorimin e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës. Pjesëmarrja jonë në këto operacione është realizuar duke përdorur kapacitetet e kufizuara të institucionit pasi, ndonëse kemi kërkuar që të na vihen në dispozicion kapacitete shtesë në nivel ndihmëskomisioneri, Kuvendi nuk e ka mundur një gjë të tillë. Si rezultat nga 44 operacione në të cilat është kërkuar prania e përfaqësuesit të institucionit tonë, ne kemi mundur të marrim pjesë në vetëm rreth 26 prej tyre për mungesë burimesh njerëzore.

Në përfundim të proceseve të monitorimit, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së në takimet e zhvilluara me përfaqësues të FRONTEX dhe të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe të Migracionit

ka sugjeruar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të migrantëve shqiptarë, respektimin rigoroz të standardeve të BE-së si dhe respektimin rigoroz të ligjit shqiptar.

- **Të publikojë rekomandimet e tij dhe t'i adresojë ato pranë institucioneve përgjegjëse dhe Kuvendit të Shqipërisë në kohë dhe të informojë Kuvendin e Shqipërisë mbi ecurinë e zbatimit të tyre.**

Siç jeni në dijeni në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr.134/2018, “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”, institucioni i Avokatit të Popullit ka informuar në mënyrë periodike (në formë elektronike dhe shkresore) Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me rekomandimet që institucioni i Avokatit të Popullit i ka adresuar institucioneve publike si dhe statusin e zbatimit të tyre (dy raportimet e fundit janë bërë me shkresat nr.392, datë 10.09.2019 dhe nr.27, datë 15.01.2020 që i korrespondojnë periudhave maj-gusht dhe shtator-dhjetor 2019). Ndërkohë në kuadër të përditësimit të faqes së re zyrtare të institucionit, vazhdon puna për transferimin e databazës së deritanishme nga faqja e vjetër në atë të re si dhe në sigurimin e hedhjes në kohë reale të rekomandimeve (tekstin e plotë të tyre) në website, çka do të mundësojë një aksesueshmëri të tyre nga çdo qytetar apo subjekt i interesuar, duke respektuar rregullat e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

- **Të ndjekë shkallën e zbatimit të rekomandimeve, arsyet pse rekomandimet nuk janë përmbushur ose nuk janë pranuar dhe të informojë institucionet përgjegjëse dhe Kuvendin e Shqipërisë për masat që duhet të marrë.**

Lutemi, referojuni informacionit të dhënë në pikën 5.1 të Kreut V, *Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së*.

- **Të krijojë dhe të bëjë publik, jo më vonë se 6-muaj nga data e miratimit të kësaj rezolute, një regjistër me ankesat/kërkesat e marra nga institucioni si dhe të deklarojë statusin e tyre, duke respektuar rregullat e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.**

Në lidhje me këtë pikë të rezolutës, ju informojmë se institucioni duke nisur nga muaji shtator 2019 ka përgatitur një regjistër me ankesat/kërkesat e marra nga qytetarët, ku përfshihet edhe statusi i trajtimit të tyre, regjistër i cili është publik dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article/transparency>

KREU III

Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike

3.1 Të drejtat e personave të privuar nga liria

Gjatë vitit 2019 janë paraqitur gjithsej 212 ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të burgosurve nga të cilat për 113 është përfunduar hetimi administrative dhe 99 janë ende në shqyrtim. Nga rastet e përfunduara 75 kanë rezultuar të pabazuara në ligj, 30 janë zgjidhur në favor të ankuesit gjatë shqyrtimit, 4 kanë rezultuar jashtë kompetence dhe 4 kanë përfunduar me rekomandim përgjithësues drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe dy institucioneve shëndetësore jashtë sistemit të burgjeve. Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar për shqyrtim me iniciativë disa raste të bërë publike në media që kanë të bëjnë me ngjarje të ndodhura në burgje si dhe ka vijuar hetimin për ankesat e mbartura nga vitet e kaluara.

Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me: cilësinë e shërbimit shëndetësor; refuzimin e kërkesës për të përfituar leje shpërblyese; zvarritjen e procedurës për të shkuar me leje shpërblyese; zvarritjen e procedurës për t'u transferuar në një IEVP tjetër; transferimin e padrejtë në një IEVP tjetër; pretendimet për ushtrim dhune fizike, psikologjike dhe keqtrajtim; dhënia e padrejtë e masës disiplinore etj.

Problematikat që dalin nga shqyrtimi i ankesave

Ankesat që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit shëndetësor vazhdojnë të zenë numrin më të madh të ankesave të paraqitura nga të burgosurit apo familjarë të tyre. Shërbimi shëndetësor në IEVP-të duhet të sigurojë diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve me medikamente. Nga ana jonë është vlerësuar se, arsyeja kryesore e mos ofrimit në kohë dhe me cilësi të shërbimit shëndetësor është mungesa e stafit shëndetësor, kryesisht mjekë. Organika e stafit shëndetësor në IEVP-të është e paplotësuar për shkak të largimeve të mjekëve/infermierëve dhe vështirësisë për të gjetur zëvendësues. Disa mjekë që i përgjigjen kërkesës për vendet vakante, pranojnë të punojnë në burgje vetëm me kohë të pjesshme. Shkaku i identifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për këtë mungesë interesi është vështirësia e punës në burgje dhe paga e ulët e personelit mjekësor, më e ulët se e kolegëve që punojnë në spitalet publike. Për këtë arsye është kërkuar rritja e pagave të mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve në sistemin e burgjeve, kërkesë që ka gjetur mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, e cila i ka kërkuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rritjen e kategorisë së pagave të stafit mjekësor në sistemin e burgjeve. Institucioni i Avokatit të Popullit është interesuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për t'u informuar nëse kjo ministri kishte vlerësuar dhe paraqitur mendim lidhur me kërkesën për rritjen e pagave të stafit mjekësor në burgje. Interesimi ynë nuk mori një përgjigje të drejtpërdrejtë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë është shprehur se është Këshilli i Ministrave që miraton drejtimin kryesor të

politikës së përgjithshme shtetërore dhe në bazë të saj, i propozon Kuvendit ligjin e buxhetit vjetor. Aktualisht jemi duke pritur një përgjigje nga Këshilli i Ministrave lidhur me rritjen e pagave të stafit mjekësor në burgje.

Pavarësisht rekomandimeve të bëra në vite nga ana jonë, konstatojmë se ende nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave për të cilët gjykata ka dhënë masë mjekësore “*mjekim të detyruar*”. Në përgjigjen e fundit që kemi marrë nga DPB jemi vënë në dijeni se, po përshtaten dy godina në IEVP Lezhë për të vendosur aty të burgosurit me probleme të shëndetit mendor që mbahen aktualisht në IEVP Krujë; në përfundim të rikostruksionit, këto mjedise do të funksionojnë si institucion i posaçëm mjekësor dhe do të kalojnë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Transferimi i të sëmurëve mendorë nga IEVP Krujë në IEVP Lezhë ishte parashikuar të kryhej në muajin nëntor 2018 por deri më sot nuk është kryer. Ne jemi interesuar në Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me organizimin e dy godinave që pritej t’i kalonin në varësi. Në përgjigjen e dt. 25.01.2019, Ministria e Shëndetësisë shprehet se, ishte duke u finalizuar projekt VKM “*Për përcaktimin e mënyrës dhe rregullave për ngritjen dhe funksionimin e Institutit Mjekësor të Posaçëm dhe për masat e sigurisë për ruajtjen e tyre*” dhe se pas miratimit të VKM-s, një grup pune i përbashkët me përfaqësues të MSHMS dhe Ministrisë së Drejtësisë do të fillonin punën për hartimin e paketës së akteve rregullatore. Ndërsa në përgjigjen e dt.31.07.2019, Ministria e Shëndetësisë shprehet se, projekt-akti në fjalë është në diskutim brenda institucionit për shkak të efekteve të konsiderueshme financiare që parashikohet të japë zbatimi i tij. Kujtojmë se, Shqipëria u dënua me 15 mijë euro dëmshpërblim dhe 2,500 euro kosto gjyqësore nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut për atë që gjykata e quajti trajtim çnjerëzor dhe degradues dhe heqje e paligjshme e lirisë për shtetasin A.Strazimiri të cilin, gjykatat shqiptare e kanë mbajtur me mjekim të detyruar në spitalin e burgut në Tiranë në mungesë të një spitali të posaçëm për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor për të cilët gjykatat urdhërojnë mjekim të detyruar.

Një numër i konsiderueshëm ankesash kanë ardhur nga të dënuarit edhe sa i përket refuzimit të kërkesave për *dhënien e lejeve shpërblyese* nga Drejtorët e IEVP-ve ku vuanin dënimin penal me burgim, ndonëse i plotësonin kriteret ligjore për dhënien e saj. Nga përmbajtja e dispozitave të akteve normative që parashikojnë dhe rregullojnë këtë të drejtë rezulton se, leja shpërblyese është parashikuar si një drejtë e cila u jepet të dënuarve të cilët plotësojnë kriteret ligjore të afatit të shlyerjes së masës së dënimit penal me burgim që kanë sjellje korrekte në IEVP-të dhe janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegritimit si dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Pra kjo e drejtë ligjore është një stimul i cili nxit dhe i motivon të dënuarit që të respektojnë rregullat dhe të bëjnë përpjekje për t’u rehabilituar dhe riintegruar në shoqëri pasi të përfundojnë dënimin e dhënë nga organet gjyqësore. Ndërkohë dhënia e lejes shpërblyese u jep mundësi përfituesve të saj të hyjnë në kontakt të prekshëm dhe më të gjerë me botën jashtë burgut duke u përgatitur për riintegrimin e tyre në të ardhmen.

Edhe në pjesën e raportit të Komitetit European për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) të vitit 2019 që ka të bëjë me IEVP-të, shkronja E, “Kontakti me

botën e jashtme’’, pika 2, theksohet rëndësia që kanë takimet me familjen dhe të afërmit për rehabilitimin e të dënuarve.

Sipas akteve normative në fuqi, autoriteti përgjegjës dhe kompetent për dhënien e lejeve shpërblyese dhe të veçanta për të dënuarit që kryejnë dënimin në seksionet e sigurisë së zakonshme është Drejtori i IEVP-së.

Nga përgjigjet dhe dokumentat shoqëruese të dërguara nga IEVP-të lidhur me këtë problem konstatuam disa shkelje si më poshtë:

- a. Qëndrimi i mbajtur nga ana Drejtorëve të IEVP-ve duke i refuzuar lejen shpërblyese të dënuarve në ato raste kur nga organet vendore të Policisë së Shtetit nuk është dhënë mendimi apo sugjerimi për dhënien ose jo të lejes shpërblyese atyre, ose nuk është dhënë mendimi nëse ata do të kthehen ose jo në vendet e vuajtjes së dënimit pas lejes nuk është në përputhje me aktet normative në fuqi.
- b. Aktmarrëveshja e bashkëpunimit e lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk është akt nënligjor (burim i së drejtës) dhe nuk mund të krijojë apo të vendosë kritere për dhënien e lejeve shpërblyese personave të dënuar, përtej atyre që janë parashikuar në aktet normative. Për rrjedhojë për deri sa sugjerimi i organeve të policisë për dhënien apo mos dhënien e lejes të dënuarit dhe dërgimi i informacionit se i dënuari mund të mos kthehet në vendin e vuajtjes së dënimit nuk janë të parashikuara si kritere ligjore, ato nuk duhet të kërkohen nga ana e IEVP-ve organeve vendore të Policisë së Shtetit.
- c. Bordit të Monitorimit nuk i janë dhënë apo deleguar kompetenca vendimmarrëse për dhënien ose jo të lejeve shpërblyese ose të veçanta si dhe për të bërë verifikime lidhur me plotësimin apo jo të kritereve ligjore për dhënien e lejeve. Për rrjedhojë ai nuk duhet t’i ushtrojë ato.

Për sa më sipër dhe me qëllim respektimin e të drejtave të të dënuarve me burgim të sanksionuara me ligj i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve si më poshtë:

1. Marrjen e masave të nevojshme tekniko-organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për respektimin e të drejtës ligjore të dhënies së lejes shpërblyese të dënuarve që plotësojnë kriteret ligjore nga IEVP-të në të gjithë vendin.
2. Përgatitjen e një kërkesë tip nga DPB që IEVP-të i dërgojnë organeve vendore të Policisë së Shtetit për kërkimin e informacionit për të dënuarit që kanë kërkuar leje shpërblyese duke iu përmbajtur vetëm kritereve ligjore.
3. Mos kryerjen e veprimeve nga ana e Bordit të Monitorimit përtej asaj të parashikuar në nenin 50/4 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve për mbikqyrjen e planifikimit të lejeve shpërblyese të bërë nga IEVP-të sipas grafikut të përcaktuar që në fillim të vitit dhe koordinim e tyre në shkallë vendi.
4. Marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur kthimin e përgjigjeve me shkrim si dhe brenda afatit ligjor të kërkesave të të dënuarve për leje shpërblyese nga IEVP-të.

5. Mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen, duke cënuar respektimin e kësaj të drejtë ligjore të të dënuarve nëpërmjet shtimit në mënyrë arbitrare të kriterëve për përfimin e lejeve shpërblyese tej atyre të parashikuara nga aktet normative në fuqi.

Ndonëse afati ligjor i kthimit të përgjigjes së rekomandimit ka kaluar, ajo nuk na është dërguar ende.

Një nga të drejtat që gëzojnë të paraburgosurit/të dënuarit është dhe e *drejta për të punuar*. Punët që ofrohen në varësi dhe të organikës, zakonisht janë ato të ndihmësit në kuzhinë, pastruesit të mjediseve të përbashkëta dhe ato të mirëmbajtjes. Punësimi në burg është një kontribut i rëndësishëm në rehabilitimin e të burgosurve dhe në përgatitjen e tyre për t'u integruar në shoqëri. Legjislacioni i vendit tonë parashikon që puna e të burgosurve duhet të shpërblehet por kjo e drejtë e tyre vazhdon të mos zbatohet për shkak të mos nxjerrjes së akteve nënligjore. Në lidhje me shpërblimin e punës të të paraburgosurve dhe të dënuarve që në vitin 2013 i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i aktit nënligjor për përcaktimin e kriterëve të shpërblimit të punës dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. Aktualisht ky rekomandim nuk është zbatuar dhe puna e tyre vazhdon të mospaguhet. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në informacionin e datës 22.10.2019 më në fund na ka vënë në dijeni se është në proces hartimi projekt VKM “Për nxitjen dhe shpërblimin e punës së të burgosurve”.

Keqtrajtimi, ushtrimi i dhunës fizike dhe psikologjike konsiderohen shkeljet më të rënda që mund të kryhen ndaj personave të privuar nga liria. Këto veprime shkatërrojnë personalitetin dhe dinjitetin e viktimës. Pasojat psikologjike dhe fizike të dhunës janë nga më shkatërrueset dhe nga më të vështirat për t'u rehabilituar. Për këtë arsye, ankesat për *ushtrim dhune* nga ana e punonjësve të Policisë së Burgjeve janë shqyrtuar me përparësi nga Institucioni i Avokatit të Popullit duke u përpjekur për të vepruar në një afat kohor sa më të shpejtë dhe me sa më efikasitet. Nga ana tjetër, pretendimet për ushtrim dhune, veçanërisht të dhunës psikologjike nuk janë të lehta praktikisht për t'u provuar. Në disa raste të burgosurit kanë cënuar rendin dhe sigurinë në burg dhe stafi policor për të rikthyer normalitetin ka ushtruar forcë, e cila në përfundim të hetimit vlerësohet nëse ka qenë e justifikuar apo është tejkaluar. Hetimi ynë ka synuar kryesisht parandalimin e dhunës. Për këtë arsye duhet të kuptohen shkaqet që kanë çuar në veprime të dhunshme qoftë nga të burgosurit qoftë nga stafi policor dhe masat që mund të merren për të parandaluar përsëritjen e situatës. Mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në IEVP, përveç atyre mjediseve ku cënohet privatësia është vlerësuar në vijimësi nga ana jonë si një proces thelbësor për arsye se mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm të masave që duhet të merren.

Në përfundim të hetimit të dy pretendimeve për ushtrim dhune fizike kemi konstatuar se mjediset ku kanë ndodhur ngjarjet nuk monitoroheshin plotësisht me kamera dhe regjistrimi i pamjeve kishte probleme. Gjithashtu është konstatuar se ngjarjet nuk janë dokumentuar në kohë dhe me hollësi në regjistrat e IEVP-së. Si edhe është relatuar më lart në këtë raport në datën 17.09.2019,

Komiteti European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtërues (CPT) ka bërë publik raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018. Në pjesën e raportit që ka të bëjë me IEVP-të, shkronja C, pika 4, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për stafin shëndetësor në lidhje me dokumentimin e gjendjes shëndetësore të të dënuarve por edhe të dëmtimeve trupore dhe raportimin e rasteve të dhunës që sipas CPT-së nuk janë të hollësishme, pa përfundime e duhen përmirësuar.

Në fokus të punës së institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë *dhe kërkesë/ankesat e stafit të administratës së IEVP-ve*. Ne çmojmë se përmirësimi i kushteve të punës për stafin e IEVP-ve si dhe garantimi i të drejtave të punonjësve ndikojnë në një qasje më pozitive në mënyrën e trajtimit të të burgosurve. Për të siguruar një administrim të mirë të IEVP-vë duhet të tregohet kujdes në rekrutimin e personelit. Paga e tyre duhet të jetë e kënaqshme për të tërhequr interesin e personave të duhur; kushtet e punës dhe kompensimet ekonomike duhet të jenë të përshtatëshme me vështirësinë që paraqet puna në këto institucione. Gjatë vitit 2019 jemi interesuar sërish në Ministrinë e Drejtësisë për t'u informuar nëse është propozuar për miratim projekt VKM-ja që përcakton rregullat për garantimin e transportit falas të punonjësve të policisë të cilët janë të punësuar në IEVP-të që ndodhen larg qendrave të banimit. Në përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë thuhet se "... Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka akorduar fond për të garantuar transportin e punonjësve të policisë në tre IEVP dhe është nxjerrë një udhëzim ku përcaktohet se punonjësit e policisë së burgjeve nuk mund të transferohen më larg se 45 km nga vendbanimi...". Disa punonjës të policisë së burgjeve të komanduar me detyrë në IEVP "Jordan Misja", Tiranë kanë pretenduar se kostoja e transportit përballohet nga vetë ata dhe se ky shpenzim nuk mbulohet nga punëdhënësi. Aktualisht hetimi nuk ka përfunduar për të kuptuar nëse të drejtat e përcaktuara zbatohen realisht në praktikë. Ne vlerësojmë se mungesa e kushteve ka çuar në mungesa të mëdha të stafit që ulin sigurinë në sistemin e burgjeve e ndaj kjo problematikë duhet adresuar në mënyrë urgjente.

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e dhunës dhe trajtimit çnjerëzor, mbetet i angazhuar fuqimisht për garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria për edhe për garantimin e përmbushjes së standardeve ndërkombetare sipas interpretimit të CPT dhe SPT.

3.2 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit⁵

Gjatë vitit 2019 në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar 145 ankesa për shkelje të të drejtave nga strukturat ose punonjësit e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit. Konstatojmë se numri i ankesave ndaj këtyre organeve në vitin 2019 është pothuajse i njëjtë me numrin e ankesave të administruara në vitin 2018 që ishte 146.

Objekti i ankesave ka qenë i larmishëm sikurse mund të përmendim: për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje në organet e policisë;

⁵ Për më shumë për këtë temë shikoni Kreun IV, pika 4.2 *E drejta e tubimeve*

për trajtim jo human e dinjitoz në mjediset e organeve të policisë ku mbahen, ruhen dhe trajtohen të shoqëruarit ose të arrestuarit/ndaluarit; për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre; për pengim të ushtrimit të të drejtës kushtetuese të tubimeve; për dëmtim të shëndetit të qytetarëve nga gazi lotësja i hedhur gjatë tubimeve; për mos dhënien apo revokimin e autorizimit për blerje/mbajtje të armëve të gjahut; për mos mbështetje me punonjës të policisë të përmbaruesve gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; për vendosje të masave administrative të padrejta; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për bllokim sendesh personale; për sigurimin e jetës; për pengim të daljes lirisht jashtë shtetit; për mos dhënie informacioni; për skualifikim të padrejtë për të vazhduar Akademinë e Sigurisë; për dhënie të përgjigjeve negative nga organet e policisë ndaj të dënuarve të cilët kanë kërkuar nga IEVP-të përfitimin e të drejtës për leje shpërblyese; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri; për cenim të të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit, etj.

Gjatë shqyrtimit të ankesave të administruara nga institucioni i Avokatit të Popullit në rastet për të cilat janë provuar shkelje të të drejtave ligjore të shtetasve kemi konstatuar se disa nga shkaqet e kryerjes së këtyre shkeljeve nga punonjësit e policisë janë mos njohja e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit si dhe neglizhenca për zbatimin e dispozitave ligjore dhe për përmbushjen e rregullt të detyrës dhe misionit ligjor por edhe veprimet haptas në shkelje të ligjit. Gjithashtu një shkak tjetër është edhe mungesa e kontrollit nga strukturat eprorë të organeve vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit.

Duhet të mbajmë në konsideratë faktin se, shkeljet dhe cenimet e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve të kryera nëpërmjet veprimeve ose mos veprimeve të punonjësve apo strukturave të caktuara të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ndikojnë drejtpërdrejtë në cenimin e imazhit të këtyre organeve në publik dhe për rrjedhojë çënojnë rëndë besimin e publikut tek ato.

Për këto raste nga institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë disa deklarata publike por edhe rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente për marrjen e masave të nevojshme penale, administrative dhe organizative me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura, ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen. Disa nga të drejtat kushtetuese dhe ligjore për të cilat janë bërë rekomandime mund të përmendim:

E drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet

Në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar disa ankesa të bëra nga shtetas të cilët pretendonin për sjellje jo korrekte të punonjësve të policisë në rastet e shoqërimit, pyetjes apo arrestimit/ndalimit të tyre nga policia si autorë të dyshuar të veprave penale, gjatë tubimeve të ndryshme të organizuara nga partitë opozitare apo grupime të ndryshme qytetarësh, ose gjatë kontrolleve rutinë që bën policia në lokale apo mjedise të tjera në kuadër të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike. Ndërkohë nga Avokati i Popullit janë filluar dhe regjistruar me nismën e vet disa raste të bëra publike të cilat bënin fjalë për dhunimin fizik apo psikologjik të shtetasve nga

punonjësit e policisë. Të gjitha situatat e komunikimit të punonjësve të policisë pa etikë dhe të ushtrimit të dhunës fizike apo psikologjike janë vlerësuar me përparësi sepse ato çenojnë rëndë imazhin e organeve të Policisë së Shtetit si dhe dëmtojnë e trondisin thellë besimin e publikut tek këto organe. Ndërsa në disa raste ato përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të shtetasve dhe përmbajnë elementët e veprave penale të kryerjes së veprimeve arbitrare dhe të torturës. Në rastet kur pas shqyrtimit të ankesave të administruara janë provuar pretendimet e ankuesve janë përpiluar rekomandime drejtuar institucioneve kompetente si organit të prokurorisë për fillimin e hetimeve ndaj autorëve të tyre, ose strukturave të Policisë së Shtetit për fillimin e procedimeve disiplinore kur shkeljet kanë qënë më të lehta ose në rastet kur për të njëjtat shkelje ligjore nga organi i prokurorisë është filluar procedimi penal.

Lidhur me këtë problematikë shqetësuese e vlerësojmë të nevojshme që të evidentojmë disa gjetje e konstatime të bëra nga Komiteti European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtërues por që kanë qënë gjetje edhe të institucionit tone në vijimësi. Në pjesën e raportit që ka të bëjë me Policinë e Shtetit, shkronja “A”, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar në organet e Policisë. Në pikën 14 të tij shprehet se është thelbësore të sigurohet që punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjës të policisë. Në veçanti, duhet t’u sillen në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat.

Oficerët e policisë duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është nevojshme dhe se ajo mund të përdoret vetëm në rast të kapjes së një personi. Pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme.

Në pikën 15 përshkruhet se, përbërës thelbësor i çdo strategjie për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një denoncimi për keqtrajtim, personat e cenuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Këto hetime duhet të kryhen shpejt të jenë të plota e gjithëpërfshirëse.

Një rast të filluar me nismën e Avokatit të Popullit, pas bërjes publike nga media të protestës së ndodhur në datën 28.06.2019 në Bashkinë e Dibrës, para zgjedhjeve vendore të datës 30.06.2019⁶ nga hetimi administrativ rezultoi se nga punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit ishin kryer një sërë shkeljesh ligjore si më poshtë:

- a. Shoqërimi i një numri personash në orët e natës duke filluar nga ora 03:00 jashtë kushteve të flagrancës dhe kur ata ishin larguar për në banesat e tyre;
- b. Dhunimi fizik e psikologjik i të shoqëruarve;
- c. Mbajtja për 9 orë e tyre në ambientet e shoqërimit pa akt dhe përpilimi i procesverbaleve të arrestimit në flagrancë pas kësaj periudhe kohore;
- ç. Mosdhënia e ndihmës mjekësore menjëherë të të dëmtuarve nga dhuna e ushtruar;
- d. Ndërhyrja në banesa pa akt të motivuar dhe për më tepër me iniciativë nga punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit;
- dh. Shoqërimi dhe arrestimi i dy personave për të cilët nga organi i prokurorisë nuk ishte konstatuar që të kishin qënë në protestë;
- e. Atribuimi i 6 fakteve penale, ndërkohë që organi i prokurorisë ka regjistruar procedimin penal vetëm për 3 akuza;
- ë. Dërgimi i akteve nga Komisariati i Policisë Dibër në organin e prokurorisë ishte bërë në datën 30.06.2019, me gati 30 orë vonesë;
- f. Mos shoqërimi i të arrestuarve në gjykatë për vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurisë në datën 01.07.2019, duke e refuzuar kërkesën e gjykatës;
- g. Mos njoftimi i prokurorisë dhe kryerja me iniciativë e veprimeve me të arrestuarit;
- gj. Mbajtja pa dijeninë e organit procedues të 26 personave në kërkim policor dhe pa masa sigurie personale.

Për sa më sipër vlerësuam se, veprimet e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit përmbanin elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, sepse kishin cënuar rëndë integritetin fizik të disa shtetasve të arrestuar të garantuar nga neni 25 i Kushtetutës, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, ligji nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti i rekomandua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, *fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit që kanë shkuar në ndihmë të DVP Dibër për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal të ndryshuar si dhe ndaj drejtuesit të Komisarariatit të Policisë Dibër për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal të ndryshuar.*

⁶Lajmi bërë publik bënte fjalë se një grup personash kishin tentuar të futeshin me forcë në ambientet e Shkollës së Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti” të qytetit të Peshkopisë ku ndodhej Komisioni Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve nr. 19 Dibër (KZAZ nr. 19 Dibër) për të shkatërruar materialet zgjedhore. Gjatë veprimeve të kryera nga punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit në orët e para të datës 29.06.2019, kur janë marrë nga banesat e tyre, shoqëruar dhe arrestuar, pretendohet për dhunim fizik të disa personave.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër u informuam se rekomandimi ynë është pranuar.

Dy raste të tjera të shqyrtuara dhe që janë vlerësuar nga ana jonë për sjellje jo profesionale e korrekte janë si më poshtë:

Rasti i ankesave të studentëve të Fakultetit Ekonomik E.K. dhe K.D. ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë për dhunim fizik nëpërmjet kapjes e përdredhjes së dorës së djathtë, dëmtim i konfirmuar dhe nga akti i ekspertimit mjekoligjor të shtetasës E.K.

Rasti i ankesës së shtetasit M.F. për ushtrim dhune fizike ndaj tij duke i shkaktuar dëmtime tek kavalja e këmbës së djathtë dhe djalit E.F. nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 1 Tiranë gjatë arrestimit në flagrancë të tyre për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” gjatë tubimit tek Unaza e Re Tiranë.

Meqënëse për të dy këto raste ishte filluar hetimi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i rekomanduam Komisarariatit të Policisë nr. 1 Tiranë, *përmirësimin e punës për rritjen e përgjegjësisë nga punonjësit e Policisë së Shtetit me qëllim sjelljen korrekte dhe profesionale ndaj protestuesve studentë apo qytetarëve të organizuar në protesta paqësore*. Nga përgjigjia e dërguar nga Komisarati i Policisë nr. 1 Tiranë rezultoi se rekomandimet u mirëpritën dhe u pranuan.

Evident është dhe rasti i bërjes publik në media të dhunimit të shtetasit F.H. nga punonjësit e Policisë së Shtetit pas kapjes dhe gjatë shoqërimit të tij nga banesa për në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë në orët e mbrëmjes, pas protestës së datës 16.02.2019⁷. Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti, filluar me nismën e vet nga Avokati i Popullit arritëm në konkluzionin se, gjatë veprimeve për arrestimin dhe shoqërimin e shtetasit F.H. nga disa punonjës të policisë janë konsumuar elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal të ndryshuar.

Gjithashtu nga disa punonjës të tjerë të policisë janë konsumuar elementët e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”. Ata ndonëse kanë parë që një koleg i tyre ka kryer një krim, “Kryerjen e veprimeve arbitrare” ndaj të shoqëruarit F.H., duke e goditur atë me pëllëmbë në trup nuk kanë bërë kallëzim në organet kompetente.

Ndërkohë për këtë rast vlerësuam se kontrolli i ushtruar në njërin prej banesave të shtetasit F.H. është i kundërligjshëm sepse është kryer jashtë afatit ligjor dhe jo në kushtet e flagrancës.

Për të rivendosur në vend të drejtat e shkelura shtetasit F.H. i rekomanduam Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës ë Parë Tiranë, *fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë të Sektorit të Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Kërkimit të DVP Tiranë dhe të DPPSH për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit*

⁷ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim>

Penal si dhe ndaj punonjësve të policisë të Sektorit të Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Kërkimit të DVP Tiranë dhe të DPPSH dhe të punonjësve të policisë të Forcës së Posaçme “Shqiponja” të DVP Tiranë për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal të ndryshuar.

Ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjes së rekomandimit ka kaluar, ajo nuk na ka ardhur ende.

Përveç sa më sipër nga intervistimi i bashkëshortes së shtetasit F.H., shtetases F.H. identifikua disa problematika në veprimet e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë ushtrimit të detyrës për arrestimin e shtetasit F.H. në praninë e fëmijëve, përmes ushtrimit eventual të forcës së panevojshme dhe jo në mënyrë proporcionale për arritjen e qëllimit të veprimit policor dhe pa marrë në konsideratë dëmtimet në zhvillimin e shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social që mund t’u passjellin fëmijëve këto veprime⁸.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor, i rekomandoi Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si më poshtë:

- 1. Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen dhe miratimin e një procedure standarde për veprimet procedurale që duhet të kryejnë punonjësit e Policisë së Shtetit në rastet kur janë të pranishëm fëmijët.*
- 2. Përfshirjen në përbërje të grupit të punës të organizuar në të tilla raste edhe të një psikologu apo sociologu për të asistuar fëmijët gjatë veprimeve që do të kryejnë punonjësit e policisë në ambientet ku janë të pranishëm ata.*

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na vuri në dijeni se rekomandimi ishte mirëpritur dhe se ishte ngritur grupi i punës për hartimin e procedurës standarde.

E drejta kushtetuese e shtetasve për informim

E drejta e informimit, e cila është një nga të drejtat themelore të njeriut nuk respektohet në masën e duhur nga organet e Policisë së Shtetit. Nga shqyrtimi i disa rasteve të paraqitura në institucionin tonë kemi konstatuar se shkaqet për mos respektim të kësaj të drejte janë mos njohja në nivelin e duhur të akteve normative në fuqi të cilat parashikojnë dhe rregullojnë realizimin e saj, mos kuptimi i frymës së akteve normative dhe i përmbajtjes së tyre si dhe i kujdesit të tepruar për të ruajtur “sekretin” për disa dokumente që për inerci, formalitet dhe mentalitet të së kaluarës janë klasifikuar si të tilla, “sekrete”. Për më tepër ka edhe drejtues të strukturave vendore që nuk reagojnë edhe pasi u sqarohet dhe rekomandohet në mënyrë të qartë e shteruese baza ligjore që rregullon të drejtën e informimit.

Një nga rastet që institucioni i Avokatit të Popullit ka shqyrtuar lidhur me shkeljen e të drejtës kushtetuese të informimit është ankesa e bërë nga shtetasi O.M. Ndonëse kishte dhënë kontribut

⁸ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim>

për zbulimin dhe kapjen e autorëve të një vrasje, kontribut për të cilin ai ishte shpërblyer, organi kompetent i policies (DVP Durrës) nuk i kishte dhënë kopje të dokumentit të shpërblimit, ndonëse kishin kaluar disa muaj nga depozitimi i kërkesës.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese vlerësuam se pretendimet e ankuesit ishin të drejta dhe të bazuara në ligj, sepse atij i ishte cënua e drejta themelore kushtetuese e informimit. Për sa më sipër, i rekomandua DVP Durrës, *marrjen e masave për dhënien e kërkesës O.M. të kopjes së njëhësuar të dokumentit për shpërblimin financiar nga Fondi i Veçantë i Policisë së Shtetit për kontributin e dhënë organeve të Policisë për zbulimin dhe identifikimin e autorëve të vrasjes.*

Por rekomandimi nuk u mirëprit me arsyetimin se “Deftesa e Pagimit” është kopje e vetme dhe nuk mund të riprodhohet, pasi është e klasifikuar “Tepër Sekret”. Rekomandimi u ridërgua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në cilësinë e organit epror të DVP Durrës.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit na vuri në dijeni se e kishte mirëpritur dhe pranuar rekomandimin. Ndërkohë u bë e mundur dhënia e një dokumenti nga DVP Durrës që provonte faktin e pretenduar nga ankuesi për kontributin e dhënë prej tij për rastin në fjalë.

E drejta kushtetuese e shtetasve për arsim (aplikantët për punonjës të policisë)

E drejta e shtetasve për arsim është një nga të drejtat themelore e garantuar nga neni 57/1⁹ i Kushtetutës. Gjatë vitit 2019 janë administruar disa ankesa të shtetasve të cilët pretendonin se ishin skualifikuar padrejtësisht nga Akademia e Sigurisë ndonëse kishin rezultuar fitues në konkurimin e zhvilluar nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Një nga rastet e trajtuara që lidhet me këtë të drejtë është ai i shtetasit L.J. që kishte konkuruar për në Shkollën Bazë të Policisë. Pas bërjes së testit shëndetësor e kishin skualifikuar, duke i thënë se kishte rezultuar me “Hepatit B”. Ankuesi pretendonte se, skualifikimi i tij i bëre për këtë arsye ishte i padrejtë dhe përbente diskriminim.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese vlerësuam se, skualifikimi i shtetasit L.J. ishte bëre nga Komisioni për Kontrollin Shëndetësor për mos plotësim të kriterëve shëndetësorë, parashikuar në Procedurën Standarde për Pranimin në Akademinë e Sigurisë. Por në këtë akt nuk parashikohej një organ epror për të shqyrtuar ankesat ndaj vendimit të Kontrollit të Kontrollit Shëndetësor, duke mos u dhënë në këtë mënyrë aplikantëve mundësinë e ushtrimit të të drejtës së ankimit.

Në përfundim të hetimit administrativ, i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit si më poshtë:

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së Procedurës Standarde “Për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të

⁹Kushdo ka të drejtën për arsimim.

dokumentacionit, verifikimit dhe ankimit të aplikantëve”, miratuar me urdhrin nr. 984, datë 17.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke parashikuar të drejtën e aplikantëve për në Akademinë e Sigurisë që të bëjnë ankim në Komisionin Shëndetësor Epror ndaj vendimit të Komisionit të Kontrollit Shëndetësor.

2. Marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin dhe përmirësimin e praktikës aktuale lidhur me vendimet e skualifikimit të aplikantëve për Akademinë e Sigurisë duke i bërë ato në përputhje me kërkesat e nenin 99/2/c/iii “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit na vuri në dijeni se e kishte mirëpritur rekomandimin dhe për zbatimin e tij kishte ngritur një grup pune me qëllim përmirësimin e Procedurës Standarde “Për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit, verifikimit dhe ankimit të aplikantëve”.

Të drejtat kushtetuese ekonomike dhe sociale të të punësuarve në organet e policisë

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë këtij viti ka administruar dhe shqyrtuar edhe disa ankesa që lidhen me cenimin e të drejtave ekonomike dhe sociale të të punësuarve, konkretisht të punonjësve të Policisë së Shtetit të garantuara nga neni 49/2¹⁰ i Kushtetutës dhe ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Sjellim në vëmendje se në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit, punonjësit e Policisë së Shtetit nuk kanë qenë vetëm subjekte ndaj të cilëve janë bërë ankesa por edhe subjekte që gëzojnë të drejtën ligjore t’i drejtohen atij kur iu shkelen të drejtat dhe interesat ligjore nga organet e administratës publike duke përfshirë edhe vetë Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme. Ankesat e punonjësve të administratës publike, duke përfshirë edhe ata të Policisë së Shtetit janë vlerësuar dhe do të vlerësohen me prioritet dhe përkushtim nga ana jonë. Ne çmojmë se, përmbushja e detyrimeve të shtetit në cilësinë e punëdhënësit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes shoqërore në punë të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës dhe i të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit të garantuara nga ligji organik, Kodi i Punës dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të kësaj strukture do të sjellë me siguri motivimin dhe përkushtimin e tyre në kryerjen e misionit ligjor të Policisë së Shtetit.

Një nga rastet e shqyrtuara është ai i filluar me nismën e Avokatit të Popullit pas bërjes publike në media të letrës me disa kërkesa të bërë nga Kryetari i Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit drejtuar Kryeministrit. Në këtë letër ngriheshin disa probleme që shqetësojnë këtë organizatë dhe që lidhen me mosrespektimin e të drejtave të anëtarëve të saj.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti arritën në konkluzionin se punonjësve të Policisë së Shtetit iu ishin cenuar disa të drejta të garantuar nga ligji organik dhe aktet e tjera nënligjore. Për të bërë

¹⁰ Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore në punë.

të mundur rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura i rekomandua Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Brendshëm si më poshtë:

1. Marrjen e menjëhershme të masave organizative për të bërë të mundur përfundimin nga strukturat përkatëse të projektvendimeve të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe miratimin e tyre nga Këshilli i Ministrave.
2. Marrjen e menjëhershme të masave organizative për të bërë të mundur përfundimin nga strukturat përkatëse të projektligjit “Për trajtimin financiar me pension shërbimi të punonjësve të Policisë së Shtetit që ndërpresin marrëdhëniet e punës” dhe dërgimin e tij për miratim në Kuvend.
3. Marrjen e menjëhershme të masave të nevojshme për sigurimin e fondeve buxhetore për të bërë të mundur likuidimin e pagesave për orët suplementare dhe shpenzimet e udhëtimit të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit për gjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019 si dhe për kompesimin për ushqim të punonjësve të policisë në zbatim të VKM nr. 68, datë 07.02.2018 “Për kufijt dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”.
4. Marrjen e masave të nevojshme për realizimin me sukses të procedurave të prokurimit për uniformat e punonjësve të Policisë së Shtetit.
5. Marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur dakordësimin për një marrëveshje ndërmjet palëve (DPPSH dhe Sindikatës së punonjësve të Policisë së Shtetit) dhe hartimin e një Kontrate Kolektive të re.
6. Analizimin e shkeljes së të drejtave ligjore të garantuara nga ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe aktet e tjera nënligjore që iu është bërë punonjësve të Policisë së Shtetit për rreth 5 vjet, nxjerrjen e përgjegjësive dhe marrjen e masave administrative ndaj personave përkatës.
7. Parashikimin e fondeve buxhetore për të bërë të mundur që në organikën e Drejtorive Vendore të Policisë të parashikohet pozicioni i psikologut për dhënien e shërbimit të trajtimit psikologjik të punonjësve të policisë.

Nga Ministria e Brendshme u informuam se rekomandimi ishte mirëpritur dhe se nga ky institucion ishin hartuar aktet ligjore e nënligjore në zbatim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar të cilat janë në proces miratimi. Por ende këto akte nuk rezultojnë të jenë miratuar.

Ndërkohë u informuam se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka miratuar në të gjitha strukturat Vendore të Policisë pozicionet specialist psikolog, pozicione të cilat janë shpallur për konkurim nga Departamenti i Administratës Publike. Gjithashtu janë parashikuar në programin buxhetor të Policisë së Shtetit për vitin 2020 fondet në pozicionin e punës të psikologut në çdo Drejtori Vendore të Policisë.

Mbrojtja e të drejtave të shtetasve të huaj që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë

Sipas nenit 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për mbrojtjen e të drejtave të të huajve të cilët janë ose jo rezidentë të rregullt në Shqipëri të refugjatëve, azilkërkuesve si dhe të personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore si dhe në aktet normative ndërkombëtare të njohura dhe ratifikuara nga shteti ynë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar dhe marrë në shqyrtim edhe ankesa të bëra nga shtetasit e huaj të cilët kanë pasur pretendime për shkeljen e të drejtave të tyre ligjore nga organet e administratës publike shqiptare.

Një nga rastet e ndjekura gjatë vitit 2019 është edhe ankesa e shtetases angleze O.A.E.G.L. Ankuesja me profesion gazetare që prej muajit tetor 2017 jetonte në Shqipëri duke u pajisur edhe me leje qëndrimi. Nga muaji dhjetor 2018 ka pasur probleme shëndetësore dhe komplikacione si rrjedhojë e një gravidance me rrezik aborti. Për këto arsye ajo kishte komunikuar nëpërmjet telefonit me punonjësit e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM) Tiranë duke i vënë në dijeni për shqetësimin shëndetësor dhe kërkuar rinovimin e lejes së qëndrimit. Sipas ankueses nga DVKM ishte informuar se për rinovimin e lejes së qëndrimit duhet të paguante një gjobë administrative për shkak të vonësës së aplikimit.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese arritëm në përfundimin se, meqënëse rastin në fjalë DVKM Tiranë e kishte vlerësuar për arsye humanitare, shtatëzani të ankueses nga ana e këtij organi nuk duhej të aplikohet penaliteti me gjobë administrative sikurse kishte bërë në fakt. Vendosija e gjobës ankueses dhe mos pagimi i saj po e pengonte atë që të pajisej me lejen e qëndrimit në RSH.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ankueses, i rekomandua DVKM Tiranë, *marrjen e masave të nevojshme për revokimin e vendimit të datës 05.02.2019 të komisionit përkatës të DVKM Tiranë për pjesën e vendosjes së gjobës administrative aplikueses O.A.E.G.L.* Por rekomandimi i bërë nuk u pranua nga DVKM Tiranë.

Sa më sipër tregon se megjithë përmirësimin e punës së strukturave të Policisë së Shtetit për zbatimin e të drejtave të lirive të individit, mbetet ende punë për të bërë në këtë drejtim. Vlerësojmë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë për të siguruar e garantuar zbatim efektiv e në çdo kohë të drejtave të qytetarëve.

3.3 Parandalimi i dhunës dhe torturës

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës ka kryer **79** vizita inspektuese. Këto vizita janë kryer në bazë të planit të miratuar të inspektimeve në institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut si dhe pikat e kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve. Përveçse sa më sipër MKPT-ja ka zhvilluar dhe aktivitete të tjera monitoruese që do të trajtohen më poshtë.

I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me përcjelljen e **79** raporteve të inspektimit dhe rekomandimeve ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara. Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë

vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t'u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione.

Gjatë kryerjes së vizitave monitoruese, MKPT-ja kishte për objekt të punës mbledhjen e informacionit mbi:

- Trajtimin e personave në institucione dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, trajtimit degradues e diskriminues, torturës apo forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.
- Nivelin e zbatimit të masave mbrojtëse, duke krahasuar përputhshmërinë e tyre me kuadrin normativ vendas dhe standardet ndërkombëtare.
- Cilësinë e kujdesit shëndetësor.
- Kushtet materiale për trajtimin e personave që qëndrojnë në ambientet e këtyre institucioneve, duke u përqendruar kryesisht në aspekte të tilla si ushqimi dhe shërbimi në kohë i vakteve, ndriçimi natyral e artificial, ventilimi-aspirimi e sistemi ngrohës, respektimi imundësisë për higjienën personale, kushtet sanitare, mbipopullimi, kushtet e banimit etj.
- Vlerësimin e respektimit të të drejtave të personave të trajtuar, sipas zërave të parashikuara në rregulloret institucionale dhe specifikave të tyre (për të pasur kontakte me këshilltarët ligjorë e familjarët për të kryer telefonata për t'u informuar mbi të drejtat e tyre në një gjuhë që e kuptonin për t'u informuar nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar për procedurat e punësimit dhe shpërblimet përpunën e kryer për të drejtën për aktivitete në ajër të pastër të drejtën e ushtrimit të riteve fetare, të drejtën për të përfituar ndihmë financiare etj.).
- Zhvillimin e arsimit të detyrueshëm, kurseve profesionale dhe të aktiviteteve rekreative e rehabilituese, sipas specifikave të institucioneve, etj.

Në inspektimet e bëra gjatë vitit 2019 u vunë re një sërë problematikash të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim.

Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

1. Kushte materiale tejet degraduese e pa mundësi rikonstruktimi të mjediseve në regjimet e brendshme të I EVP Zahari Krujë, I EVP Tepelenë, I EVP Kukës, I EVP Lezhë të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm, mungesës së investimeve dhe amortizimit, Avokati i Popullit ka rekomanduar mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
2. Infrastruktura në pjesën më të madhe të I EVP-ve paraqiste probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. I EVP-të me

- problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin IEVP Zahari-Krujë, Lushnje, Rrogozhinë, Sarandë, Lezhë, Tepelenë. Përrjashtim bënin IEVP-të e reja dhe ato të rikonstruktura të cilat praktikisht kanë krijuar një sistem me dy standarde në sistemin penitenciar shqiptar.
3. Mbipopullimi, megjithëse ka pësuar një rënie vitet e fundit në disa nga IEVP-të si në IEVP 302, Tepelenë, Jordan Misja, IEVP Durrës, vazhdon të jetë prezent. Gjatë vizitave në jo pak mjaft raste grupet e inspektimit kanë gjetur 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) persona të akomodohen në një qeli, duke mos respektuar standardin 4m² hapësirë jetike për çdo të burgosur. *(Për më shumë referojuni tabelës nr. 1 më poshtë).*
 4. Moszbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Investimi i filluar gjatë vitit 2019 në përshtatjen e dy ndërtesave të IEVP Lezhë, ende nuk ka përfunduar, duke shkelur afatin e përcaktuar në kontratë dhe për më tepër nuk dihen arsyet e ndërprerjes të punimeve. Trajtimi i kësaj kategorie vazhdon të kryhet në IEVP Zahari-Krujë, i cili është në kushte materiale degraduese, me mungesa në organikë të personelit mjekësor dhe ku aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi. Gjithashtu, trajtimi në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, gjë e cila vazhdon të reflektohet në raportet kombëtare, ndërkombëtare dhe në konferencat rajonale. Gjendja gjatë vitit 2019 u rëndua dhe më shumë në këtë institucion për shkak të mbipopullimit të theksuar.
 5. Mungesa e Mjekëve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale mbetet një problematikë shqetësuese e sistemit tone penitenciarë. Avokati i Popullit gjatë vitit 2019 për rreth 12 IEVP në rang vendi ka rekomanduar marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit. Më problematike paraqitet situata në IEVP 302, IEVP Tepelenë, IEVP Fushë Krujë, IEVP Kukës, IEVP Korçë, IEVP Berat, IEVP Durrës, IEVP Fier, IEVP Peqin, IEVP Lushnje. *(Për më shumë referojuni tabelës 2 më poshtë).*
 6. Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar IEVP-të e reja si në Vlorë, Berat, Fier, Durrës, Elbasan dhe Shkoder, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita mjekësore si dhe janë të pa pajisura me materiale ndihmëse.
 7. Probleme me ofrimin e mundësisë për arsim. Në IEVP Kukes, IEVP Jordan Misja 313, IEVP Rrogozhinë, IEVP Fier, IEVP Tropojë, IEVP Fushë-Krujë, IEVP Sarandë, IEVP Shën Koll-Lezhë, IEVP Elbasan, IEVP Peqin, IEVP 302, mungonin kurset profesionale dhe nuk ofrohej arsimi detyrueshëm në përputhje me marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Theksojmë se në asnjë prej institucioneve penitenciare nuk ofrohej arsimi i mesëm. Ndërsa në mbi 17 (shtatëmbëdhjetë) IEVP, mungojnë kurset e formimit profesional në bashkëpunim me drejtoritë rajonale.
 8. Shpërblimi për punën e kryer në të gjitha institucionet, vazhdon të kryhet me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në

këtë kuadër për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore. Kjo problematikë është trajtuar më gjerësisht dhe pikën 4.1 “Të drejtat e personave të privuar nga liria”.

9. Ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese mungonin në një pjesë të IEVP-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit apo ushtrimit të rriteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi apo mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzonin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë në thuajse të gjitha IEVP-të, u konstatuan probleme sa i përket aktiviteteve në grup apo individuale dhe pamundësi nga sektori psiko-social të cilat ndonëse mundohen t’i realizojnë realisht nuk arrijnë t’i kryejnë për mungesë të ambienteve të përshtatshme, bazës materiale apo dhe organikës së paplotësuar.
10. Vonesa dhe mangësi paraqiten në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e IEVP-ve që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
11. Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej IEVP-ve për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
12. Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në IEVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstrakcioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
13. Sistemet qendrore të ngrohjes, pothuajse në të gjitha IEVP-të, ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i difekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngrohja sipas parashikimeve ligjore.
14. Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit, u konstatuan në shumicën e IEVP-ve.
15. Mungesat në dollapë e rafte të rrobave bënin që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndeshej kryesisht në IEVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, Tiranë (“Jordan Misja”), Sarandë, Kukës, Rrogozhinë e Tropojë.
16. Problem i hasur në të gjitha institucionet e inspektuara, ishte konstatimi i çmimeve të larta të produkteve të dyqaneve të IEVP-ve.

17. Mbetej shqetësuese thuajse në të gjitha IEVP-të, cilësia dhe larmia e ushqimit.

Problematikat e vërejtura nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të bërë përmirësime të nevojshme të sistemit si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

Tabela 1– Rekomandimet e inspektimeve të MKPT-së për 2019, me të dhëna mbi mbipopullimin ose jo në IEVP

Nr.	IEVP	Data e inspektimit	Kapaciteti zyrtar i Institucionit	Numri i të burgosurve në ditën e inspektimit	Mbi kapacitet
1	IEVP Tepelenë	11.12.2019	75 persona	90 persona	15 persona
2	IEVP Elbasan	12.03.2019	140 persona	145 persona	5 persona
3	IEVP Peqin	05.04.2019	560 persona	548 persona	-
4	IEVP Durrës	02.07.2019	300 persona	261 persona	-
5	IEVP Kukës	22.07.2019	36 persona	13 persona	-
6	IEVP Tropojë	23.07.2019	26 persona	19 persona	-
7	IEVP 302	11.12.2019	170 persona	90 persona	-
8	IEVP Fushë-Krujë	16.10.2019	312 persona	384 persona	72
9	Instituti i të Miturve Kavajë	21.03.2019	40 persona	32 persona	-
10	IEVP Korçë	23.09.2019	312 persona	375 persona	63
11	IEVP Berat	02.07.2019	112 persona	108 persona	-
12	IEVP Lushnjë	10.04.2019	198 persona	179 persona	-
13	IEVP Fier	11.04.2019	870 persona	813 persona	-
14	IEVP Reç	27.05.2019	857 persona	405 persona	-
15	IEVP Rrogozhinë	08.07.2019	343 persona	309 persona	-
16	IEVP Krujë	20.06.2019	190 persona	288 persona	98
		17.12.2019		290 persona	100
17	IEVP Jordan Misja	04.09.2019	482 persona	486 persona	4

Tabela 2 – Rekomandimet e inspektimeve të MKPT-së për 2019, mbi mungesën e mjekëve dhe stafit mjekësor në IEVP

Nr	Institucioni	Data e Inspektimit	Numri i të dënuarve në ditën e inspektimit	Gjendja aktuale e stafit mjekësor	Rekomandimet e MKPT-së
1.	EVP 302	26.12.2019	170 të burgosur	1 mjek me kohë të pjeshme	Marrjen e masave për plotësimin e organikës me 1 mjek me kohë të plotë

2.	IEVP Fushë Krujë	16.10.2019	384 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Të merren masa të menjëhershme për sigurimin e mjekut me kohë të plotë.
3.	IEVP Tepelenë	11.12.2019	90 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit.
4.	Instituti i të Miturve Kavajë	21.03.2019	32 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për sigurimin e mjekut me kohë të plotë.
5.	IEVP Korçë	23.09.2019	375 të burgosur	2 mjekë me kohë të pjesshme	Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve të organikës.
6.	IEVP Berat	02.07.2019	108 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme	Marrjen e masave të menjëhershme për punësimin me kohë të plotë të 1mjeku, 1 stomatolog dhe 1 farmacisti
7.	IEVP Durrës	30 maj 2019	261 të burgosur	1 mjek të përgjithshëm dhe 1 infermier me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për plotësimin e organikës të stafit mjekësor me 1 mjek të përgjithshëm dhe 1 infermier.
8.	IEVP Peqin	05.04.2019	548 të burgosur	Mungonin 3 mjekë dhe 1 stomatolog	Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës të institucionit me 3 mjekë të përgjithshëm dhe stomatologu me kohë të plotë, për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të të dënuarve/paraburgosurve për vizita mjekësore dhe ofrimin e një shërbimi shëndetësor sa më cilësor
9.	IEVP Fier	11.04.2019	813 të burgosur	Organika përbëhej nga 2 mjekë, ku njëri prej tyre punonte me kohë të pjesshme	Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut të dytë me kohë të plotë

10.	IEVP Lushnjë	10.04.2019	179 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme, si dhe nuk kishte farmacist	Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e I.E.V.P, Kosovë, Lushnjë ose në mënyrë alternative me dy mjekë me kohë të pjesshme
11.	IEVP Kukës	22.07.2019	13 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme dhe 3 ndihmësmjekë	Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë
12.	IEVP Kukës	23.07.2019	19 të burgosur	1 mjek me kohë të pjesshme dhe 3 ndihmësmjekë	Marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë

Për vitin 2019 kemi rekomanduar për 12 (IEVP) plotësimin e organikës me mjek të përgjithshëm.

Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë e policisë

Inspektimet e kryera në njësitë policore gjatë vitit 2019 kishin si qëllim, vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikën e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016 për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici” si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme.

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë, u konstatua sa më poshtë vijon:

1. Mbipopullim i herë pas herëshëm në DPV Tiranë si dhe në disa nga komisaritet ku gjenden ambiente sigurie në varësi të saj. Në këto struktura punohet në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal por edhe për shkak se personat e dënuar me vendim të formës së prerë në mungesë, vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Gjithashtu mbyllja e dhomave të sigurisë në disa komisariate e bënte më të theksuar këtë problem.
2. Pretendime për raste të ushtrimit të dhunës dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë ka patur në disa komisariate. Ankesat e gjetura të bazuara janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.

3. Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të pakta në numër dhe nuk krijonin ambiente të përshtatshme, dinjitoze të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra të rritur dhe të mitur.
4. Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Përjashtim bënin ambientet e sigurisë në DPV Tiranë, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisarariatet e varësisë të DPV Tiranë ku gjenden dhoma sigurie, po ashtu ishin në shkelje të dukshme të këtyre standardeve. Në komisarariatet e policisë nr.1, 2 dhe 3 në Tiranë nga inspektimi rezultoi se disa dhoma sigurie janë mbyllur dhe janë nxjerrë jashtë funksionit, duke i mbyllur me procesverbal.
5. Probleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor nga disa DPV, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e konsultave. Në disa drejtori mjeku mungon. Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh të përcaktuar në Manualin e Policisë së Shtetit por dhe cilësia e vizitave nuk përmbush qëllimin për të cilin duhen realizuar. Kjo problematikë është ngritur dhe raportin e CPT për Shqipërinë për vitin 2018.¹¹
6. Probleme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate.

Rastet e torturës, keqtrajtimin dhe ushtrimin të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë së Shtetit për dhunimin fizik të tyre në njësitë policore si dhe ndaj Policisë së Burgjeve për dhunimin fizik të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucionet penitenciare ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet e institucionit të Avokatit të Popullit.

Duhet theksuar sepavarësisht hapave të rëndësishëm përpara kjo problematikë mbetet shqetësuese, pasi përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut. E drejta për të mos ju nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, e cila garantohet dhe mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 25), Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 3), Konventa e OKB-së, Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese, “Protokolli Opsional i Konventës Kundër

¹¹<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3https://rm.coe.int/168097986b> “access to a doctor” page 19

Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese (OPCAT)”, Kodi Penal (nenet 86 dhe 250) është një e drejtë absolute.

Dhuna e ushtruar nga punonjës policie që në disa raste përbën torturë ose veprime arbitrare, cenon rëndë integritetin fizik e psikologjik të personit dhe lë pasoja në shëndetin dhe në raste të veçanta edhe në jetën e të dhunuarit, deri në humbjen e saj. Ky veprim është i dënueshëm penalisht për personin që e kryen atë. Ndërkohë ai cenon rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve si dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek këto organe. Gjithashtu, ky tregues negativ i Policisë është i papranueshëm në një shtet të së drejtës dhe në një shoqëri demokratike.

Rastet e tejkalimit të forcës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t’u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare por edhe në rastet kur ka të tillë është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë. Ekziston edhe frika e hakmarrjes tek qytetarët për ti denoncuar rastet e dhunës si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa më shpejtë, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend. Mekanizmi për Parandalimin e Torturës ka hetuar për vitin 2019, 4 (katër) raste me iniciativë dhe 5 (pesë) ankesa me pretendim ushtrim dhune. Për më shumë shikoni rekomandimet përkatëse në faqen e Avokatit të Popullit.

Bashkëpunimi në kuadër të OPCAT-it

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2019 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimi me këto struktura është kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta e kontakteve të drejtpërdrejta dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it.

Me ftesë të Avokatit të Popullit në datat 27-31 Maj 2019, një delegacion i Observatorit të Pavarur të NPM-së (NPM Obs) shoqëroi NPM-në shqiptare (MKPT) në vizitat inspektuese në vendet e privimit të lirisë si:

- IEVP Reç, Shkodër
- Pika e kalimit kufitar të Muriqanit
- Drejtoria e Policisë Kufitare Shkodër
- Komisariati i Policisë Bushat
- Shërbimi psikiatrik i Shkodrës
- Burgu Shën Koll i Lezhës, dy ndërtesa që përkohësisht do të shërbejnë për të dënuarit me mjekim të detyruar
- Spitali psikiatrik i Elbasanit
- Qendra pritëse e mbyllur për emigrantët e Kareçit

- Instituti i të miturve në Kavajë
- IEVP Durrës

Delegacioni i NPM Obs kryesohej nga z.Patrizio Gonella, ekspert i njohur ndërkombëtar në fushën e jurisprudencës dhe parandalimit të torturës dhe në përbërje të tij ishin z.Petur Hauksson, mjek psikiatër me shumë përvojë në fushën e tij, ish anëtar i CPT-së si dhe z. Markus Jaegger, drejtues i Seksionit për të Drejtat e Njeriut dhe Migracionin, pranë Këshillit të Europës, një nga personalitetet më të shquara ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut të parandalimit të torturës dhe sjelljeve degraduese e çnjerëzore, i cili mori pjesë si përfaqësues i Këshillit të Europës, nën statusin e vëzhguesit të NPM Obs në kuadrin e një projekti të përbashkët midis Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian të quajtur "Forumi Europian i NPM".

Të gjitha vizitat ishin të paparalajmëruara. Delegacioni i NPM Obs/Këshilli i Europës mundi të hyjë në të gjitha institucionet e sipër përmendura, së bashku me MKPT-në shqiptare, bazuar në legjislacionin kombëtar dhe parimet e OPCAT që lejon NPM-në të shoqërohet nga çdo ekspert që zgjedh, duke përfshirë të huajt.

Në përmbyllje të këtyre takimeve nga të dyja palët u hartuan konkluzionet paraprake në të cilat, grupi i NPM Obs shprehu mirënjohjen për eksperiencën e kaluar gjatë gjithë javës së monitorimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale si dhe në qendrat e tjera ku privohet liria e individëve në Republikën e Shqipërisë dhe u ndal në mënyrë të veçantë në punën dhe procedurat e ndjekura nga grupi i ekspertëve të MKPT-së të cilët sipas grupit të ekspertëve të observatorit njëzëri dëshmuar nivel të lartë profesionalizmi në zbatimin e detyrave të tyre si dhe paralelisht një organizim të mirëfilltë që tregonte funksionimin e këtij seksioni në përputhje me standardet e kërkuara nga OPCAT, CPT dhe legjislacioni shqiptar. Rekomandimet e grupit të OBS do të shërbejnë në vijimësi për përmirësimin e punës së MKPT-së.

Mbi vizitat e kryera është hartuar një raport i përbashkët, i cili është në fazën e diskutimit dhe do të bëhet publik në momentin e finalizimit.

Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës vijoi të zbatojë, gjatë vitit 2019, Marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët “Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Europës Juglindore”. Krahës zonës kufitare të Gjirokastrës, Sarandës dhe Përmetit, aktiviteti i Avokatit të Popullit përmes ekspertëve u shtri përgjatë vitit 2019 edhe në zonën e Shkodrës, Kukësit, Korçës dhe Bilishtit.

Ekspertët, sipas orientimeve të institucionit të Avokatit të Popullit dhe në bashkëpunim me UNHCR, përgjatë gjithë vitit realizuan kontakte në këto tre zona ndërkufitare me qindra të huaj të parregullt duke i informuar për të drejtat, duke i intervistuar dhe duke monitoruar procesin e evidentimit të tyre që kryhet nga punonjësit e sektorit të emigracionit, duke parë dhe bashkëpunuar për nevojat në asistimin e tyre për trajtim me ushqime dhe veshmbathje, duke kryer koordinimin e bashkëpunimit me strukturat përgjegjëse në raste të asistencës mjekësore kur ka qenë e

nevojshme, përfshirë komunikimin me urgjencën spitalore, ndjekjen e rasteve në spital, komunikime për mbarëvajtjen e mjekimeve për raste të thjeshta, etj.

Ekspertët u përfshinë në monitorimin sistematik të kufijve, raportimin periodik pranë institucionit të Avokatit të Popullit të gjetjeve, trajtimin e zgjidhjen e problematikave të hasura duke bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Kufirit në nivel vendor, autoritetet qëndrore të kufirit dhe migracionit si dhe në bashkëveprim me UNHCR-në.

Shqipëria u përball gjatë vitit 2019 me shtim të hyrjes së të huajve të parregullt kryesisht përmes kufirit jugor dhe juglindor me Greqinë për të vijuar më tej drejt Malit të Zi, me destinacion përfundimtar vendet e Bashkimit Europian. Rritja e prurjes së të huajve të parregullt u shoqërua me shtim të kërkesave për azil në territorin shqiptar dhe me adresimin e nevojave prioritare për mbrojtje, ndihmë dhe shërbime sidomos për grupet më të rriskuara, siç janë gratë dhe fëmijët, personat me nevoja të veçanta apo personat me probleme shëndetësore.

Prurjet e rritura ndikuan edhe në aktivitetin e rrjeteve të trafikut të qenieve njerëzore ndaj të cilëve pati një forcë goditëse të policisë shqiptare në bashkëpunim me Rojën Europiane të Kufijve “Frontex”. Në maj të vitit 2019 hyri në fuqi Marrëveshja për menaxhimin e përbashkët të kufirit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Europian dhe 50 oficerëtë parë të Frontex u vendosën në zonën e kufirit të Shqipërisë me Greqinë (25 në Qarkun e Gjirokastrës dhe 25 në Qarkun e Korçës) duke punuar së bashku me oficerët shqiptarë të Kufirit dhe Migracionit dhe me aktorët që bashkëpunojnë në trajtimin e problematikave të të huajve të parregullt dhe kufirit.

Ekspertët kanë pasur akses nga sektori i migracionit për të qenë të pranishëm fizikisht në intervistat e përzgjedhjes për qindra të huaj të parregullt që hynë në harkun e një viti nga territori grek duke vëzhguar respektimin e udhëzimit përkatës dhe realizimin e standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë fushë. Në shumë raste përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në terren dhe MKPT në bashkëveprim me Zyrën e UNHCR-së Gjirokastrë apo Zyrën qëndrore të UNHCR-së referuan tek autoritetet kufitare problematikave të paraqitura nga të huajt e parregullt dhe trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit janë prirur nga mendimi kritik gjatë kontakteve për të përmirësuar cilësisht elementë të ndryshëm në mekanizmin e mbrojtjes së migrantëve mbi bazë të identifikimit të boshllëqeve në sistemin e azilit. Një nga sfidat me të cilat përballlet sistemi është mungesa e perkthyesve për gjuhë të rralla (pasi një person nga grupi i migrantëve shërben vetëm me anglishte të dobët si perkthyes për pjesën tjetër të grupit) dhe pengesa të tilla gjuhësore ndikojnë në procesin e identifikimit dhe përzgjedhjes.

Tabela 3. Aktiviteti i përmbledhur i Ekspertëve në Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër

Proceset e ndjekura	Rajonet	Treguesit vjetorë
Vëzhgimi në procesin e evidentimit të të huajve të parregullt dhe Intervistat e Përzgjedhjes	Gjirokastrë	1.510 persona
	Saranda	18 persona
	Korça	110 persona
	Bilisht	680 persona
	Shkodra	1180 persona

	Kukës	17 persona
Monitorime kufiri dhe vizita në terren në zonat kufitare	Gjirokastrë Saranda Korça Bilisht Shkodra Kukës	146 vis. 15 vis. 16 vis. 38vis. 135 vis 9 vis.
Intervista të thelluara me të huaj të parregullt	Gjirokastrë Saranda Korça Bilisht Shkodra Kukës	330 persona 14 15persona 46persona 181 9
Raporte Analitike për gjetjet gjatë vëzhgimeve	Gjirokastrë Saranda Korça Bilisht Shkodra Kukës	10 1 2
Raporte rekomanduese mbi gjetjet gjatë vëzhgimeve	Gjirokastrë Saranda Korça Bilisht Shkodra Kukës	7 2 1 3

Tabela 4: Të huajt e parregullt të trajtuar nga ekspertët në 3 zonat Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër

Moshat	Meshkuj		Femra		Total	
	Në numër	në %	në numër	ne %	në numër	në %
0-17	212	7,1	160	26,8	372	10,6
18-59	2400	82,5	380	63,8	2780	79,1
60 >	305	10,4	55	9.4	360	10,3
Total:	2917	100%	595	100%	3512	100%
Rajonet <i>Korçë, Shkodër, Gjirokastrë</i>						

Gjejmë me vend të theksojmë se ky aktivitet nuk do mund të kryhej pa bashkëpunimin dhe mbështetjen e UNHCR-së pasi kapacitetet aktuale të MKPT-së nuk mund ta kryejnë këtë mandat.

3.4 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria

Veprimtaria e punës së organit të Prokurorisë është parë dhe vlerësuar në kontekst me ndryshimet në legjislacionin procedural-penal dhe gjatë zhvillimit të një procesi të vështirë të reformës në drejtësi. Këto ndryshime e kanë vendosur organin procedues përpara detyrimeve ligjore në zbatimin korrekt të procedurave si në marrjen e vendimit përfundimtar, ashtu dhe hetimin e fakteve e rrethanave që janë në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, duke marrë parasysh edhe volumin e rritur të punës për shkak të mungesave në sistem.

Nën këtë prizëm janë marrë, vlerësuar dhe trajtuar kërkesë/ankesat e qytetarëve në rastet kur ata kanë ngritur pretendime të ndryshme për punën e kryer nga prokurorët, gjatë hetimit të procedimeve penale duke qenë palë në procesin penal në cilësinë e kallëzuesit apo të personit nën hetim.

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur kushtetues për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut është munduar të luajë një rol aktiv në formën e një mekanizmi, duke shqyrtuar praktika të punës së prokurorëve pas shqetësimeve të ngritura nga qytetarët, duke adresuar problematikat dhe mbi këtë bazë ka ndërhyrë me anë të rekomandimeve me qëllimin final vënien në vend të së drejtës së shkelur.

Gjatë vitit 2019 në institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur dhe janë trajtuar 79 ankesa të qytetarëve që në mënyrë të grupuar dhe sipas llojit të cenimit të të drejtave në procesin penal, paraqiten si më poshtë:

Së pari: Për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale

Zvarritjen e hetimit të procedimeve penale Avokati i Popullit e ka ndjekur me përparësi, duke e vlerësuar në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor në respekt të detyrimeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ.

Arsyet e zvarritjeve të pajustificuara të hetimit, sipas vlerësimit tonë kanë qenë kryesisht për:

- a. moskryerje e hetimeve të gjithanshme, pasqyrim pa plan i veprimeve hetimore dhe jo në vijimësi, vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore, sidomos nga policia gjyqësore e Policisë së Shtetit, duke moszbatuar me korrektësi urdhërimet e prokurorit;
- b. zvarritje të theksuara për rastet kur gjyqtari i seancës paraprake nuk ka miratuar kërkesën e prokurorit për mosfillim të procedimit penal apo pushim të çështjes, duke i kthyer aktet prokurorisë dhe urdhëruar dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore;
- c. kryerje e ekspertimeve të ndryshme, shpesh dhe disa ekspertimeve në një procedim të vetëm, kryerje dhe administrim me vonesë i akteve të ekspertimit;
- d. mosvlerësim, mosshqyrtim apo shqyrtim me vonesë i kërkesave të palëve në procesin penal, sidomos pretendimeve të personit nën hetim; mosparaqitje e dëshmitarëve në fazën e hetimit

paraparak rrjedhojë dhe e adresave të pasakta të tyre, kthimi me vonesë i përgjigjeve të letërporosive të autoriteteve të drejtësisë të shteteve të huaja etj.

Së dyti: Në mosrespektimin e të drejtës së informimit për veprimet e kryera gjatë fazës së hetimit apo vendimet përfundimtare për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale ose përfundimit të hetimit.

Nga informacionet e dërguara prej prokurorive si dhe komunikimin që kemi pasur me prokurorët e çështjeve, jemi informuar për faktin se qytetarët, palë në procesin penal janë njoftuar me shkresa për vendimin e marrë por mosdijenja apo mosmarrja e vendimit lidhet dhe me mungesën e adresave të sakta të banimit të tyre.

Për këtë arsye, kemi sugjeruar që në shkresat përcjellëse për njoftim të palëve të vendoset dhe numri i telefonit celular apo numri fiks në rast se disponohet prej tyre, praktikë kjo e cila ka dhënë rezultate të mira dhe është ndjekur në institucionin e Avokatit të Popullit.

Së treti: Në mosvënien në dispozicion të akteve të ndryshme nga fashikulli i hetimit apo dokumenteve të sekuestruara.

Nga mosveprimi i organit proçedues dhe zvarritjet për mosdhënie të akteve të ndryshme të procedimit penal kanë ardhur pasoja në cenim të interesave të ligjshme të qytetarëve si p.sh për të ndjekur procedurat e nevojshme gjyqësore sikurse është e drejta e ushtrimit të ankimit në gjykatë.

Përmendim këtu dhe trajtimin e sendeve prova materiale të sekuestruara gjatë hetimit nga prokuroria. Edhe pse rregulli bazë për kthimin e sendit të vjedhur të sekuestruar është atribut i gjykatës, neni 218 i Kodit Penal i jep diskrecionin prokurorit që të realizojë kthimin pronarit të ligjshëm edhe në fazën e hetimeve paraprake. Pra, pasi të jenë kryer veprimet e nevojshme procedurale me sendin, kur nuk dëmtohet hetimi i çështjes, prokurori pa hezitim dhe pa vonesa duhet ta kthejë atë, pasi e kundërta do të sillte pasoja në biznesin familjar apo aktivitete të tjera të qytetarëve. Për këtë arsye është hartuar edhe rekomandimi nr.K2/A87-9, datë 11.07.2019, ku i kemi rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë “*Marrjen e masave të menjëhershme kthimin e sendit të sekuestruar provë materiale në zbatim dhe të vendimit nr.859 Akti, datë 27.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*” si dhe është kërkuar edhe hetimi i thelluar për fatin e sendit provë materiale dhe personit përgjegjës që ka kryer veprimin e kundërligjshëm.

Së katërti: Ngritjen e pretendimeve për akuzë të padrejtë

Pavarësisht vështirësive që ndesh organi i prokurorisë në këto raste, rrjedhojë e numrit të konsiderueshëm të personave të arrestuar nga Policia Gjyqësore e Policisë së Shtetit dhe pamundësisë së gjetjes dhe administrimit të provave të nevojshme ndaj personave nën hetim për arsye të kohës së shkurtër deri në paraqitjen e kërkesës në gjykatë, do të çmonim se organi i prokurorisë ka patur raste të dukshme kur duhet të urdhëronte lirimin e menjëhershëm të të arrestuarve.

Gjithashtu janë paraqitur ankesa nga familjarë të personave me probleme të shëndetit mendor që kanë paraqitur pretendime ndaj organit të prokurorisë për mosnxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës të cilat përmbajnë masa mjekësore të detyrueshme, parashikuar nga nenet 46 dhe 239 të Kodit të Procedurës Penale.

Avokati i Popullit prej vitesh ka vënë theksin mbi faktin se mbajtja e këtyre personave në mjedise brenda sistemit të burgjeve, përbën një trajtim degradues dhe çnjerëzor, pasi bie në kundërshtim me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 3 të KEDNJ-së. Sipas akteve ndërkombëtare, personat me çrregullime të shëndetit mendor trajtohen si të paafte dhe të cenueshëm, prandaj atyre duhet t'u sigurohet trajtimi i duhur mjekësor, përshtatshmëri e ndihmës dhe e përkujdesit mjekësor në një Institucion Psikiatrik të Specializuar.

Nisur nga ky shqetësim kemi rekomanduar: *“Përpilimin e një udhëzimi me qëllim që Prokurorët e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale të atashuar pranë Seksioneve të Prokurorisë në Rrethe apo pranë Prokurorive të Apeleve në përmbushje të detyrës së tyre funksionale në cilësinë e subjektit procedues, bazuar në nenin 24 dhe 480 të Kodit të Procedurës Penale të paraqesin kërkesë për shuarjen e dënimit, e cila vë në lëvizje gjykatën për të ndërmarrë hapat e nevojshme ligjore, me qëllim që të dënuarit mos të privohen nga të drejtat e tyre ligjore”.*

Në disa raste, kur Prokuroria ka vendosur pezullimin e hetimeve për mosnjohje të autorit të veprës penale si për *“Vrasje”*, *“Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”* me pasojë vdekje për të cilat ka kaluar një periudhë e gjatë kohe është kontaktuar me drejtues apo prokurorë të prokurorive si dhe punonjës të Policisë së Shtetit në komisariate për të shpejtuar kryerjen e veprimeve të nevojshme, me qëllim administrimin e provave dhe bërjes së analizës së përbashkët për të vendosur rifillimin e hetimit të pezulluar.

Shqetësues është edhe fakti se disa prokurorë në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore si në Tiranë, Gjirokastrë etj, ngurojnë të japin sqarime kërkesave tona për informacion më e theksuar kjo për të sqaruar arsyet e zvarritjeve në hetimin e procedimeve penale, duke e justifikuar me karakterin sekret të hetimit.

Në vëmendje të këtyre prokurorëve, kemi sjellë të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar edhe informacione apo dokumente që lidhen me çështjen në shqyrtim të klasifikuara si sekret shtetëror, e cila parashikohet në nenin 20 të ligjit funksional të Avokatit të Popullit.

Një problem thelbësor i evidentuar është dhe interpretimi i gjendjes së flagrancës në kundërshtim me parimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkojnë që çdo kufizim i lirisë duhet të jetë përjashtim, objektivisht i justifikuar dhe për një kohëzgjatje jo më shumë se sa është absolutisht i domosdoshëm duke inkurajuar shprehimisht mospërdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjyqimit, deri në dhënien e vendimit.

Në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale parashikohen kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal¹². Në caktimin e tyre duhet të krijohet bindja se provat të bëjnë të dyshosh që është kryer apo është duke u kryer një vepër penale. Natyrisht, kjo bindje apo dyshim i arsyeshëm krijohet kur personi ndalohet, ose arrestohet në flagrancë por kjo bindje duhet të jetë e atillë që të vlerësohet nga gjyqtari. Në të dyja rastet respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë. Dyshimi i arsyeshëm sipas GJEDNJ kërkon fakte, ose informacione që do të bindin një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer vepër penale. Fakti që një individ ka precedentë penal nuk konsiderohet i mjaftueshëm për të krijuar dyshime të arsyeshme. Dyshimi i arsyeshëm mund të bazohet edhe në informacione anonime. Megjithatë, GJEDNJ ka vlerësuar se informacionet e një informatori anonim të pakonfirmuara nga prova apo informacione të tjera të pamjaftueshme janë për të krijuar dyshimin e arsyeshëm.

Kodi i Procedurës Penale të RSH parashikon vendosjen e disa masave paraprake të kufizimit të lirisë, përkatësisht “*arrestit në flagrancë*” dhe “*ndalimi i të dyshuarit për një krim*”. Këto masa paraprake kanë kohëzgjatje të kufizuar në kohë dhe duhet të ndjekin respektimin e disa kriterëve strikte si edhe të të drejtave dhe garancive procedurale ndaj personave që zbatohen, deri sa gjykata të vendosë vleftësimin ose jo të masës së sigurimit personal të kërkuar nga prokuroria. Ndalimi nuk lidhet me flagrancën por me dyshimin për kryerjen e një krimi dhe rrezikun e ikjes. Kërkesa e prokurorit për vlerësimin e arrestit në flagrancë apo të ndalimit si masë e ligjshme dhe për caktimin e masës së sigurimit që vlerësohet e përshtatshme, duhet të jetë e argumentuar. Ashtu si kemi theksuar edhe më lart, veprimet e kryera nga Policia Gjyqësore e Policisë së Shtetit, shpeshherë janë kryer me iniciativë të tyre, pa vënë në dijeni organin procedues¹³.

Vlen të theksohet se, nëse një person arrestohet në flagrancë apo ndalohet në procesverbalin përkatës të arrestimit/ndalimit duhet të vihet çasti, ora, e kapjes së tij në fakt, kur ai është privuar realisht nga liria.¹⁴ Gjatë punës sonë është evidentuar se për një numër të konsiderueshëm të shtetasve që janë ndaluar/arrestuar në flagrancë, prokuroria ka kërkuar masën “*arrest në burg*”. Po kështu janë konstatuar, raste të caktimit të masës së sigurimit, pa vlerësuar në kompleks edhe rrethanat, kushtet në të cilat është kryer vepra, pasojat që kanë ndodhur etj. Në shumicën e rasteve rezulton se kërkesa për masat e sigurimit bazohet kryesisht në provat e mbledhura nga policia gjyqësore e Policisë së Shtetit dhe se prokuroria nuk ka kryer hetim apo përpunim të akteve të përpiluara nga policia. Po ashtu, provat e siguruara nga prokuroria gjatë kryerjes së veprimeve

¹²Sipas pikës 1 të këtij neni, askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të personit nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

¹³ Arrestimi në flagrancë duhet të kryhet nga strukturat e policisë gjyqësore të organit të Prokurorisë dhe nën drejtimin e prokurorit, sipas neneve 24/1, 30/2 dhe 304/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo me qëllim që të mënjanohej çdo situatë konflikti interesi për shkak se strukturat e policisë kanë qenë subjekt i dëmtuar. Avokati i Popullit e gjen me vend të theksojë se në vendosjen e masave të sigurimit personal ndaj autorëve të dyshuar të veprave penale duhen mbajtur në konsideratë kushtet dhe kriteret e caktimit të tyre të parashikuara nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 228, 229 dhe 230 të tij.

¹⁴ Duke iu referuar neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48- të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

procedurale nuk kanë respektuar në mënyrë të plotë kërkesat e ligjshmërisë. Ndërgjegjësimi për zbatimin e drejtë të ligjit nga ana e organit të akuzës do të reflektojë edhe në respektimin më të mirë të të drejtave që ligji u garanton personave të ndaluar/arrestuar dhe atyre ndaj të cilëve caktohet një masë sigurimi personal. CPT ka bërë rekomandime konkrete në raportin tyre për Shqipërinë të botuar gjatë vitit 2019 në lidhje me faktin se hetimet nga prokurorua për rastet e dhunës duhet të hetohen me shpejtësi e efikasitet dhe jo se bashku me hetimet për akuzat e ngritura ndaj personit në konflikt me ligjin ndaj të cilit është ushtuar dhunë. Avokati i Popullit do të ndjekë me kujdes të veçantë zbatimin e këtij rekomandimi.

3.5 E drejta për një proces të rregullt ligjor

Në kuadër të ankesave të paraqitura lidhur me organet gjyqësore problematikat kanë qenë kryesisht lidhur me shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, më konkretisht:

- mosofrimin e ndihmës juridike parësore dhe asaj dytësore në zbatim të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- zvarritje të proceseve gjyqësore në veçanti afate të tejzgjatura për marrjen në shqyrtim të çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

Sipas dispozitës bazë të nenit 6 të KEDNJ-së, *“çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet në një proces të rregullt, publik ligjor dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”* Përmbushja e detyrimeve nga ana e shteteve nënshkruese të KEDNJ-së, kërkon kryerjen e veprimeve pozitive nga ana e tyre.

GJEDNJ ka theksuar marrëdhënien e gjerë midis të drejtës për një gjykim të drejtë dhe parimit të shtetit të së drejtës. Objekti dhe qëllimi i nenit 6 për të mbrojtur të drejtën për gjykim të drejtë ka qëllim të ushqejë dhe të ruajë parimin e shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike. Kështu shprehja “Drejtësia jo vetëm duhet bërë, ajo duhet edhe të shihet si është bërë”, thekson konceptin e gjerë të një gjykimi të drejtë, duke përfshirë tiparin specifik të mbrojtjes dhe parimin e barazisë mes palëve. Duke marrë në konsideratë të gjitha procedimet së bashku, e drejta për t’iu drejtuar gjykatës përbën një element i cili është i brendshëm për të drejtën e parashikuar nga neni 6/1 nga njëra anë, parimi i të drejtës ndërkombëtare ndalon refuzimin nga drejtësia dhe nga ana tjetër parimi sipas të cilit një pretendim civil, duhet të jetë i mundur të paraqitet para një gjyqtari si një nga parimet ligjore themelore të njohura universalisht.

Po ashtu lidhur me të drejtën e gjykimit brenda një kohe të arsyeshme, KEDNJ-ja përcakton një detyrim të shteteve anëtare të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të lejojnë gjykatat të përmbushin detyrimet e nenit 6/1 të KEDNJ-së, duke përfshirë atë të një gjykimi “brenda një kohe të arsyeshme”.

Proçesi i rregullt ligjor është i sanksionuar edhe nga Kushtetuta në nenin 42 të saj dhe konsiderohet si një prej parimeve bazë të shtetit të së drejtës, duke shoqëruar si proceset administrative, ashtu edhe ato gjyqësore. Paanshmëria, shkëputja nga pushtetet e tjera ekzekutive dhe legislative, presioni politik, interesi ekonomik, shoqëror dhe pavarësia janë garanci për një sistem gjyqësor të konsoliduar. Për këtë arsye, funksionimi normal i gjykatave në shkallë vendi është një domosdoshmëri dhe detyrë funksionale e shtetit për t'u siguruar qytetarëve një sistem gjyqësor që përmbush këto garanci.

Gjykatat në Shqipëri si në çdo vend tjetër janë një element kyç për të bërë të mundur një shtet të së drejtës. Kështu si i gjithë sistemi ligjor, gjatë viteve të tranzicionit të Shqipërisë drejt demokracisë, ato kanë tërhequr mjaft vëmendjen kombëtare e ndërkombëtare. Është e një rëndësie të veçantë që të përkrahet pavarësia e tyre dhe njëkohësisht të sigurohet kualifikimi dhe përgjegjësia e tyre profesionale.

Për shkak të vakancave të krijuara në Gjykatën e Lartë si për shkak të emërimit të asnjë gjyqtari për plotësimin e vendeve vakante që prej vitit 2013 si dhe për shkak të procesit të vetingut në drejtësi dhe mosemërimeve të reja, zvarritjet në vite të gjykimit të çështjeve në këtë gjykatë janë bërë problem shqetësues. Duhet të jetë prioritet bërja funksionale e kësaj gjykate, pasi kjo lidhet drejtpërsëdrejti me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e në mënyrë të veçantë me të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Fakti i ngarkesës së lartë sasiore të gjyqtarëve administrativë, sidomos në Gjykatën e Apelit është një faktor tjetër që ndikon në vonesat në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore. Kjo çështje kërkon ndërhyrje, pasi këto vonesa po dëmtojnë qytetarët të cilët kanë paraqitur ankesa.

Ka pasur kërkesa të përsëritura për prezencën e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit në seancat gjyqësore por institucioni ynë për shkak të mandatit të kufizuar si dhe ngarkesës dhe volumit të punës ka patur pamundësi reale për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave të qytetarëve për prezencën tonë gjatë seancave gjyqësore. Nga ana tjetër në ushtrim të kompetencave që i njeh ligji nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, institucioni i AP ka kërkuar informacion dhe ka tërhequr dokumentacion në rrugë zyrtare në gjykata lidhur me pretendimet e ardhura.

Për ankesat për vendime të padrejta dhe të paligjshme të gjykatave është dhënë këshillim ligjor lidhur me ushtrimin e të drejtës së ankimit ose rishikimit të vendimeve.

Lidhur me ankesat e pretenduara për korrupsion të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ankuesit janë orientuar t'i drejtohen organeve të vetingut, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pas ngritjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kompetencave të caktuara nga legjislacioni në fuqi. Ndryshimet e bëra në Kodin e Proçedures Civile në lidhje me këtë çështje nuk janë zbatuar ende në vendimarrje konkrete në mënyrë që vërehet efektiviteti i tyre.

Sa i përket kategorisë së ish të dënuarve politikë të regjimit komunist në institucionin e Avokatit të Popullit janë trajtuar disa ankesa për dëmshpërblimin të cilat lidhen me:

- mospranimin e dokumenteve për trajtim nga Ministria e Drejtësisë;
- vonesën në dhënien e kështit të tretë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- mosvlerësim të drejtë të masës së dëmshpërblimit;
- mospërfitimin e pensionit apo të dëmshpërblimit të personave të dëbuar apo internuar gjatë regjimit totalitar për shkak të mungesës së akteve normative etj.

Edhe pse kjo shtresë e shoqërisë dhe familjarët e tyre kanë vuajtur mjaftueshëm gjatë regjimit totalitar dhe një pjesë e mirë e tyre janë në moshë të thyer, me probleme shëndetësore dhe ekonomike, ende konstatohen afate të zgjatura në kohë sidomos për dhënien e kështit të tretë të dëmshpërblimit. Kjo lidhet me parashikimet e udhëzimit nr.273/1, datë 27.08.2012, ku përfitojnë dhënie përparësie për pagesën e dëmshpërblimit financiar familjarët e ish të dënuarve politikë të cilët nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) janë vlerësuar me humbje të plotë të aftësisë për punë apo vuajnë nga sëmundje malinje onkologjike ose hematologjike (sëmundje gjaku) të trajtuara nga spitalet universitare shtetërore.

Ndonëse kanë kaluar rreth 12 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9831/2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” të ndryshuar, ende nuk është miratuar VKM-ja për të mundësuar procesin faktik të dëmshpërblimit financiar për kategorinë e të internuarve dhe të dëbuarve të parashikuar në nenin 6 të tij.

Për sa më sipër, i rekomandua Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si më poshtë:

1. *Marrjen e menjëhershme të masave organizative për ngritjen e grupit të përbashkët të punës të përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të bërë të mundur hartimin dhe propozimin në Këshillin e Ministrave të skemës të pensionit të veçantë për të internuarit dhe dëbuarit gjatë regjimit totalitar.*
2. *Marrjen e masave organizative për nxjerrjen e Vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e skemës së pensionit të veçantë për të internuarit dhe dëbuarit gjatë regjimit totalitar.*

Nga Ministria e Drejtësisë u vumë në dijeni se rekomandimi është mirëpritur dhe po merren masat për krijimin e grupit të punës për hartimin e projektit të VKM-së.

3.6 Ndhimja juridike falas

Avokati i Popullit në rolin e garantit të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë ka monitoruar me vëmendje vënien në zbatim të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Edhe më herët kemi trajtuar rëndësinë e këtij ligji dhe nevojën që shteti t’u garantojë këtë shërbim qytetarëve, duke marrë në konsideratë edhe numrin e kërkesave të ardhura për të kërkuar ndihmë juridike falas.

Për këtë arsye nga ana jonë është kryer hetim administrativ dhe janë ndjekur në vijim të gjithë hapat e ndërmarrë nga institucionet përgjegjëse si për miratimin e akteve nënligjore, ashtu edhe për ngritjen e strukturave të parashikuara nga ligji.

Numri i kërkesave të paraqitura në vitet e fundit për periudhën 2016-2019 paraqitet si më poshtë:

Tabela e kërkesave për vitet 2016-2019

Vitet	2016	2017	2018	2019
Kërkesa për ndihmë juridike dytësore falas në total	19	24	54	14 ¹⁵
Kërkesa për ndihmë juridike dytësore falas nga gra dhe vajza	9	11	13	5

Gjatë vitit 2019 ka ardhur një numër prej 14 ankesash ku kërkohej ndihmë juridike falas, kryesisht nga kategori me të ardhura të pakta apo të pamjaftueshme, individë të cilët e kanë të pamundur aksesin në gjykatë përmes avokatit privat. Çështjet për të cilat kërkohej ndihma ligjore falas kanë si objekt kryesisht çështje familjare (si divorce, kujdestari, detyrime pensioni ushqimor etj.), civile (si shkaktim dëmi, pjesëtim pasurie etj.), administrative por nuk mungojnë edhe ato penale. Ndërmjet institucionit të Avokatit të Popullit, Ministrisë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe gjykatave ka pasur komunikime të vazhdueshme zyrtare për të mundësuar orientimin e duhur të qytetarëve drejt strukturave për caktimin e një avokati pa pagesë.

Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ka hyrë në fuqi në datën 1 qershor 2018. Ky ligjparashikon krijimin e një personi juridik publik nën varësinë e Ministrisë të Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Aktet nënligjore dhe Drejtoriae Ndihmës Juridike Falas në zbatim të ligjit të ri duhej të ishin miratuar dhe ngritur brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Pra në muajin shtator 2018 ngritja e strukturës dhe miratimi i akteve nënligjore do të kishin vënë në zbatim ligjin.

Ndërkohë puna për ngritjen e kësaj drejtorie ka filluar vetëm pas miratimit të urdhrorit të Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, me më shumë se 6 muaj vonesë nga hyrja në fuqi e ligjit.

Avokati i Popullit është interesuar në mënyrë të përsëritur, duke theksuar rëndësinë e ngritjes së kësaj drejtorie tek institucionet përgjegjëse si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Kryeministria.

Pas procedurave të realizuara për rekrutimin e stafit konstatohet se edhe pasi po afron një vit nga ngritja e kësaj drejtorie, organika nuk është plotësuar. Mungojnë drejtuesit e nivelit të lartë dhe të mesëm të cilët kanë për detyrë administrimin, koordinimin dhe eventualisht identifikimin e

¹⁵ Rastet e mësipërme të rregjistruara dhe trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit kanë të bëjnë me ndihmën juridike dytësore, dhe nuk përfshijnë rastet e shumta ku qytetarët janë këshilluar/orientuar nga institucioni i Avokatit të Popullit në lidhje me rrugët ligjore që duhet të ndjekin për trajtimin e mëtejshëm të problemit të tyre (ndihma juridike parësore).

nevojave për ndryshime dhe përmirësime në sistemin e ofrimit të ndihmës juridike falas. Mosngritja në kohë dhe brenda afateve ligjore e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas nga Ministria e Drejtësisë si dhe mosmiratimi i akteve nënligjore, bëri që për një kohë të gjatë të krijohesh një vakum ligjor për rregullimin e fushës për ofrimin e ndihmës juridike falas.

Në këtë mënyrë, mosrespektimi i detyrimeve ligjore nga organet përgjegjëse, me qëllim plotësimin e vakumit nënligjor dhe ngritjen brenda afateve ligjore të drejtorisë përkatëse, bën të pamundur aksesin në drejtësi të shtresave në nevojë dhe mungesën e përfaqësimit përmes një avokati falas në çështje të caktuara. Duhet theksuar se tejkalimi i afateve ligjore ka bërë të lindin shumë problematika në gëzimin e të drejtave themelore të grupeve me të ardhura të pamjaftueshme apo të pakta. Mundësia e aksesit në drejtësi të grupeve vulnerabël, parim i rëndësishëm i shtetit të së drejtës dhe i pritshmërive të ligjshme ka qenë për një kohë të gjatë inekzistente.

Nga detyrat e caktuara nga ligji, konstatohet se mbeten ende pa përfunduar nga Ministria e Drejtësisë:

- ✓ miratimi i krijimit të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pas marrjes më parë të mendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. (Deri tani e vetmja qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore është ajo e hapur në qytetin e Elbasanit, e ngritur në datë 16.10.2019 ku janë rekrutuar dy punonjës me trajnim të posaçëm. Mbetet domosdoshmëri ngritja e këtyre qendrave në disa qytete të vendit, duke mbajtur parasysh zgjerimin sipas shpërndarjes gjeografike për ofrimin e shërbimeve sa më afër komunitetit.)
- ✓ miratimi me udhëzim të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, “Për kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifave përkatëse të shpërblimit të avokatëve të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore”;
- ✓ miratimi i projektudhëzimit të përbashkët me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë “Për rregullat e zbatimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore”.
- ✓ autorizimi i organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore dhe publikimi i listës në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Edhe pse janë miratuar aktet nënligjore lidhur me rregullat dhe procedurat e autorizimit, mbeten ende pa u autorizuar organizatat jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore.

Nga korrespondenca që kemi pasur gjatë vitit 2019 me një numër të madh gjykatash të rretheve gjyqësore në shkallë vendi, sa i përket shqyrtimit të kërkesave për ndihmë juridike dytësore si dhe përjashtimin nga tarifave dhe shpenzimet gjyqësore, jemi njohur me faktin se në një pjesë të

konsiderueshme të tyre nuk ofrohej ndihma juridike dytësore falas si p.sh Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë etj.

Nga ana jonë është vërejtur se nga hyrja në fuqi e ligjit, ende mbetet shumë punë për ta bërë funksional dhe të zbatueshëm atë. Po ashtu, kategoritë me të ardhura të pamjaftueshme ose të pakta kanë nivel të ulët të njohurive mbi aksesin për ndihmën juridike dhe të drejtën për të kërkuar përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, qytetarët nuk kanë informacionin e nevojshëm për sa i takon përparësive të ndihmës juridike, procedurës që duhet të ndjekin për ta përfituar atë dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë. Për këtë arsye është e nevojshme të përgatiten fushata sensibilizuese ku të synohet edukimi ligjor, përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikime, fushata televizive dhe në median e shkruar, duke u kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të grupeve vulnerable.

3.7. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2019 ka pranuar për shqyrtim gjithsej 28 raste në të cilat subjektet gjyqësues/kreditor kanë pretenduar cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të titujve ekzekutiv në një afat të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara me ligj për zbatimin e tyre, sikurse parashikuar në nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile, akteve noteriale që përmbajnë detyrim në të holla si dhe akteve administrative të konsideruara tituj ekzekutiv si pjesë përbërëse e procesit të gjykimit ka mbartur pothuaj të njëjtat problematika, sikurse pasqyruar edhe në raportet e viteve të kaluara të Avokatit të Popullit.

Largimet/heqjet e nëpunësve civilë nga administrata që kanë përfunduar në procese gjyqësore, i kanë kushtuar jo pak buxhetit të shtetit. Gjykatat kanë vendosur në favor të të larguarve duke kërkuar ekzekutim të pretendimeve financiare të tyre si dhe rikthim në pozicionet e punës që kanë mbajtur para se të largoheshin, ose në një të ngjashëm. Në radhët e institucioneve tashmë diskutohet gjetja e mundësive për të rikthyer në pozicione të larguarit në mënyrë që përfitimi i tyre financiar të mos vijë nga vendimi i gjykatave por të paguhet për punën që bëjnë¹⁶.

¹⁶Raporti i Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil i vitit 2019 nënvizon, se konstatohen 601 vendime gjyqësore të formës së prerë të detyrueshme për t'u ekzekutuar. Nga këto 236 vendime, ose 39% e tyre janë zbatuar dhe nëpunësit janë rikthyer në shërbimin civil, ose janë liruar nga shërbimi civil për shkaqe ligjore (pension i plotë pleqërie ose dorëheqje) dhe 365 vendime ose 61% e tyre, gjyqfituesit janë regjistruar në listëpritje për t'u sistemuar në një pozicion të rregullt të shërbimit civil. *"Sipas të dhënave të raportuara nga institucionet, rezultoni se aktualisht është paguar nga buxheti i shtetit në favor të nëpunësve gjyqfitues vlera prej 511.748.508 lekësh në zbatim të vendimeve gjyqësore"* thuhet në raport. Po ashtu, *"Procesi do të vijojë gjatë vitit 2020 me ndjekjen e zbatimit të vendimeve nga ministrinë e linjës dhe do të vijojnë seancat dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila ka rreth 143 vendime të pa ekzekutuara dhe me institucionet e administratës vendore dhe ato të pavarura"*.

Kthimi në detyrë i nëpunësve gjyqfitues ishte pjesë e rezolutës së një viti më parë miratuar nga Kuvendi, çka kërkonte ndjekjen e procesit dhe mënyrën sesi ishin zbatuar vendimet.¹⁷

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna prej gjykatave në Republikën e Shqipërisë apo Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, mbetet një çështje me rëndësi thelbësore për shtetin shqiptar, pasi lidhet me forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë. Tejzgjatja e ekzekutimit, “vënia në diskutim” e drejtësisë së dhënë nga gjykata, ndikon në radhë të parë në humbjen e besimit ndaj shtetit.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të administruara gjatë vitit 2019, me objekt detyrimin e organeve të administratës publike të paguajnë shumën në të holla, Avokati i Popullit gjykon, se shkak i mosekzekutimit të titujve ekzekutivë, i cili ka cënauar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, është dhe problematika që mbart Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogaritë e thesarit”*. Për përmirësimin e kësaj situatë, Avokati i Popullit, rast pas rasti ka ndërhyrë dhe do të vijojë ndërhyrjen pranë organeve përkatëse për rregullimin e saj.

i) Çështja e moslejimit të borxheve të reja edhe pse është përcaktuar si objektivi qeverisë, sikurse shprehur në VKM nr.50, datë 05.02.2014, *“Përmirësimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”*, rezulton se nuk është arritur.

Organet apo institucionet debitoare, me rastin e dorëzimit të detyrimit në të holla, sikurse është vendosur nga gjykata nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë procedurat e përcaktuara në Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, (neni 62) apo në Udhëzimin nr.1, datë 13.06.1997 të Ministrit të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, paragrafi 7, sipas të cilit përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryejë auditimin e të gjithë procesit, i cili ka sjellë dëmin ekonomik si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile kundër personave që kanë shkaktuar dëmin. Mosrespektimi i akteve të lartpërmendura ka sjellë do të sjellë cenim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë.

Cënimi i parimit për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë në një afat të arsyeshëm në vlerësimin e Avokatit të Popullit vjen si pasojë e një sërë shkaqeve të tilla si:

Shfaqja e mungesave të cilësive dhe njohurive profesionale nga ana e përmbaruesve gjyësorë të veçantë;

¹⁷Komisioneri ka raportuar se ka komunikuar dhe ka administruar të dhëna nga 208 institucione të administratës publike, ku përfshihen ministratë e linjës, institucionet e varësisë të administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe institucionet e administratës vendore nga të cilat rezultuan me probleme 36 prej tyre (11 ministratë e linjës, 6 institucione në varësi të tyre, 11 bashki, 5 Këshilla Qarku dhe 3 institucione të pavarura). Shih për më shumë lidhur me këtë argument <http://www.panorama.com.al/largimet-e-padrejta-nga-administrata-del-raporti-ja-sa-milione-euro-ka-paguar-buxheti-i-shtetit/>.

- Kryerje e veprimeve përmbartimore jashtë objektit të ekzekutimit apo të parashikuara në ligj si dhe keqinterpretim i dispozitivit të vendimit gjyqësor civil apo administrativ;
- Hezitim të pajustificueshëm nga ana e përmbartuesve gjyqësorë për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit debitor, personave të tjerë të cilët refuzojnë ose kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që janë të detyruar me vendim të gjykatës;
- Moskryerja e veprimeve të duhura prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv të cilat mundësojnë përmbushjen e detyrimit në të holla që institucioni shtetëror detyrohet të paguajë sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës;
- Mosnxjerrja e akteve nënligjore prej Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat dhe atij për rendin dhe sigurinë publike, sikurse parashikuar në nenin 24, pika 3; nenin 36, pika 2; nenin 39; nenin 54, pika 4; nenin 55, pika 3 dhe nenin 56, pika 2, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 89 të ligjit nr.26/2019, *“Për Shërbimin e Përmbartimit Gjyqësor Privat”*.

Në raportin vjetor të vitit të kaluar, Avokati i Popullit ka riprezantuar çështjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit. Në kushtet kur Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka pranuar dhe pranon kërkesa për vënien në ekzekutim të tyre si dhe ka kryer dhe kryen veprime përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre është rekomanduar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.K2/I40-9 Prot, datë 22.02.2016, *“Marrja e nismës për ndryshim legjislacioni”*. Edhe pse ky rekomandim është pranuar në parim, Ministria e Drejtësisë me rastin e dërgimit në Kuvend të projek-ligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale nuk ka reflektuar amendimet e kërkuara prej Avokatit të Popullit. Për rrjedhojë, çështjet e prezantuara në rekomandimin e dhënë Ministrit të Drejtësisë, kanë mbetur të pazgjidhura dhe se procesi i ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve penale të dënimit me gjobë të subjektit, kryhet prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, jo në përputhje me parimet apo të drejtat e garantuara nga legjislacioni në fuqi.

ii) Problematikë e trashëguar është procesi i ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë mbi të ardhurat mujore (pagën) e debitorit. Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror apo Privat me rastin e kryerjes së veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, kanë kryer dhe kryejnë sekuestrimin e të ardhurave mujore të debitorit, duke krijuar situata në cënim të interesave jetike të tij për shkak të mosrespektimit të parashikimeve të nenit 533 të Kodit të Proçedurës Civile apo nenit 123 të Kodit të Punës.

Fakti që deri më sot nuk është përcaktuar minimumi jetik, ka bërë që parashikimi i nenit 533 të Kodit të Proçedurës Civile të jetë i pazbatueshëm prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor. Sipas dispozitës ligjore në fjalë, vendosja e masës së sekuestrës mbi të ardhurat mujore (paga) e debitorit, kryhet pa cënuar “minimumin jetik”, minimum i cili deri më sot është i pa përcaktuar. **Kjo situatë meriton vëmendjen maksimale për trajtimin e saj në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në respektim të të drejtave të individit.**

- iii) Një çështje tjetër të cilën e konsiderojmë të rëndësishme është problematika që kemi pasur me përmbarues privatë dhe Ministrinë e Drejtësisë për pozicionin tonë ndaj tyre si subjekt. Në mënyrë të gabuar, kuptohet se, veprimtaria e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Privat është jashtë sferës sëkompetencës dhe juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky kuptim i dhënë prej organeve të lart përmendura bie ndesh me parashikimet e nenit 3/6 të Kodit të Procedurës Administrative si dhe nenit 2 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*” të ndryshuar.

Gjithashtu nga përmbarues gjyqësorë të veçantë në procesin e marrdhënieve me Avokatin e Popullit janë shfaqur qëndrime refuzuese për dhënie informacioni dhe shpjegime në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Ky qëndrim vjen si rrjedhojë e mosnjohjes dhe interpretimit të gabuar të kuadrit ligjor, përse i përket prevalimit të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “*Për Avokatin e Popullit*” të ndryshuar, mbi ligjin nr.26/2019, “*Për Shërbimin e Përmbarimit Gjyqësor Privat*”.

3.8. Respektimi i të drejtës së pronës

Çështja e respektimit të të drejtës së pronës edhe përgjatë vitit 2019 ka qenë objekt vlerësimi prej institucionit të Avokatit të Popullit. Numri i ankesave që lidhen me këtë çështje mbetet ende shumë i lartë dhe problematikat që duhen adresuar janë shumë komplekse e të akumuluar vit pas viti. Në ushtrim të kompetencave dhe detyrave të tij funksionale, institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë mjaft aktiv dhe i fokusuar në trajtimin dhe shqyrtimin në themel të disa prej problematikave kyçe të të drejtës së pronës të ndjeshme dhe delikate për individë të veçantë apo edhe komunitete të gjera individësh¹⁸.

Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, veçanërisht të drejtës së pronës nga ana e organeve dhe institucioneve shtetërore, përgjatë viteve ka vijuar të ketë problematika të cilat kanë shkelur midis të tjerave të drejtën e pronësisë apo cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor sikurse garantuar respektivisht në nenin 41 dhe 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ, nenin 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut¹⁹.

Avokati i Popullit thekson se e drejta e pronës duhet të mbrohet e garantohet jo vetëm në tekstet e ligjeve dhe akteve nënligjore por duhet të jetë në themel të punës së çdo institucioni të administratës shtetërore për të garantuar zbatimin efektiv të kësaj të drejte. Por, zbatimi i kërkesave të shtetit të së drejtës duke siguruar procedura ligjore që garantojnë zbatimin e paanshëm dhe uniform të ligjit, pjesëmarrjen e personave të prekur, transparencën e proceseve vendimmarrëse dhe lufta ndaj tendencave të korrupsionit, ka vijuar të jetë problematikë e veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore.

¹⁸ Shih gjithashtu edhe Raportet e Veçanta të hartuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në faqen zyrtare <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>

¹⁹ Miratuar prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “*Për ratifikimin e Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore*”.

Organe të caktuara publike nuk kanë zhvilluar në mjaft raste veprimtarinë administrative në përputhje me parashikimet e kryera në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke cënuar në këtë mënyrë të drejtat subjektive apo interesat e ligjshme të individit në mënyrë të paligjshme. Zbatimi i saktë dhe i plotë i kërkesave dhe dispozitave të ligjit nuk është parë si funksioni më i rëndësishëm, prej organeve të caktuara administrative. Mospërbushja dhe mosushtrimi i detyrave ligjore në mënyrë efikase, ekonomike të drejtë dhe të përshtatshme si dhe sa më shpejtë të jetë e mundur janë situata të konstatuara në veprimtarinë administrative të disa organeve publike.

Konstatimi i situatave të tilla, tregon se realizimi efektiv i funksioneve publike administrative nuk ka ndodhur.

Krijimi i një institucioni të vetëm, Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllimin e centralizimit të të gjithë veprimtarisë së institucioneve si ish-ZVRP dhe ish-ALUIZNI, u realizua formalisht dhe vetëm fizikisht pa një qasje të mirëfilltë në mënyrën e zgjidhjes së problematikës që këto institucione kanë patur kur kanë funksionuar në mënyrë të pavarur.

Një adresim i tillë i gabuar në formalizimin e institucioneve të reja nuk ka dhënë efektivitet në veprimtarinë e përbushjes së detyrave ndaj subjekteve, individëve dhe ka shkaktuar një fragmentarizim të veprimtarisë së tyre, si dhe shmangie nga funksioni më i rëndësishëm i tyre administrativ, përgjigjia në kohë dhe zgjidhja e problematikave të konstatuara në çështjet e pronave.

Po ashtu, miratimi i VKM-së nr.138, datë 23.02.2018, *“Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi në zonën me rëndësi për fondin mbështetës së investimeve strategjike”* të ndryshuar është konsideruar prej Institucionit tonë në shkellje të së drejtës së pronësisë si dhe parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor²⁰.

Prezantimi i kësaj çështjeje në Gjykatën Kushtetuese nga ana e Institucionit tonë nuk u bë e mundur, pikërisht për shkak të mosfunksionimit të kësaj Gjykate. Shfuqizimi i vendimit nga vetë organit që e miratoi, me anë të VKM-së nr.241 datë 04.04.2019 në vlerësimin tonë është tregues reflektimi.

Kuadri ligjor për të drejtat e pronës në Shqipëri ka dobësi ligjore dhe teknike të cilat thellohen edhe më shumë për shkak të zbatimit jo uniform të ligjit. Ende nuk ofrohet siguri juridike për të drejtën e pronësisë dhe se kuadri ligjor që e trajton këtë çështje është i komplikuar dhe ndryshon vazhdimisht. Kjo situatë është komentuar prej Komisionerit të BE-së, z. Hahn në mënyrë të sintetizuar, se: *“... Përmbyllja e sigurisë ligjore dhe qartësia e titujve të pronësisë nuk është arritur ende plotësisht, pavarësisht nga vazhdimi i përpjekjeve për arritjen e tyre. Copëzimi, fragmentarizimi ligjor, zbrastëritë në sistemin e regjistrimit dhe zbatimi i tij në këtë fushë mbeten*

²⁰Parashikuar në nenin 41, 42/2 të Kushtetutës së Shqipërisë apo nënenin 1 të Protokollit nr.1 si dhe nenin 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ratifikuar me Ligjin nr.8137/1996.

të adresohen në të gjithë vendin...."²¹. Po kështu edhe përfaqësues të Bankës Botërore, pas inspektimit të drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kanë konkluduar se:

- Hartat ekzistuese kadastrale kanë një tendecë të lartë të mos jenë në përputhje me situatën në terren.
- Problematika që haset më shpesh është se njësitë e pasurive të paluajtshme (parcelat dhe ndërtesa) në shumë raste janë të pozicionuara gabimisht. Me kalimin e kohës për shkak të ndryshimeve në specifikime dhe referencë, problematika është rritur.
- Në shumë raste, kur ka kopje të ndryshme fletë harte, vihet në diskutim se cila hartë është aktuale apo e sakta.
- Në zyrat e ASHK-së të dhënat mbi parcelat nuk mungojnë por nuk dihet me saktësi statusi i pronës²².
- Situata është përgjithësisht më e ngatërruar në zonat urbane, sidomos në Tiranë dhe rreth saj si dhe në zonat bregdetare më të mëdha, ku ka shumë ndërtime informale.
- Gabimet më së shumti janë akumuluar për shkak të mospërputhjeve që vijnë edhe nga mungesa e dokumentacionit.
- Gabimet në regjistrimet e pronave përgjithësisht reflektojnë kufinj të gabuar, madhësinë e parcelës dhe dokumentacionin e pronësisë.
- Gabimet zakonisht zbulohen në kohën kur bëhet një transaksion në njësinë përkatëse të pasurive të paluajtshme. Në kohën kur bëhet një transaksion, pronari i pronës ose pronarët ngjitur të pronave nuk kanë njohuri për gabimet mbi pasurinë²³.

Përveç konstatimeve dhe gjetjeve të lartpërmendura, Institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e shqyrtimit të rasteve të prezantuara nga individë të ndryshëm ka konstatuar se:

- Organet e administratës publike²⁴ në nivel lokal kanë nivel të ulët bashkëpunimi apo ndërveprimi dhe nuk përmbushin detyrimin ligjor për dhënie shpjegimesh dhe informacioni Avokatit të Popullit në afatin ligjor të caktuar, situatë kjo e konstatuar vit pas viti. Ky problem krijon jo vetëm pakënaqësi te qytetarët për moskryerjen e shërbimit qëduhet të kryejnë në zbatim të legjislacionit në fuqi por ul edhe besimin e qytetarëve te efektiviteti i institucionit tonë. Kjo çështje nuk ka marrë vlerësimin e duhur as nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, as nga vetë Ministria e Drejtësisë.
- Po ashtu, këto organe në nivel lokal nuk përmbushin detyrimin ligjor për qëndrimin në lidhje me zbatimin rekomandimet e adresuara nga Avokati Popullit.
- Procesi administrativ i shqyrtimit të vetëdeklarimeve të kryera në vite prej subjekteve të ndryshëm nuk ka përfunduar edhe pse është tejkaluar çdo afat i arsyeshëm. Drejtoritë Vendore të ASHK-së vijojnë nxjerrjen e lejeve të legalizimit me ekstremitete të paqarta si

²¹ <https://www.dë.com/sq/hahn-shqip%C3%ABria-situat%C3%AB-problematike-me-t%C3%AB-drejt%C3%ABn-e-pron%C3%ABs/a-4840086>

²² <https://shqiptarja.com/lajm/pronat-banka-boterore-regjistrimi-i-te-patundshmeve-lemsh-me-hartat-ne-shqiperi>.

²³ <https://www.monitor.al/projekti-i-bb-hartat-e-pronave-ne-hipoteka-pa-lidhje-me-realitetin/>

²⁴ Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK dhe Bashkitë.

dhe mangësi në formën dhe përmbajtjen ligjore të kërkuar²⁵.

- Subjektet shtetërore apo jo shtetërore, kanë vijuar dhe vijnë mos përmbushjen e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 196 të Kodit Civil, neni 24, i ligjit “Për Kadastrën” për dërgimin për regjistrim të akteve/vendimeve pranë drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës²⁶. Në këtë situatë të mos respektimit të ligjit ndodhen edhe të gjitha gjykatat e vendit, noterët apo përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë/privatë dhe organet e tjera shtetërore.
- Detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 24/2 të ligjit nr.111/2018, “Për Kadastrën” për deklarimin nga ana e organeve të aktit/vendimit në Kadastrën Digjitale Kombëtare nuk mund të kryhet pikërisht për shkak të mos funksionimit të saj.
- Organet e administratës publike në nivel lokal nuk ushtrojnë të drejtën e kërkimit për saktësimin e dokumentacionit të pronësisë pranë subjektit që e ka nxjerrë titullin e pronësisë por e kanë adresuar dhe e adresojnë këtë kërkim tek subjekti përfitues i së drejtës së pronësisë. Kjo situatë konstatohet sidomos në procesin e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi.
- Gabimet që kanë ardhur nga veprimtaria e ish – zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sot drejtoritë vendore të ASHK-së nuk korrigjohen edhe pse korrigjimi i gabimit të konstatuar. sipas ligjit nr.111/2018, “Për Kadastrën” është i detyrueshëm për t’u kryer.
- Administrimi në ish-zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sot Drejtoritë apo Zyrat Vendore të ASHK-së, i disa titujve të pronësisë për një pasuri/pronë ka krijuar mbivendosje të titujve, e cila ka gjeneruar më tej konflikte gjyqësore të individëve apo subjekteve të ndryshme.
- Gjithashtu duhet theksuar se Drejtoritë Vendore të ASHK-së nuk kanë përfunduar apo nisur regjistrimin fillestar të pronave në 353 zona kadastrale. Mungesa e regjistrimit fillestar të pasurive në këto zona kadastrale ka sjellë pasiguri të individëve në dokumentet e pronësisë që zotërojnë. Pasuria mund të zotërohet me dokumenta nga më shumë se një individ. Pasiguria ligjore e dokumentave të pronësisë që zotërojnë mbajtësit e titullit në këto zona reflektohet së pari në konfliktet e mundshme me persona/individë/subjekte që zotërojnë edhe ata dokumente pronësie për të njëjtën pronë, pasojë e të cilave, përveç cënimit të të drejtës së pronësisë mbi qarkullimin civil të sendit, gjeneron edhe në konflikte, deri në humbje jete. Nëse do të kishte nisur procesi i regjistrimit fillestar në këto zona,

²⁵ Shih Raportin e veçantë të përgatitur prej Institucionit të Avokatit të Popullit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja” në <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20p%C3%ABr%20zon%C3%ABn%20e%20Astirit.pdf>

²⁶ Ligji nr.111/2018 “Për kadastrën” përcakton shërbimin publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organizimin e institucionit përgjegjës për këtë shërbim dhe mënyrën e administrimit të kadastrës si regjistër publik i pasurive të paluajtshme. Ky institucion i krijuar nga ligji është Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe sipas pikës 1 të nenit 67 të ligjit, krijimi i saj bazohet në bashkimin e Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, ALUIZNI-t dhe ZRPP-së. Nga ky bashkim institucionesh të veçanta me juridiksionin dhe kompetencat e tyre respektive ligjore, del e qartë se Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka tashmë përgjegjësinë e vazhdimit dhe përfundimit të procesit të përcaktuar nga ligji nr.9482 datë 3.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar por nuk ka kompetenca në dy proceset e tjera të sipërcituara që lidhen me të drejtën e pronës.

individët/subjektet që zotërojnë dokumente pronësie për të njëjtën pronë do të ishin orientuar më shpejt për zgjidhjen e problematikës në rrugë gjyqësore dhe regjistrimin përfundimtar të pasurisë.

- Edhe në ato zona kadastrale ku ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurisë në përputhje me ligjin 111/2018 “Për Kadastrën” ka problematika të shumta në drejtim të pajisjes së individëve apo subjekteve me aktet kadastrale si çertifikata, kartela etj., pasi ende këto zyra kërkojnë nga individët dokumentacion plotësues edhe pse ky është një detyrim për tu zbatuar nga vetë zyrat vendore të ASHK-së.
- Mungesa e arkivës digjitale, e cila përfshin të gjithë dokumentacionin arkivor pranë Drejtorive Vendore të ASHK-së, përbën një problematikë të pazgjidhur ndër vite.
- Në ish-zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sot Drejtoritë Vendore të ASHK-së në kundërshtim me parashikimin e kryer në nenin 196 të Kodit Civil apo nenin 24 të ligjit “Për Kadastrën”, vazhdon të jetë problematik fakti i mosregjistrimit të vendimeve të gjykatave që kanë të bëjnë me të drejtën e fitimit të pronësisë, kryesisht parashkrimin fitues sipas parashikimeve të Kodit Civil, me argumentin se zyrat nuk kanë qenë palë në këto procese gjyqësore.
- Rreth 80% e numrit të pronave të regjistruara janë me probleme, sipas deklarimeve të vetë kreut të ASHK-së.²⁷ Rreth 220,000 akte të marrjes së tokës në përdorim të nxjerra në zbatim të ligjit nr.7501/1991 “Për tokën”, i ndryshuar, ende janë të paregjistruara të cilat përfaqësojnë gjysmën e tokës së punueshme në fshat. Janë për tu pajisur ende dhe 20000 familje bujqësore me AMTP.²⁸
- Rreth 160.000 prona (96% e totalit) që u kanë kaluar njësive vendore janë ende të paregjistruara.
- Rreth 10% e banesave të ndërtuara para vitit 1991, ende nuk janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme.²⁹
- Komunikimi në linjë telefonike, me zyrat e drejtorive vendore të ASHK-së është totalisht i pamundur edhe pse linjat janë disponibël që do të thotë se kjo mënyrë aksesit për qytetarët është jo funksionale.

²⁷<https://abcneës.al/kreu-i-ri-i-hipotekave-prezantohet-artan-lame/>

²⁸<http://gazetashqiptare.al/2019/04/07/agjencia-shtetore-te-kadastres-te-regjistroje-220-mije-amtp/>

²⁹Sipas Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, situata e respektimit të së drejtës së pronësisë përgjatë viteve të shkuara e deri më sot është prezantuar në mediat vizive me këto fjalë: “... Ditë pas dite ne kemi grumbulluar dhe vijaime të evidentojmë raste abuzimi me pronën, qoftë atë publike e qoftë atë private. Ky evidentim nuk bëhet thjesht se s’kemi me ç’merremi apo se duam të çojmë njerëz përpara drejtësisë. Ky evidentim bëhet, sepse abuzimi me pronën është shkelje e rendit kushtetues është bllokim i jetës ekonomike të vendit. Në këta 6 muaj operim të Kadastrës së re Shqiptare janë kryer 30 audite, kontrole dhe verifikime nëpër të gjitha drejtoritë vendore. Janë marrë 120 masa, përfshirë edhe largimet nga detyra, madje si një risi e jona të gjitha masat janë shoqëruar edhe me vendosje gjobash ndaj punonjësve. Janë trajtuar në këta muaj rreth 7500 ankesa nga publiku dhe nga institucione të ndryshme, ku pjesa dërmuese ka sfond grabitjen e të drejtës së pronës. Do të mjaftonin këto shifra për të dëshmuar se sa i thellë është problemi, se sa e thellë ka qenë reforma dhe se sa e madhe është pritshmëria e publikut ndaj këtij institucioni të ri. Harta e abuzimeve me pronat përfshin të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë por është e kuptueshme që këto abuzime dëndësohen në zonat me interes ekonomik, pra pikërisht në zonat ku vendi dhe ekonomia duhet të tregohen më të hapura ndaj investimeve, zhvillimeve dhe iniciativës së lirë” <https://shqiptarja.com/video/problemet-me-pronat-kreu-i-kadastres-artan-lame-kemi-trajtuar-7-500-ankesa-tokat-ne-disa-zona-dalin-me-nga-4-pronare>.

- Lidhur me vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare, ATP-ja ka përfunduar vlerësimin financiar për 9458 vendime prej të cilave: **a.** 8642 vendime u vlerësuan financiarisht me një vlerë prej 34 156 228 643 lekë (e cila mund të ndryshojë për shkak të ankimeve); **b.** 632 vendime konsiderohen të kompensuara referuar nenit 7, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 133/2015; **c.** 184 vendime u njohën me të drejtën e parablerjes. ATP bazuar në detyrimin ligjor për përfundimin e procesit të vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare, brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 133/2015, (datë 23 Shkurt 2019) ka vlerësuar financiarisht 25 314 vendime përfundimtare që i përkasin periudhës 1993-2013³⁰. Avokati i Popullit shpreh rezervat e tij lidhur me procesin e vlerësimit financiar të vendimeve të ish-organeve të ngarkuara me ligj me procesin e kthimit dhe kompesimit të pronave si edhe numrin e dosjeve që nuk janë trajtuar dhe shqyrtuar në zbatim të nenit 34 të Ligjit 133/2015. Për shkak të problemeve dhe burokracive që kanë karakterizuar këtë proces ndër vite, tashmë shtetasit shqiptarë të prekur nga kjo procedurë të trajtimit të kërkesave të tyre dhe rivlerësimi financiar të vendimeve respektive që dispononin prej vitesh në vend që të kompesohen me vlerën e njohur ndër vite, duke marrë në konsideratë përkundrazi edhe interesat apo fitime munguar për atë vlerë të mohuar ndër vite, detyrohen tashmë të enden nëpër gjykata për të kërkuar rivlerësimin dhe verifikimin e vendimeve apo akteve administrative respektive. Për shkak të prolematikës dhe bllokimit që karakterizon tashmë strukturat gjyqësore, proceset e iniciuara nga individët për këto akte administrative, gjykojmë se nuk do të mund të përfundojnë edhe për disa vite. Kjo çështje po vijon të shqyrtohet nga Avokati i Popullit në vijim të të cilit kemi kërkuar dhe po vijojmë të marrim informacionet zyrtare tashmë nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore lidhur me kërkesat që ata kanë pranuar dhe po shqyrtojnë përsa i përket rivlerësimin financiar të ish-vendimeve të strukturave të kthim/kompesim pronave. Më datë 23 shkurt 2019 ka përfunduar afati i vlerësimit të 25.314 vendimeve përfundimtare të dhënë deri në vitin 2013 prej ATP-së, sipas së cilave është vendosur për njohjen e pronës me të drejtë kompensimi. Agjencia e Trajtimit të Pronave, ashtu sikurse është parashikuar në ligj nuk ka arritur të kryejë brenda tre viteve vlerësimin financiar për 2.886 vendime. Për gjithë vendimet, sipas të cilave është vendosur për njohjen e pronës me të drejtë kompensimi, subjektet duhet që t’i drejtohen gjykatës.
- Mospërfundimi i procesit administrativ në afatin ligjor të përcaktuar, përveç se ka cënuar parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, rëndon padyshim edhe pushtetin gjyqësor me çështje për gjykim dhe zvarrit akoma më shumë zgjidhjen e kësaj çështjeje problematike. Rezulton e qartë se qëllimi i ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave” nuk realizuan qëllimin e tij për të përmbyllur procesin e kthimit dhe kompesimit të pronës për të cilën edhe u ndryshua thelbësisht mënyra e kompesimit dhe kthimit të vlerësë pronës. Gjejmë rastin të vlerësojmë se sistemi gjyqësor ende nuk ka mundur të trajtojë deri në fund (pra në të tre shkallët e sistemit gjyqësor) çështjet që ishin në gjykim në momentin e miratimit të ligjit nr. 133/2015 dhe sigurisht as rishikim gjyqësor të vendimeve të dhëna nga ATP në

³⁰<http://atp.gov.al/>.

përputhje me ligjin e ndryshuar. Në këtë kuptim, problematika e çështjes së kthimit dhe kompensimit të pronave mund të konsiderohet larg zgjidhjes përfundimtare.

- Mosekzekutimi deri më sot, i vendimeve të dhëna deri në vitin 2013 prej ATP-së, me të drejtë kompensimi ka bërë që ky proces të mbetet ende në kuadrin deklarativ. Janë ekzekutuar vetëm 2.2% e numrit të përgjithshëm të vendimeve të dhëna me të drejtë kompensimi.
- Përmbushja e detyrimit ligjor prej Agjencisë së Trajtimit të Pronës për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e pronës me të drejtë kthimi në natyrë apo kompensimi të saj nuk ka ndodhur.

Përpos konstatimeve të sipër përmendura, institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të kompetencave dhe detyrave të tij funksionale, përveç trajtimit të ankesave ka qenë mjaft aktiv dhe ka ndjekur me vëmendje duke analizuar në detaje propozimet/ndryshimet ligjore në lidhje me çështjet e pronave³¹. Vlen të theksohet këtu projektligji “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ku institucioni ynë ka dhënë disa mendime si në takimin me Komisionin e Venecias³², ashtu edhe me përfaqësues të institucioneve për përmirësimin dhe mirëfunksionimin e strukturave shtetërore të cilat kanë përgjegjësinë ligjore të trajtimit të një problematike mjaft të gjerë dhe komplekse, siç është ajo e pronës në Shqipëri³³. Vlen të përmendet se ky projekt ligj në fazën e parë nuk ka pasur një diskutim të gjerë publik, duke u konsideruar si një akt procedural në lidhje me të drejtën e pronësisë dhe jo si një akt që do të krijonte ndër të tjera edhe shumë probleme për titujt e pronësisë që qytetarët kishin e mbanin prej vitesh, duke ia nënshtruar vlefshmërinë e tyre rishikimit nga organet administrative. Kjo do të çonte qytetarët në një pasiguri të madhe e të vazhdueshme për titujt e tyre për shkak se ato nuk ishin regjistruar nga organet administrative që duhet të bënin një veprim të tillë.

Theksojmë se regjistrimi i titujve të pronësisë është një shërbim që garantohet nga shteti e lidhet me garancinë që ky i fundit u jep qytetarëve në lidhje me titull mbajtësin e një sendi të paluajftshëm dhe ky detyrim nuk mund t’i kalohet automatikisht qytetarit nëse shteti dështon të krijojë sistemet e duhura të regjistrimit, siç ka ndodhur prej vitit 1991 e në vijim. Nga ana tjetër, praktika e delegimit të rregullimit të shumë çështjeve për trajtim përmes akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe jo në ligje (apo çështje të tilla me rëndësi të madhe për të drejtën e pronësisë së qytetarëve), krijon probleme të mëdha për lirinë dhe drejtat e individëve. Kjo jo vetëm për faktin se në praktikë aktet nënligjore kanë krijuar jo pak rregulla që nuk janë në frymën e ligjit por edhe se aktet në të shumtën e rasteve kanë dalë shumë më vonë se afatet e parashikuara në ligj, duke paralizuar tërësisht veprimtarinë e organeve shtetërore, duke cënuar të drejtat e individit dhe rritur pasigurinë e tyre juridike.

³¹ Shih për shembull Ligjin nr. 9/2019 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve” të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 11.12.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private në funksion të planeve të përgjithshme vendore”.

³² <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/home/neës/this-article-is-available-only-in-albanian-309/>

³³ Komisioni i Venecias në datë 19.10.2019 ka dhënë një Opinion për Shqipërinë, “Mbi draftligjin për përfundimin e proceseve të pronësisë”, ku ndër të tjera ka dhënë edhe disa rekomandime konkrete lidhur me nenin 6, 7 dhe 9 të projektligjit në fjalë.

Në këtë kuptim, vlerësojmë se gjetjet e Komisionit të Venecias në Opinionin e tyre nr. 952/2019 në lidhje me këtë çështje janë shumë të vlefshme dhe qartësisht kanë ndikuar në përmirësimin rrënjësor të ligjit nga drafti i miratuar nga Komisioni i Ligjeve dhe parashtruar për konsultim publik³⁴ në atë të miratuar me Ligjin nr. 20/2020³⁵, pas opinionit të Komisionit të Venecias. Një procedurë më e hapur, më e strukturuar e mëkonstruktive e konsultimit publik për draftin, para se ai të dërgohej për mendim në Komisionin e Venecias, do të kishte kursyer mjaft energji dhe do të kishte arritur më lehtë qëllimin e lavdërueshëm të adresimit të problematikave të ngritura më lart në lidhje me të drejtën e pronës.

Së fundmi, Avokati i Popullit ngre shqetësimin për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet e pronësisë. Vendimet e kësaj Gjykate kanë dy qëllime kryesore. Së pari, ato adresojnë një veprim apo mosveprim konkret të shteteve për të garantuar të drejtat dhe detyrimet sipas Konventës, ose një praktikë në shkelje të këtyre të drejtave, duke vendosur më pas në rastin e konstatimit të shkeljeve, një dëmshpërblim për t'iu paguar individit ankues. Qëllimi kryesor i vendimeve të Gjykatës është eliminimi i praktikave në shkelje të të drejtave dhe detyrimeve të Konventës; dëmshpërblimi është tërësisht dytësor në realizimin e qëllimit që ka ky Mekanizëm i zbatimit të Konventës.

Në vendin tonë vërejmë me keqardhje se në lëmin e të drejtës së pronës, ky aspekt nuk trajtohet në mënyrën e duhur dhe vendimet shihen veç si shuma detyrimi por jo si udhëzim apo interpretim përfundimtar për të konstatuar praktikën e paligjshme dhe cënuesen për të drejtat e njeriut, sipas parashikimeve të Konventës. Në këtë drejtim, mendojmë se Kuvendi së pari si edhe më pas administrata shtetërore në përgjithësi por edhe Avokati i Shtetit³⁶ në veçanti, duhet të kenë fokusin e duhur në vlerësimin, shmangien dhe eliminimin e praktikave që kanë çuar në cënimin e të drejtave të qytetarit në përgjithësi por edhe të së drejtës së pronësisë në veçanti, duke qenë se aplikimet më të shumta në GJEDNJ kanë qenë në lidhje me këtë çështje.

3.9. Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës

Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit për të drejtat e fëmijës, gjatë vitit 2019, vitit jubilar që shënoi dhe 30 vjetorin e Konventës së OKB “Për të Drejtat e Fëmijës” ka vijuar e ndërthurur në tre funksione kryesore: atë të **mbrojtjes**, **promovimit** dhe të **garantimit** të të drejtave të fëmijëve.

Gjatë vitit 2019 në kuadër të 30 vjetorit të Konventës së OKB-së, institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol proaktiv në promovimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve në organizimin

³⁴ Shih varantin në

[https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_102_Projektligji%20"Per%20perfundimin%20e%20proceseve%20kalimtare%20te%20pronesise%20ne%20Republiken%20e%20Shqiperise".pdf](https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_102_Projektligji%20)

³⁵ Shih varantin përfundimtar në

<http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200310112944ligji%20nr%20%2020%20dt%20%205%203%202020.pdf>

³⁶ Shih nenin 8 pika 3 të Ligjit 20/2020 në të cilin parashikohet kompetenca e Avokatit të Shtetit për ngritjen e padisë për pavlefshmërinë e akteve që nuk mund të regjistrohen dhe njohjen e pronësisë së shtetit mbi pronën.


e veprimtarive të ndryshme dhe ditëve të hapura, duke kulmuar me organizimin për herë të parë të Konferencës së Rrjetit Rajonal të Ombudsmanëve për Fëmijë të Europës Juglindore (CRONSEE). Një vëmendje e shtuar i është kushtuar përgjatë këtij viti, trajtimit të problematikave më të ndjeshme të të drejtave të fëmijëve, e kryesisht trajtimit të rasteve të dhunës ndaj fëmijëve dhe garantimin e mbrojtjes së tyre si dhe në vijimësi, promovimit të të drejtave të fëmijëve.

Në ndryshim nga viti 2018, 2019 ishte viti në të cilin Avokati i Popullit filloi zbatimin në praktikë të veprimtarive të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, pjesë e planit strategjik të institucionit³⁷.

Kjo strategji shërben si udhërrëfyes në drejtim të monitorimit, vlerësimit dhe analizimit të vetë veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit në përmbushjen e objektivave strategjike për garantimin e përfshirjes drejtpërdrejt të fëmijëve dhe ndarjes me ta të përvojave dhe perspektivës së fëmijëve në drejtim të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të tyre.

Gjithashtu, vlen për t'u theksuar se për herë të parë, institucioni ynë mundësoi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e RSH-së në projektin ENYA të Rrjetit ENOC³⁸.

Paraqitja skematike e funksioneve themelore të institucionit të AP-së në drejtim të përmbushjes së tre drejtimeve kryesore të veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve është si vijon:



³⁷Qëllimi i strategjisë dhe planit të veprimit është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet shqyrtimit profesional e në kohë të ankesave, promovimit të rolit proaktiv të institucionit në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe bashkëpunimit efektiv me administratën shtetërore dhe aktorët e shoqërisë civile.

³⁸Pjesë e ENOC (Rrjetit European të Ombudsmanëve për Fëmijët) organizuar në 2019 në Bruksel. Në këtë veprimtari, fëmijët nga të gjitha vendet anëtare të rrjetit ENOC, përfshirë edhe fëmijët që përfaqësonin vendin tonë, u përfshinë në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve për rezolutën “Për të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital”. Kjo veprimtari e ENOC-ut kishte si qëllim rritjen e kapaciteteve, lidhur me politikat e mbrojtjes së fëmijëve në mjedisin digjital. Këto rekomandime të ENOC do të bëjnë të mundur hartimin dhe nxjerrjen e udhëzimeve të Këshillit të Europës të cilat do të pasqyrojnë një qasje gjithëpërfshirëse strategjike për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijës në mjedisin digjital.

Për vitin 2019 në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara janë trajtuar rreth **150 raste**, ankesa, kërkesa, raste me iniciativë, me objekt të drejtat e fëmijëve, prej të cilave, **95 raste me iniciativë**. Nga numri total i trajtimit të rasteve në sistemin e regjistrimit për herë të parë, kemi rritjen e ankesave të kryera drejtpërdrejt nga vetë fëmijët të tilla **10 raste**. Ky numër ankesash nga vetë fëmijët edhe pse modest është motivues për përpjekje e punë të shtuar nga institucioni për një qasje miqësore të drejtpërdrejtë tek vetë fëmijët për çdo ankesë/kërkesë që ata mund të kenë.

Pavarësisht numrit të ankesë/kërkesave të trajtuara apo edhe rasteve me iniciativë, theksojmë, se shumë nga ankesat e trajtuara kanë patur si objekt një numër të caktuar individësh – fëmijë dhe nga trajtimi i tyre mund të kenë përfituar një numër edhe më i madh ankues/kërkuesish. Kjo do të thotë, se kemi arritur të trajtojmë e prekim një numër të konsiderueshëm problematikash dhe rastesh, ku të miturit kanë qenë prezent, madje edhe thelbi i tyre. Po kështu, përgjatë vitit 2019, institucioni ynë ka trajtuar një sërë problematikash për respektimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar, ndër të cilat mund të përmendim ankesat për mospagimin e kontributeve shoqërore për statusin e ndihmësit personal të miratuar me Vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP) si rezultat i aftësisë së kufizuar të fëmijës³⁹.

Gjatë vitit 2019, institucioni i Avokatit të Popullit, u ka drejtuar institucioneve shtetërore të administratës publike në nivel qendror dhe vendor, **20** (njëzet) rekomandime, përfshirë këtu edhe rekomandimet e adresuara, nëpërmjet raporteve sintezë. Nga numri total i rekomandimeve, **8 (tetë)** prej tyre janë pranuar, **10** (dhjetë) janë në proces dhe **2** (dy) prej tyre nuk janë zbatuar⁴⁰.

Në vitin 2019 janë trajtuar, me iniciativën e Avokatit të Popullit, **95 raste**, me objekt të drejtat e fëmijëve dhe si burim kryesor për identifikimin e tyre kanë shërbyer mediat e shkruara apo vizive si dhe rrjetet e ndryshme elektronike e sociale. Kryesisht, objekt i përbashkët i shumicës prej tyre kanë qenë **probleme të natyrës sociale-ekonomike të tilla si:** trajtim familjesh me shumë fëmijë nga sistemi i ndihmës ekonomike, shërbimet e kujdesit shoqëror, etj. Nëpërmjet trajtimit të rasteve me iniciativë nga korrespondencat e shkëmbyera me përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, kemi synuar, jo vetëm zgjidhjen e problematikave të parashtruara mediatikisht por edhe promovimin dhe nxitjen e një kulture të re të respektimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe zbrërthimit konkret të tij në praktikë nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse si dhe të detyrimeve që burojnë nga ligji nr.18/2017. Në praktikën tonë administrative, sërish vijojmë të konstatojmë problematika dhe sfida që lidhen me zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, lidhur me:

- **ngritjen e shërbimeve të reja** në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve;
- **hartimin e politikave gjithëpërfshirëse** sociale në nivel vendor, bazuar në një bazë të dhënash

³⁹Rezultojnë të regjistruara në sistemin e trajtimit të ankesave, rreth **7 (shtatë) ankesa**, me të njëjtën problematikë.

⁴⁰Nga rekomandimet e pazbatuara janë, një rekomandim drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me garantimin e të drejtave të nxënësve të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe rekomandimi i dytë i është drejtuar Bashkisë Lushnjë.

- të sakta mbi numrin e familjeve në nevojë si dhe kategoritë e fëmijëve me probleme sociale;
- **mungesën e buxheteve të nevojshme** të dedikuara për garantimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës;
- **fuqizimin e mekanizmave shtetërorë përgjegjës** që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- **analizën dhe rishikimin tërësor të kuadrit ligjor në fuqi** në të gjithë sektorët e linjës për t’u harmonizuar me ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe ligjin nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, sikundër edhe garantimin e harmonizimit, ndërmjet këtyre dy ligjeve;
- **vlerësimin e kapaciteteve të profesionistëve** të fushave të ndryshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve;
- **angazhimin e anëtarëve të GTN (Grupit Teknik Ndërsektorial)** për të zbatuar detyrimet ligjore dhe institucionale në kuadër të menaxhimit të rastit dhe të ndjekjes së planit individual të mbrojtjes.

Avokati i Popullit për një ndër rastet e trajtuara me iniciativë⁴¹, gjatë vitit 2019 e që vlen për t’u përmendur si për nga natyra e çështjes së trajtuar në të, ashtu edhe nga përmbajtja e problematikave të evidentuara gjatë hetimit administrativ të kryer nga institucioni i AP-së është rasti që ka të bëjë me shkeljen e një ndër të drejtave më themelore të fëmijës (e pa trajtuar më parë), **liria e organizimit dhe tubimeve paqësore**. Duke patur parasysh edhe ligjërimin e kahershëm të garantimit të të drejtave të fëmijëve, AP konstatoi mosfunksionimin e të gjitha hallkave zinxhir të mekanizmave të parashikuara në legjislacionin parauniversitar, gjë që ka passjellë shkeljen e të drejtave të fëmijëve për t’u dëgjuar e për t’u organizuar në interesin më të lartë të tyre. Kjo si rrjedhojë e mosvlerësimit të aftësive dhe zërit të tyre si dhe ushtrimit të kompetencave dhe detyrave funksionale nga ana e stafit drejtues të shkollës në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Në mënyrë që edukimi i fëmijëve të kryhet në një mjedis të qetë, duke garantuar të drejtën e tyre për t’u arsimuar, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës⁴², kemi rekomanduar ndër të tjera:

- Forcimin e punës për **përsosjen e marrëdhënieve edukatorë-fëmijë, mësues-nxënës**: marrëdhënie bashkëpunimi për arritjen e realizimit të objektivave të përbashkëta për një edukim cilësor, bashkëkohor; marrëdhënie bashkëpunëtorësh që sigurojnë një shtrat të shëndetshëm për funksionimin e metodave aktive krijuese në edukim e arsimim; marrëdhënie të shëndetshme që nuk i lënë shteg shfaqjes dhe veprimit të autoritarizmit në edukim si dukuri karakteristike e shoqërive jodemokratike; marrëdhënie të sinqerta që synojnë përmirësim e jo penalizim që ndikojnë fuqishëm në formimin e autoritetit të vërtetë të edukatorit dhe nxënësit në konsolidimin e respektit real të ndërsjellë.

⁴¹Në mediat vizive janë transmetuar dy video të realizuara në mjediset e shkollës së mesme të përgjithshme “Sami Frashëri”, ndërmjet nxënësve dhe drejtuesit të këtij institucioni, me temë protestën e studentëve në muajin dhjetor 2018.

⁴²Në zbatim të neneve 18 e 28 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës si dhe të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

- Marrjen e masave nga institucionet edukative e më gjerë për të punuar më shumë me fëmijët në **drejtim të edukimit, ndërgjegjësimit dhe informimit të tyre**, lidhur me të drejtën e tubimit dhe organizimit dhe të promovojnë praktika të mira pune për përmbushjen e kësaj të drejte. Si rrjedhojë, fëmijët të mos përdoren nga askush dhe kurrkush por të shfaqin aftësitë e tyre për zgjidhjen e problematikave që lidhen drejtpërsëdrejti me ta në mënyrë paqësore dhe në zbatim të rregullave të caktuara.

Një tjetër rast kompleks e delikat, i trajtuar me nismën tonë dhe që vlen të përmendet ka të bëjë me abuzimin seksual të një minoreneje, rast i publikuar edhe në mediat vizive e të shkruara. Avokati i Popullit kreu hetimin administrativ mbi këtë çështje dhe nëvlerësim të informacionit të gjeneruar, konstatoi mospërmbushjen e detyrimit që kanë mekanizmat shtetërorë përgjegjës në rastet kur vërejnë ndodhi të abuzimit të fëmijës apo kanë dyshime, mungesë të bashkëpunimit e bashkërendimit institucional, ndërmjet institucioneve shtetërore në nivel vendordhe komunikim i fragmentarizuar, bazuar në një qasje individuale, jofunksionale, ndërmjet këtyre organeve. Më e rëndësishmja ndër gjetjet e konstatuara është mungesa e njohurive dhe informacionit për faktet apo ngjarjet që përbëjnë elementë të veprës penale dhe detyrimi për kallëzim të menjëhershëm të tyre.

Në përfundim, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar një set të plotë rekomandimesh për institucionet shtetërore përgjegjëse⁴³. Ndër to përmendim:

- **ushtrimin e detyrimeve dhe përgjegjësi** në zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit;
- **forcimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit** të respektimit të të drejtave të fëmijëve;
- **trajtimin më të gjerë të temës së abuzimit/dhunës seksuale** në programet mësimore (konkretisht të lëndës së edukatës seksuale) dhe organizimin e fushatave ndërgjegjëse dhe edukative me prindërit dhe anëtarët e komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve në interesin më të lartë të tyre;
- monitorimin në vijimësi të punës së strukturave shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrjen e **masave konkrete nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për vendosjen dhe ekzekutimin e sanksioneve administrative** në rast të mospërmbushjes së detyrimeve ligjore nga këto struktura;
- **ngritjen e shërbimit të specializuar për fëmijët e dhunuar seksualisht**, pasi ekzistenca e kësaj qendre nuk mund të limitohet për shkak të pamjaftueshmërisë së buxheteve por ajo është nevojë dhe domosdoshmëri;
- **përfundimin e procesit të miratimit të akteve nënligjore** në zbatim të ligjeve nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;
- **ndryshimin e legjislacionit që rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive** për përcaktimin e rregullave më të detajuara për sa i përket trajtimit të çështjeve të abuzimit/dhunës

⁴³ Konkretisht, u ka drejtuar rekomandimet e tij: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Bashkisë Kavajë.

seksuale tek të miturit⁴⁴.

Gjatë vitit 2019, ndër fushat kryesore të angazhimit të Avokatit të Popullit që lidhen me zbatimin e legjislacionit të ri të drejtësisë penale për të mitur në drejtim të mbrojtjes e garantimit të të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktima dhe/apo dëshmitarë janë si vijon:

- **promovimi dhe monitorimi i të drejtave të fëmijëve** nga institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor;
- **vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit**⁴⁵, me qëllim monitorimin e kushteve dhe trajtimit të të miturve në institucionet e privimit të lirisë, porë kjo edhe në frymën e legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur;
- **nismës për promovimin dhe zbatimin në praktikë të ligjit nr.37/2017** “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” në disa prej institucioneve të cilat trajtojnë të miturit në konflikt me ligjin e të privuar nga liria⁴⁶ por jo vetëm.

Në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës dhe administrimit të drejtësisë penale për të mitur, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, Institucioni i Avokatit të Popullit për monitorimin e kushteve dhe trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin dhe të privuar nga liria në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit, organizoi një tryezë pune në të cilën prezantoi gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet kryesore në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Të drejtat e fëmijës në kuadër të promovimit dhe garantimit

Në vitin 2019, Avokati i Popullit ka realizuar veprimtari të ndryshme, si: tryeza pune, veprimtari promovuese, konferenca, etj. Në këto veprimtari të organizuara janë evidentuar jo vetëm problematikat e mprehta që lidhen me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës por në të njëjtën kohë, ato kanë shërbyer si forume diskutimi për mundësitë për zgjidhje efektive në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu në to janë prezantuar edhe rekomandimet përkatëse.

Ndër veprimtaritë kryesore të organizuara, përmendim si vijon:

- ❖ Tryeza e punës për monitorimin e kushteve dhe trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin dhe të privuar nga liria në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit, ku u prezantuan gjetjet nga inspektimet e kryera në organet kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

⁴⁴Sërish sjellim në vëmendje, nisur edhe nga rastet e tjera të trajtuara mediatikisht, mediat kanë të drejtë të flasin për fenomenin por jo për rastin.

⁴⁵Raporti i veçantë “Me zërin e të miturve të privuar nga liria”, Tiranë 2016.

⁴⁶Gjatë periudhës maj-qershor 2019 në kuadrin e mbështetjes dhe nga UNICEF, Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve ka inspektuar institucionet kryesore që trajtojnë të mitur në kushtet e privimit të lirisë, konkretisht: Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, 6 (gjastë) komisaritet që përfshin kjo drejtori në nivel vendor si dhe IEVP Shën Koll (Lezhë) dhe IEVP Kavajë.

- ❖ Tryeza e punës “Për edukimin për/rreth të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti në programet mësimore” në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit si nxitës në përfshirjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në programet mësimore si dhe zbatimin e tyre në institucionet arsimore por edhe si anëtar në Mekanizmin Institucional për Edukimin Ligjor të Publikut⁴⁷.

Përgjatë vitit 2019, veprimtaritë e realizuara nga AP për garantimin e pjesëmarrjes së vetë fëmijëve, institucioni ynë realizoi me sukses 7 takime informuese, me fëmijët e shkollave 9-vjeçare në Tiranë, Elbasan, Durrës, Korçë, Berat, Sarandë dhe Kukës për vlerësimin e mendimeve të tyre për të dëgjuar fëmijët dhe idetë e tyre nga afër në funksion të analizimit të thelluar të situatës së të drejtave të fëmijës për të identifikuar boshllëqet e mundshme në sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës. Kjo metodologji, pati edhe rezultatet e para proaktive në referimin e rasteve nga vetë fëmijët pranë institucionit të AP. Edhe përdorimi nga fëmijët i platformave në internet (faqja *online* e SMPDF, aplikacioni i AP në *smartphone*, rrjetet sociale) për herë të parë u mundësojë të aksesojnë dhe të përdorin faqen zyrtare *online*(website) të Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve në një gjuhë të thjeshtë të kuptueshme dhe miqësore për të marrë informacion për/rreth të drejtave të tyre.

Në kuadër të promovimit të të drejtave të fëmijës, Avokati i Popullit ka marrë pjesë në shumë veprimtari në të cilat ka prezantuar qasjen institucionale në parashtrimin e problemeve dhe shkeljeve të konstatuara ka përcjellë zërin e fëmijëve si dhe ka ndarë përvojën dhe praktikën më të mira të punës së institucionit të Avokatit të Popullit. Ndër veprimtaritë kryesore në të cilat AP ka marrë pjesë në mënyrë aktive, përmendim si vijon:

- Prezantim dhe debat konstruktiv me studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, dega “Punë Sociale” për rolin e institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut në mbrojtjen, garantimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti.
- Pjesëmarrja aktive në vlerësim të veprimtarisë për lancimin e Qendrës Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve nga Dhuna Seksuale, organizuar nga CRCA/ECPAT, ku morën pjesë dhe deputetë të Kuvendit të RSH-së.⁴⁸
- Pjesëmarrje aktive në adresimin e problematikave të identifikuara nga praktikën e punës së ndjekur nga AP në tryezën e organizuar nga AMA, me temë “Fëmijët dhe reklamat në transmetimet audiovizive”.
- Pjesëmarrje aktive, nëpërmjet adresimit të rekomandimeve përkatëse të AP-së, gjatë veprimtarisë me temë “Të gjithë bashkë për realizimin e Objektivit 8.7 për Zhvillim të

⁴⁷Vendimi nr.47/2019, i Kuvendit “Për miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut, 2019-2023”

⁴⁸Rekomandime adresuara nga AP për ofrimin e shërbimeve të specializuara për fëmijët dhe të rinjtë e dhunuar seksualisht.

Qëndrueshëm në Shqipëri në kuadër të Agjendës 2030”, organizuar nga MSHMS në bashkëpunim me OSBE dhe ILO.

- Ndarjen e praktikave të mira të punës së Avokatit të Popullit për zbatimin korrekt të detyrave funksionale të institucioneve përgjegjëse shtetërore të Mekanizmit Kombëtar të Mbrojtjes së Fëmijëve, organizuar nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Qendrën COD në Kryeministri, me pjesëmarrjen e vetë të rinjve.

Po kështu, institucioni i Avokati i Popullit në përmbushje të detyrimit ligjor si anëtar i Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka luajtur një rol proaktiv dhe me kontribute konkrete në miratimin e disa prej akteve kryesore të vendimmarrjes së Këshillit⁴⁹, siç është miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019-2021 në të cilin janë pasqyruar të gjitha rekomandimet e adresuara nga institucioni ynë në raportin e veçantë “Puna e fëmijëve në Bashkinë Bulqizë”, nëntor 2018⁵⁰, dorëzuar edhe në Kuvendin e RSH-së.

Përfundime

Në përfundim, Avokati i Popullit do të vijojë edhe më fuqishëm misionin e tij në drejtim të mbrojtjes, promovimit të të drejtave dhe monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në mbarë vendin.

Përpjekjet e deritanishme për të finalizuar të gjitha ato që përmendëm më sipër në përputhje me konventat dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, promovimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave janë një fillim i mirë por që kërkon ende shumë punë për të bërë, shumë përpjekje nga të gjithë ne, shoqëria të gjithë aktorët dhe faktorët me ndikim në ciklin e politikave publike, ofj-të, etj.

Besojmë, se çdo lloj investimi të fëmijët që promovon potencialin e tyre sot e që nxit në ta vetëbesimin e nevojshëm për t’u bërë anëtarë të dobishëm të shoqërisë nesër, qytetarë të përgjegjshëm e me norma është një investim me vlerë, i cili ka nevojë për përmirësim të vazhdueshëm.

Fëmijët duhet të kenë qasje dhe akses në mekanizmat që sigurojnë dhe garantojnë gëzimin e të drejtave të tyre në përputhje me parimet bazë të Konventës dhe në këtë rast, puna e të gjithëve së bashku është pikërisht ***garantimi i fëmijëve, se një qasje dhe akses i tillë ekziston vërtet.***

3.10. Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor

⁴⁹Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019-2021 dhe raporti i monitorimit afatmesëm 2017-2018 të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës.

⁵⁰ Shkresa zyrtare me nr.412. prot. datë 31.10.2018 për dërgimin e raportit të veçantë të Bulqizës.

Në qasjen e institucionit të Avokatit të Popullit, parimi, mbi të cilin duhet të mbështetet funksionimi i sistemit të kujdesit shëndetësor është cilësia e shërbimit dhe efienca, duke garantuar sigurinë e pacientit. Në këtë mënyrë mundësohet zbatimi i një tjetër standardi ndërkombëtar që e ka filluesën qysh në Deklaratën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut.

Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2019, rezulton të jenë trajtuar **35 ankesa** nga qytetarët të cilat evidentojnë ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: trajtimi mjekësor jo në përputhje me standardet, burokraci lidhur me radhët e pritjes në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), mungesa në medikamente, kryesisht në Spitalin Onkologjik në QSUT, mungesa e protokolleve mjekësore, mungesa e mjekëve dhe infermierëve në spitalet rajonale dhe zonat rurale, etj. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara rezulton se për 27 ankesa është përmbyllur shqyrtimi, ndërsa 8 ankesa të tjera vijojnë ende të trajtohen. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 20 ankesa janë zgjidhur në favor të 8 qytetarit.

Mbështetur në juridiksionin dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin organik të Avokatit të Popullit, veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me të drejtën për kujdes shëndetësor është bazuar edhe në hetimet “*ex-officio*” që ai ka ndërmarrë për këtë qëllim. Rastet e trajtuara me iniciativë nga institucioni për vitin 2019 janë 5 e indiciet për iniciimin e tyre janë marrë kryesisht nga rastet e bëra publike në median e shkruar dhe vizive.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2019 e në vijim, problematikat e bëra prezent, qoftë nëpërmjet ankesave të ndryshme të depozituara pranë institucionit por edhe ato të evidentuara në rastet e bëra publike në median e shkruar dhe *online* si dhe ato të ndjekura me iniciativë. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson dhe eidenton dallime të qënësishme në cilësinë dhe nivelin e trajtimit dhe kujdesit që ofrohet, në varësi të vendit ku jetojnë pacientët. Diferencat janë tejet evidente në zonat urbane krahasuar me ato rurale. Gjithashtu, konstatohet, se aksesimi ndaj qendrave shëndetësore në vende të caktuara, vijon të mbetet një problem tepër shqetësues për shkak të terrenit dhe mungesës së infrastrukturës. Mungesa e personelit mjekësor dhe atij infermier në zonat rurale të afërta dhe të largëta, vijon edhe këtë vit të mbetet një problematikë evidente dhe e pazgjidhur.

Për realizimin efektiv të **së drejtës për kujdes shëndetësor** si një problematikë e raportuar edhe në vitet pararendëse nga institucioni ynë, nevojitet në mënyrë të vazhdueshme, furnizimi me medikamente të mjaftueshme të qendrave shëndetësore dhe spitaleve, kryesisht në QSUT Tiranë për shkak të fluksit të pacientëve nga e gjithë Shqipëria. Mungesa e shërbimeve apo aparaturave në spitalet rajonale, ndikon që pacientët të gjejnë rrugë alternative kurimi, siç është fluksi i pacientëve drejt kryeqytetit, me destinacion QSUT-në, Spitalin Universitar të Traumës, Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” si dhe dy spitalet Universitare Obstetrik-Gjinekologjike.

Problematikat e manifestuara në sistemin shëndetësor u intensifikuan për shkak të tërmetit të 26 Nëntorit 2020, i cili gjeneroi pasoja negative në qytetet e Tiranës, Durrësit, Lezhës etj.

Një problematikë tjetër evidente vijon të mbetet mosgarantimi i të drejtave të stafit mjekësor dhe

zgjatja e pakuptimtë tej afateve ligjore e konkurseve për pozicionet drejtuese në sistemin shëndetësor.

Skema e subvencionit të medikamenteve për personat që dalin në pension, vijon të raportohet si një problematikë konstante, pasi implementimi i saj rezulton të jetë jo efektiv për një numër të madh pensionistësh.

Referuar ankesave specifike të qytetarëve të shqyrtuara e për të cilat janë hartuar rekomandime për vitin 2019 spikat rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e nevojave të Spitalit Bashkiak “Dr. Stefan Gjoni” Krujë në të cilin tërhiqet vëmendja, citojmë:

“...Gjetjen e fondeve për rikonstruksionin total të maternitetit në këtë spital dhe plotësimin e nevojave për 1 mjek laborator, 1 mjek obstetër-gjinekolog, 1 mjek reanimator, 1 mjek dermatolog. Rikonstruksionin e rrjetit hidraulik, i cili ishte totalisht i amortizuar, vënien në funksion të sistemit ngrohës dhe ashensorit, shtimin e pajisjeve ekzaminuese mjeksore që mungojnë si: skaner rezonancë dhe pajisje laboratorike, shtimin e fondeve për plotësimin e nevojave për pajisje hotelerike...”

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se mekanizmat e përgjegjësisë janë thelbësore për të siguruar, se janë respektuar detyrimet e shtetit që rrjedhin nga zbatimi i të drejtës për kujdes shëndetësor. Monitorimi dhe vënia para përgjegjësisë e shtetit, arrihet nëpërmjet mekanizmave administrativë, politikë, gjyqësorë si dhe duke përfshirë në proces një numër aktorësh, siç janë organizatat e ndryshme të shoqërisë civile institucionet kombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut si dhe vetë qytetarët të cilët po ndërgjegjësohen për të drejtën e tyre për një kujdes të denjë shëndetësor.

3.11. Respektimi i të drejtës për arsimim

Shteti duhet të luajë rolin kryesor për reforma ligjore dhe institucionale, deri në realizimin e objektivit për të shpërndarë edukim cilësor për të gjithë individët. E drejta për arsim është një nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut, sepse shërben si përforcuese e të drejtave të tjera, kur është e garantuar dhe si përjashtuese për gëzimin e tyre në rast se mohohet. Vlen të theksohet, se sistemi ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar është i konsoliduar sa i takon të drejtës për arsim.

Gjatë vitit 2019, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 53 ankesa në fushën e të drejtës për arsimim. Objekti i këtyre ankesave ka konsistuar kryesisht në: mospërfshim nga tarifat e studimit të kategorive të studentëve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë, moskthime përgjigjesh nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), probleme administrative nga stafi i universiteteve dhe punonjësve të administratës, punësime dhe pretendime për shkelje të barazisë për t’u punësuar ose transferuar nga portali “Mësues për Shqipërinë”, etj. Nga numri total i ankesave të administruaraka përfunduar shqyrtimi për 40 ankesa, ndërsa 13 ankesa janë ende në shqyrtim. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, në favor të qytetarëve.

Më konkretisht, problematikat kryesore që kanë spikatur në përmbatjen e ankesave të trajtuara, kanë qenë të tilla si psh, ajo e përjashtimit apo përgjysmimit të tarifave të universiteteve për studentët që vijnë nga shtresa sociale në nevojë, ankesa të cilat janë adresuar rregullisht për zgjidhje në administratat e universiteteve.

Një problematikë shqetësuese e që meriton specifikisht vëmendje të përshihet në këtë raportim, listohet edhe ajo e një grupi ish-studentësh, aktualisht sot në marrëdhënie pune si mësues të cilëve nuk u njihet diploma nga autoritetet arsimore, pasi në kohën e ndjekjes së studimeve pranë një universiteti privat, ky i fundit rezulton të ketë qenë i pa akredituar.

Gjithashtu transferimet, lëvizjet paralele apo ankesat për subjektivizëm në punësim, specifikisht në zyrat arsimore në rrethe, kanë qenë objekt i shqyrtimit të ankesave për vitin 2019. Referuar ankesave specifike të qytetarëve të shqyrtuara e për të cilat janë hartuar rekomandime për vitin 2019 spikat rekomandimi drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për ndryshimin e menjëhershëm dhe përfshirjen edhe të kategorisë së mësuesve të arsimit parashkollor të kopshteve në varësi të bashkive, kategori e përfshirë në udhëzimin nr.13, datë 22.05.2019 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Mbështetur në juridiksionin dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin organik të Avokatit të Popullit, veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me të drejtën për arsimim është bazuar edhe në hetimet “*ex-officio*” që ai ka ndërmarrë për këtë qëllim. Rastet e trajtuara me iniciativë nga institucioni për vitin 2019 janë 4 të cilat trajtojnë problematikat për përmbajtjen e disa shkollave në Tiranë apo rastin e moshapjes së konviktit të ri në qytetin e Beratit.

Në funksion të rolit të tij promovues, institucioni i Avokatit të Popullit në vitin 2019, startoi organizimin e një sesi trajnimesh me mësuesit e arsimit parauniversitar të qytetit të Tiranës. Pas shqyrtimit të përmbajtjes së teksteve shkollore të lëndës “Qytetari/Edukata Qytetare” të arsimit 9–vjeçar, u evidentua përmbajtja jo shumë e gjerë e informacionit mbi të drejtat e njeriut dhe të fëmijës si dhe u identifikua përfshirja e një informacioni tejet të reduktuar mbi institucionin e Avokatit të Popullit, përgjegjësitë dhe funksionin e tij. Kjo solli në vëmendje, rëndësinë e informimit të mësuesve të arsimit parauniversitar, mbi rëndësinë e veprimtarisë së këtij institucioni kushtetues dhe funksionit të tij. Sesionet e trajnimeve do vijojnë edhe përgjatë vitit 2020.

Rritja e cilësisë së mësimdhënies është një problem i mbartur ndër vite që nuk po adresohet në mënyrën e duhur ende, pavarësisht përpjekjeve serioze në këtë drejtim. Megjithatë theksojmë se, qëndrimet e Drejtorive Arsimore, duhet të synojnë të promovojnë meritokracinë dhe jo përkatësinë partiake gjatë procedurës së punësimit të personelit mësimor.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson nevojën për hartimin dhe/ose modifikimin e akteve ligjore në funksion të refomimit të sistemit arsimor aktual, me synim zgjidhjen e problematikave sistematike dhe sporadike, me të cilat ballafaqohet dukshëm sot ky sistem.

3.12. Respektimi i lirisë së shprehjes

Liria e shprehjes përbën një nga themelet kryesore të një shoqërie demokratike, një nga kushtet bazë për progresin dhe për zhvillimin e saj⁵¹. Kjo e drejtë është thelbi i demokracisë dhe çelësi i gëzimit të shumë të drejtave të tjera dheqë njëkohësisht luan një rol kyç në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve⁵². Liria e shprehjes nuk shihet si një e drejtë e lidhur ngushtësisht me individin por si një e drejtë dhe liri themelore të cilën duhet ta gëzojë media, kjo e fundit e konsideruar si pushteti i katërt i çdo shoqërie demokratike⁵³.

Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues ka monitoruar në vazhdimësi diskutimet e shumta në organet shtetërore shqiptare si edhe rekomandimet dhe komentet e grupeve të interesit e partnerëve ndërkombëtarë⁵⁴, ashtu sikurse dha ka marrë pjesë në mënyrë aktive për të dhënë mendime lidhur me propozimet ligjore⁵⁵ sa i përket shërbimeve mediatike në RSh deri në miratimin e Ligjit nr. 91/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar datë 19.12.2019⁵⁶. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit është treguar mjaft aktiv gjatë vitit 2019 duke analizuar në detaje projekt-ligjet në fjalë në variantet e tyre të ndryshme, projektligje që në fakt, *per se nuk* janë bërë publike për t'u shqyrtuar në kohë nga subjektet dhe institucionet e interesuara. Nëpërmjet veprimtarisë tonë, kemi synuar që të përmbushim detyrimin institucional përmes ndikimit dhe ndërgjegjësimit të strukturave shtetërore për sjelljen në vëmendje të problematikave të shumta që paraqet ligji nr. 91/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar si dhe për të treguar gatishmërinë për të ofruar garancitë e standardeve ndërkombëtare për ushtrimin e rolit të medias dhe të gazetarëve në lidhje me çështje të caktuara.

⁵¹Liria e shprehjes në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë rregullohet me hollësi nëpërmjet disa dispozitave. Neni 10 trajton lirinë e shprehjes në jetën publike, neni 20, lirinë e shprehjes për pakicat, neni 22, lirinë e shprehjes dhe lirinë e shtypit, radios dhe televizionit etj.

⁵²Neni 10 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut përcakton se "Cdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u 12 13 kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë."

⁵³Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) por edhe praktika e konsoliduar e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) si autoriteti më i lartë që siguron interpretimin e dispozitave të kësaj konvente i mëshojnë faktit se në kontekstin e një demokracie të efektshme dhe respektimit të të drejtave të njeriut të përmendura në preambulën e Konventës, liria e shprehjes është jo vetëm tepër e rëndësishme si një e drejtë por ajo luan një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të tjera sipas KEDNJ. Pa një garanci të gjerë të së drejtës së lirisë së shprehjes të mbrojtur nga gjykata të pavarura dhe të paanshme nuk ka vend të lirë nuk ka demokraci.

⁵⁴Mbi këto çështje të mprehta është organizuar dhe Konferenca Vjetore e institucionit të Avokatit të Popullit, e titulluar "Liri pa urrëjtje". *Liria e shprehjes përballë të drejtave të njeriut*, në dt. 06.12.2019, ku personalitete, ekspertë të fushës të ftuar dhe studiues të tjerë ndanë mendimet dhe eksperiencën e tyre në këtë Konferencë.

⁵⁵Projektligjet për disa ndryshime dhe shtesa në ligjet nr.97/2013, "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

⁵⁶Ligji nr. 91/2019 datë 19.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, gjendet on line i aksesueshëm. në <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200121101826ligj%20nr%20%2091%20dt%20%2018%2012%202019.pdf>

Në këto kushte, insitucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar një Opinion ligjor të depozituar pranë Komisionit të Ligjeve, me qëllim paraqitjen e një sërë problematikave që evidentohen në këtë ligj. Ndërsa Avokati i Popullit konsideron të nevojshëm regjistrimin e personave juridikë që të ofrojnë këto shërbime, mendon se vetërregullimi duhet të jetë mënyra se si duhet të adresohen problematikat e “fake news”. Vlen të përmendet këtu procedura administrative e shqyrtimit të ankesave, e cila edhe në versionin përfundimtar të miratuar, ende në gjykimin tonë nuk ofron garanci për një vendimmarrje objektive e të paanshme në përputhje me detyrimin për respektimin e lirisë së medias për t’u shprehur. Veshja e një organi administrativ si AMA me kompetenca kuazi-gjyqësore nuk ofron garanci kushtetuese të mjaftueshme për paanshmërinë e këtij institucioni, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se Bordi i AMA zgjidhet mbi bazën e propozimeve të mbështetura të partive politike nga Kuvendi dhe që nga krijimi e deri më tash nuk ka rezultuar të ketë krijuar besimin e masës së madhe të mediave për ushtrimin e rolit që ai ka luajtur në këtë fushë në median audiovizive. Për këtë shkak, ky organ i cili do të përzgjedhë edhe përbërjen e Këshillit të Ankesave, strukturë kjo e cila do të ketë në dorë vendimmarrjen në përfundim të shqyrtimit të ankimeve ndaj operatorëve të shërbimeve elektronike⁵⁷ dhe vetë ky Këshill nuk garantojnë paanshmërinë e domosdoshme në rastin konkret për të adresuar një temë kaq delikate sa kufiri midis lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes.

Duhet theksuar gjithashtu se sanksionet dhe tarifat e gjobave të parashikuara nga ligji në fjalë janë tepër të larta dhe aplikimi i tyre do të vendosë operatorët që ofrojnë shërbime të publikimeve elektronike në pozita të pabarabarta. Në gjykimin e institucionit të Avokatit të Popullit në aplikimin e këtyre sanksioneve duhet të sigurohet respektimi i parimit të proporcionalitetit, duke mbajtur në vëmendje jo vetëm kapacitetet e kapitalin (madhësinë) e ofruesve të shërbimeve të publikimit elektronik por edhe shkeljen e kryer nga operatorët, me qëllim që sanksionet të vendosen në përputhje me kapacitetet e ofruesve të shërbimeve të publikimit elektronik si edhe me rëndësinë apo pasojat e shkeljes së kryer. Nga ana tjetër vlen të theksohet se ligji ka pasur një sërë ndryshimesh nga versioni i parë deri në versionin përfundimtar por transparenca në fazën nga rënia e draftit të parë të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AMA për të cilën edhe Avokati i Popullit ka marrë pjesë në diskutime e deri në paraqitjen e draftit në Kuvend ka lënë shumë për të dëshiruar.

Kundër miratimit të ligjit është shprehur edhe Komisionerja për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Europës, Dunja Mijatovic në një deklaratë publike⁵⁸. Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 11413, datë 11.01.2020⁵⁹ ktheu ligjin për rishqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë duke paraqitur dhe një sërë arsyesh që në gjykimin e Avokatit të Popullit duhet të merren në konsideratë me shumë vëmendje nga komisionet përkatëse të Kuvendit. Ato duhet të trajtohen së bashku me opinionin e

⁵⁷Shih nenin 29 të Ligjit nr. 91/2019 datë 19.12.2019 i cili ndryshon nenin 132 të Ligjit 97/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

⁵⁸ <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/commissioner-urges-albania-s-parliament-to-revieve-bills-ehich-restrict-freedom-of-expression>

⁵⁹ <http://president.al/presidenti-meta-dekreton-kthimin-per-rishqyrtim-ne-kuvend-te-ligjit-nr-91-2019-arsyet-e-kthimit-per-rishqyrtim-te-ligjit/>

prishëm të Komsionit të Venecias mbi këtë çështje i cili pritet të shqyrtohet në mbledhjen e muajit Qershor 2020.⁶⁰

Avokati i Popullit do të vijojë të ketë në vemendjen e tij ecurinë e garantimit të lirisë së shprehjes si dhe do të mbikëqyrë zbatimin korrekt të ligjit për mediat.

3.13. Respektimi i të drejtës për kujdes social

Risia e vitit 2019 në kontekstin e ndihmës ekonomike, ishte miratimi i kuadrit të ri ligjor, konkretisht i ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”⁶¹ dhe i akteve përkatëse nënligjore në zbatim të tij.

Një nga programet e mbrojtjes sociale që gjen rregullim specifikisht e në mënyrë të detajuar në ligjin e ri “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” është dhe ai i ofrimit dhe shpërndarjes së ndihmës ekonomike.

Synimi i ligjvënësit në këtë nismë të re ligjore konsistonte në shndërrimin e kësaj skeme mbrojtjeje shoqërore në një skemë aktive, ku integrohen edhe programe të nxitjes së punësimit për kategorinë e përfituesve të ndihmës ekonomike.

Në kuadër të rolit proaktiv, institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë gjithë procesit të draftimit të projektligjit përkatës, duke dhënë vërejtje dhe sugjerime të cilat janë pasqyruar në një masë të mirë të tyre në përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr.57/2019. Ky rol i yni ka vijuar dhe po vijon edhe në procesin e diskutimit dhe miratimit të akteve nënligjore që janë nxjerrë dhe që pritet të nxirren nga ana e organeve përkatëse të ngarkuara me këtë detyrim në zbatim të dispozitave të ligjit të sipërcituar.

Referuar ankesave të regjistruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2019, rezulton të jenë trajtuar 40 ankesa nga qytetarët të cilat evidentojnë ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: ndërprerja e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe paqartësia e qytetarëve për arsyet e mospërfitimit apo mospërfshirjes së tyre në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike dhe masa e ulët e ndihmës ekonomike.

Trajtimi i ankesave të qytetarëve nga institucioni i Avokatit të Popullit ka mundësuar informimin e rregullt e në vijimësi të tyre lidhur me bazueshmërinë ligjore të trajtimit të problematikave nga

⁶⁰Për këtë ligj, Komisioni European ka kërkuar opinionin e Komisionit të Venecias i cili dërgoi një mision në Shqipëri më datë 10-11 Shkurt 2020. Avokati i Popullit pati një takim me përfaqësuesit e Komsionit të Venecias në të cilin shprehu qëndrimin dhe mendimin e tij në lidhje me ligjin e miratuar dhe me implikimet e mundshme jo pozitive që mund të kenë për të drejtat e njeriut disa nga nenet e këtij ligji.

⁶¹Miratuar më datë 18.7.2019, ky ligj përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, kriteret dhe procedurat e përfitimit apo përjashtimit nga ndihma ekonomike, llojet e pagesave të ndihmës, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale.

ana e njësive të pushtetit vendor si dhe kushtet ligjore dhe faktike që ata që duhet të plotësojnë për të qenë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike.

Një problem kryesor dhe lehtësisht i evidentueshëm ka qenë dhe mbetet masa e ndihmës ekonomike e cila është shumë e ulët dhe thuajse e papërfillshme në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme që i duhen familjes ose një individi të vetëm për të mbijetuar, e jo më pastaj për t'i mundësuar atij një jetësë dinjitoze dhe integritet në shoqëri. Ndihma aktuale ekonomike është e pamjaftueshme për të adresuar nevojat e grupeve në nevojë në tërësi dhe veçanërisht ato të grave kryefamiljare, grave romë apo atyre nga grupe të tjera vulnerabël si dhe të viktimave të dhunës në familje apo viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore.

Është i pajustificueshëm mospërcaktimi ende i një minimumi jetik, i cili duhet të jetë dinjitoz, qoftë edhe brenda mundësive të burimeve të shtetit shqiptar, i cili, pa dyshim, do të plotësonte më mirë nevojat e çdo qytetari në nevojë. Mungesa e shpalljes së minimumit jetik mbetet një pengesë konstante në përcaktimin e politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë.

Mbështetur në juridiksionin dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin organik të Avokatit të Popullit, veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me ndihmën ekonomike është bazuar edhe në hetimet “*ex-officio*” që ai ka ndërmarrë për këtë qëllim. Rastet e trajtuara me iniciativë nga institucioni, kanë qenë kryesisht rastet e bëra publike në median e shkruar dhe vizive për problematika që lidhen përkatësisht me mospërfshirjen në skemën e ndihmës ekonomike apo ndërthurje të problematikës e gjendjes së rëndë të banesës dhe ndërprerjes së ndihmës ekonomike për familje të caktuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, pavarësisht synimit të ligjvënësit në nismën e tij të re ligjore për shndërrimin e skemës së ofrimit dhe shpërndarjes së ndihmës ekonomike në një skemë aktive, ku integrohen edhe programe të nxitjes së punësimit në funksion të zbutjes së varfërisë, varfëria vijon të mbetet një problematikë e mprehtë në nivel kombëtar.

Sa më sipër evidentohet lehtësisht, me numrin e madh të individëve apo familjeve që vijnë të trajtohen me ndihmë ekonomike.

3.14. Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar si të gjithë shtetasit shqiptarë, padyshim që duhet të konsiderohen si persona të mundësive si persona të barabartë mes të barabartëve, persona me dinjitet të lindur dhe me të drejta të patjetërsueshme. Nga ky këndvështrim, personat me aftësi të kufizuara janë ajo pjesë e shoqërisë, e cila e ka të domosdoshme mbështetjen e vazhdueshme nga shteti për t'iu respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore si dhe aksesin dhe përshtatjen e arsyeshme në çdo fushë të jetës.

Pavarësisht përmirësimeve të dukshme që ka pësuar kuadri ligjor specifik reformuar kohë pas kohe për të akomoduar kërkesat dhe nevojat dinamike të kësaj kategorie si dhe rritjes së nivelit të

ndërgjegjësimi të shoqërisë e cila rezulton natyrshëm në një nivel ndjeshmërie më të lartë ndaj personave me aftësi të kufizuara, sërisht kjo kategori individësh cilësohet e diskriminuar me referencë në aspekte të tilla si: punësim, arsim, akses në infrastrukturë, akses në shërbime, etj.

Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2019, rezulton të jenë trajtuar 33 ankesa të qytetarëve.

Konstatohet se problematikat më të spikatura të shprehura në përmbajtjen e ankesave të shqyrtuara konsistojnë në sa më poshtë:

- *Personave me aftësi të kufizuar nuk u është garantuar plotësisht e drejta e votës për të shprehur vullnetin e tyre në mënyrë të pavarur.*

Kodi ynë zgjedhor në nenin 108 të tij ka përcaktuar shprehimisht procedurat e votimit për zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë, duke filluar që nga regjistrimi në listat e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, infrastrukturës së përshtatshme për lehtësimin e pjesëmarrjes në votime për personat paraplegjikë e tetraplegjikë si dhe pajisjen e komisioneve të qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi për personat që nuk shikojnë.

Sa më sipër në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me kërkesë të shprehur qartë për marrjen e masave lidhur me garantimin e së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar në territorin e Republikës së Shqipërisë për të cilën ende nuk disponojmë asnjë përgjigje zyrtare. Kjo kërkesë është sjellë në vëmendjen e këtij Institucioni në të tëra proceset zgjedhore që nga viti 2012 e në vijim.

Më tej në përmbushje të tagrit të tij ligjor, institucioni ka monitoruar 47 qendra votimi, përkatësisht në qytetet Tiranë dhe Vlorë, lidhur me sigurimin e aksesueshmërisë, e orientuar në identifikimin e sa më poshtë:

- ✓ vendosjes së rampave për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë;
- ✓ përshtatshmërisë së infrastrukturës (sinjalistika me shirita të verdhë) për hyrjen në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe personave të verbër;
- ✓ garantimin e pavarur dhe të fshehtë të votimit për personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe personave të verbër (fleta e votimit duhet të jetë në shkrimin *Brail*).

Problematikat e konstatuara në përfundim të procesit të monitorimit:

- ✓ Pothuajse të gjitha qendrat e votimit kishin të vendosur në hyrje rampat për personat me aftësi të kufizuar (paraplegjikë dhe tetraplegjikë). Qendrat e votimit ishin vendosur përkatësisht në katet e para dhe të dyta të ndërtesës. Për qendrat e vendosura në kate të dyta, vërehet problematika e aksesueshmërisë së tyre nga personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Këto qendra nuk ishin të përshtatura në funksionalitet për këtë kategorinë specifike. E vetmja mënyrë aksesueshmërie ishin shkallët.
- ✓ Të gjitha qendrat e votimit të monitoruara, karakterizoheshin nga mungesa e infrastruktures së përshtatur për hyrjen e personave me aftësi të kufizuar në shikim dhe personave të verbër

(sinjalistika për aksesueshmërinë e personave të verbër-shiritat e verdhë).

- ✓ Të gjitha qendrat e votimit ishin të pajisura me fletë votimi, me shkrimin *Brail*.

Motintorimi i zgjedhjeve vendore 2019, rikonfirmoi edhe njëherë si një problematikë të identifikuar edhe në monitorimet pararendëse, atë të mungesës së përshtatshmërisë së infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuar, problematikë kjo, e cila e afekton në mënyrë të qenësishme, negativisht, ushtrimin e plotë dhe të qetë të së drejtës së votës për këtë kategori individësh.

- *Mospërfitim i kompensimit të shpenzimeve për transportin urban dhe interurban të invalidëve të punës dhe personat që përfitojnë statusin e të verbërit*

Viti 2019 risolli edhe njëherë në vëmendje një problematikë të hershme të evidentuar ndër vite, atë të mospërfitimit të kompensimit të shpenzimeve për transportin urban dhe interurban të invalidëve të punës dhe personat që përfitojnë statusin e të verbërit për të cilën institucioni i Avokati i Popullit është angazhuar rigorozisht me shkresa zyrtare, rekomandime dhe takime të posaçme, pranë strukturave përgjegjëse në fuksion të zgjidhjes së saj. Avokati i Popullit ka raportuar për këtë çështje edhe në disa Komisione Parlamentare për të tërhequr vëmendjen ndaj këtij problemi.

Pas riadresimit edhe këtë vit të kësaj problematike pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, informohemi, se në përputhje me urdhrin nr.474, datë 24.6.2019 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për transportin e kategorive që përfitojnë falas sipas legjislacionit në fuqi” ka vijuar bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe qeverisjen vendore për të përcaktuar masën e kompensimit të individëve dhe përgatitjen e projektvendimeve përkatëse. Aktet nuk rezultojnë të jenë miratuar ende.

- *Mosdhënia e të drejtës për të përfituar rimbursimin për shpenzimet në blerjen e karburantit dhe vajit lubrifikant për invalidët që kanë mjetë motorrike në përdorim të cilët janë deklaruar me grup invaliditeti pas vitit 2011.*

Ligjet specifike për personat që gëzojnë statusin e invalidit të punës të invalidit paraplegjik e tetraplegjik dhe statusin e të verbërit⁶², i japin të drejtën këtyre kategorive për të përfituar rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve për mjetet motorrike në përdorim të përshtatura për ta. Ata invalidë që e kanë përfituar këtë të drejtë para vitit 2011, vijojnë ende ta marrin këtë përfitim, ndërsa invalidët e tjerë që janë pajisur me mjete motorrike pas muajit korrik 2011 nuk e përfitojnë këtë rimbursim.

⁶²Ligji nr.8098/28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar

Ligji nr.8626/22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar

Ligji nr.7995/20.09.1995 “Për statusin e invalidëve të punës”, i ndryshuar

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.10458, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9975 datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare të ndryshuar”, invalidët përjashtohen nga detyrimi për të paguar vetëm taksën e zhdoganimit të makinës por nuk u jepet e drejta për të përfituar rimbursimet përkatëse. Theksojmë faktin se, asnjë nga aktet nënligjore në zbatim të ligjeve specifike për kategoritë e sipërcituara për përfitimin e kësaj të drejte nuk është shfuqizuar apo ndryshuar.

Pas riadresimit edhe këtë vit të kësaj problematike pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, u informuam se, këshilli administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me vendim nr.27, datë 6.12.2019 ka miratuar rregulloren “Mbi kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e vlerësimit të kërkesave të invalidëve për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe vajrave lubrifikantë”. Me urdhrin nr.766, datë 3.2.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore është ngritur komisioni i veçantë për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe vajrave lubrifikante.

Mbështetur në juridiksionin dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin organik të Avokatit të Popullit, veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar është bazuar edhe në hetimet “*ex-officio*” që ai ka ndërmarrë për këtë qëllim.

Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se, pavarësisht miratimit të vendimit nr.1074, datë 23.12.2015 të KM-së “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, mungesa e papërshtatshmëria e ndërtesave publike dhe private e rrugëve urbane dhe rurale vijon të mbetet një problem thelbësor për këtë kategori individësh.

Në këto kushte, institucioni në vitin 2019, filloi me iniciativë rastin në Njësinë Administrative Dropull i Poshtëm për të identifikuar nivelin e përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar dhe të moshës së tretë në zyrën “ALEAT”, gjatë procesit të aplikimit dhe pajisjes së tyre me karta ID dhe pasaporta biometrike.

Monitorimet në terren, evidentuan faktin e mungesës së përshtatshmërisë dhe aksesueshmërisë së duhur dhe brenda standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, duke krijuar vështirësi konkrete, e cila përshkallëzohej deri në pamundësi totale për marrjen e shërbimit për personat me aftësi të kufizuar dhe ata të moshës e tretë.

Pas evidentimit të problematikave, u hartua rekomandimi përkatës, drejtuar kryetarit të Bashkisë Dropull, “Për marrjen e masave për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë brenda standardeve për personat me aftësi të kufizuar dhe moshën e tretë në zyrën e “ALEAT”, Njësia Administrative Dropull i Poshtëm, fshati Sofratikë, me qëllim marrjen e shërbimeve për aplikimin dhe pajisjen me karta ID dhe pasaporta biometrike.

Në kuadër të tagrit të tij ligjor, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2019, nivelin e respektimit të drejtave të personave me aftësi të kufizuar të cilët janë të akomoduar në institucionet e përkujdesit social, nëpërmjet inspektimeve përkatësisht në qytetet Gjirokastrë, Shkodër, Kavajë, Fier dhe Tiranë.

Pas inspektimeve të kryera dhe evidentimit të problematikave janë hartuar rekomandime konkrete të cilat i janë dërguar rregullisht strukturave përkatëse shtetërore, kryetarëve të bashkive dhe Shërbimit Social Shtetëror të cilat orientojnë drejt përmirësimit të kushteve të jetesës dhe zbatimin sa më cilësor të standardeve të përkujdesit social për këtë kategori.

3.15. Barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTI

Pavarësisht arritjeve në drejtim të përmirësimit të pjesëmarrjes së grave në qeveri apo në pozicione të tjera drejtuese e vendimarrëse, institucioni i Avokati të Popullit vlerëson se gjendja aktuale e të drejtave dhe lirive të grave dhe vajzave në Shqipëri, karakterizohet nga problematika të mprehta, sidomos në drejtim të pësimit të gjuhës misogjene të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, aksesit në drejtësi, punësimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

Zhvillimi i aktiviteteve promovuese e ndërgjegjësuere që evidentojnë problematikën tashmë të shprehura në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të grave (si pjesë integrale e të drejtave të njeriut) të shoqëruara edhe me sugjerime apo rekomandime për mënyrën e adresimit dhe zgjidhjes adekuate të tyre, kanë një vlerë të shtuar dhe ndikim të drejtëpërdrejtë tek komuniteti i grave e vajzave në vendin tonë.

Kjo, pasi në Shqipëri ende nuk ekziston një kulturë e shoqërisë që të orientojë individët të adresojnë institucionin e Avokatit të Popullit, me ankesa në të cilat të parashtrohen pretendimet e tyre për mosrespektimin apo shkeljen e të drejtave për shkak të gjinisë. Sa më sipër, reflektohet dhe në numrin e kufizuar të ankesave me këtë objekt të depozituara dhe të trajtuara përgjatë vitit 2019 nga institucioni ynë.

Nga perspektiva e institucionit të Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të individit, konstatohet, se problematikën më të spikatura të shprehura në përmbajtjen e ankesave të depozituara dhe të shqyrtuara për vitin 2019 për gratë, konsistojnë në pretendime për punësim, ndihmë ekonomike, pension, akses në drejtësi, mosekzekutim të detyrimeve ushqimore të vendosura në vendimet e gjykatave, etj.

Një problem kryesor dhe lehtësisht i evidentueshëm vijon të mbetet përdorimi i gjuhës misogjene, e përdorur kjo që nga anëtarët e parlamentit e duke vijuar në biseda në studio televizive apo në shkrime të botuara në shtypin shqiptar dhe në mediat sociale. Misogjinia është më e evidente ndaj grave në karrierë.

Institucioni i Avokati të Popullit u ka bërë thirrje institucioneve të tjera në sferën e kompetencave të të cilave bie mbrojtja e të drejtave të grave si dhe organizatave të shoqërisë civile që në raste të identifikimit të gjuhës misogjene është e nevojshme një përgjigje e bashkërenduar dhe e menjëhershme e të gjithë aktorëve kundrejt misogynëve, pasi indiferenca fuqizon ata duke përkeqësuar pozitën e grave.

Gjithashtu, gjatë vitit 2019 në ushtrim të mandatit të tij monitories e garantues të zbatimit të standardeve ndërkombëtare, institucioni i Avokatit të Popullit nisi punën për hartimin e Raportit Alternativ për përcaktimin e nivelit të zbatimit të detyrimeve të parashikuara në Konventën CEDAË. Periudha e raportimit përfshin vitet 2016-2020.

Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, siç është institucioni i Avokatit të Popullit, përbëjnë një shtyllë themelore të sistemeve kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ato shihen si një mekanizëm kyç që kontribuojnë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Përmes monitorimit dhe raportimit në lidhje me progresin e bërë nga shteti shqiptar në përmbushjen e detyrimeve të Konventës, Avokati i Popullit ndihmon në evidentimin e problemeve specifike të zbatimit të Konventës dhe të aktorëve përgjegjës për zgjidhjen e tyre, duke dalë me propozime konkrete për përmirësimin e situatës së të drejtave të grave në Shqipëri. Gjithashtu, ky raport do të ndihmojë Komitetin e Ekspertëve të Konventës CEDAW për t'u njohur me situatën reale të grave në Shqipëri dhe nevojat që ato kanë, me qëllim formulimin e rekomandimeve që ju përgjigjen këtyre nevojave.

Të drejtat e personave LGBTI

Shqipëria ka njohur progres lidhur me njohjen e të drejtave të personave LGBTI, duke startuar që nga hartimi i një legjislacioni efikas kundër diskriminimit, diskutimit publikisht për të drejtat e LGBTI, krijimin e një komuniteti të konsoliduar dhe aktiv në mbrojtje të këtyre të drejtave për t'u përmbysur me hartimin e një planiveprimi me detyra konkrete për çdo institucion.

Nga këndvështimi i institucionit të Avokatit të Popullit, vlerësojmë se problematika më e shprehur e këtij komuniteti është vështirësia e të kuptuarit të diversitetit dhe niveli i njohurive mbi komunitetin LGBTI.

Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave që i përkasin komunitetit LGBTI për vitin 2019 ka vijuar e ndërthurrur në dy funksione kryesore, atë të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të këtij komuniteti.

Referuar ankesave të regjistruara pranë institucionit nga persona të komunitetit LGBTI për vitin 2019, rezulton se është regjistruar vetëm një ankesë për ushtrim të dhunës kundrejt një përfaqësuesi të këtij komuniteti. Mungesa e adresimit të institucionit me ankesa për mosrespektimin dhe shkeljen e të drejtave të këtij komuniteti, motivohet dhe ka në themel të saj, hezitimin për shkak të stigmatizimit që ky komunitet ka për të pranuar hapur identitetin e tij gjinor.

Institucioni i Avokatit të Popullit në këtë kontekst ka një rol të kyç sa i përket promovimit të të drejtave të këtij komuniteti në kuadër të drejtave të njeriut, njohjen e legjislacionit në mbrojtje të të drejtave të tij si edhe monitorimin në vazhdimësi të respektimit apo masat që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore përgjegjëse për garantimin e plotë të këtyre të drejtave.

Gjatë vitit 2019, institucioni i Avokatit të Popullit ka konsoliduar partneritetin e tij me të gjitha organizatat e shoqërisë civile të cilat mbrojnë të drejtat e këtij komunitetit, duke luajtur rol proaktiv në të gjitha veprimtaritë e organizuara me qëllim ndërgjegjësimin e shoqërisë në lidhje me këto të drejta por edhe duke organizuar vetë të tilla.

Në kuadër të mbrojtjes dhe garantimit të respektimit të të drejtave të grave e vajzave dhe atyre të komunitetit LGBTI, njohja e tyre me standardet më të larta të të drejtave që gëzojnë si nga legjislacioni ndërkombëtar ashtu edhe ai vendas është një nga aktivitetet që do të vijojë të jetë në fokusin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit.

3.16. Respektimi i të drejtave të personave të moshuar

Institucioni i Avokati i Popullit si një institucion që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut ka në prioritetet e punës së tij edhe mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve të cilët kategorizohen si një ndër grupet më vulnerabël dhe më të ekspozuar ndaj riskut të mosrespektimit dhe garantimit të të drejtave të tyre të saksionuara në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

Për të garantuar të drejtat e tyre për siguri sociale për akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor për një transport falas etj, ndër vite institucioni ka artikuluar kërkesën e tij në formën e rekomandimeve për administratën shtetërore dhe veçanërisht për ministritë e linjës në lidhje me miratimin e statusit të moshës së tretë.

Qysh prej vitit 2018 është ngritur një grup i posaçëm pune për hartimin e projekt ligjit “Për moshimin aktiv”⁶³. Në kuadër të rolit proaktiv, institucioni i Avokatit të Popullit merr pjesë aktive në këtë grup pune me një përfaqësues të tij.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2019, nivelin e respektimit të të drejtave të moshuarve të cilët janë të akomoduar në institucionet e përkujdesit social, nëpërmjet inspektimeve përkatësisht në shtëpitë e të moshuarve Gjirokastër, Shkodër, Kavajë, Fier dhe Tiranë. Pas inspektimeve të kryera dhe evidentimit të problematikave janë hartuar rekomandime konkrete të cilat i janë dërguar rregullisht strukturave përkatëse shtetërore, kryetarëve të bashkive dhe Shërbimit Social Shtetëror dhe fokusi i tyre ka qenë i orientuar drejt përmirësimit të kushteve të jetesës e zbatimin sa më cilësor të standardeve të përkujdesit social për këtë kategori.

Viti 2019 risolli edhe njëherë në vëmendje një problematikë të hershme të evidentuar ndërvite, atë të mungesës së qendrave ditore për të moshuarit për të cilën institucioni i Avokati i Popullit ka

⁶³Shoqëria Shqiptare për të gjitha Moshat (ASAG), Dhoma Kombëtare të Ndërmjetësve, Shoqata e Demografëve të Shqipërisë, Shoqata e Pensionistëve të Shqipërisë, etj.

hartuar rekomandimin për ngritjen dhe funksionimin e tyre. Një problematikë e shprehur për këtë kategori dhe e trajtuar nga institucioni është ajo e moszbatimit të drejtë të akteve ligjore në fuqi që rregullojnë këtë fushë të së drejtës.

Më konkretisht për kërkesën e sistemimit në një nga shtëpitë e të moshuarve nga ana e punonjësit social nuk ishte kryer verifikimi në vend për të parë realisht kushtet në të cilat ndodhej i moshuari në kundërshtim me kriteret e parashikuara në vendimin nr.425, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike të përkujdesjes shoqërore”*.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje haptazi e të drejtave ligjore, adresuam rekomandimin tonë pranë strukturës përgjegjëse, kryetarit të njësisë administrative nr.8 për verifikimin nga administratori social të gjendjes social-ekonomike të shtetasit dhe plotësimin e saktë të formularit *“Verifikimi i situatës social-ekonomike”*. Rekomandimi ynë u mor në konsideratë dhe nga ana e administratorit social u krye verifikimi në vend i situatës social-ekonomike të të moshuarit dhe u plotësua saktë *“Formulari i vlerësimit social- ekonomik i familjes”*.

Gjithashtu në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019, pas marrjes së rastit me iniciativë, me qëllim krijimin e kushteve dhe infrastrukturës së nevojshme për t'i mundësuar personave të moshuar të ushtronin lirisht të drejtën e tyre të votës, u jemi drejtuar drejtuesve të shtëpive të të moshuarve Tiranë, Kavajë, Shkodër, Fier dhe Gjirokastrë, me kërkesën për marrjen e masave përkatëse në funksion të ushtrimit të plotë dhe të qetë të së drejtës së votës. Në përgjigje të kërkesave tona, u informuan se të gjithë të moshuarit ishin pajisur rregullisht me dokumenta identifikimi dhe ishin marrë të gjitha masat e nevojshme që ata të ushtronin të drejtën e votës, konform ligjit.

Në funksion të rolit të tij promovues, institucionit i Avokatit të Popullit në vitin 2019, organizoi gjithashtu një takim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, me fokus rolin e institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të moshuarve, duke mundësuar marrjen e ankesave konkrete të të moshuarve në vend.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se shteti dhe vetë shoqëria shqiptare duhet të vijojnë të forcojnë mekanizmat socialë dhe ekonomike në mbështetje të të moshuarve.

3.17. E drejta e minoriteteve (pakicave) kombëtare

Viti 2019 mbetet një vit dinamik në zhvillimet që lidhen me detyrimet që Shqipëria duhet të përmbushë në hapat që ajo po ndjek në procesin e hapjes së negociatave me BE-në dhe nga ana tjetër, realizimin konkret të këtyre detyrimeve dhe përputhshmërisë së tyre me parimet bazë të respektimit të shtetit të së drejtës dhe lirive themelore të njeriut.

Institucioni i Avokati i Popullit në rolin e institucionit të pavaruar kushtetues, garantues të lirive të ligjshme dhe të drejtave të njeriut si dhe të promovuesit të standardeve më të larta të shtetit të së drejtës ka ndjekur nga afër një sërë iniciativash apo edhe zhvillimesh konkrete të cilat ndërthurin

në vetvete pikërisht, respektimin, garantimin dhe promovimin e këtyre standardeve në Shqipëri, gjatë vitit që lamë pas.

Një vëmendje e veçantë në këtë këndvështrim të zgjeruar të gjendjes së të drejtave dhe lirive të ligjshme të njeriut, i ka takuar analizës së situatës se, ku jemi sot sa i takon respektimit të të drejtave të minoriteteve kombëtare dhe se çfarë masash konkrete po ndërmerren për ushtrimin efektiv të tyre.

Mbështetur në juridiksionin dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin organik të Avokatit të Popullit, veprimtaria e Avokatit të Popullit, lidhur me respektimin e të drejtave të pakicave në këto vite është bazuar kryesisht në hetimet “*ex-officio*” që ai ka ndërmarrë kohë pas kohe për këtë qëllim. Kjo mënyrë veprimi është kondicionuar edhe për faktin, se numri i ankesave që vijnë nga individë pjesëtarë të pakicave ka rezultuar të jetë i ulët. Për këtë arsye Avokati i Popullit është prirur që të gjendet sa më afër këtyre individëve dhe komuniteteve, duke shkuar dhe kontaktuar me ta në vendet e banimit, qoftë në raste individuale apo edhe nëpërmjet organizimit të ditëve të hapura në zonat e tyre të njohura të banimit.

Gjatë vitit 2019 janë marrë në shqyrtim 27 ankesa nga individë të cilët u përkasin komuniteteve të minoriteteve (pakicave) kombëtare. Specifika qëndron në faktin se në këto ankesa nuk ngrihet shqetësimi për mohim apo shkelje të të drejtave kolektive të minoriteteve, pjesëtarë të të cilëve janë ankuesit përkatës por në to pretendohet për shkelje të të drejtave dhe lirive të ligjshme individuale të këtyre shtetasve. Kjo bën që numri i ankesave të deklaruara për këtë pjesë të raportit të mos jetë mirëfilltazi një numër që i përket kësaj fushe të të drejtave të njeriut por të jetë një e dhënë statistikore e përfshirë në ankesat e shqyrtuara nga ana e Avokatit të Popullit për të drejta dhe liri të ligjshme të individit të trajtuara në pjesë të tjera të këtij raporti vjetor. Më konkretisht, këto ankesa kanë pasur të bëjnë me të drejtën për strehim të drejtën për punësim, cënimin e së drejtës të pronës të drejtën për të përfituar nga sistemi i përkujdesjes shoqërore (ndihma ekonomike) apo edhe me të drejtën për furnizim me ujë të pijshëm si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në tërësi.

Konkretisht, sa i përket të drejtës së pronës sjellim në vëmendje se nxjerrja e akteve nënligjore nga ana e Këshillit të Ministrave, sikurse Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 708 datë 21.11.2018 “Për regjistrimin dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizimin të disa pronave të paluajtshme shtetërore në vijën bregdetare Vlorë-Sarandë”, i ndryshuar, me VKM nr.187 datë 4.04.2019 ka krijuar problematika që lidhen me cënimin e kësaj të drejte dhe të drejtave të tjera që rrjedhin prej saj. Ky fakt është pasqyruar në disa ankesa të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit. Megjithatë duhet theksuar se, sensitiviteti i krijuar për pasojat juridike që sjell ky akt nënligjor normativ në vlerësimin e Avokatit të Popullit nuk lidhet drejtëpërdrejtë me cënimin e mundshëm të të drejtave të minoriteteve kombëtare që jetojnë në këtë zonë të vendit por në përgjithësi me cënimin e së drejtës të pronës për një sërë subjektsh pronare të pronave të paluajtshme të ndodhura përgjatë gjithë vijës bregdetare.

Krahas shqyrtimit të ankesave të paraqitura, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve kushtuar të drejtave të minoriteteve si brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij. Veçojmë këtu, organizimin e një aktiviteti promovues në bashkëpunim me Rrjetin e Organizatave Rome dhe Egjiptiane për qarkun e Korçës në ambientet e Qendrës Komunitare Korçë. Temat e diskutuara gjatë këtij aktiviteti lidheshin me aktivizimin real të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në procesin e vendimmarrjes në nivel vendor dhe pjesëmarrja efektive e tyre në këtë proces si dhe rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me institucionin e Avokatit të Popullit në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Në kuadër të rolit proaktiv të Avokatit të Popullit në këtë fushë, gjatë vitit 2019, risjellim në vëmendje faktin, se institucioni i Avokatit të Popullit ka luajtur një rol aktiv gjatë gjithë procesit të draftimit të projektligjit përkatës, duke dhënë vërejtje dhe sugjerime të cilat janë pasqyruar në një masë të mirë të tërë në përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Ky rol i yni ka vijuar dhe po vijon edhe në procesin e diskutimit dhe miratimit të akteve nënligjore (qoftë të atyre të miratuara apo në proces) në zbatim të dispozitave të ligjit nr.96/2017.

Kuadri i ri ligjor në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve kombëtare ka nxjerrë nevojën tashmë që nga ana jonë të rivlerësohet pozita aktuale e këtyre minoriteteve në marrëdhënien aktuale me popullsinë mazhoritare, duke identifikuar stadin e ri në të cilin shfaqen problematikat që shqetësojnë individët apo komunitetet përkatëse të tyre në të gjithë vendin, masat që janë ndërmarrë nga ana e shtetit për integrimin e tyre si dhe vlerësimin real të qasjes që është ofruar pikërisht për këtë aspekt në një kuptim sa më gjithëpërfshirës.

Realiteti i ri i krijuar me afirmimin dhe garatimin e mbrojtjes së të drejtave kolektive të minoriteteve në Shqipëri, i konkretizuar me njohjen zyrtare tashmë të 9 minoriteteve kombëtare, përbën një mundësi të mirë promovuese dhe analitike për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në këtë fushë.

Megjithatë, duhet theksuar, se përpos zhvillimeve pozitive që lidhen me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” apo edhe të miratimit dhe hyrjes në fuqi të disa akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, përsëri mbetet problematike, nxjerrja në tërësi e të gjithë paketës së akteve nënligjore të parashikuara si të nevojshme për mundësimin e zbatimit real të këtij ligji. Sikurse na rezulton në tejkallim të afateve të përcaktuara nga ligji, ende nuk janë nxjerrë dhe nuk kanë hyrë në fuqi, disa akte të rëndësishme nënligjore për këtë qëllim.

Kushtetuta e RSH- së e ka të shprehur qartësisht detyrimin ligjor që kanë organet e parashikuara në të për të miratuar aktet nënligjore në dhe për zbatim të ligjeve. Fryma e shprehur në këtë dispozitë të Kushtetutës nuk lë vend për interpretime të ndryshme nga ajo që përcaktohet si, detyrim kushtetues i organeve të autorizuar me ligj për të nxjerrë aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjeve. Ky detyrim do të thotë respektim i afateve të përcaktuara në ligj për nxjerrjen e

akteve nënligjore nga organi i autorizuar përkatës, referimin dhe përcaktimin e parimeve bazë mbi të cilat do të nxirren këto akte si dhe çështjet konkrete që duhen rregulluar nëpërmjet akteve nënligjore që duhet të nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjit.

Efektivisht, mospërmbyllja e këtij detyrimi identifikon jo vetëm shkelje të dispozitave kushtetuese si dhe të parashikimeve ligjore por edhe shkelje të së drejtës së ligjshme të individëve, përfaqësues të minoriteteve kombëtare për të gëzuar në jetën e tyre të përditëshme komunitare të drejtat e afirmuara dhe garantuara tashmë në ligjin nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Pra, megjithëse ligji i njeh kësaj kategorie individësh të drejta specifike në kuadër të të drejtave kolektive të minoriteteve kombëtare në kushtet kur nuk është nxjerrë akti nënligjor përkatës, me të cilin rregullohen teknikalitetet e gëzimit dhe mundësimin të ushtrimit efektiv të së drejtës së garantuar nuk sigurohet dot zbatimi efektiv i ligjit dhe për rrjedhojë nuk sigurohet dot jetësimi dhe ushtrimi efektiv i së drejtës nga ana e subjekteve të cilëve ju është njohur dhe garantuar kjo e drejtë.

Kjo gjendje faktike ka bërë që edhe vetë përfaqësuesit e komuniteteve minoritare kombëtare të shprehin skeptikë dhe t’u shohin këtë mungesë si një ndikim negativ në respektimin e standardeve të demokracisë, mirëqeverisjes si dhe të proceseve integruese të vendit. Ky proces është shumë i nevojshëm dhe duhet përmbyllur në një kohë sa më të shpejtë, me qëllim garantimin e plotë të të drejtave komunitare por edhe të të drejtave individuale të pjesëtarëve të minoriteteve kombëtare në Shqipëri.

Kjo mungesë, i shtohet tashmë gamës së sfidave të ndeshura në zbatimin e të drejtave të pakicave të cilat konsistojnë në krijimin e besimit të ndërsjelltë mes aktorëve që veprojnë në këtë fushë, ndryshimin e mentalitetit lidhur me pranimin e realiteteve të reja dhe respektimin e të drejtave të individëve që i përfaqësojnë ato, krijimin e një mjedisi të përshtatshëm institucional që mundëson barazinë reale të individëve pjesëtarë të minoriteteve të ndryshme me pjesën tjetër të popullsisë në vend dhe të integritetit të tyre.

Një sfidë tjetër, mbetet shmangia e fushatave propagandistike të përkohëshme dhe të pavlera dhe formësimi i një procesi të vazhdueshëm të pandërprerë për monitorimin e respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe mundësimin e ushtrimit të tyre.

Kontributi i Avokatit të Popullit do të vazhdojë të jetë konsistent në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të minoriteteve, specifikisht duke nxitur dhe monitoruar punën e grupeve ndër-institucionale gjatë procesit të diskutimit dhe miratimit të këtyre akteve nënligjore si dhe duke dhënë mendime konkrete mbi përmbajtjen e projekt akteve. Ky kontribut do të jetë i qenësishëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve në vend, qofshin ato të njohura si të drejta kolektive të komuniteteve minoritare apo edhe të drejta individuale të pjesëtarëve të këtyre minoriteteve.

Në këtë frymë, jo rastësisht, më herët dhe ndër të tjera, ne kemi theksuar, nevojën për ndryshimin dhe përmirësimin e legjislacionit të brendshëm, lidhur me shtimin e kriterëve ligjorë të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi të cilat çojnë në diskriminim apo edhe ratifikimi nga ana e shtetit tonë të Kartës Europiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare.

Ky proces i ndjekur nga një integrim real i minoriteteve në nivelin e qeverisjes vendore dhe atë qendrore, do të sjellë padyshim produktin e pritshëm të një shoqërie demokratike dhe të harmonisë tradicionale të bashkëjetesës që do të njihej si vlerë e shtuar e shoqërisë shqiptare. Edhe censusi i ri i popullsisë që pritet të kryhet gjatë vitit 2020, duhet të kryhet mbi bazën e kriterëve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, nëpërmjet një procesi, ku minoritetet të gjejnë veten për t'u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre.

Mbrojtja e ekzistencës së minoriteteve dhe akomodimi i diversitetit në shoqëri duhet të jetë një objektivi i përhershëm i shtetit shqiptar për të ndërmarrë masa shtesë si për t'u paraprirë, ashtu edhe për t'i zgjidhur problemet sa herë që ato lindin dhe do të rilindin.

Respekti ndaj të drejtave të minoriteteve nuk është një privilegj që shteti dhe shoqëria jonë bënë atyre por një detyrim dhe një proces i natyrshëm që bazohet tek dinjiteti njerëzor dhe diversiteti, duke prezantuar kështu një investim madhor që një shoqëri i rezervon vetvetes për të ardhmen.

3.18. Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore

E drejta në fushën e sigurimeve shoqërore është një e drejtë e sanksionuar shprehimisht në Kushtetutën e RSH-së, e cila në nenin 52/1, parasheh se "...Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj..."

Respektimi dhe zbatimin efektiv i kësaj të drejte është me rëndësi jetike për qytetarët, ndaj kjo kategori sensitive e së drejtës duhet që të respektohet e realizohet në mënyrë efikase e brenda afateve ligjore.

Megjithëse, sistemi publik i sigurimeve shoqërore është reformuar konform zhvillimeve ekonomiko-sociale të diktura kohë pas kohe, sërish problematika të hershme e të reja identifikohen nga institucioni ynë në lidhje me mosrespektim apo shkelje të të drejtave të individëve në fushën e sigurimeve shoqërore

Referuar ankesave të regjistruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2019, rezulton të jenë trajtuar 77 ankesa nga qytetarët. Konstatohet, se problematikat më të spikatura të shprehura në përmbajtjen e ankesave të depozituara dhe të shqyrtuara, konsistojnë në pretendime të qytetarëve, lidhur me shkelje të të drejtave për shkak të moslllogaritjes së drejtë apo të mosrishikimit të masës së pensioneve të pleqërisë, mosnjohjen e vjetërsisë së punës për masën e ulët të pensioneve për kohën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë për mosmarrje të përgjigjes të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të degëve të përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, zvarritje në lidhjen e pensionit të pleqërisë për ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, etj.

Më konkretisht, institucioni i Avokatit të Popullit, evidenton dhe shtjellon sa më poshtë, problematikat më të qenësishme, me të cilat është ballafaquar gjatë vitit 2019 në fushën e sigurimeve shoqërore:

- *Mbajtje pa të drejtë të shumës mujore të pensionit shtetëror suplementar në masën 100%.*

Ankuesit, përfitues të pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar shtetëror në të njëjtën

periudhë kohore, ankimonin masën e ndalesës 50% ose 100% të pensionit suplementar shtetëror, çdo muaj, deri në shlyrjen e detyrimit përkatës.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështje, konstatuam se ligji nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar në paragrafin e pestë të nenit19, parashikon në mënyrë të shprehur se: “...E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se tre vjet nga marrja e tyre por jo më vonë se gjashtë muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20% e këstit mujor të përfitimit...”.

Duke rezultuar, se në asnjë dispozitë të tij, ligji nuk e kishte parashikuar shprehimisht ndalesën në masën 50% ose 100% të pensionit shtetëror suplementar për çdo muaj, i adresuam strukturës shtetërore, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rekomandimin përkatës. Rekomandimi u mor në konsideratë, duke aplikuar ndalesën debitorë në masën 20 % për çdo muaj, deri në shlyrjen e detyrimit përkatës.

- *Mosdhënia e së drejtës për të përfituar pensionin e invaliditetit për kategorinë e personave që në 5 vjeçarin e fundit para lindjes së të drejtës nuk kanë qenë në marrëdhënie pune, pavarësisht se plotësojnë kriteret mjekësore.*

Edhe gjatë këtij viti, institucioni ka administruar e trajtuar ankesa nga qytetarët, objekti i të cilave ka qenë mosdhënia e së drejtës për t’u vlerësuar për gjendjen shëndetësore nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë për arsye se individët nuk kanë patur 12 muaj sigurim në 5vjeçarin e fundit, para lindjes së të drejtës për përfitim.

Për kategorinë e personave të cilët janë penalizuar nga pika 2, e nenit 35 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite, qysh prej hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore⁶⁴ ka adresuar këtë problematikë të hershme pranë institucioneve shtetërore, me shkresa zyrtare, rekomandime dhe takime të posaçme në fuksion të zgjidhjes së saj.

⁶⁴Ligji nr.104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Nisur nga ky vit, pas angazhimit shumëvjeçar e rigoroz institucional në lidhje me çështjen e sipërcituar, kategoria e personave që nuk plotësojnë kriterin ligjor për të përfituar nga legjislacioni në fushën e sigurimeve shoqërore, do të trajtohen me ligjin nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

- *Masë e ulët të pensionit të pleqërisë.*

Nga institucioni ynë janë trajtuar ankesa të cilat adresoheshin për Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, me objekt llogaritja jo e drejtë e masës së pensionit të pleqërisë.

Nga shqyrtimi dhe ndërmjetësimi ynë institucional, duke sugjeruar rillogaritje të masës së pensionit, ankuesit kanë përfituar rritje të masës së pensionit. Gjithashtu janë llogaritur diferencat sipas legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore.

Mbështetur në juridiksionin dhe kompetencat e përcaktuara në ligjin organik të Avokatit të Popullit, veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me sigurimet shoqërore është bazuar edhe në hetimet “*ex-officio*”. Rasti i trajtuar me iniciativë nga institucioni është ai i publikuar në media, me titull “Lista/Alarmante, bashkitë nuk paguajnë sigurimet shoqërore për punonjësit”.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve më datë 18.5.2019 ka paraqitur një listë, ku të gjitha bashkitë dhe ish-komunat rezultojnë me detyrime tatimore, kryesisht për sigurimet shoqërore të papaguara për punonjësit e tyre, duke vënë njëkohësisht edhe masën e ekzekutimit me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara për Bashkitë e Libohovës, Memaliajt, Përmetit, Tepelenës, Pustecit, Sukthit, Himarës, Poliçanit, Fushë-Krujës, Krujës, Kavajës, Rrogozhinës dhe Divjakës. Burimet zyrtare të asaj drejtorie pohuan, se borxhi i bashkive dhe komunave përbëhet nga sigurimet shoqërore të papaguara. Mospagesa e sigurimeve shoqërore nga bashkitë është e patolerueshme. Planifikimi i një buxheti të një institucioni publik, siç është bashkia, bëhet bazuar në rregulla dhe ligje dhe qartësisht planifikimi i shpenzimeve fillon me paga dhe sigurime shoqërore që janë të pandara, pasi nuk mund të kryhet pagesa e pagës, pa bërë pagesën për sigurime shoqërore, sipas përqindjes së përcaktuar në ligj.

Mund të jetë e vërtetë që bashkitë ndodhen në vështirësi financiare, pasi ato nuk po marrin buxhet të mjaftueshëm nga pushteti qendror për të përmbushur funksionet dhe shërbimet publike vendore, ashtu si dhe njësitë vendore që nuk po arrijnë të rrisin buxhetet e tyre nga të ardhurat e veta (taksa, tarifë vendore). Por, asnjë nga këto vështirësi nuk e justifikon mospagesën e sigurimeve shoqërore. Nga ana tjetër, po aq shqetësues është edhe fakti, se si e kanë lejuar këtë situatë degët e Thesarit. Thesari është një filtër që duhet të kujdeset dhe të shtyjë bashkitë të procedojnë fillimisht me sigurimet shoqërore, përpara se të certifikonin shpenzimet e tjera.

Këto bashki, referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duhet të rishikojnë buxhetet dhe të ulin shpenzimet aty ku munden dhe të sigurojnë fondin për sigurime. Nga ana tjetër, Drejtoria e

Përgjithshme e Tatimeve duhet t'i asistojë dhe të bashkëpunojë me këto bashki dhe të bien dakord për një plan për t'a mbyllur këtë problem, pasi asnjë i punësuar nuk duhet të preket nga kjo situatë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nga ana e saj ka pohuar se strukturat e pushtetit vendor, shpesh nuk janë korrekte për sjelljen e listë-pagesave në Thesar dhe abuzojnë me udhëzimet që kanë të bëjnë me pagesat nga Thesari.

Sipas të dhënave nga Shoqata e Bashkive, pushteti vendor ka patur të punësuar në vitin 2018, rreth 33,500 punonjës nga 22,000 në vitin 2015, ose 11 mijë e 500 punonjës më shumë. Nga transferimi i funksioneve të reja nuk janë më shumë se 10 mijë punonjës.

Edhe pa transferimin e funksioneve të reja (arsimi parashkollor, administrimi i pyjeve, mirëmbajtja, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri, etj.) administrata e bashkive rezulton të jetë më e fryrë, se përpara Reformës Administrative Territoriale. Për këtë arsye, bashkitë në të gjithë vendin kanë dështuar të paguajnë sigurimet shoqërore për punonjësit por edhe të adresojnë qëllimin e deklaruar të Reformës Administrative Territoriale.

Pas shqyrtimit të këtij rasti, iu drejtua 61 kryetarëve të bashkive për të na dërguar një informacion të hollësishëm, lidhur me:

- numrin e punonjësve të institucionit që drejtojnë dhe të institucioneve të varësisë për periudhën 2015-2019;
- numrin e punonjësve për të cilët nuk janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- periudhat përkatëse për të cilat nuk janë derdhur këto kontribute.

Gjithashtu, kërkuam kopje të dokumentacionit të periudhave për të cilat nuk janë derdhur këto kontribute. Konkretisht:

- a) deklaratat e "Listëpagesave e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore";
- b) urdhër-pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- c) urdhër-shpenzimet.

Kjo çështje është ende në shqyrtim, pasi nuk kanë ardhur përgjigjet nga 20 kryetarë bashkie⁶⁵.

Nga 41 përgjigjet e administruara ka rezultuar, se vetëm 7 njësi të qeverisjes vendore kanë patur detyrime të pashlyera ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Konkretisht, bashkitë: Has, Kukës, Konispol, Selenicë, Mallakastër, Tepelenë (që nga viti 2009) dhe Librazhd.

Institucioni të Avokatit të Popullit, vlerëson se qeveria shqiptare së bashku me institucionet e tjera përgjegjëse, me gjithë arritjet e deritanishme, duhet të jetë më efektive në politikat që lidhen me fushën e sigurimeve shoqërore.

⁶⁵ Bashkitë: Vorë, Kavajë, Peqin, Tropojë, Mirditë, Vau i Dejës, Finiq, Delvinë, Himarë, Sarandë, Vlorë, Ura-Vajgurore, Klos, Mat, Gjirokatër, Përmet, Korçë, Pogradec, Rrogozhinë.

KREU 4

Angazhime të tjera institucionale

4.1. Raporti i veçantë për “Astirin”⁶⁶

Ky raport i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë në datën 21 tetor 2019. Ai ende rezulton të jetëshqyrtuar nga ana e Kuvendit në një nga mënyrat e parashikuara në nenet 27 dhe 28 të ligjit nr.8454, datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar.

Mosrespektimi i së drejtës së pronësisë si një ndër të drejtat më themelore të njeriut vazhdon ende të përbëjë një fenomen shqetësues në vend. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit ka trajtuar me iniciativë çështjen që lidhet me zbatimin e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”. Ai ka shqyrtuar gjithashtu paralelisht edhe petitionin e paraqitur nga 427 banorë të segmentit të zonës së Astirit si dhe 16 ankesa individuale të paraqitura në institucionin tonë apo në terren gjatë verifikimeve dhe inspektimeve të ndërmarra nga ekspertë të institucionit.

I gjithë ky proces i është nënshtruar një monitorimi të vazhdueshëm në vend nga ana e Avokatit të Popullit për çdo njoftim apo çdo ngjarje që lidhet me veprimtarinë e organeve publike si dhe të protestave të shpeshta të banorëve të zonës së Astirit. Raporti është fokusuar në analizimin e procesit të vendimmarrjes për miratimin e projektit që po zbatohet të veprimtarisë së ish ALUIZNI-t dhe vijon me procesin e ndjekur nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), procedurat e shpronësimit, bashkëpunimin dhe rolin e Bashkisë Tiranë në këtë proces si edhe rolin e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) të Bashkisë Tiranë apo subjekteve të treta që kanë kryer veprime për prishjen e banesave ose të veprave publike.

Vendimmarrja për miratimin e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”

Ajo që është evidentuar që në fillim të procedurës është fakti se nuk ka patur një informacion apo njoftim zyrtar të plotë e në përputhje me ligjin mbi projektin që po zbatohet në këtë zonë, vendimin me të cilin ai është finalizuar, koston e tij totale si edhe koston e planifikuar për shpronësimin e banorëve në bazë të kuadrit ligjor që rregullon procedurat e shpronësimit. Ky ka qenë dështimi i parë i organeve të administratës shtetërore në këtë problematikë komplekse.

⁶⁶ Kjo është një përmbledhje e raportit të cilin të plotë e gjeni në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20p%C3%ABr%20zon%C3%ABn%20e%20Astirit.pdf>

Në kuadër të hetimit të kësaj çështjeje nga ana jonë i jemi drejtuar me një sërë shkresash të gjitha organeve shtetërore me përgjegjësi administrative në këtë proces si, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT).

Në përgjigjen zyrtare të dhënë nga ana e AZHT-së⁶⁷ sqarohet ndër të tjera se në mbledhjen e datës 20.11.2018, Këshilli Kombëtar i Territorit miratoi Vendimin nr.01, “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”. Theksojmë se pavarësisht kërkesave tona të hollësishme e të përsëritura, informacioni i dhënë nga ana e AZHT-së dhe më pas nga ana e ARRSH-së për të sqaruar procedurat dhe afatet e ndjekura nga ana e ARRSH-së për miratimin e kërkesave për vendimmarrjen e nevojshme nga ana e KKT-së për lejimin e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë” nuk **ka qenë i plotë**.

Miratimi i lejes së zhvillimit, përkatësisht me vendimin e sipërcituar është një moment shumë i rëndësishëm në trajtimin e kësaj problematike, pasi në përputhje me legjislacionin në fuqi, dokumenti i lejes së zhvillimit është parakusht dhe shërben si bazë për pajisjen me lejen e ndërtimit por është leja e ndërtimit akti administrativ që i mundëson subjektit zhvillues të procedojë me kryerjen e punimeve në zbatim të projektit të miratuar.

Nga përgjigja e AZHT-së dhe nga analiza e legjislacionit rregullator në fuqi na ka rezultuar se, KKT-ja ka miratuar vetëm leje zhvillimore për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë” por jo një leje ndërtimi. Kjo leje ndërtimi ka munguar si një akt administrativ i domosdoshëm për lejimin e punimeve përkatëse në zonën e Astirit, gjatë kohës së përgatitjes të këtij raporti të veçantë. Ndërkohë nga verifikimi i kryer në faqen “on line” të AZHT-së,⁶⁸ lidhur me vendimet e miratuara nga ana e KKT-së për kërkesat e paraqitura pranë saj për leje ndërtimi gjatë vitit 2019, rezulton se ende nuk ka një vendim të KKT-së për miratimin e një leje ndërtimi për objektin “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”. Në këto rrethana kemi konstatuar se të gjitha organet ligjzbatuese të përfshira në këtë proces kanë dështuar për të ndaluar punimet e kryera pa leje apo edhe përgatitjet e kantierëve të ndërtimit pa leje nga cilido subjekt tenderfitues, i dalë nga procedurat e tenderimit të zhvilluara nga ana e ARRSH-së.

Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, i bën një trajtim shumë specifik procesit të këshillimit dhe takimit publik nga ana e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit, përpara çdo vendimmarrje lidhur me dokumentet e planifikimit në nivel qendror dhe me planin e përgjithshëm vendor. Ky proces mbart një rëndësi të veçantë pasi në thelb ruan balancën ndërmjet interesave private dhe atyre publikë të

⁶⁷ Shkresa nr. 3116/1 prot, datë 26.12.2018

⁶⁸ Ky verifikim është kryer në datën 24.09.2019 në website; www.azht.gov.al.

ndërthurura në vendimmarrjet që lidhen me dokumentet e planifikimit, zhvillimit apo kontrollit të zhvillimit të territorit.

Në asnjë informacion të dhënë nga ana e ARRSH-së që lidhet me procesin e miratimit paraprak të projektit “Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me Shigjeta” – Rrethrotullimi “Shqiponja” (Lot.1, Lot.2, Lot.3), me vendimin e Këshillit Teknik të ARRSH-së, nr.56 datë 4.09.2018 nuk gjejmë dokumentacion zyrtar që tëvërtetojë ezaurimin e procedurave ligjore që kërkojnë kryerjen e njoftimit publik, takimeve publike apo edhe të pasqyrimin të vërejtjeve, komenteve apo propozimeve të mundshme të paraqitura nga palët e interesuara, ndaj projektit në fjalë të hartuar nga subjekti “AVE” shpk. Ky proces duhet të ishte kryer midis datës 4.09.2018 dhe në vijim por nuk ka asnjë të dhënë dhe asnjë publikim zyrtar në këtë periudhë kohore.

Nga inspektimet dhe monitorimet e vazhdueshme të kryera nga ana jonë në zonën e Astirit, ndër të tjera ka rezultuar se janë kryer ndërhyrje ndërtimore dhe prishje e pronës publike në zona publike të destinuara për gjelbërim, para vendimmarrjes së KKT-së. Pas kërkesës sonë për shpjegime drejtuar ARRSH-së, kjo e fundit ka dhënë shprehimisht informacionin se: “Autoriteti Rrugor Shqiptar ka lidhur kontratën me nr.7733/5 prot, datë 2.11.2018, me objekt “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 2”, me Shoqërinë “Salillari” shpk dhe Kontratën me nr.7732/5 datë 2.11.2018 me objekt, “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1”, me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “Biba – X” & “DH ALBANIA”. Tabelat informuese janë vendosur nga kontraktori i punimeve në mbështetje të kontratave të sipërcituara dhe zhvendosja e objektit të Shqiponjës nuk është kryer nga Autoriteti Rrugor Shqiptar”⁶⁹.

Lidhja e kontratave të zbatimit si veprim juridik është kryer 18 ditë përpara miratimit të lejes së zhvillimit. Nuk është e qartë nëse në përmbajtjen e kontratave gjenden parashikime ku përcaktohet se, punimet nga ana e kontraktorit do të fillojnë vetëm pas nxjerrjes së vendimit nga ana e KKT-së për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe miratimit të projektit përkatës të ndërtimit të veprës publike, pasi nuk na janë dërguar kopje të plota të këtyre kontratave nga ARRSH-ja.

Informacion është kërkuar për këtë çështje edhe nga ana e Kryeinspektorit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) si dhe nga ana e IMT në Bashkinë Tiranë.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e IKMT-së⁷⁰, sqarohet shprehimisht se: “Me shkresën nr.9765 prot, datë 5.11.2018, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.4287 prot, datë 6.11.2018, Autoriteti Rrugor Shqiptar kërkon mbështetje për lirimin e sheshit të ndërtimit nga objektet pa leje për realizimin e projektit të Unazës së Madhe segmenti rrugor “Mbikalimi pallati me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja”. Deri në këto momente jemi në fazë verifikimi të situatës në terren, ndërsa në lidhje me prishjen e “Shqiponjës” të ndodhur në rrethrotullim, ju informojmë

⁶⁹ Shkresa nr.10492/1 datë 2.12.2018

⁷⁰ Shkresa nr.4483/2 datë 27.11.2018

se IKMT-ja nuk ka mbajtur procedurë ligjore dhe nuk ka bërë asnjë veprim për heqjen e këtij monumenti”.

Në përgjigjen e dhënë nga ana e IMT në Bashkinë Tiranë⁷¹, thuhet ndër të tjera se: “Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkisë Tiranë nuk ka dijeni zyrtare për miratimin e këtij projekti apo leje zhvillimore në segmentin nga “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrrrotullimi “Shqiponja””. Nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit nuk është marrë pjesë në ndërhyrjen për prishje të objekteve që pengojnë zhvillimin e këtij projekti”.

Natyra e përgjigjeve të paplota dhe kontradiktore të dhëna nga ana e IKMT-së dhe IMT në Bashkinë Tiranë, tregon vullnet për të anashkaluar ligjin apo për të kryer punime të kundërligjshme por edhe për të mënjeluar dhënien e llogarisë apo ushtrimin e kompetencave ligjore. Nga veprimet dhe mosveprimet e këtyre dy institucioneve shtetërore u janë garantuar përfitime materiale ose jopasurore subjekteve ndërtuese që kanë kryer punime në këtë objekt pa pasur një leje ndërtimi, e njëkohësisht janë dëmtuar haptazi në mënyrë flagrante interesat e ligjshme të shtetit dhe shtetasve të cilët si rrjedhojë e punimeve të kryera pa leje dhe pa projekt të miratuar, kanë dëmtuar infrastrukturën rrugore e njëkohësisht edhe pronat e personave që jetojnë pranë aksit rrugor.

Procesi i ndjekur nga ana e ARRSH-së

Në kuadër të hetimit administrativ të kësaj çështjeje nga ana jonë, i janë kërkuar shpjegime ARRSH-së,⁷² ish ALUIZNI-t dhe Bashkisë Tiranë, lidhur me pretendimet dhe shqetësimet e banorëve të zonës. Në përgjigje të kërkesës sonë për shpjegime nga ana e Drejtorit të Autoritetit Rrugor Shqiptar jemi informuar⁷³ se për këtë investim ishte hartuar projekti “Studim Projektim Rehabilitim i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrrrotullimi Shqiponja” nga konsulenti “AVE” sh.p.k, sipas kontratës së Sponsorizimit me nr. 3625/2 datë 25.05.2018. Ndërkohë që, ai thekson më tej se, ky projekt është miratuar me Vendimin nr. 56 datë 04.09.2018 të Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Nga përmbajtja e kësaj shkrese të Autoritetit Rrugor Shqiptar si dhe dokumentacioni bashkëngjitur saj konstatohet fakti se, Bashkia Tiranë është kërkuesi dhe financuesi i projektit “Studim Projektim Rehabilitim i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrrrotullimi Shqiponja”, ndërkohë që ARRSH është zbatuesi i saj.

Bazuar në informacionin e marrë paraprakisht nga ana e AZHT-së kemi konstatuar se nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar në cilësinë e zbatuesit të projektit “Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrrrotullimi Shqiponja, Bashkia Tiranë” janë ndërmarrë

⁷¹ Shkresa nr.1062 prot, datë 24.01.2019

⁷²Shkresa e Avokatit të Popullit, me nr. K3/K45-8 datë 16.11.2018 dhe shkresa e Avokatit të Popullit me nr. K3/K45-8 prot, datë 16.11.2018, drejtuar Drejtorit të ARRSH-së

⁷³ Shkresa nr. 10425/1 prot, datë 26.11.2018

veprime konkrete në dëm të pasurive të shtetasve që banojnë në zonën e Astirit, pa qenë të pajisur me një leje ndërtimi. Në rastin konkret, ky projekt prek një numër të madh banorësh, posedues prej vitesh të objekteve të shfrytëzuara nga ana e tyre për qëllime banimi apo shërbimi. Mungesa e lejes së ndërtimit përbën një cënim të rëndë dhe flagrant të të drejtave themelore të qytetarëve për shkak të ndërhyrjes së realizuar ndaj objekteve të banorëve të zonës së Astirit.

Për më tepër nga informacioni zyrtar⁷⁴ i marrë gjatë përgatitjes së raportit evidentohet se ka qenë Autoriteti Rrugor Shqiptar që ka kërkuar heqjen e pemëve si dhe heqjen e shtyllave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në zonën e Astirit, pa dalë ende leja e ndërtimit, fakt që konstaton shkelje të rënda që çojnë në përgjegjësi administrative por edhe penale.

Procedurat e shpronësimit

Kufizimet e së drejtës të pronës private (shpronësimi apo kufizime që barazohen me shpronësimin) si një e drejtë themelore e njeriut e njohur dhe garantuar në Kushtetutë, legjitimohen që të ndodhin vetëm në rrethana qartësisht të përcaktuara në ligj. Pra, shteti mund t'i privojë individët nga prona ose pasuritë e tyre vetëm në kushtet e përmbushjes së një interesi publik, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe në respektim të së drejtës së ankimit të individit të cënuar për masën e shpërblimit. Pra, qëllimi i shpronësimit për interes publik duhet të jetë i ligjshëm dhe i arsyeshëm. Në vlerësimin e interesit publik duhet respektuar gjithashtu parimi i proporcionalitetit. Sa më sipër është e qartë se ndërhyrja në të drejtën e pronës bëhet vetëm për shkaqe të përcaktuara në ligj në mënyrë shteruese dhe sipas një procedure që respekton të drejtën themelore për një proces të rregullt ligjor.

Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit nuk rezulton që të ketë pasur procedurë paraprake shpronësimi të nisur para fazës së implementimit të projektit “Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja, Bashkia Tiranë”. Kjo ka ndodhur pavarësisht faktit se në këtë zonë ka pasur dhe ka pasuri me dokumentacion të rregullt pronësie apo edhe subjekte që kanë vetëdeklaruar objektet e tyre për legalizim prej vitesh pranë ALUIZNI-t në rrethanat kur ky i fundit ende nuk ka qenë shprehur me një vendim përfundimtar për kualifikimin apo përjashtimin nga procesi i legalizimit të këtyre objekteve.

Një ndër problematikat thelbësore të evidentuara nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit është edhe fakti i përfshirjes në procedurat e shpronësimit të pasurive të paluajtëshme të ligjshme të individëve të caktuar,⁷⁵ pa dijeninë e tyre (pra pa u njoftuar zyrtarisht për këtë fakt nga autoriteti përfitues prej procesit të shpronësimit) dhe pa u ndjekur dhe respektuar procedurat dhe afatet që parashikon kuadri ligjor në fuqi, mbi shpronësimin e pasurisë për interes publik⁷⁶.

⁷⁴ Shkresa nr.1071 prot, datë 14.11.2018, e ARSH-së drejtuar Bashkisë Tiranë.

⁷⁵ Ky rast i përket ankesës së shtetasës N.D të regjistruar në sistemin e administrimit të ankesave në institucionin e Avokatit të Popullit, “Doculive”, me numrin 201802429.

⁷⁶ Shih Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar.

Lidhur me procedurat e shpronësimit duhet theksuar fakti se Këshilli i Ministrave ka miratuar ndër të tjera edhe Vendimin nr.231 datë 17.04.2019 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Pallati me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja”.⁷⁷ Ky vendim është miratuar rreth gjashtë muaj pas fillimit të procedurave dhe veprimeve konkrete nga autoritetet shtetërore ndaj pasurive dhe objekteve që ndodhen në zonën e Astirit, ku efektivisht ka filluar të zbatohet projekti, “Rehabilitimi i segmentit Rrugor “Mbikalimi i Pallatit me Shigjeta-Rrethrotullimi Shqiponja, Bashkia Tiranë”.

Pas paqartësisë së të dhënave në lidhje me numrin e pasurive që do të prekeshin nga zbatimi i projektit në fjalë në zonën e Astirit, kemi konstatuar se në bazë të VKM 231/2019, procesit të shpronësimit do t’i nënshtrohen 209 pasuri ndër të cilat disa kanë edhe shumë bashkëpronarë. Nisur nga kriteret ligjore për përmbajtjen vendimeve që nxirren nga ana e Këshillit të Ministrave në rast shpronësimi për interes publik konstatohet se VKM nr. 231 datë 17.04.2019 në të 11 pikat e përmbajtjes së tij nuk përcakton shprehimisht afatin dhe mënyrën e pagimit për pronarët që shpronësohen për pronarët e pasurive që zhvlerësohen për personat e tretë që kompensohen për të drejtat e tyre për shkak të shpronësimit. Kjo bie ndesh haptazi me ligjin. Po kështu, VKM nuk përcakton shprehimisht afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit si dhe afatin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve për projektin dhe investimin, ose për realizimin e qëllimit të shpronësimit.

Veprimtaria e Agjensisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI-t).

Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka kërkuar ish-Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t si dhe ish Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, me disa shkresa⁷⁸, informacion dhe shpjegime nëse janë kryer komunikime, kërkesa zyrtare nga institucione të tjera shtetërore në kuadër të këtij projekti dhe se si po trajtoheshin në vijim nga ana e ish ALUIZNI-t Tirana – Veri, pretendimet dhe shqetësimet e banorëve në zonën e Astirit.

Nga informacionet e marra është evidentuar se, sipas listës së dërguar ARRSH-së nga ana e ish Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri⁷⁹, numri i përgjithshëm i subjekteve, ndërtimet e të cilëve preken nga zbatimi i projektit është 73, ndërsa vendimet e marra prej ish Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri për skualifikimin e ndërtimeve informale (përgjashtimin nga procesi i legalizimit) që preken nga zbatimi i projektit dhe dërguar Avokatit të Popullit është 90. Kjo situatë mospërputhjeje në shifrat e deklaruara nuk justifikohet.

⁷⁷ Informacion i marrë nga faqja zyrtare e Këshillit të Ministrave: <https://www.kryeministria.al/neesroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-17-prill-2019/>.

⁷⁸ Shkresat me anë të të cilave është kërkuar informacioni përkatës janë: nr.H23-2 Prot, datë 19.11.2018; nr.H23-5 Prot, datë 04.12.2018; nr.H23-5 Prot, datë 04.12.2018; nr.H23-8 Prot, datë 04.02.2019; nr. K3/H25-4 Prot, datë 06.12.2018; nr. K3/K45-4 Prot, datë 09.11.2018; nr.K3/L37-13 Prot, datë 25.02.2019;

⁷⁹ Shkresa nr. 10981/1 Prot, datë 08.11.2018

Gjithashtu ka patur mospërputhje të dhënash në informacionin e dërguar nga ana e ish Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, ku konfirmohet përjashtimi nga legalizimi i 78 ndërtimeve informale të cilat preken nga zbatimi i projektit “Mbikalimi i pallatit me shigjeta- rrethrotullimi Shqiponja” në ndryshim me numrin e bërë të ditur prej ish Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri.⁸⁰

Sipas të dhënave të konfirmuara në nga Drejtori e Përgjithshme e ALUIZNI-t, situata e ndërtimeve të cilat preken nga zbatimi i projektit, rezultonte se gjithsej, 209 ndërtime preken nga të cilat, 74 të pajisura me tituj pronësie, tre troje të kaluar në pronësi subjekteve që posedojnë ndërtime informale, 26 ndërtimet e tjera të përjashtuara nga procesi i legalizimit dhe 106 në proces shqyrtimi të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve posedues. Gjithashtu po shkreserisht na është komunikuar për përjashtimin e 78 ndërtimeve informale nga procesi i legalizimit si dhe faktin e vënies në dispozicion të Avokatit të Popullit të 90 vendimeve të marra për përjashtimin e ndërtimeve informale nga procesi i legalizimit nga ana e Autoriteti Rrugor Shtetëror, me shkresën nr. 468/2 Prot, datë 15.04.2019, drejtuar Avokatit të Popullit.

Te dhënat statistikore të konfirmuara zyrtarisht prej Autoritetit Rrugor Shqiptar, ish Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t apo ish Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, kanë pasaktësi, mospërputhje dhe informacion të pjesor, pasoja këto që sjellin lindjen e problemeve të ndryshme në zbatimin e projektit dhe rrjedhimisht çojnë në cënim të rëndë të interesave pasurorë të subjekteve pronarë apo posedues të pasurive të paluajtshme.

Sipas dispozitave të Ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ALUIZNI për çdo vetëdeklarim për legalizim ndërtimi informal të paraqitur nga subjektet e ndryshme pranë tij është i detyruar të nxjerrë një vendim, qoftë ky për legalizimin e ndërtimit informal apo edhe për përjashtimin e tij nga procesi i legalizimit. Vendimet që i janë vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, prej ish Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri, kanë si objekt përjashtimin nga procesi i legalizimit të ndërtimeve informale dhe ato janë nxjerrë prej datës 27.11.2018, e deri më datë 05.12.2018. Konkretisht rezultojnë të jenë, 87 vendime të nxjerra më datë 27.11.2018, 2 vendime të nxjerra më datë 03.12.2018 dhe një vendim i datës 05.12.2018. Megjithatë nga të dhënat e marra rezulton gjithashtu se, përgjatë viteve 2011-2017 janë lëshuar në këtë zonë, 22 leje legalizimi.

Shkaku ligjor i përjashtimit nga procesi i legalizimit, sipas akteve është se, këto ndërtime informale janë në kushtet e parashikuara në nenin 35 dhe nenin 39 të Ligjit nr.9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, por në to nuk ka asnjë analizë konkrete e as arsyetim të aktit për rastin konkret të trajtuar. Këto janë elementë të përcaktuar qartë në nenin 109/c të Kodit të Procedurës Administrative.

⁸⁰ Shkresa nr. 10981/1 Prot, datë 08.11.2018

Veprimtaria e ish Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana – Veri në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve të interesuara është në çënim të së drejtës themelore të njeriut për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, ku një ndër shkaqet ka të bëjë me mospërfundimin e procedurës administrative të shqyrtimit të të gjithë vetëdeklarimeve në afatin ligjor të parashikuar në nenin 49 të Ligjit nr. 8454, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Vetëdeklarimet për legalizim të paraqitura nga subjektet e interesuara, posedues të ndërtimeve informale që përfshihen në gjurmën e projektit në fjalë janë kryer gjatë periudhës së viteve 2005-2006, kohë në të cilën nuk ka pasur të miratuar një plan të përgjithshëm vendor si dhe një projekt të miratuar zhvillimor në këtë zonë. Sikurse rezulton, Plani i Përgjithshëm Vendor, i Bashkisë Tiranë është miratuar në vitin 2017, ndërsa leja zhvillimore është miratuar për këtë zonë në fund të vitit 2018, gjë që do të thotë se nuk ka asnjë lloj justifikimi ligjor për mosdaljen me vendim kualifikimi, ose përjashtimi nga procesi i legalizimit nga ana e ALUIZNI-t, përgjatë kësaj periudhe të gjatë kohore.

Bashkëpunimi i Bashkisë Tiranë në proces

Gjatë procesit të shqyrtimit të disa ankesave të paraqitura nga banorë, ndërtimet e të cilëve pretendohet se mund të prekeshin nga realizimi i projektit, i është kërkuar informacion dhe shpjegime edhe institucionit të Bashkisë Tiranë. Nga informacioni i dërguar kemi konstatuar se, Bashkia Tiranë ka ndërmarrë një proces të vetin për vlerësimin social ekonomik të familjeve të cilat preken nga zbatimi i projektit, segmenti rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrotullimi “Shqiponja” por ky proces është i pjesshëm dhe i mangët, referuar qasjes së duhur ndaj situatës potenciale të dëbimit me forcë të të gjitha familjeve që preken. Numri i objekteve të bëra me dije mediatikisht se do të preken, ai atyre që janë prishur tashmë ose që do të prishen, identifikon një komunitet banorësh të konsiderueshëm në numër që duhet të zhvendoset nga kjo zonë për shkak të ndërtimit të një vepre publike.

Roli i Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) në Bashkinë Tiranë

Në një proces normal të kryerjes së një punimi infrastrukturor dhe të zbatimit të një leje ndërtimi të miratuar me vendimmarrjen e organit kompetent për ndërtimin e një vepre publike, nevojitet lirimi dhe përgatitja e sheshit të ndërtimit për fillimin e punimeve.

Sipas shkresave të IKMT-së⁸¹ drejtuar Avokatit të Popullit, na ka rezultuar se në rrugë zyrtare, fillimisht në datën 27.11.2018, ARRSH-ja i ka kërkuar IKMT-së, mbështetje për lirimin e sheshit të ndërtimit nga objektet pa leje për realizimin e projektit të Unazës së Madhe segmenti rrugor “Mbikalimi pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”, kur leja e ndërtimit nuk ishte miratuar ende nga ana e KKT-së. Më pas në datën 14.12.2018, ARRSHN-ja kërkon të njëjtën gjë nga ana e IKMT-së por pa i përcjellë zyrtarisht lejen e ndërtimit, mbi bazën e së cilës do të kryhen punimet.

⁸¹ Shkresat me nr.4483/2 datë 27.11.2018 dhe nr.4726/1 datë 14.12.2018

Ndërkohë, sipas shkresës nr.1062 prot, datë 24.01.2019 të IMT në Bashkinë Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit, na rezulton që së paku, deri në datën 24.01.2019 nga ana e këtij organi pohohet se nuk është marrë pjesë dhe për rrjedhojë nuk është mbajtur asnjë procedurë për prishje të objekteve të ndodhura në gjurmën e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor, “Mbikalimi pallati me shigjeta –rrethrotullimi Shqiponja”.

Pozicioni i pretenduar, i tërhequr, i IMT-së në Bashkinë Tiranë dhe IKMT-së si organe të specializuara e ngarkuara nga ligji për të kontrolluar në mënyrë të pavarur ligjshmërinë e punimeve të ndërtimit, pavarësisht kërkesave të ARRSH-së, i evidentuar ndër të tjera nga trajtimi edhe i disa ankesave individuale të pasqyruara në këtë raport nuk justifikon mosveprimin dhe mungesën e sjelljes në vëmendje të faktit të mungesës së lejes së ndërtimit nga ana e këtyre organeve.

Çdo dëmtim i pronës publike, sikurse ka ndodhur me prishjen e objektit të “Shqiponjës” në rrethrotullimin e njohur me të njëjtin emër, prishjen e lulishteve publike për krijimin e kantierëve të firmave të ndërtimit të kontraktuara nga ARRSH-ja, pa përmendur këtu edhe heqjen e sinjalistikës rrugore, pemëve dhe trafikndarësive të rrugës të gjitha këto pronësi publike janë bërë në dijeninë e këtyre organeve si rezulton nga korrespondenca me ARRSH (shkresa e datës 14.11.2018). Në këto kushte, këto organe duhej të përgjigjeshin që s’duhej të kryhej asnjë veprim pa dalë akti përkatës dhe jo të mbështesnin për prishje subjekte private.

Mosveprimi i dukshëm i këtyre organeve, i vendos personat përgjegjës përfaqësues të tyre në rrethanat dhe kushtet e përgjegjësisë penale. Nuk mohohet përgjegjësia e punonjësve dhe drejtuesve të këtyre organeve për të thënë të vërtetën kur kjo gjë ka qënë e dukshme, sikundër nuk duhej të heshte ndaj kërkesave që këtyre organeve i janë drejtuar nga ana e ARRSH-së, kur në kushtet e analizuara më sipër nga ana e ARRSH-së kërkohej prishja e ndërtimeve në pronësi shtetërore dhe private.

Transparenca e organeve publike të përfshira në këtë proces

Problematika e analizuar në këtë raport konstaton mungesë transparence në veprimtarinë dhe aktivitetin apo edhe “pasivitetin”, e organeve publike të përfshira në të gjithë procedurat që lidhen me procesin e hartimit, miratimit dhe zbatimit të projektit, “Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me shigjeta” – Rrethrotullimi “Shqiponja” (Lot.1, Lot.2, Lot.3)”. Mungesa e transparencës është evidentuar si në marrëdhënien e organeve publike të përfshira në këtë proces në veçanti me banorët e zonës së “Astirit”, ku do të zbatohet projekti në fjalë, ashtu edhe me institucionin e Avokatit të Popullit në kuadër të mosdërgimit të informacioneve të kërkuara prej tij apo dërgimit të informacioneve të pjesshme dhe jo të plota.

Mungesa e transparencës për të gjithë procesin e ndjekur në këtë rast ka qënë një çështje e ngritur edhe në qëndrimin publik të Presidentit të Republikës, pas verifikimeve të kryera mbi projektin e

segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta - rrethrotullimi i Sheshit “Shqiponja”.⁸²Në qëndrimin publik të Presidentit të Republikës, referohet se kërkesave që ai iu ka drejtuar disa institucioneve shtetërore për informacion për çështjet që kanë të bëjnë me detyrat e tyre në lidhje me këtë projekt nuk i kanë dhënë përgjigje disa prej tyre edhe pas kalimit të 75 ditëve nga koha e paraqitjes së kërkesës.

Mosdhënia e informacionit të kërkuar rikonfirmon edhe një herë se, këtij projekti i ka munguar transparenca në çdo hallkë të tij. Në këto kushte mungesa e transparencës në këtë proces paraqet një problem strukturor që nuk duhet anashkaluar apo trajtuar si një çështje dytësore por duhet të konsiderohet si një çështje shumë thelbësore, pasi lidhet drejtëpërsëdrejti me ligjshmërinë e procesit dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

Në përfundim të këtij raporti janë dhënë edhe konkluzionet përfundimtare dhe disa rekomandime nga të cilat po veçojmë disa prej tyre si më poshtë vijon:

- Fillimi i procesit dhe situata e zbatimit të projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”, me autoritet zhvillues ARRSH, paraqitet problematike dhe në shkelje flagrante të ligjit, sepse çdo akt i nxjerrë dhe çdo veprim i kryer nga ana e autoriteteve publike të analizuara në këtë raport ka ndodhur në mungesë të vendimit përkatës të KKT-së për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”. KKT me vendimin nr.01 datë 20.11.2018 ka miratuar Lejen e Zhvillimit për Objektin, Rehabilitim i Segmentit Rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta – Rrethrotullimi Shqiponja” por jo vendimin për miratim leje ndërtimi. Leja e ndërtimit e nxjerrë në kushtet e një akti të ligjshëm dhe të vlefshëm administrativ nga ana e organit kompetent publik (KKT) është i vetmi akt që mundëson dhe lejon njëkohësisht subjektin përfitues të fillojë zbatimin e projektit të miratuar tashmë.
- Nga ana e ARRSH-së në shkelje të detyrimit ligjor nuk është zhvilluar procesi i detyrueshëm i konsultimit dhe informimit publik me banorët e zonës së Astirit por edhe me të gjithë aktorët e interesuar, gjatë fazës së hartimit dhe miratimit të projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta – rrethrotullimi Shqiponja”.
- Çdo kërkesë e ARRSH-së drejtuar organeve të tjera publike, IMT në Bashkinë Tiranë dhe IKMT-së për lirim të sheshit të ndërtimit; çdo njoftim për lirim banese si dhe çdo ndërhyrje në ndërtime private për prishjen e tyre apo edhe dëmtimin pjesor nga cilido subjekt qoftë; çdo dëmtim i pronës publike nga cilido subjekt që e ka kryer dhe që e ka lejuar; çdo vendimmarrje për përjashtim nga legalizimi pa u përmbyllur procesi i miratimit të akteve të nevojshme për mundësimin e fillimit të punës për ndërtimin e veprës publike; çdo procedurë shpronësimi e filluar; si dhe çdo veprim tjetër konkludent i kryer në këto rrethana që ka cënuar të drejtat dhe

⁸²Qëndrimi publik i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, i është dërguar për dijeni Avokatit të Popullit, me anë të shkresës përcjellëse nr.131/1 datë 4.02.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Presidentit të Republikës.

liritë e ligjshme të banorëve të zonës së Astirit dhe jo vetëm është i kundërligjshëm por dhe i dënueshëm penalisht.

- Avokati i Popullit konstaton se nga ana e ARRSH-së janë kryer veprime haptazi në kundërshtim me ligjin të cilat konsistojnë në mospërmbushjen e rregullt të detyrës prej të cilës i është shkaktuar dëm ekonomik shtetit dhe njëkohësisht dëm ekonomik pasuror individëve të prekur nga shembja pa kriter e banesave dhe aktiviteteve private tregtare që ndodheshin në aksin rrugor që preket nga projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta - Rrethrotullimi Shqiponja”. Pikërisht në lidhje me këtë fakt Avokati i Popullit konstaton se ndaj përfaqësuesve të ARRSH-së, duhet ti rekomandojë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fillimin e hetimeve për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal. Vlen të theksohet se, aktiviteti i kundërligjshëm, i kryer nga subjekti shtetëror ARRSH, evidentohet përmes nxjerrjes së urdhërave që bien në kundërshtim me ligjin, urdhëra të cilët kanë sjellë pasoja të rënda si për shtetin ashtu edhe për individët që janë dëmtuar në pronat e tyre që kanë qënë të ndërtuara pranë aksit rrugor.
- Konstatohet se nga veprimet dhe mosveprimet e IKMT-së dhe IMT-së në Bashkinë Tiranë, me mosveprime por dhe në raste të veçanta me veprime, u janë garantuar përfitime material ose jomateriale subjekteve përkatëse ndërtuese që kanë kryer punime në këtë objekt dhe njëkohësisht janë dëmtuar haptazi në mënyrë flagrante, interesat e ligjshme të shtetit dhe shtetasve. Si rrjedhojë e punimeve të kryera pa leje ndërtimi dhe pa projekt të miratuar, subjektet përkatëse kanë dëmtuar infrastrukturën rrugore e njëkohësisht edhe pronat e personave që jetojnë pranë aksit rrugor.
- Prishja e disa ndërtimeve/objekteve private të cituara në raport që përfshihen në gjurmën e projektit për të cilin është dhënë leja e zhvillimit e miratuar me vendimin nr.01, datë 20.11.2018 të KKT-së për objektin: “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta, rrethrotullimi “Shqiponja”, Bashkia Tiranë”, jo vetëm që përbën veprim të kundërligjshëm dhe vepër penale por evidenton edhe mosndërhyrjen e IMT-së në Bashkinë Tiranë si dhe të IKMT-së në këto raste. Subjekti që ka kryer këto prishje objektivisht dhe që i ka shkaktuar një dëm konkret poseduesve të tyre mbetet ende i paidentifikuar, gjë që kërkon ndjekje të mëtejshme të këtyre rasteve nga ana e organit të Prokurorisë. Çdo vendimmarrje e organeve të IMT-së në Bashkinë Tiranë dhe IKMT-së për prishje të ndërtimeve/objekteve në kushtet kur ende nuk kemi një leje ndërtimi të miratuar me vendimin përkatës të KKT-së, me justifikimin e liritë të sheshit të ndërtimit përbën vendimmarrje në kushtet e paligjshmërisë nga ana e këtyre organeve dhe njëkohësisht i ngarkon ato me përgjegjësi penale.
- Veprimtaria e ish organit të ALUIZNI-t (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës), vazhdon të mbartë mungesën e përgjegjësisë institucionale dhe ligjore për mostrajtimin në afatet ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi të procedurave administrative për shqyrtimin e vetëdeklarimeve për legalizim dhe daljen me një vendim përfundimtar, rast pas rasti. Ky fakt si dhe vendimet e marra për përjashtimin e një sërë ndërtimesh informale të ndodhura në gjurmën e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi – pallati me shigjeta–rrethrotullimi Shqiponja” në mungesë të përfundimit të procesit të vendimmarrjes që lejon

zbatimin e tij, rëndon pozitën e këtij organi në këtë çështje dhe rrit koston e pasojave që vijnë më pas.

- Në datë 29.06.2018 nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur dhe dorëzuar në Kuvend⁸³, Raporti i Veçantë “Për problematikat e vërejtura në veprimtarinë e disa organeve të administratës publike, gjatë zbatimit të projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës”⁸⁴. Sikurse në raportin e sipërcituar edhe në këtë rast janë konstatuar të njëjtat problematika, gjë që tregon se mosreagimi dhe mosreflektimi në kohë ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve tona përkatëse ka sjellë vazhdimin e një veprimtarie të kundërligjshme dhe në shkelje të të drejtave themelore të njeriut nga ana e organeve të administratës publike të përfshira në procesin e zbatimit faktik të projektit, “Rehabilitimi i segmentit rrugor “Mbikalimi i pallatit me shigjeta – rrethrrrotullimi “Shqiponja.
- E gjithë fryma, propaganda dhe komunikimi nga ana e përfaqësueve të organeve publike të përfshira në këtë proces të analizuar nga raporti ynë nuk ka qënë ajo e garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut por ndër të tjera ka identifikuar edhe gjuhë të papërshtatshme e gati diskriminuesetë përdorur ndaj individëve.
- Avokati i Popullit në kuadër të mbrojtjes sa më të mirë të të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit si dhe për një mirëadministrim në veprimtarinë e ARRSH-së, ALUIZNI-t si IMT në Bashkinë Tiranë, IKMT-së si dhe Bashkisë Tiranë, rishpreh qëndrimin se, projektet madhore janë shumë të rëndësishme për t’u zbatuar, pasi kontribuojnë për zhvillimin e mëtejshëm të vendit. Por është i domosdoshëm respektimi dhe zbatimi rigoroz i kuadrit ligjor në fuqi, i cili ekziston dhe është mjaft i gjerë si dhe proporcionaliteti lidhur me veprimet që ndërmerren në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës.

Rekomandime:

- Nevojitet dhe përbën një domosdoshmëri bashkëpunimiluaajalinstitucional i organeve/institucioneve shtetërore në të gjithaproceset e realizimit të vepravepublike.
- Marrja e masave ligjore nga ana e organeve kompetente ndaj personave që kanë shkelur dhe shkelinligjin në trajtimin e këtyreproblematicave është një nevojë dhe domosdoshmëri e theksuar me forcë nga ana jonë. Mosndëshkueshmëria apo mosnxjerrja e përgjegjësive për këtësituata i kthenkëtoçështje në shembuj të shkeljevesistematike të të Drejtave të Njeriut, pasi punonjësit e administratës shtetërore që kanë shkelur si procedurat ligjore të detyrueshme për to që kanë lejuar prishjen e paligjshme të pronës publike e private që kanë cënuar interesat e ligjshme të qytetarëve nuk janë vënë përpara përgjegjësive, as të natyrës administrative, as civile dhe as penale.

⁸³ Shkresa nr. 256 datë 29.06.2018

⁸⁴Raporti i Veçantë “Për problematikat e vërejtura në veprimtarinë e disa organeve të administratës publike, gjatë zbatimit të projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës” gjendet i aksesueshëm në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit,

[https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Shkoza%20\(shqip\)\[2\].pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Shkoza%20(shqip)[2].pdf)

- Avokati i Popullit i rekomandon organit të Prokurorisë, fillimin e hetimeve në lidhje me veprimtarinë e ARRSH-së, IKMT-së dhe IMT-së në Bashkinë Tiranë për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal si dhe për vepra të tjera penale të cilat do të rezultojnë gjatë hetimit të këtij procesi ndaj subjekteve shtetërore apo edhe atyre private, referuar shkeljeve ligjore të konstatuara nga hetimi administrativ.
- Duke u nisur nga specifikat e konstatuara gjatë hartimit të këtij raporti por edhe e raporteve të tjera të veçanta të paraqitura tashmë në Kuvendin e Shqipërisë ku trajtohen problematika të ngjashme, gjykojmë se del nevoja e ndryshimit dhe përmirësimit të legjislacionit, lidhur me parashikimin e një dëmshpërblimi të arsyeshëm për të gjithë subjektet posedues të objekteve informale që preken nga zbatimi i projekteve për ndërtimin e veprave publike. Në këtë grupim duhet të futen ndërtimet informale për të cilat ka filluar procesi i legalizimit apo edhe ndërtime të tjera informale të cilat vërtetohet se janë ekzistuese në kohë, para miratimit dhe zbatimit të projekteve për ndërtimin e veprave publike. Dëmshpërblimi i arsyeshëm duhet të konceptohet në kuadër të një procesi shpronësimi specifik në këto raste. Ky konkluzion kërkon sjelljen në kohorencë të parashikimeve si dhe ndërmarrjen e iniciativës legislative për ndryshime në Ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe për amendime sqaruese në Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Siç edhe u theksua që në krye në datën 21 tetor 2019 ky Raport i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë si dhe institucioneve të tjera shtetërore të përfshira por nga asnjë institucion nuk ka patur reagim lidhur me situatën në fjalë. Në nëntor të vitit 2019 të tëra këto shtëpi u shembën pa pasur një dëmshpërblim efektiv të personave dhe pa bërë publike se si janë paguar dëmshpërblimet përkatëse të miratuara nga ana e Këshillit të Ministrave. Si konkluzion nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë për të analizuar apo zbatuar rekomandimet e dhëna nga Avokati i Popullit për këtë situatë.

4.2. Liria e tubimit

Liria për t’u mbledhur është e lidhur ngushtë me lirinë e shprehjes, sikurse parashikohet në nenin 11 të Kartës dhe në nenin 10 të KEDNJ-së në të cilën përcaktohet se çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes, e cila përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. E drejta e organizimit dhe e lirisë së shprehjes janë thelbësore dhe përbëjnë themelin e demokracisë. Protestat shfaqen atëherë kur një shoqëri ka ezauruar të gjitha mjetet e tjera demokratike, ato janë mjeti me të cilin njerëzit shfaqin mendimin e tyre dhe njëkohësisht u kërkojnë llogari atyre që kanë zgjedhur në funksionet publike.

Liria e tubimeve paqësore si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar nga neni 47⁸⁵ i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë si një nga të drejtat themelore të njeriut. Po kështu, kjo e drejtë

⁸⁵ “1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.

themelore gjen mbrojtje edhe në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr.8137 datë 31.7.1996, respektivisht në nenin 11⁸⁶.

Rezoluta e Parlamentit European e 14 shkurtit 2019 parashikon, referuar të drejtës për protestë paqësore dhe përdorimit proporcional të forces, se: *“liria e organizimit duhet të mbrohet, duke pasur parasysh se një shoqëri e gjallë civile dhe një media pluraliste luajnë një rol jetësor në promovimin e një shoqërie të hapur dhe pluraliste dhe të pjesëmarrjes publike në procesin demokratik si dhe në forcimin e përgjegjshmërisë së qeverive.”*

Avokati i Popullit vlerëson se liria për t’u organizuar/protestuar është një e drejtë e cila nuk duhet të kufizohet nga autoritetet shtetërore në formën e një miratimi paraprak. Në këtë kuadër në vëmendjen e këtij institucioni kanë qenë ngjarjet e lidhura me protestat e zhvilluara gjatë vitit 2019 si ato të organizuara nga opozita e bashkuar prej muajit shkurt 2019 të cilat kanë ardhur në rritje deri në muajin korrik të po këtij viti por edhe protestat e tjera të organizuara nga shoqëria civile, studentët, banorët e “Unazës së Re”, zona e “Astirit”, “Bregut të lumit” Tiranë të cilët kanë protestuar për prishjet e objekteve të tyre për shkak të zbatimit të projektit të zgjerimit të “Unazës së Re” dhe të zgjatimit të Bulevardit “Zogu i Parë”.

Pas vendimit të opozitës për djegien e mandateve, mungesa e opozitës në parlament e cila nuk njihte më qeverisjen, rriti trysninë e vazhdueshme të protestave masive. Kështu, duke filluar nga muaji shkurt 2019 protestat janë organizuar në rang kombëtar në mënyrë të vazhdueshme, kryesisht përpara selisë së Kuvendit, ku zhvilloheshin punimet në seancë plenare.

Me qëllim monitorimin nga afër të situatës, Avokati i Popullit ka ngritur grupe të posaçme për të vëzhguar në terren dhe për të qenë të pranishëm në çdo protestë të organizuar si dhe për verifikimin e menjëhershëm të rasteve kur ka pasur të dhëna se janë kryer veprime të paligjshme nga autoritetet shtetërore ⁸⁷. Në kuadër të këtij procesi janë marrë deklarime të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, pjesëmarrës në protesta si dhe janë monitoruar seancat gjyqësore për vlerësimin e ligjshmërisë së arrestimeve dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj personave nën hetim. Kjo veprimtari është kryer duke pasur një angazhim thelbësor të tërë stafit të institucionit pasi kapacitetet e Seksionit të Veçantë dhe të MKPT-së, kanë qenë shumë të kufizuara.

Protestat e opozitës kanë pasur një ritual të tyre i cili zakonisht ka filluar me marshim në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe më pas ka vijuar me qëndrimin e protestuesve për një

2. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj”.

⁸⁶1. “Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët....

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve..”.

⁸⁷ Insitucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2019 ka monitoruar rreth 31 protesta të organizuara nga subjekte të ndryshme. Po ashtu ka realizuar 45 verifikime në organet e policisë lidhur me protestuesit e shoqëruar apo në qendra spitalore lidhur me protestuesit që kanë marrë trajtim mjekësor si dhe ka monitoruar 6 seanca gjyqësore të vlerësimit të masavë të sigurimit personal për protestuesit e arrestuar.

kohëzgjatje të caktuar përpara selisë së Kryeministrit apo Kuvendit, momente gjatë të cilave janë vënë re tensione të rritura midis protestuesve dhe forcave të rendit.

Në një pjesë të madhe të këtyre protestave, Policia e Shtetit ka hedhur sasi të mëdha të gazit lotsjellës mbi protestuesit. Shpeshherë duke mos u kufizuar se kishte të mitur të moshuar, gra apo qoftë edhe thjesht kalimtarë të tjerë që nuk kishin lidhje me protestën. Protestuesit si dhe kalimtarët e rastësishëm të cilët janë gjendur në zonat ku është hedhur gaz lotsjellës gjithnjë e më shumë janë ankuar për efektet e tij, dhimbjet e kokës dhe të stomakut, djegiet dhe lotimin e syve dhe disa ditë pas tubimeve. Është e pranuar se efektet afatshkurtra të gazit lotsjellës përfshijnë irritim dhe djegie të fortë të lëkurës, syve dhe traktit respirator, shkarkimin masiv të mukusit nga hunda, çorientim, marramendje, vështirësi në frymëmarrje apo edhe humbjen e vetëdijes.

Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit ka mbajtur qëndrimin e tij institucional duke u shprehur se, gaz lotsjellës është hedhur në mjaft raste në mënyrë të shpërpjestuar dhe ka penguar qytetarët të ushtrojnë të drejtën për tubim paqësor.

Përveçse në protestat e zhvilluara nga opozita janë regjistruar edhe raste të veçanta të përdorimit të gazit lotsjellës si ato gjatë operacioneve për shembjen e banesave në zbatim të projekteve urbanistike. Si të tilla mund të përmendim punimet e kryera për ndërtimin e segmenteve të Unazës së Re, zona e “Astirit”, “Bregut të lumit” Tiranë. Kur disa banorë kanë kundërshtuar me forcë shembjen e banesave të tyre nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit i asistuar nga Policia e Shtetit është përdorur gaz lotsjellës për t’i shpërndarë ata në mënyrë që të ekzekutoheshin vendimet i prishjes së ambienteve apo banesave. Në këto raste nga ana e Policisë së Shtetit është përdorur gaz lotsjellës në mjedise të mbyllura, ndërkohë që brenda godinave ka patur persona, ndër ta fëmijë të mitur dhe gra.

Avokati i Popullit ka shprehur indinjatë të thellë mbi sjelljen e autoriteteve publike në mënyrë të veçantë për përdorimin e forcave të Policisë së Shtetit për të ndërhyrë në banesa duke përdorur gazin lotsjellës për të nxjerrë me forcë banorët nga shtëpitë e tyre. Kjo mënyrë aspak profesionale, joproporcionale dhe për më tepër në përballjen jo me turma të mëdha njerëzish por thjesht me banorë/familjarë të shtëpive përreth është tërësisht në kundërshtim me aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm.

Po ashtu, përdorimi në mënyrë të shpërpjesëtuar i gazit lotsjellës në turma të tëra protestuesish në rrugë e rrugica ku njerëzit vazhdonin rutinën e tyre të përditshme ka sjellë lëndime të një mase të gjerë, pa bërë dallimin e kategorisë që ata përfaqësonin, nëse ishin protestues a jo, nëse kishin kryer veprime të kundërligjshme apo jo dhe nuk mund të neutralizoheshin në një formë tjetër.

Ajo që është vënë re nga grupet e punës të Avokatit të Popullit gjatë monitorimit të protestave të opozitës është fakti se sasia e hedhur e lëndëve lakrimogjene, kryesisht në sheshin përpara selisë së Kuvendit ka qenë e lartë, granatat janë lëshuar edhe në rrugica, vala e shpërndarjes së tyre shkonte deri në apartamentet dhe lagjet fqinje me vendin ku zhvillohej protesta, pra rrezja e gazit lotsjellës përfshinte një shtrirje të gjerë.

Sipas akteve dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përdorimi i forcës, gjatë tubimeve/protestave duhet të jetë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe llogaridhënies. Ai duhet të përdoret gjithashtu me qëllim parandalues. Organet ligjzbatuese kanë detyrimin për të shmangur ose minimizuar përdorimin e forcës gjatë ushtrimit të së drejtës për t'u tubuar. Forca duhet të përdoret si mjet i fundit, madje edhe në situata ku organizimet përfshijnë aktet e dhunës dhe vetëm kur është e nevojshme dhe proporcionale me një qëllim të ligjshëm.

Gjatë tubimeve, ngacmuesit kimikë mund të përdoren vetëm me qëllim të shpërndarjes dhe vetëm kur niveli i dhunës ka arritur në një shkallë të tillë që organet e zbatimit të ligjit nuk mund ta përballojnë kërcënimin, duke synuar drejtpërsëdrejti vetëm personat e dhunshëm.

Sipas legjislacionit të brendshëm, përdorimi i forcës nga ana e Policisë së Shtetit është veprimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve, mjeteve të tjera apo armëve të zjarrit në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke përzgjedhur nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara.

Ne vlerësojmë se përdorimi i gazit lotsjellës në mënyrë joproporcionale në rastet e tubimeve të organizuara nga qytetarët, bëhet shkak për ardhjen e pasojave ndaj jetës dhe shëndetit të pjesëmarrësve në tubim. Ndërkohë, kjo mund të ndikojë tek pjesa më e madhe e qytetarëve që protestojnë paqësisht edhe në mosushtrimin, pengimin apo kufizimin e lirisë kushtetuese të tubimit nga frika e dëmtimit të shëndetit të tyre.

Konstatime lidhur me shoqërimet/ndalimet dhe arrestimet e protestuesve si dhe të vlerësimit të masave të sigurimit personal të tyre

Në përmbyllje të çdo proteste të organizuar, forcat e policisë, kryesisht punonjësit e krimeve të veshur civilë kanë ndaluar protestuesit por shpeshherë ka pasur pretendime prej personave të ndaluar si për ushtrim dhune, ashtu edhe se personat e ndaluar nuk kanë qenë protestues. Në institucionin e Avokatit të Popullit janë trajtuar disa raste me iniciativë dhe ankesa lidhur me pretendimet për ushtrim dhune.

Vendet e ndalimit të personave kanë qenë nga më të ndryshmet, duke filluar nga lokalet, rrugë, stacionet e autobuzit etj por në dokumentacionin e përpiluar më pas nga oficerët e policisë gjyqësore pasqyrohej “arrestimi në flagrancë”.

Avokati i Popullit gjykon se kryerja e arrestimeve në flagrancë nga ana e policisë së shtetit, jo gjatë kryerjes së veprimeve apo mosveprimeve të konsideruara vepër penale por në një moment të dytë të mëvonshëm, pas përfundimit të protestave apo gjatë orëve të natës nuk plotëson kushtet e

arrestit në flagrancë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale dhe të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ka pasur raste kur masat e zbatuara nga ana e Policisë së Shtetit për dërgimin dhe ruajtjen në ambiente spitalore kanë qenë edhe më të ashpra sesa ato për ruajtjen e personave të arrestuar apo të dënuar, ndonëse qytetari ka qenë thjesht i shoqëruar (rasti i S.D.).

Në raportet e shoqërimit të përpiluara nga ana e punonjësve të policisë në disa raste janë pasqyruar arsye të shoqërimit të tilla si: *“Dyshohet si pjesëmarrës në protestë”*, *“Shoqëruar pasi ka qenë në protestë”*, arsye të cilat nuk janë aspak në përputhje me nenin 109 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar por për më tepër askush nuk mund të shoqërohet në organet e policisë si pjesëmarrës në protestë në një vend demokratik.

Përcaktimi i saktë i arsyes së shoqërimit është detyrim ligjor për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe njëkohësisht një kërkesë e lënë për zbatim në rekomandimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit, pasi ka të bëjë me një moment delikat të privimit të lirisë për një afat kohor të limituar deri në 10 orë.

Numri i të shoqëruarve në ambientet e policisë pas çdo proteste ka qenë relativisht i lartë, numri i të arrestuarve po ashtu. Mbështetur në korrespondencën e mbajtur midis Avokatit të Popullit dhe Policisë së Shtetit është përcjellë se numri i tubimeve të zhvilluara në total me ose pa miratimin e Policisë së Shtetit për periudhën kohore nga 01.01.2019 deri 31.05.2019 në juridiksionin e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë ka qenë **247**, numri total i personave të shoqëruar në organet e policisë të cilët kanë qenë pjesëmarrës në tubime ka qenë **397 nga të cilët 153** persona të shoqëruar janë arrestuar në flagrancë si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të kryera gjatë zhvillimit të tubimeve.

Gjejmë me vend të sqarojmë se numri i të shoqëruarve dhe të arrestuarve iu referohet të gjitha tubimeve të mbajtura, jo vetëm atyre të opozitës por sigurisht që numrin më të madh e përbëjnë protestuesit në protestat e opozitës. Është vërejtur se pjesa më e madhe e personave të arrestuar, pjesëmarrës në protesta të dyshuar për kryerjen e veprës penale vijnë nga shtresa të varfra të shoqërisë apo dhe studentë dhe jo në pak raste edhe persona me probleme të shëndetit mendor.

Ambientet ku janë mbajtur dhe janë trajtuar këta të ndaluar/arrestuar në disa raste kanë qenë të papërshtatshme si dhe në kufijtë apo jashtë kapaciteteve për të përballuar këtë numër të lartë. Në kontaktet e realizuara me të shoqëruarit/ndaluarit grupet e punës kanë vërejtur se disa prej tyre kanë patur ankesa për ushtrim dhune, moskomunikim me familjet, pasi vinin nga zona të largëta të vendit. Ankesat e tyre janë marrë nga ekspertët dhe janë trajtuar duke ndërmarrë veprimet e nevojshme hetimore.

Në dokumentacionin e përpiluar shpeshherë janë pasqyruar orët e vona të marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore. Po ashtu në këtë dokumentacion janë përfshirë në mënyrë standarde veprat penale për të gjithë të arrestuarit, pa bërë dallim ndërmjet tyre.

Procesverbalet mbi arrestimet në flagrancë iu janë referuar disa veprave penale si “*Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme*”, “*Kundërshtimi me dhunë i punonjësve të policisë së rendit publik*”, “*Shkatërrim i pronës*” si dhe “*Prishja e rendit dhe qetësisë publike*” të kryera në bashkëpunim të parashikuara nga nenet 262, 236/2, 150, 274 dhe 25 të Kodit Penal, ndërkohë që gjatë seancave gjyqësore të mbajtura në Gjykatën Penale të Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rezultuar se nga prokuroria akuza është ngritur për veprën penale “*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*”, paragrafi 2, neni 236 i Kodit Penal.

Problematika janë konstatuar edhe me orën e pasqyruar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë, kur ajo nuk reflekton orën e shoqërimit por atë të përpilimit të procesverbalit të arrestimit në flagrancë. Në rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit në vijimësi që prej më shumë se dhjetë vjetësh si për rastet e ankesave të trajtuara, ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit është kërkuar që edhe në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet të vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij. Ndërsa në bazë të nenit 258 të Kodit të Procedurës Penale nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi, ose ndalimi.

Avokati i Popullit vlerëson se evidentimi dhe mbajta me saktësi e procesverbaleve sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale si dhe i regjistrave të Policisë është i vetmi mjet për të siguruar zbatimin e garancive që ligji u ka dhënë të ndaluarve. Dokumentacioni i hartuar nga oficerët e policisë gjyqësore i është përcjellë organit të akuzës i cili ka vijuar me paraqitjen e kërkesave në gjykatë për vleftësimin e masave të arrestit. Organi procedues ka regjistruar procedimin penal vetëm për një vepër penale sikurse është “*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*”, parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal. Nga ana tjetër tepër shqetësues ka qenë fakti i shkakut të shoqërimit në disa raste si pjesëmarrës në protestë.

Kryesisht prokuroria në kërkesat e saj para gjykatës është bazuar në prova si raport shërbimet e përpiluara nga Policia e Shtetit si dhe në disa raste është pretenduar se ka pasur filmime dhe pamje fotografike. Në konkluzionet përfundimtare prokuroria përveç vleftësimit të ligjshëm të masave të sigurisë ka kërkuar në shumë raste masën e arrestit në burg, duke mosargumentuar dhe mbështetur në prova këtë masë të privimit të lirisë si për shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale ashtu edhe të individit.

Në kuadër të hetimit të gjithanshëm, çmojmë se organi procedues duhet të hetojë dhe rastet e qasjeve represive të punonjësve të policisë së shtetit ndaj protestuesve në tejkalim të kompetencave për përdorimin e forcës gjatë shoqërimeve, arrestimeve dhe në raste të tjera dhe në mjediset e dhomave të sigurisë apo gjatë marrjes në pyetje të tyre. Jo gjithmonë ka vlerësim të rasteve kur

konstatohen shenja të dukshme dhune tek qytetarët për të cilat organi i prokurorisë duhet të kryejë verifikimet e nevojshme dhe të iniciojë fillimin e procedimit penal.

Në këto raste organi i Prokurorisë duhet të tregohet më rigoroz dhe kërkues në hetim për të sqaruar pozitën procedurale si të autorit të dyshuar për kryerjen e këtyre veprave penale, ashtu dhe ndaj punonjësve të policisë që kanë ushtruar dhunë me qëllim për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme. Nga ana tjetër hetimet duhet të zgjerohen edhe për veprën penale “*Mosmarrje e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme*” në rastet kur drejtuesit e Policisë së Shtetit janë të pranishëm kur nga vartësit e tyre kryhen veprime të kundërligjshme.

Lidhur me këto problematika shqetësuese vlen të evidentojmë disa gjetje e konstatime të bëra nga Komiteti European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtërues (CPT)⁸⁸ të cilat janë në të njëjtën linjë me gjetjet e bëra nga institucioni ynë. Në raportin e publikuar, CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ofruar trajnime për prokurorët përkatës në mënyrë që të sigurohet:

- ankesat dhe informacionet e tjera për keqtrajtim të policisë të hetohen në mënyrë efektive;
- sa herë që prokurorët të marrin ankesa ose informacione të tjera treguese për keqtrajtim nga ana e policisë të urdhërohet menjëherë një ekzaminim mjeko-ligjor.

Në përgjithësi, CPT ka vërejtje për faktin se shqyrtimi i pretendimeve për keqtrajtim të policisë i kishte kaluar të njëjtit prokuror që ishte përgjegjës për hetimin penal kundër personit, i cili pretendohet se është keqtrajtuar. Sipas prokurorit, i cili u takua nga delegacioni, kjo ishte praktikë normale në sistemin gjyqësor shqiptar. Sipas mendimit të CPT-së, një përgjegjësi e tillë e dyfishtë mund të çënojë paanshmërinë të prokurorit në fjalë. Prandaj, **Komiteti rekomandon** që raste të keqtrajtimit të mundshëm të policisë të hetohen nga prokurorë të cilët nuk kanë lidhje me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtuara.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ndryshuar legjislacionin përkatës lidhur me ekspertimin mjeko-ligjor në mënyrë që:

- raporti i hartuar nga mjekë ligjorë në rastet e keqtrajtimit të mundshëm të policisë të përmbajë:
 - (i) përshkrim të plotë të gjetjeve objektive mjekësore bazuar në një ekzaminim të hollësishëm;
 - (ii) përshkrim të pretendimeve për keqtrajtim ose deklaratave të tjera të bëra nga personi i interesuar në lidhje me shkaqet e lëndimeve;
 - (iii) vëzhgimet e mjekut në dritën e (i) dhe (ii), duke treguar shkallën e përpunueshmërisë midis çdo pretendimi/deklaratave të bërë dhe gjetjeve objektive mjekësore;

⁸⁸ Raporti i CPT-së bërë publik në datën 17.09.2019, pas vizitave që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri nga data 20 deri në datën 30 nëntor 2018. (<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>)

- personat që pretendojnë se janë keqtrajtuar nga policia të kenë të drejtën (me shpenzimet e tyre) për një ekzaminim mjeko-ligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, pa autorizim paraprak nga policia ose prokurori.

Ndërsa gjatë monitorimit të seancave gjyqësore të zhvilluara për vleftësimin e masave të sigurimit personal janë konstatuar:

- Prania e një numri të lartë të personave të ndaluar/arrestuar, me salla të tejmbushura, ku numri arrinte edhe mbi 40 persona në të njëjtën kohë.
- Koha në dispozicion për të dëgjuar çdo protestues ishte relativisht e pamjaftueshme, 2-3 minuta dhe shpeshherë u është kërkuar të mos binin në përsëritje ose të fliste vetëm avokati, duke sjellë kufizime të së drejtës së tyre për t'u dëgjuar.
- Në përfundim, gjykata ka vleftësuar të ligjshme të gjitha arrestimet në flagrancë edhe pse në dokumentacionin e paraqitur nuk argumentoheshin kushtet e ekzistencës së flagrancës. Në pjesën më të madhe ka vendosur masën “detyrim paraqitje” dhe më pak atë të “arrestit në burg”. Në fokus të punës sonë gjatë seancave gjyqësore kanë qenë respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Trajtimi dhe vlerësimi i rasteve që lidhen me lirinë e tubimit nga institucioni i Avokatit të Popullit

Për protestat e zhvilluara gjatë vitit 2019 janë regjistruar 36 raste me iniciativë dhe mbi bazën e ankimeve nga subjekte të ndryshme si persona fizikë dhe juridikë (OJQ, sindikata, studentë, grupime qytetarësh, etj.) të cilët kanë pasur pretendime ndaj organeve të Policisë së Shtetit dhe konkretisht për:

- ushtrim dhune fizike dhe keqtrajtme fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit të shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje nga organet e policisë;
- pengim të ushtrimit të të drejtës kushtetuese për tubim;
- mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor;
- dëmtim të shëndetit të qytetarëve nga përdorimi jo proporcional nga Policia e Shtetit i gazit lotës-jellës të hedhur gjatë tubimeve.
- prangosje të të shoqëruarit, gjatë kohës së marrjes së trajtimit në Spitalin Universitar të Traumës etj.

Në disa raste për të cilat janë provuar shkelje të të drejtave ligjore të shtetasve është konstatuar se nga strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit, kryesisht të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë ka pasur raste të ndalimit të lirisë së tubimit të qytetarëve, duke cënuar një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut; të shkeljes së parimit të proporcionalitetit nëpërmjet tejkallimit të forcës fizike të ushtruar ndaj qytetarëve dhe hedhjes së gazit lotës-jellës në ambientet e

mbyllura. Disa nga shkaqet e kryerjes së këtyre shkeljeve nga punonjësit e policisë janë mosnjohja e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit si dhe neglizhenca për zbatimin e dispozitave ligjore dhe për përmbushjen e rregullt të detyrës dhe misionit ligjor. Gjithashtu, një shkak tjetër është edhe mungesa e kontrollit nga strukturat eprorë të organeve vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka konstatuar se ende nuk tregohet kujdesi i duhur që mjetet e përdorura nga Policia gjatë menaxhimit të protestave të garantojnë që mediat të kryejnë të pacënuara detyrën e tyre të raportimit. Nga ana jonë janë dënuar aktet e papranueshme të kufizimit nga ana e Policisë të gazetarëve apo punonjësve të tjerë të medias së lirë për të ushtruar detyrën e tyre. Ndalimi i pasqyrit të ngjarjeve nga ana e medias me çdo lloj preteksti është në kundërshtim me parimet e lirisë së medias si shtyllë qendrore e standardeve demokratike të një vendi. Janë vënë re në disa situata, prirje për të krijuar pengesa të paarsyeshme nga ana e Policisë për përfaqësuesit e Avokatit të Popullit të cilët kanë mandat kushtetues për të mbledhur në kohë e me efektivitet dëshmi si të të ndaluarve, ashtu edhe të të lënduarve në qendra shëndetësore.

Për rastet për të cilat janë konstatuar shkelje të të drejtave të qytetarëve nga institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente për marrjen e masave të nevojshme penale, administrative dhe organizative, me qëllim rivendosjen në vend e të drejtave të shkelura qytetarëve, ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mospërsëritjen në të ardhmen.

Disa nga rastet lidhur me këtë problematikë shqetësuese mund t'i evidentojmë si më poshtë:

- Rastin e filluar me nismën e Avokatit të Popullit pas njoftimit të bërë publik në media se Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka ndaluar zhvillimin e një tubimi paqësor në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” më datë 24.12.2018 të thirrur nga disa qytetarë të diasporës.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se e drejta për tubime e qytetarëve nuk mund të kufizohet në mënyrë të pajustificuar nga autoritetet e ngarkuara nga ligji me detyrë të sigurojnë mbarëvajtjen e tyre. Referuar frymës dhe qëllimit të akteve normative në fuqi që garantojnë dhe rregullojnë lirinë e tubimit rezulton se Policia e Shtetit ka për detyrë që t'u garantojë shtetasve lirinë/të drejtën e tubimit dhe atë të lirisë apo të sigurisë së qarkullimit, pasi vetëm në këtë mënyrë ajo e kryen detyrën konform ligjit. Për rrjedhojë, organet e policisë duhet të gjejnë modalitetet për të menaxhuar të dyja këto liri themelore dhe të mos bëhen pengesë në realizimin e tyre nga qytetarët. Në rastin në fjalë Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, jo vetëm nuk ka marrë përsipër garantimin e ushtrimit të këtyre dy të drejtave themelore, sikurse e ka për detyrë ligjore por ka vepruar duke i penguar qytetarët e diasporës të ushtrojnë tubimin e tyre.

Në përfundim të hetimit administrativ, i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, *marrjen e masave për një qëndrim të drejtë dhe zbatim korrekt nga Policia e Shtetit të ligjit nr.8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet” për të mos ndaluar apo kufizuar organizimin apo*

pjesëmarrjen e qytetarëve në tubimet paqësore me qëllim, respektimin e mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si atë të tubimit ashtu edhe atë të lëvizjes së lirë.

Nga përgjigjia e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit u informuam se rekomandimi u mirëprit dhe në vijim u morën masat e nevojshme duke udhëzuar strukturat qendrore dhe vendore për një sjellje më profesionale në të gjitha rastet e tubimeve të qytetarëve.

- Rastet e bëra publike në media, sipas të cilave Policia e Shtetit kishte përdorur në kundërshtim me ligjin gaz lotsjellës gjatë operacionit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë për shembjen e banesave në zonën e njohur me emrin “Bregu i lumit” dhe te zona e “Astirit”, Tiranë. Sipas banorëve që kanë protestuar kundra shembjes së banesave të tyre, punonjës të policisë kanë hedhur gaz lotsjellës në mjedise të mbyllura, ndërkohë që brenda banesave ka patur persona, ndër ta edhe fëmijë të mitur.

Nga shqyrtimi i këtyre rasteve dhe referimet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi rezulton se legjislacioni e lejon përdorimin e lëndëve lotsjellëse nga Policia e Shtetit edhe në mjedise të mbyllura apo gjysëm të hapura por pasi janë konsumuar të gjitha masat paraprake dhe përdorimi i lëndëve lakrimogjene mbetet një mundësi e fundit për arritjen e qëllimit të planit operacional të miratuar ose kur rrethanat ndryshojnë papritur dhe përdorimi i lëndëve lakrimogjene frenon rritjen e veprimeve të dhunshme ndaj forcave të policisë.

Në të gjitha situatat duhet të mbahet parasysh se, përdorimi i gazit përbën një rrezik të shtuar për jetën dhe shëndetin e banorëve. Siç dëshmuam rrëfimet e banorëve të zonës së “Astirit” dhe pamjet e publikuara në media që dokumentuan operacionin gjatë të cilit u përdor gaz lotsjellës, mundësia për t’u larguar nga një mjedis i mbyllur, i mbushur me gaz ishte e pakët, veçanërisht për personat vulnerabël.

Edhe personat që gjendeshin në tarracë apo çati, siç ndodhi gjatë operacionit të “Bregu i lumit”, e kishin të vështirë të orientoheshin nën efektin e gazit dhe me shikueshmëri të dobët për të gjetur një rrugë të sigurtë largimi. Gjithashtu, gjetja e personave të dëmtuar dhe ardhja në ndihmë nga ekipet mjekësore në një zonë me dendësi banesash mund të bëhet me vonesë.

Nga ana jonë u konstatua se nga strukturat e Policisë së Shtetit në rastin e banorëve të “Bregut të Lumit” dhe të “Astirit” nuk është zbatuar parimi i proporcionalitetit kur është përdorur gazi lotsjellës. Për të dy këto raste iu rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit:

- 1. Zbatimin e parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret gazi lotsjellës nga punonjës të policisë;*
- 2. Analizimin e rasteve nga strukturat përgjegjëse për përdorimin e gazit lotsjellës dhe në Drejtoritë Vendore të Policisë.*

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na ka vënë në dijeni se rekomandimet janë dërguar për zbatim nga strukturat e vendore të policisë në shërbimet në vijimësi. Gjithashtu jemi informuar

se nga strukturat e policisë që janë angazhuar me shërbim në këto dy operacione janë zhvilluar analizat përkatëse për veprimet e kryera.

Disa sugjerime për përmirësime në legjislacion

Me qëllim përmirësimin e legjislacionit në fuqi dhe krijimin e garancive për ushtrimin e të drejtës së tubimit, Avokati i Popullit thekson nevojën për ndryshime ligjore të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet”, i ndryshuar.

Ndryshimet në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë iu referohen amendimeve të nenit 262 “*Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme*”, i cili vazhdon të trajtojë organizimet e grumbullimeve dhe manifestimeve të personave në sheshe dhe vende të kalimit publik si të kushtëzuara nga miratimi i lejes së organit të policisë. Nga prokuroria vijnë të procedohen protestues për veprën penale të parashikuar në këtë nen, kur ky nen është tërësisht në kundërshtim me kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe frymën e ligjit “Për tubimet”. Kjo gjetje është dhe një detyrë e lënë nga raporti përkatës i Komisionit European për Shqipërinë. Po ashtu, ligji “Për tubimet”, i ndryshuar, megjithëse është kryesisht në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare për të drejtën e organizimit dhe lirinë për tubime, duhet të adresojë të drejtën e qytetarëve për të organizuar apo marrë pjesë në tubime paqësore spontane dhe kundërprotesta.

Ndryshimet në ligjin nr.8773, datë 23.04.2001 kanë si qëllim përmirësimin më tej të lirisë së tubimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare sipas sugjerimeve të mëposhtme:

1. përcaktimi i rolit dhe autoritetit të Policisë së Shtetit në lidhje me njoftimin për organizimin e një tubimi në sheshe dhe në vendkalime publike.

a.Kërkesat e njoftimit për tubime të thjeshtohen, informacionet e kërkuara të reduktohen të jenë relevante për tubimet paqësore dhe të mos jenë penguese.

b.Në kuadër të transparencës me qytetarët të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, politikat, vendimet dhe informacionet e tjera që lidhen me ushtrimin e lirisë së tubimit paqësor duhet të jenë në dispozicion të publikut dhe lehtësisht të aksesueshme.

2. kuadri ligjor të sigurojë mbrojtje për të gjithë qytetarët që organizojnë ose marrin pjesë në tubime paqësore, duke përfshirë ato spontane, kundërprotestat dhe tubimet që nuk kanë një organizator të identifikuar në përputhje me udhëzuesit ndërkombëtarë për lirinë dhe të drejtën për tubime.

3. ligji “Për tubimet” duhet të ofrojë sqarime dhe udhëzime mbi procesin e apelimit ndaj vendimeve të autoriteteve shtetërore lidhur me kufizimet e mundshme të tubimeve.

Në kuadër të konstatimeve të evidentuara, mendojmë se gjendemi përballë shkeljes së të drejtave

të parashikuara nga nenet 3, 5, 6, 10 dhe 11 të KEDNJ-së: ndalimi i torturës, dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, e drejta për liri dhe siguri, e drejta për një proces të rregullt, liria e shprehjes dhe liria e tubimit dhe e organizimit.

4.3. Hapat e ndërmarra nga Avokati i Popullit për evidentimin e problematikave të evidentuara gjatë situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për përballimin e tyre

Tërmeti tragjik i mëngjesit të 26 nëntorit 2019 la pas pasoja të konsiderueshme njerëzore e materiale, konkretisht: 51 viktima/humbje jetë njerëzore, përrreth 17 mijë të zhvendosur, 913 persona të plagosur dhe dëme të konsiderueshme materiale. Në mbështetje të vendimit nr.750, datë 27.11.2019 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, qeveria shqiptare shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në zonat e prekura nga kjo fatkeqësi natyrore si dhe u hartuan akte të tjera ligjore e nënligjore për rregullimin normativ të situatave të tilla.

Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligj, ndërmjet të tjerave ka mandat për të trajtuar edheçështje që kanë të bëjnë me të drejtën për mirëqeverisje dhe të drejtën për strehim të përshtatshëm.

Në kuadër të kësaj veprimtarie dhe pas reagimit mbështetës publik të momentit, menjëherë pas fatkeqësisë natyrore janë kryer monitorime nga grupet e punës të ngritura nga Avokati i Popullit të cilët kanë qenë prezent në bashkitë e prekura për të parë nga afër situatën e rëndë të krijuar dhe pasojat e ardhura nga kjo fatkeqësi. Gjithashtu, u zhvillua monitorimi i masave të marra nga institucionet shtetërore në përpjekje për të adresuar pasojat e krijuara nga kjo fatkeqësi. Më konkretisht, me urdhër të veçantë të Avokatit të Popullit u krijuan disa grupe pune në përbërje të të cilave u përfshinë ndihmëskomisionerë/ekspertë nga disa seksione në mbikqyrjen e komisionerëve të seksioneve përkatëse në varësi dhe të çështjeve dhe problematikave të adresuara. Puna e këtyre grupeve u përqëndrua në bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Krujë, Shijak, Kurbin, Vorë dhe Lezhë.

Në fokus të këtij monitorimi, kanë qenë problematikat si më poshtë:

- masat e marra nga strukturat shtetërore për strehimin e banorëve të prekur nga tërmeti (strehimin e tyre në hotele, akomodimin nëpër çadra, përfitimin e bonusit të qirasë etj);
- monitorimin e procesit të evidentimit të dëmeve nëpër banesa, procedurat e ndjekura/problematikat e hasura;
- masat e marra për sigurimin e kushteve të nevojshme të jetesës për familjet e prekura nga tërmeti (ushqim, veshmbathje, kujdes shëndetësor, shkollim etj);
- masat e marra për eliminimin e pasojave dhe traumave psikologjike që kjo fatkeqësi ka lënë tek fëmijët dhe familjarët e tyre;
- zhvillimin e takimeve me përfaqësues të Zyrës Operacionale për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore, përfaqësues të pushtetit vendor dhe banorë të zonave të prekura.

Ky monitorim u krye bazuar në veprimtaritë e mëposhtme të grupeve të punës si:

- takime me përfaqësues të qeverisë, drejtues të Shtabit të Emergjencave në Qarqet përkatëse;
- inspektimin në terren të institucioneve përgjegjëse në nivel vendor si dhe të mjediseve ku janë sistemuar qytetarët, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti, konkretisht: qendra komunitare, njësia administrative, hotelet ku janë strehuar banorët e prekur, çadra dhe ambejnte të tjera të mundshme për strehim;
- vlerësimin dhe analizimin e saktë të informacionit të dhënave, dokumentacionit dhe deklaratave të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, veçmas për të evidentuar saktë veprimet ose mosveprimet e ndërmarra nga ana e tyre.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka ndërmarrë me iniciativë disa çështje të cilat janë bërë publike në mediat e shkruara dhe ato vizive si dhe ka në proces shqyrtimi disa ankesa të adresuara nga personat e prekur nga kjo fatkeqësi natyrore. Këto çështje janë në proces hetimi administrativ pasi pritet përgjigja e institucioneve përgjegjëse të cilave u kemi kërkuar informacion dhe shpjegime duke adresuar shqetësimet e ngritura nga ankuesit për shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme. Edhe pse janë dërguar disa herë kërkesat për informacion duhet të theksohet se përveç Bashkisë së Durrësit e cila ka sjellë informacion pjesërisht, institucionet e tjera përgjegjëse nuk kanë kthyer asnjë përgjigje. Ky fakt është bërë pengesë në punën tonë.

Avokati i Popullit do të vijojë punën për të evidentuar problematikat në këtë rast e do dalë me një raport të veçantë, ku do të paraqiten konstatimet përkatëse, konkluzionet dhe rekomandimet drejtuar institucioneve përgjegjëse.

Gjithsesi, paraprakisht janë konstatuar disa gjetje/problematika nga grupet e monitorimit të përmbledhura si më poshtë:

- Situatat e gjendjes së jashtëzakonshme parashikohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë gjegjësisht në nenet 170-176. Neni 170 paragrafi i parë parashikon shprehimisht se masat e jashtëzakonshme vendosen ndër të tjera edhe për shkak të gjendjes së fakeqësisë natyrore. Më tej në paragrafin e dytë të po këtij neni parashikohet se... *“parimet e veprimtarisë së organeve publike legjislative dhe shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njërit gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme përcaktohen me ligj; ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të gjendjes së jashtëzakonshme, aktet që ndërmerren si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme duhet të jenë në përpjestim me shkallën e rrezikut e duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të shtetit”*.

Rezulton se nga miratimi i Kushtetutës në vitin 1998 nuk është hartuar ende një ligj i plotë apo unik në kuptim të nenit 170 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e për këtë qëllim, mendojmë se kemi një vakum jo të papërfillshëm konstitucional. Megjithatë, ndonëse nuk janë tërësisht në

përputhje dhe në pajtim me sa mësipër e nuk trajtojnë të tëra kërkesat e normës së mësipërme kushtetuese, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka trajtuar disa elementë të adresimit të kësaj situatë në ligjin Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Theksojmë se ky ligj në vetë tekstin e tij nuk përcakton nenin 170 të Kushtetutës si bazën mbi të cilin ai ka dalë. Mendojmë se ky vakum ligjor duhet të plotësohet sa më parë dhe Ministria e Drejtësisë të përgatisë nismat përkatëse ligjore për të hartuar legjislacionin përkatës që duhet të trajtojë në thelb, çështjet e nenit 170 *b* dhe *c* të Kushtetutës.

Në momentin e monitorimit është evidentuar fakti që nuk ishin miratuar ende të gjitha aktet nënligjore në zbatim të përcaktimeve të ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Ky ligj është miratuar në datën 18.07.2019 dhe ka hyrë në fuqi në datën 02.08.2019. Kjo ka sjellë mungesën e funksionimit dhe organizimit të strukturave përgjegjëse të mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Kapaciteti i këtyre strukturave është minimal dhe baza materiale e tyre e papërshtatshme për të realizuar në mënyrë efektive përballimin e ngjarjeve të tilla si përsa i përket aspektit të kërkim shpëtimit ashtu edhe atij të identifikimit të banesave të papërshtatshme për banime ashtu edhe për ndihmën e parë për personat që kishin mbetur pa strehë për shkak të tërmetit. Pavarësisht përpjekjeve dhe mobilizimit mangësitë strukturore dhe financiare si të pushtetit qendror edhe atij lokal ishin evidente. Eksperiencat e mëparshme edhe pse në një shkallë më të vogël dhe jo kaq të gjerë nuk ishin përdorur për të krijuar e siguruar një reagim të përshtatshëm për situatë të tilla. Me kalimin e ditëve e për shkak të një mobilizimi të shtuar situatë në disa aspekte erdhi duke u përmirësuar. Është bërë një punë e mirë në planifikim të projekteve për të adresuar këtë situatë e cila do të vlerësohet në zbatimin e projekteve që kanë marrë mbështetje. Në mbështetje të kësaj është dhe krijimi i një ministri pa portofol.

- Çështja më e ndjeshme që prekte pothuajse të gjitha zonat e goditura nga tërmeti dhe veçanërisht bashkitë Tiranë-Kamëz, Durrës-Lezhë e Vorë-Shijak ishte strehimi.

Të dhënat tregojnë, se familjet e prekura që kanë dëmtime serioze në banesat e tyre jetojnë në varfëri. Çështjet e strehimit ishin të lidhura ngushtësisht me kushtet klimatike të stinës në të cilën ndodhej (stina e dimrit) dhe familjet e prekura ishin të ekspozuara ndaj të ftohtit dhe shiut, pa mbrojtjen e duhur.

- Në shumë bashki nuk ishte miratuar bonusi i qerasë dhe nuk ishte kryer verifikimi/ekspertimi mbi gjendjen e banesave në mënyrë që të konkludohej nëse ishin apo jo të banueshme dhe cilët ishin kategoritë që përfitonin bonusin.

- Problem tjetër shqetësues ishin të ardhurat pakta. Tërmeti ka dëmtuar ndjeshëm jetesën në zonat rurale të cilat janë të predispozuar për t’u varfëruar akoma më shumë, pasi në pjesën më të madhe të rasteve të ardhurat e tyre janë prej gjësë së gjallë.

- Po kështu, mbetej problematikë edhe infrastruktura arsimore. Prindërit ishin të shqetësuar për sigurinë fizike të ndërtesave të shkollave në bashkitë përkatëse.

- Përgjegjësia e autoriteteve shtetërore në raport me popullatën e këtyre zonave të prekura, mbetej shqetësuese. Popullsia e prekur në zonat e thella rurale nuk kishte marrë informacion ose mbështetje të mjaftueshme nga organet kompetente të mbrojtjes civile si përgjigje ndaj tërmetit.

- Kushtet higjierno-sanitare dukej se ishin një problem tjetër i personave të strehuar në ambiente të përshtatura si psh në klinika mjekësore, çadra, etj.
- Në rastet e banesave të vlerësuara kishte mjaft kontestime mbi vlerësimin e tyre, pasi banorët pretendonin se banesat e tyre janë të pabanueshme edhe pse pas një vlerësimi të dytë ishin konsideruar të banueshme.
- Gjithashtu në mjaft bashki dukej se mungonte ndihma psikologjike, post traumës, veçanërisht për të miturit të cilët janë dhe pjesa më e ndjeshme e popullatës dhe kërkohet trajtim i posaçëm për ta.

Sa më sipër Avokati i Popullit në përfundim të këtij hetimi do të hartojë e paraqesë në Kuvend një raport të veçantë.

4.4 Ushtrimi i rolit të vëzhguesit në procesin e përzgjedhjes me short të anëtarëve Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), si dhe pjesëmarrësit në mbledhjet dhe veprimtarinë këtij Këshilli⁸⁹

Në kuadër të ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2016, Avokatit të Popullit iu shtua një mandat specifik: **ai i vëzhguesit në procedurën e hedhjes së shortit si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi⁹⁰**, që u detajua nga ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Raportimi për vëzhgimin e veprimtarisë së KED-së, është një mekanizëm i rëndësishëm, jo vetëm për paraqitjen e gjetjeve në mënyrë efektive (si tregues për përmbushjen me sukses nga ana e Avokatit të Popullit të kësaj detyrë Kushtetuese dhe ligjore), por edhe për bërjen e rekomandimeve kyçe për ecjen përpara të reformës së sistemit gjyqësor në shina kushtetuese e ligjore. Ky rol mund të shërbejë edhe si një instrument i vlefshëm për dialogimin e aktorëve dhe palëve të interesuara në këtë Reformë.

Fryma e përçarur nga Kushtetuta në dispozitat e saj që lidhen me reformën në drejtësi, flet dhe përcakton kompetenca “atipike” të Avokatit të Popullit,⁹¹ të lidhura drejtëpërsëdrejti me këtë reformë shumë të rëndësishme për vendin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, duke i ndërthurur dhe komplementuar ato në proceset reformuese, me mandatin dhe detyrat bazë të Avokatit të Popullit, të përcaktuara në ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Gjejmë rastin të theksojmë se procedura aktuale e përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si është parashikuar në Kushtetutë dhe në ligjin 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” përben një hap shumë serioz për të garantuar përzgjedhje sa më objektive e të bazuar mbi meritë. Kjo procedurë përben një hap

⁸⁹Ky titull është një përmbledhje e raportit të veçantë të Institucionit të Avokatit të Popullit për këtë çështje

⁹⁰Shiko neni 149/d paragrafi 5 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

⁹¹ Në vende të ndryshme, ka edhe praktika të tjera, psh Avokati i Popullit i Kosovës ka kompetenca më të gjera, pasi është anëtar i Komisionit të Përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese

domethënës përpara për të rregulluar përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Aspekte të ndryshme që po trajtohen në këtë raport duhet të lexohen në dritën e përmirësimeve të mundshme zbatimin e këtyre procedurave në përputhje me parashikimet ligjore.

Detyra e parë në këtë proces lidhet me monitorimin e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ku në Raportet përkatëse hartuar për hedhjet e shorteve të dhjetor 2017 dhe dhjetor 2018, u ngriten një sërë shqetësimesh (një nga kryesoret ishte moszbatimi i kriterëve të ligjit për të përpiluar listat e kandidatëve, të paraqitura nga organet propozuese dhe pa asnjë shpjegim; ndërkohe që për disa organe e kategori të përfaqësuara, u përdoren kriterë më të kufizuara).⁹²

Në lidhje me veprimtarinë dhe punën e KED-së duhet të theksojmë se ajo ishte një punë e veprimtari tejet voluminoze, që kryhej për herë të parë dhe që kishte jo pak sfida në lidhje me interpretimin korrekt të kriterëve, kushteve dhe procedurave.

Problematika e parë gjatë vitit 2019 u paraqit në lidhje me nevojën që kishte rregullimi i veprimarisë së KED me akte të tjera proceduriale. Ato duhet të garantonin respektimin e standardit të procesit të rregullt ligjor dhe qëllimin për të siguruar cilësi sa më të lartë profesionale dhe morale në përbërjen e Gjykatës Kushtetuese dhe në përzgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Me mbështetjen e misionit Euralius në Shqipëri i cili përgatiti draftet e para të këtyre akteve, KED hartoi akte të detajuara në lidhje me veprimtarinë e tij, të cilat kishin një cilësi thelbësisht më të lartë se draftet. Sigurisht që aktet parashikonin procedura në kushtet kur procesi i përzgjedhjes nuk kishte nisur të kryhej efektivisht dhe, si rezultoi më pas, disa çështje mund të kishin gjetur rregullim më të hollëshishëm për disa aspekte. Disa prej tyre çuan në një krizë jo të vogël për vendin e prodhuan një debat shumë të ashpër e të dëmshëm që në vetvete nuk i ka shërbyer aspak rritjes së besimit të qytetarëve në organet e reja të krijuara si rezultat i zbatimit të Reformës në Drejtësi por as tek Gjykata Kushtetuese.

Për të marrë një opinion në lidhje me këtë çështje, Kuvendi dhe me pas edhe Presidenti i Republikës kanë kërkuar opinion pranë Komisionit të Venecias, të Këshillit të Europës, opinion përfundimtar i të cilit pritet të dalë në qeshor të këtij viti. Avokati i Popullit është përpjekur me përkushtim dhe seriozitet maksimal të kontribuojë në mënyrë konstruktive për të zbatuar çdo detyrë me përgjegjësi në përputhje me qëllimet madhore të kësaj reforme. Nga ana tjetër puna shumë e madhe dhe me dedikim e të gjithë anëtarëve të KED-së, e pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje, por edhe e këshilltarëve ligjorë dhe e sekretarisë së KED-së, nuk arriti të realizonte një proces pa të meta për përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Ligji 115/2016 në lidhje me organin e KED parashikon një organ që nuk zhvillon mbledhje të

⁹² Për më shumë shikoni raportet përkatëse për hedhjen e shortit në faqen e institucionit

hapura, e kundërta mbledhjet e KED janë të mbyllura pa praninë e palëve të treta të interesuara (në ndryshim nga veprimtaria e Këshillit të Lartë të Prokurorisë apo Këshillit të Lartë Gjyqësor). Shkaqet kryesore për këtë zgjedhje kanë qënë duket për të pasur një organ i cili të mos ketë ndikim politik në vendimarrjen e tij dhe në të cilin anëtarët të ishin të lirë të bënin vlerësimin e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe Inspektor të Lartë të Drejtësisë, por në bazë të kriterëve të caktuara në ligj (shih nenet 218 dhe 229 të ligjit 115/2016).

Nga ana tjetër për të mënjeluar problemin tjetër të madh që organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë kishin pasur në të shkuarën e në mënyre të veçante korporatizmin, u mendua që organi të mos vepronte tërësisht pas detyrës të mbyllura e pa llogaridhënie dhe u parashikuan mekanizma të ndryshëm në ligj e gjegjësisht arsyetimi i hollësishëm i vendimeve të lejimit apo jo të kandidimit dhe vendimit të vlerësimit, publikimi i njoftimeve të mbledhjeve dhe publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve, si dhe prania në cilësinë e pjesëmarrësit në mbledhje dhe veprimtari e Avokatit të Popullit⁹³. Ajo që rezultoi nga procesi i miratimit të rregulloreve ishte se mekanizmat e sigurimit të një transparence në nivel të kënaqshëm nuk u garantuan nga ana e KED. Në të kundërt pas miratimit të tyre, ky organ rezultoi të ishte edhe më i mbyllur se parashikimet ligjore.

Në këtë raport e kemi të pamundur të mos përmendim se me anë të këtyre akteve u kufizua prania e Avokatit të Popullit dhe të te ftuarve të tjerë vetëm në një pjesë të veprimtarisë së Këshillit, u fut koncepti i *“Dhomës së këshillimit”* në mbledhjet e këtij organi administrativ (i pa parashikuar në asnjë ligj), në kundërshtim me qëllimin e legjislatorit për garantimin dhe ruajtjen e transparencës në tërësinë e veprimtarisë së KED-së. Gjithashtu në rregullore në versionin përfundimtar të saj, mundësia e Avokatit të Popullit për të dhënë mendime në Këshill u kufizua vetëm në lidhje me ndonjë shkelje formale të procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe jo në lidhje me thelbin e çështjes, apo problematikës së shtruar për diskutim nga relatorët. Duke vlerësuar parashikimin e mësipërm në kundërshtim me kompetencat që i janë dhënë Avokatit të Popullit, në muajin dhjetor 2019, institucioni ynë depozitoi padinë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, me objekt shfuqizimin e disa prej neneve, në tre prej rregulloreve të miratuara nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, proces i cili aktualisht është duke u gjykuar.

Gjithashtu gjatë gjithë vitit 2019, pati edhe problematika të tjera, si: - Moszbardhja në kohë e procesverbaleve të mbledhjeve të KED-së (u vonua me 11 muaj zbardhja dhe publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këtij organi, ndërkohe që nga ana e kryetarit të KED-së refuzohej t’i vihehin në dispozicion këto procesverbale institucionit tonë); - parregullsi në dërgimin e materialeve të mbledhjeve (materialet ishin të paplota, nuk repektohej afati i dërgimit paraprak). Për të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces, nuk ka asnjë shpjegim të asnjë lloji (as publik dhe as në mbledhje pa praninë e të tretëve), se çfarë e shkaktoi dërgimin nga kryetari i KED-së, të listave përfundimtare për te organet e emërtesës shumë ditë pas datës 21.09.2019 (pas 15 ditësh Presidentit të Republikës dhe pas 21 ditësh Kuvendit të Republikës së Shqipërisë). Procesi zgjati tej afateve të parashikuara nga ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” dhe nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit

⁹³ Shiko nenet 232, 233, 240 paragrafi 7 të ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

të Drejtësisë”, (shqyrtimi i praktikave të ndjekura nga ana e KED-së gjatë vitit 2019, rezulton se afati që nga momenti i dërgimit të listave me kandidatë nga organet e emërtesës për çdo vakancë në Gjykatën Kushtetuese është tejkaluar në mënyrë të konsiderueshme, por në vlerësimin tonë kjo çështje ka të bëjë me afatet e shkurtë ligjore të parashikuara nga legjislatori dhe jo me performancën e KED-së 2019).

Një problematikë tjetër e konstatuar nga ne ishte edhe *kandidimi i një kandidati për anëtar në Gjykatën Kushtetuese, për disa pozicione vakante njëkohësisht*. Nisur nga problemi që u krijua në praktikë, mendojmë se një situatë e tillë ka nevojë të rregullohet më mirë nga ana ligjore.

Për më tepër, të dyja vakancat e Kuvendit, kishin më pak kandidatë në listë se ato të Presidentit të Republikës dhe secili/a prej kandidatëve në listat e Kuvendit ishte edhe në ato të Presidentit. Pra, nuk rezulton të ketë asnjë mundësi që të mos jenë të njëjtat materiale të listuara dhe vendime të arsyetuara, gjë që tregon se nuk kishte arsye objektive që Kuvendit listat t’i dërgoheshin me 6 ditë vonesë, në krahasim me ato të dërguara Presidentit të Republikës.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, disa prej kandidatëve (9 prej tyre), ankimuan vendimin e KED-së për ndalimin e kandidimit të tyre, në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Proceset gjyqësore të zhvilluara mbi bazën e këtyre ankimeve, u monitoruan nga Avokati i Popullit.⁹⁴ Në përfundim të këtyre proceseve gjyqësore rezultoi se vetëm një prej padive të paraqitura u pranua, ndërkohë që paditë e tjera u rrëzuan. Paditë megjithatë, nxorën disa problematika dhe një këndvështrim tjetër të dhënë nga kandidatët në lidhje me mënyrën si ata e konsideronin procesin por edhe me konceptin e “shkeljeve të rënda proceduriale” të patrajtuar me parë në kuadër të kësaj procedure⁹⁵.

Një problem thelbësor i pazgjidhur në lidhje me këtë proces është nëse kandidatet e propozuar nga radhët e gjyqësorit do të duhet të kenë kaluar të dyja shkallët e procesit të rivlerësimit apo vetëm të kenë kaluar me sukses një shkallë. Pavaresisht se KED ka qenë e qartë se do ishte më mirë të shkonin vetëm kandidatë nga radhët e gjyqësorit për të cilët i kanë kaluar të dy shkallët e procesit, kohezgjatja e atij procesi do conte në një pezullim të procesit për vakancën përkatëse. Nga ana tjetër është e qartë se kjo çështje komplekse nuk mund të zgjidhet pa një bashkëpunim dëshirëmirë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit me KED për të bërë të mundur që kandidatët nga radhët e gjyqësorit të vetohen me përparësi e procesi i ankimit të tyre të shqyrtohet gjithashtu me përparësi cilado të jetë vendimarrja e Komisionit të Posaçëm të Kualifikimit. Në mbledhjen e KED-së, të datës 24.07.2019, ishin parashikuar të merreshin në shqyrtim kandidatë, të cilët nuk e kishin përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar për gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë. Qëndrimi i Avokatit të Popullit, në varësi të problematikës së konstatuar në këtë rast ka qenë për pezullimin e procesit të shqyrtimit të këtyre kandidaturave dhe rishikimin e pikës 112,

⁹⁴Në disa prej padive të depozituara në gjykatë, Avokati i Popullit ishte thirrur si palë në procesin gjyqësor, në cilësinë e «Palës së interesuar»

⁹⁵Neni 338 i ligjit 116/2016 parashikon shprehimisht se *Ankimet kundër vendimit të KED për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda proceduriale behen në Gjykatën Administrative të Apelit*.

të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019, të KED-së.⁹⁶ Në çdo rast, fakti që një prej kandidatëve të propozuar KED në një vakancat, u përzgjodh për të ushtruar këtë detyrë e më pas u shkarkua nga KPA sigurisht që tregon se procesi ka nevojë të mendohet më me thellësi dhe të jetë rezultat i një bashkëpunimi korrekt e dëshirëmirë për të çuar përpara reformën si një të tërë dhe jo si të fragmentuar.

Një konstatim tjetër është se sipas neneve 7/b pika 2, 7c pika 5 dhe 7ç pika 1 të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”- i ndryshuar: *«Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë, mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi»*. Gjatë vitit 2019 nuk rezulton që dy kategoritë e mësipërme (a. institucionet publike, b. organizatat e shoqërisë civile) të kenë dhënë opinione në lidhje me kandidaturat.

Neni 7/ç i ligjit nr. 8577/ 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”- i ndryshuar, përcakton procedurën e zgjedhjes nga Gjykata e Lartë. Sipas këtij neni: *«Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, njofton për vendin vakant Kryetarin e Gjykatës së Lartë, i cili shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit»*.

Deri në datën 26 korrik 2019, nga ish kryetari z. Zaganjori, nëpërmjet faqes së internetit të Gjykatës së Lartë u bënë disa shpallje, ndërkohë që pas largimit të tij, nga drejtuesi në detyrë i kësaj Gjykate z. Ardian Dvorani, i cili njëkohësisht ishte edhe kryetar i KED-së për vitin 2019, jo vetëm u ndërpre ky proces (nuk u bë më asnjë shpallje), por për më tepër nuk është dhënë ndonjë shpjegim (as në mbledhjet e KED-së dhe as në raportin vjetor të KED-së për vitin 2019) për arsyet e këtij mosveprimi.

Plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese është i një rëndësie jetike për vendin dhe për garantimin e një sistemi funksional drejtësie. Numri kaq i madh i vakancave përveç kësaj kohe shumë të gjatë pa gjykatë efektive çon edhe në një pasiguri për praktikën apo jurisprudencën e gjykatës. Në këto kushte edhe pas plotësimit të anetarëve të saj (duket e vështirë që kjo gjykatë të plotësohet me 9 anëtarë brenda vitit 2020) do të jetë e natyrshme që do të duhet një kohë jo e shkurtër për të konsoliduar vendimarrjen e saj si një trupë solide.

Nga ana e KED-së gjatë vitit 2019 u përballua një volum i madh pune, i cili u bazua së pari në hartimin e kuadrit nënligjor, e më pas edhe në shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidatëve. Situata ku ndodhej sistemi i drejtësisë (veçanërisht mosfunksionimi i Gjykatës Kushtetuese), bëri që numri i vendeve vakante dhe rrjedhimisht edhe i kandidatëve për këto vende, të ishte mjaft i lartë, gjë që do të thotë edhe një volum pune i paparashikuar për KED-në.

⁹⁶Argumentimi mbi bazën ligjore të këtij qëndrimi, është dhënë në mënyrë të detajuar në Raportin e plotë për veprimtarinë e KED-se për vitin 2019

Duke qenë se vetë legjislacioni për reformën në drejtësi është i ri dhe po aplikohet për herë të parë, zbatimi në praktikë, bëri të lindnin një sërë çështjesh, për të cilat pati edhe qëndrime të ndryshme.

Në kuadër të çështjeve të përmendura në këtë material, rrjedhim i trajtimit analitik e tërësor të situatës së krijuar, nga institucioni i Avokatit të Popullit, për KED-në e vitit 2020 paraqiten këto rekomandime:

A. Për zbatimin në mënyrë korrekte të akteve normative në fuqi:

- Të rimarrë në shqyrtim kërkesën e Avokatit të Popullit për kufizimin e kompetencave bërë nga KED e vitit 2019 nëpërmjet Rregulloreve dhe me konkretisht të heqë “dhomën e këshillimit”, mekanizëm ky i paparashikuar në asnjë akt normativ (Kushtetutë, ose ligj) që rregullon punën e KED-së.
- Të hartojë rregulloren për mënyrën e komunikimit brenda KED-së (përfshi edhe komunikimin ndërmjet relatorëve dhe kryetarit, relatorëve dhe këshilltarëve ligjorë, etj.).
- Të merren masa për sistemimin e arkivës së KED-së, konform parashikimeve për legjislacionin për arkivat.
- Kryetari i KED-së, për kërkesat që i drejtohen KED-së, konform nenit 229 të ligjit 115/2016, t’i përcjellë ato për diskutim në mbledhjet e KED-së.
- Njoftimi për mbledhjet e KED-së të bëhet brenda afateve të parashikuara nga neni 11 i Rregullores së brendshme për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Në rastet kur ky afat është i pamundur, konform parashikimit të bërë po në pikën 11 të Rregullores së sipërpërmendur, të jepen arsyet e mosrespektimit të afatit.
- Materialet për mbledhjet e KED-së të shpërndahen në kohën e nevojshme (të paktën sipas afateve të parashikuara në pikën 11 të Rregullores së brendshme për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi) dhe materialet që dërgohen të jenë të numërtuara/inventarizuara paraprakisht.
- Të merren masa për tu plotësuar tërësisht standardet e procesit të rregullt në lidhje me procedurën e verifikimit të kandidatëve si për sa i përket përmbajtjes së relacionit përfundimtar për secilin kandidat, ashtu edhe njoftimin e kandidatit, si dhe dhënien e mundësisë efektive për të kundërshtuar gjetjet përkatëse.
- Të garantohet aksesimi në procesverbalet audio dhe në procesverbalet e pjesëmarrësve në mbledhje, ose të të ftuarve,
- Të garantohet mbajtja e procesverbaleve në përputhje me parashikimet ligjore, por duke garantuar thelbësisht sigurimin e transparencës si një nga elementet bazë.

B. Rekomandime legjislative (për ndryshime në Rregulloret e KED-së):

- Në rastet e mungesave të anëtarëve të KED-së në mbledhje, njoftimi për mungesën të shoqërohet me dokument justifikues.

- Të ndryshohet pika 13/2 e Rregullores nr. 1 të KED-së, sipas së ciles: “2. *Avokati i Popullit, nëse e vlerëson të jetë i pranishëm, merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit. Në mungesë të tij, Avokati i Popullit mund të përfaqësohet nga njëri prej komisionerëve*”. Kjo për faktin se konform dispozitave që rregullojnë institucionin e përfaqësimit, Avokati i Popullit është i lirë të caktojë përfaqësuesin e tij dhe jo kjo gjë t’i caktohet nga KED. Një përcaktim i tillë nga KED, nuk është në harmoni as me nenin 118 të Kushtetutës, pasi ligji nuk ka autorizuar KED-në në përcaktimin e një çështjeje të tillë.
- Per procesverbalet e mbledhjeve: Saktësimin në Rregulloren e brendshme për funksionimin e KED-së, të detyrimit për hartimin e dy llojeve të ndryshme procesverbalesh: 1. *Procesverbal të plotë të mbledhjes* dhe 2. *Procesverbal përmbledhës*.

C. Rekomandime të tjera:

- Në e KED gjykon të pamjaftueshme burimet njerëzore dhe financiare, për kryerjen me cilësi dhe sipas afateve ligjore, të detyrave të përcaktuara nga ligji, të llogarisë dhe kërkojë sa më parë mbulimin e këtyre nevojave.
- Të parashikohet mundësia për të ulur përpjestimisht ngarkesën në punë në Gjykatat apo Prokuroritë ku ata ushtrojnë detyrën e tyre funksionale për anëtarët e KED në përgjithësi por domosdoshmërisht për anëtarët relatorë.
- Për problematikat e konstatuara gjatë vitit 2019 dhe për të cilat ka nevojë për ndryshime ligjore, KED ka paraqitur një raport vjetor për të cilin ka edhe gjetjet përkatëse të cilat ne i mbështesim në tërësinë e tyre.
- Të zgjidhet në ligj problemi i kandidimeve në më shumë se një vakancë.
- Të parashikohen afate më të përshtatshme për kandidatët por edhe për Këshillin gjatë procesit të kryerjes së vlerësimit të kandidaturave,
- Të garantohet detyrimi ligjor i organeve të tjera ligjzbatuese për të komunikuar drejtëpërdrejtë me Këshillin, ose të ndryshojnë parashikimet ligjore në këtë pikë, në mënyrë që këto garanci/kritere të mos mbeten vetëm në letër,
- Rishikimi i kriterëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese për të garantuar mundësinë e konkurimit të individëve në grupet me individë me kariera të ngjashme dhe përcaktim i kriterëve të ndryshme vlerësimi për gjyqtarë dhe ose jogjyqtarët,
- Të përcaktohet një afat i arsyeshëm për periudhën gjatë të cilës kandidatët do duhet t’i nënshtrohen kontrollit të pasurisë së tyre.
- Të unifikohet procedura për dërgimin e listës përfundimtare pranë organit të emërtesës.⁹⁷

⁹⁷ Në rastin e listës për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese kjo listë parashikohet të dërgohet menjëherë, ndërsa në rastin e Inspektorit të lartë të Drejtësisë ajo duhet të dërgohet brenda një afati prej 3 ditësh (shiko nenet 201 2 e të ligjit “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” dhe nenet 7b 4 e 7c 4 i ligjit 8577, date 10.02.2000, «Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë»

- Të përcaktohet data nga e cila nis fillimi i rrjedhjes së afatit të mekanizmit zhblllokues për secilin prej organeve të emërtesës (shiko nenin 201 2 f të ligjit 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” dhe nenin 7b 4 dhe nenin 7c 6),

Në përfundim të gjithë sa më sipër, Avokati i Popullit jo vetëm nisur nga detyrimet specifike që legjislacioni i ka ngarkuar në këtë proces, por edhe si një institucion i pavarur Kushtetues, që ka si shtylla kryesore të veprimtarisë së tij, mbrojtjen, parandalimin e shkeljeve dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, të cilat i sheh të lidhura ngushtë edhe me mirëfunksionimin dhe mirëadministrimin e sistemit të drejtësisë, siguron se procesi i Reformës në Drejtësi do të vazhdojë të jetë një nga objektivat kryesorë të veprimtarisë së punës së institucionit tonë.

Avokati i Popullit nuk duhet të shihet si i pakonsiderueshëm për suksesin e procesit të zbatimit të kësaj reforme që në vetvete mbart dy qëllime kryesore, luftën kundër “koorporatizmit” dhe transparencën e plotë në vendimmarrje, për të siguruar besueshmërinë e pritshme dhe të nevojshme për sistemin e drejtësisë në vend. Ne e konsiderojmë si jetësore për të gjithë shoqërinë shqiptare kthimin e besimit në sistemin e drejtësisë në vend dhe për këtë po përpiqemi të japim kontributin në monitorimin e shumë prej proceseve që po realizohen në kuadër të Reformës në Drejtësi.

4.5. Monitorimi i disa aspekteve të zbatimit të procesit kalimtar të verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vëmendje të veçantë zbatimin e reformës në drejtësi në përgjithësi dhe sidomos ngritjen e institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe funksionimin e këtyre institucioneve. Avokati i Popullit ka rol të dyfishtë në ndjekjen e kësaj reforme; **Së pari:** Si Institucion Kushtetues në mbrojtjen dhe garantimin e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe **Së dyti :** Si institucion të cilit Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni për Reformën në Drejtësi i ka dhënë rol dhe kompetenca të caktuara në këtë proces. Gjithashtu, Avokati i Popullit, si institucion kombëtar i të drejtave të njeriut është garant i respektimit të standardeve më të larta të shtetit të zbatimit të të drejtave të njeriut ku një rol parësor ka edhe sistemi gjyqësor ku qytetarët mund të drejtohen për të vënë në vend të drejtat e tyre. Qëllimi thelbësor i reformës në drejtësi është rikthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë e qoftë edhe për këtë shkak ajo përbën një nga çështjet që është konsideruar si prioritet i punës tonë.

Në kuadër të këtij roli kushtetues e ligjor, institucioni ynë ka ndjekur dhe monitoruar zbatimin e reformës në drejtësi në të tërë komponentët e vet, por në këtë pjesë do të përqëndrohemi tek institucionet e rivlerësimit, të krijuara për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht kemi ndjekur e monitoruar me vëmendje të veçantë seancat dëgjimore të zhvilluara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim KPK) ashtu edhe seancat publike të zhvilluara nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim KPA), si dhe kemi ndjekur me vëmendje edhe ankimet e ushtruara nga Institucioni i Komisionerëve Publik (në vijim IKP).


Nga monitorimi i kryer për vitin 2019, rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

- **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK)** ka mbaruar procesin e hetimit administrativ dhe ka rivlerësuar 126 subjekte rivlerësimi, nga të cilët 51 janë konfirmime në detyrë, 47 shkarkime nga detyra, 11 ndërprerje procesi, pasi subjektet e rivlerësimit janë dorëhequr nga detyra (para nisjes së procesit ose edhe në fazë të avancuar të tij) dhe procesi është ndërprerë, sipas parashikimeve të pikës G të Aneksit të Kushtetutës. Ndërkohë, në 16 raste janë pa vendim përfundimtar (kjo pasi subjektet e rivlerësimit kanë mbushur moshën për pension) dhe një subjekt është pezulluar nga detyra, sipas përcaktimeve të pikës E/1 të Aneksit të Kushtetutës.
- **Institucioni i Komisionerit Publik (IKP)**, është vënë në dijeni, përmes njoftimit nga KPK, për 127 vendime për vitin 2019 dhe në zbatim të detyrave të tij kushtetuese e ligjore ka proçeduar, duke i shqyrtuar këto vendime dhe arritjen në vendimet përfundimtare, si më poshtë:
 - o 13 ankime për vitin 2019
 - o ka shpallur 114 vendime mosankimi
 - o 4 vendime në proces
 - o janë depozituar pranë këtij institucioni 361 denoncime nga publiku, për vitin 2019.
- **Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA)** për vitin 2019 ka regjistruar 60 çështje, nga të cilat:
 - o 13 çështje të ankimuara nga IKP
 - o 47 çështje të ankimuara nga subjektet e rivlerësimit
 - o 1 çështje është ankimuar nga të dy palët.

Gjatë vitit 2019 KPA ka marrë 34 vendime, nga të cilat:

- 23 vendime shkarkimi të KPK janë lënë fuqi nga KPA;
- 8 vendime konfirmimi nga KPK janë ndryshuar dhe KPA ka vendosur shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit;
- 2 vendime të KPK-së për konfirmimin në detyrë të subjekteve të rivlerësimit, të ankimuara nga IKP, janë lënë fuqi nga KPA vetëm pas kërkesës së parashtruar nga ana e Komisionerit Publik për lënien në fuqi të vendimit;
- për një vendim është vendosur pushimi i gjykit në apel;

Ndërkohë nuk rezulton që ndonjë vendim shkarkimi nga KPK të jetë ndryshuar dhe KPA të ketë vendosur konfirmimin e subjektit të rivlerësimit.



Paraqitja grafike e vendimeve të marra nga KPA për vitin 2019


➤ Monitorimi i seancave dëgjimore pranë KPK.

Për vitin 2019 rezulton të jenë rivlerësuar 15.75 %⁹⁸ të numrit total të subjekteve të rivlerësimit, ndërsa nëse i referohemi vitit paraardhës, pra vitit 2018 rezulton një numër prej 92 subjekte të rivlerësuar në total dhe e shprehur në përqindje rreth 11.5% e tyre, por jo i mjaftueshëm për përfundimin e procesit brenda afatit ligjor të përcaktuar në kushtetutë dhe Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Neni 70/1 i këtij ligji parashikon: “*Institucionet e rivlerësimit pushojnë së funksionuari sipas nenit 179/b, pika 9, të Kushtetutës.*”, ndërsa neni 179/B, pika 8 e Kushtetutës, parashikon: “*Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik është 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit tyre*”.

KPK është ngritur si institucion dhe ka marrë funksionet e tij zyrtarisht në Qershor 2017, pra përreth 2 vite e gjysëm⁹⁹ dhe gjendet në mes të mandatit të tij zyrtar, çka do të thotë se duhet të ishin rivlerësuar rreth 400 subjekte rivlerësimi deri në këto momente, por numri real i të rivlerësuarve është 220, pra mjaft larg këtij numrit që duhet të ishte trajtuar proporcionalisht.

⁹⁸Në çdo vit duhet të kalojnë këtë proces një numër i barabartë me 20% të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve dhe ose prokurorëve.


⁹⁹Afati i referohet periudhës deri në 31.12.2019.



Si dhe u relatua më lart, KPK për vitin 2019 ka përfunduar hetimin gjyqësor vetëm për 99 subjekte, ndërsa për pjesën tjetër prej 27 subjektësh nuk është kryer hetim administrativ i plotë pasi janë dorëhequr apo kanë mbushur moshën për pension e për disa prej tyre procesi është ndërprerë në fazë fillestare. Në rastin më të mire dhe nëse mendojmë në mënyrë hipotetike se dhe për vitet në vazhdim do të ecet me këto ritme dhe do të kemi fatin që subjekte të tjera do të dorëhiqen apo do të mbushin moshën për pension, do të duhej të paktën 4,6 vite që procesi të përfundonte. Por nëse do të jemi realist dhe do ti referohemi ecurisë së deritanishme, për subjektet për të cilët realisht ka përfunduar shqyrtimi administrativë, do të duhej të paktën edhe 5.8 vite të tjera që procesi të përfundonte, gjithnjë nëse ecuria do të ishte me ritmin mesatar të deritanishëm.


Mesatarja nëse i referohemi subjekteve për të cilët ka përfunduar shqyrtimi administrativë.

Numri total SR	mesatarja që do duhej per çdo vit	Nr. real i SR për të cilët ka përfunduar shqyrtimi administrativ në 2019	Nr. i viteve që do duheshin sipas këtyre viteve	Afati i mbetur për funksionimin e KPK, në vite
800	160	99	5.8	2.5



Paraqitja grafike e subjekteve që kanë përfunduar shqyrtimin administrativ

Ritmet me të cilat ka ecur procesi i rivlerësimit edhe për vitin 2019 nuk rezultojnë pra të jenë proporcionale me afatet që janë dhënë në ligj në përputhje me parashikimin ligjor. Në vijim të kësaj, rezultojnë se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për vitin 2018 ka dhënë vendime për shkarkim nga detyra për **35** subjekte rivlerësimi, ka konfirmuar në detyrë **42** subjekte rivlerësimi, ndërprerë procesin sipas nenit G të Aneksit Kushtetutës për **7** subjekte, pushuar procesin sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016 për **8** subjekte rivlerësimi. Pra në total një numër prej 92 subjekte të rivlerësuar për vitin 2018. Por realisht është zhvilluar hetim i mirëfilltë administrativ për 77 subjekte rivlerësimi. Nëse e shohim në mënyrë krahasimore konstatohet se ka një rritje nga njëri vit në tjetrin prej një numri prej 34 subjektësh më shumë në vitin 2019. Ky numër, megjithëse më i lartë se viti 2018, është ende i ulët si e paraqitëm në krahasim me parashikimin ligjor. E shprehur kjo në përqindje, për vitin 2018 janë rivlerësuar vetëm 11.5% e numrit total të subjekteve, ndërsa në vitin 2019 janë rivlerësuar 15.75 % e tyre, pra me një diferencë prej 6.25% më shumë krahasuar me vitin 2018.




Ky numër, megjithëse më i lartë se viti 2018, është ende i ulët si e paraqitem në krahasim me parashikimin ligjor. Gjejmë me vend të vëmë në dukje se zgjatja e procesit të vetingut ka qenë objekt edhe i vlerësimit të bërë nga Komisionin i Venecias në opinionin e tyre në lidhje me disa aspekte të reformës në drejtësi. (ref. Opinionit të Komisionit të Venecias të vitit 2016). Sipas këtij opinionit zgjatja në kohë mund të çojë në një përkeqësim të performancës së sistemit të drejtësisë në vend dhe për këtë kohëzgjatja brenda të cilës ky proces duhet të kryhet është nga 3 në 5 vite. Kuvendi i Shqipërisë me ndryshimet kushtetuese vendosi të përcaktojë si afat për kryerjen e këtij procesi në KPK afatin më të gjatë të mundshëm të treguar në opinionin e sipërcituar, pra 5 vite.


Nga ana tjetër, është e qartë se struktura dhe kapacitetet njerëzore që Kuvendi duhet të miratonte duhet të ishte e papërshtatshme për të garantuar zhvillimin e procesit sipas afatit të treguar në ligj e të udhëzuar si më sipër. Avokati i Popullit vlerëson se shkaqet e këtyre ritmeve janë komplekse, mund të lidhen qoftë me thellësinë e hetimit, apo me numrin e ulët të stafit apo Komisionerëve të Komisionit të Posaçëm të Kualifikimit, por në çdo rast ndërsa KPK është tashmë në mes të mandatit të saj duhet që Kuvendi të adresojë me prioritet këtë çështje. Është thelbësore të merren masat që procesi të përfundojë me sukses dhe brenda afateve ligjore duke garantuar të njëjtin standard hetimi për të tërë gjyqtarët dhe prokurorët e vendit e jo për të pasur organe të ndryshme e rrjedhimisht edhe standarde të ndryshme të verifikimit për ta.

Zhvillimi me ritme më të shpejta i këtij procesi, pa cënuar në asnjë rast cilësinë e vendimmarrjes së institucioneve të rivlerësimit do të ndihmojë në rikthimin në gjendje normale të sistemit të drejtësisë, i cili duket se po funksionon me numër të kufizuar burimesh njerëzore. Një nga arsyt e këtij ritmi, jo të kënaqshëm të rivlerësimit, mund të jetë numri i personelit të miratuar në organikën e këtij institucioni, referuar për këtë qëllim pretendimit të parashtruar nga ana e këtij të fundit se ky institucion të jetë përballur me një ngarkesë të lartë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij. Kjo gjë mund të kërkojë rishikim të organikës së KPK dhe mundësinë e rritjes së numrit të personelit, në mënyrë që të kemi rezultate më pozitive në lidhje me përmbylljen e procesit brenda një afati të arsyeshëm.


Nëse të dhënat sa më sipër do ti paraqesim mbi bazë gjinore, konstatohet se gjatë vitit 2019, KPK ka rivlerësuar (dmth ka dalë me vendim) në një numër prej 86 subjekte rivlerësimi meshkuj dhe 40 femra. Shprehur kjo në përqindje, 68.25% janë meshkuj dhe 31.75 janë subjekte femra.



Nga të cilët, 55.5% subjekteve meshkuj janë shkarkuar, 24.418% janë konfirmuar në detyrë, 12.418% është ndërprerë /pushuar procesi për shkak të mbushjes së moshës për pension dhe 6.976% prej tyre është ndërprerë procesi sipas nenit G të Aneksit Kushtetues.



Ndërsa përsa i përket subjekteve femra, 20% e tyre janë shkarkuar nga detyra, 57.5 janë konfirmuar në detyrë, 10% është pushuar hetimi për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, 10% është ndërprerë procesi sipas nenit G të Aneksit Kushtetues.



➤ **Në lidhje me transparencën në zhvillimin e seancave dëgjimore në KPK.**

- Transparenca në zhvillimin e seancave dëgjimore, ka qenë përgjithsisht e kënaqshme përse i përket zhvillimit të saj me dyer të hapura për publikun dhe median, si dhe të dhënave të pasqyruara në faqen zyrtare të këtij institucioni. Ndërsa përse i përket transparencës në lidhje me hetimin administrativ, relatimin e çështjeve nga trupat gjykuese dhe vendimarrjen, në disa raste, mund të themi se ka pasur rezerva nga disa prej subjekteve gjatë zhvillimit të seancave. Ajo çfarë konstatohet nga seancat dëgjimore është fakti se nga ana e relatorit të çështjes parashtrihen gjetjet e konstatuara nga ana e KPK – së gjatë hetimit administrativ në mënyrë të përmbledhur. Disa çështje janë evidentuar jo prej relatimit apo vendimit po prej ankimit të bërë nga Komisioneri Publik, dhe kjo tregon se relatimi i çështjeve nuk paraqet të tëra gjetjet që mund të ndikojnë në vendimarrjet negative për subjektin, ashtu edhe si ka pasur raste kur për subjektet janë përfshirë në relatin edhe çështje të cilat nuk kanë pasur asnjë ndikim pasi kanë rezultuar fakte të sqaruara. Në disa raste relatimi nuk ka qenë i qartë dhe nuk janë pasqyruar të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë çuar në një vendimarrje të caktuar, duke i mohuar publikut njohjen me to. Një fakt i tillë cënon në mënyrë të dukshme parimin e transparencës si dhe mjaft të cunguar për publikun dhe median..

- Në raste të tjera ka pasur mungesë të transparencës në lidhje me raportet e organeve ndihmëse (ILDKPKI, DSIK dhe KLD/KLGJ). Nga monitorimi i seancave dëgjimore, është konstatuar se gjatë seancave trupat gjykuese kanë relatuar mbi raportet e ILDKPKI, si organ ndihmës.

Nga relatimi ka rezultuar se ILDKPKI të ketë paraqitur një raport të parë pranë KPK, në lidhje me kriterin e pasurisë, por KPK ka kërkuar rishikimin e raportit dhe më pas është pasuar me ndryshimin e tij. Trupat gjykuese gjatë seancës dëgjimore nuk kanë pasqyruar arsyet e këtij ndryshimi dhe faktet e reja që e kanë paraqitur realizimin e një raporti të dytë të ndryshëm nga i pari, duke cënuar edhe në këtë rast, parimin e transparencës ndaj publikut. Në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe me disa raporte të DSIK, ku trupat gjykuese kanë kërkuar rishikimin e tij apo kanë relatuar se nuk përmbante prova për përfshirjen e subjekteve të rivlerësimit në akte korruptive apo në kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, por pa e argumentuar atë dhe pa bërë të njohur arsyet e një vendimarrje të tillë për publikun. Psh. Organi ndihmës/DSIK në raste të caktuara ka raportuar, ndër të tjera, se ka të dhëna që ngrenë dyshime për përfshirjen e subjekteve të rivlerësimit në korrupsion pasiv, por në përfundim KPK ka arritur në konkluzionin se subjektet nuk janë në kushtet e referuara nga DSIK, pa bërë të njohura për publikun provat, faktet dhe arsyet që të shpien në këtë vendimarrje.

Ndërkohë, në raste të tjera të ngjashme, kur raporti i DSIK ka konkluduar se ka indicie për korrupsion pasiv e kontakte me persona të papërshtatshëm, trupa gjykuese ka konkluduar se mbështet konstatimet e DSIK, pa bërë të njohura edhe në këtë rast, provat e faktet që të shpien në këtë vendimarrje, edhe pse rastet ishin të ngjashme.

Pra, KPK nuk ka paraqitur në mënyrë shteruese arsyetim në rastet e ndryshimit të raporteve të ILDKPKI dhe DSIK dhe as në rishikimin e tyre. Të njëjtat mangësi janë vërejtur edhe në

arsyetimin e vendimeve për këtë çështje por janë rimarë në disa prej tyre edhe prej Komisionerit Publik.

- Gjithashtu, në mjaft raste, subjektet e rivlerësimit janë vlerësuar vetëm mbi një kriter, kryesisht mbi kriterin e pasurisë dhe dy kriteret e tjera nuk janë bërë të ditura për publikun. Mendojmë se vlerësimi vetëm mbi një kriter (atë të pasurisë) do të sillte paragjykimin e subjekteve në lidhje me vendimmarrjen dhe hetimi administrativ do të ishte i paplotë, s'i dhe në një rast të tillë është cënuar parimi edhe në dukje të paanësisë së anëtarëve të trupit gjykues. Parim ky themelor për të pasur një proces të rregullt ligjor në këndvështrim kjo të kërkesave të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pavarësisht disa qëndrimeve të trupës së KPK në lidhje me faktin se vlerësimi vetëm me një kriter nuk cënon procesin dhe se KPK mund të vijojë përsëri me vlerësimin e kriterëve të tjera në rast të një vendimmarrje përfundimtare pozitive për atë kriter ne jemi të mendimit se vlerësimi vetëm me një kriter, nuk garanton në asnjë rast arritjen e qëllimit të këtij procesi që është besimi i qytetarëve por edhe vetë personave që i nënshtrohen këtij procesi në të. Komisioni jo vetëm që duhet të jetë i paanshëm deri në vlerësimin e çdo prove e rrethane për çështjen në hetim deri në vendimmarrje por edhe duhet të duket i tillë.

- Një moment mjaft i rëndësishëm në procesin e rivlerësimit të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë, është edhe denoncimi i publikut. Këtij momenti i është dhënë një vlerë mjaft e rëndësishme, duke përfshirë edhe publikun në këtë reformë kaq të rëndësishme që po aplikohet në Shqipëri. Neni 53 i ligjit 84/2016 (Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë), përcakton: *“Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim”*.

Parimi i transparencës është një nga parimet kryesore dhe jetike në funksionimin e një organi administrativ në një shtet të së drejtës, përfshirë parimin e një procesi të rregullt ligjor, parimin e barazisë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Sipas këtij parimi, të gjithë palët e interesuar dhe publiku duhet të kenë qasje të barabartë në burimin e të dhënave.

Në një shtet demokratik, sjellja e organeve administrative, (përfshirë këtu KPK-në si një organ administrativ /“Quasi Gjyqësor”, por që zhvillon hetim të mirëfilltë administrativ), duhet të jetë transparente dhe e hapur. Çështjet duhet të mbahen sekret ose konfidenciale vetëm në raste të veçanta, si në rastet kur ndikohet me të vërtetë siguria kombëtare ose çështje të ngjashme, por edhe në keto raste duhet të bëhet i qartë ky fakt. Parimi i transparencës së organit administrativ i shërben dy qëllimeve specifike, mbrojtjes së interesit publik sepse pakësojnë mundësinë e keqadministrimit dhe dyshimeve për korrupsion dhe mbrojtjes së të drejtave individuale. Në këto kushte, cënimi i këtij parimi do të sillte, cëmin të vetë procesit të hetimit administrativ. Pra, mungesa e transparencës, sjell cënimin e një procesi të rregullt ligjor, si një parim themelor i së drejtës.

Në lidhje me procesin e rregullt ligjor

Nga monitorimi i seancave dëgjimore në disa raste është evidentuar fakti se trupat gjykuese kanë refuzuar kërkesat e subjekteve të rivlerësimit për paraqitjen e provave të reja, në seancë dëgjimore, me arsyetimin se kanë pasur gjithë kohën e nevojshme për paraqitjen e tyre. Kjo është kushtëzuar kryesisht me faktin se provat që pretendohet të depozitoheshin ishin akte ekspertimi, të kryera privatisht nga ekspertë të marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe binin ndesh me analizën financiare të kryer nga KPK.

Gjithashtu, KPK ka evidentuar faktin se këto prova nuk mund të pranoheshin dhe merreshin në konsideratë nga komisioni, pasi vetë KPK në organikën e tij kishte këshilltarët ekonomik/financiar dhe kjo mjaftonte për këtë proces. Refuzimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për dorëzimin e provave të reja/akt ekspertimi i hartuar nga ekspertë të pavarur, të licencuar, duket se përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Vetë ligji 84/2016 i jep mundësinë komisionit të marrë në konsideratë aktin e ekspertimit dhe ky akt të administrohet në cilësinë e provave. Neni 491/ përcakton: *“Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë: b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku”*.2. *Deklarata e dhënë nga dëshmitari ose eksperti gjatë një procesi penal mund të përdoret në cilësinë e provës”*.

Ajo çfarë e bën shqetësuese veprimtarinë e KPK – së në një rast të tillë është fakti se ky i fundit asnjëherë nuk ka bërë publike metodologjinë e përdorur për realizimin e analizës financiare të subjekteve të rivlerësimit lidhur me kriterin e pasurisë. Mungesa e transparencës lidhur me metodologjinë dhe kriteret e përdorura nga ana e KPK – së për realizimin e analizës financiare të subjekteve të rivlerësimit lidhur me kriterin e pasurisë jo në pak raste ka vendosur në dyshim veprimtarinë e tyre, s’i dhe në shumë raste është bërë edhe shkak për paraqitjen e kërkesave për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues nga ana e subjekteve të rivlerësimit.

Vlerësojmë se bërja publike nga ana e KPK – së të metodologjisë dhe kriterëve të përdorura lidhur me realizimin e analizës financiare do të ishte në të mirë të procesit të rivlerësimit si dhe në funksion të transparencës së veprimtarisë së saj si dhe të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

- Në disa raste ka rezultuar një afat tepër i shkurtër kohor midis datës së depozitimit të propozimeve të subjekteve pas komunikimit të raportit përfundimtar, dhe caktimit të datës së seancës e cila mund të krijojë përshtypjen se këto materiale e shpjegime përfundimtare e përmbledhëse, nuk trajtohen me vëmendjen e duhur nga të tërë anëtarët e trupës. Nga ana tjetër në çdo rast vendimmarrjet e themelit janë shpallur në një seance të ndryshme nga seanca dëgjimore që tregon se trupa ka marrë kohë për të trajtuar çështjen.

- Një moment tjetër i konstatuar nga monitorimi i seancave dëgjimore, si dhe studimi i vendimeve të arsyetuara të KPK, rezulton të jetë, në disa raste çmuarja e provave në mënyrë jo të barabartë për të gjithë subjektet e rivlerësimit. Në disa raste KPK ka arsyetuar se prova të ngjashme janë të

mjaftueshme për të provuar faktet dhe ka vendosur konfirmimin e subjekte në detyrë, ndërsa në raste të tjera i ka konsideruar si të pamjaftueshme për të provuar faktin e pretenduar dhe është vendosur shkarkimi i subjekteve nga detyra. Mbajtja e standarteve të ndryshme dëmton rëndë procesin dhe çënon atë që është thelbi i këtij procesi, rikthimi i besimit të publikut tek drejtësia. Është e vërtetë se gjykata apo trupa quazi gjyqësore ka diskrecion në marrjen e një vendimi dhe se ai është rezultat i një hetimi të gjatë e vlerësimit të më shumë se një fakti konkret, por në çdo rast rezultati duhet të jetë i tillë që të garantojë besimin e gjithkujt që vëzhgon procesin në drejtësinë e vendimmarrjes.

- Gjithashtu evidentohet një moment tjetër që ka të bëjë me vështirësitë apo pamundësinë e disa prej subjekteve të rivlerësimit për të paraqitur të dhëna për një periudhë të gjatë, psh. mbi 20 vjet më parë, në mënyrë të veçantë atëherë kur sistemi bankar nuk ka funksionuar në mënyrën që sot funksionon e kërkojnë të dhënat, kur vetë shteti ka lejuar informalitetin dhe probleme në drejtim të përmbushjes së detyrimeve tatimore (pasi disa dokumenta edhe vetë arkivat e këtyre institucioneve nuk i disponojnë pasi mbajtja dhe ruajtja e tyre kushtëzohet me afate të caktuara dhe provat nuk mund të sigurohen më). Detyrimi i barrës së provës duket se shtrihet përtej mundësive reale të subjekteve por edhe të vetë shtetit. Pyetja që lind natyrshëm është se ku mund të gjendet një provë e cila nuk ekziston në institucionet shtetërore, pasi mund të jetë zhdukur apo djegur nga ngjarjet e vitit 1997 apo të jetë eliminuar nga vetë organet e administratës pasi ka kaluar afati ligjor i mbajtjes dhe ruajtjes së tyre.

Pamundësi në sigurimin e provave paraqesin edhe subjektet apo personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur, të cilët kanë qenë emigrantë dhe mund të kenë punuar në mënyrë informale/në të zezë në një shtet tjetër. Vlerësimi i provave dhe vetë subjektit të rivlerësimit në këtë rast duhet të bëhet në mënyrë proporcionale me gjendjen e diktuar.

Referuar faqes zyrtare të KPK, si mjeti njohës me vendimet e Komisionit dhe arsyetimin e tyre, rezulton:

- Në mjaft raste janë konstatuar vendime të cilat janë arsyetuar dhe publikuar tej afatit ligjor të përcaktuar. Konkretisht, nga 126 vendime të dhëna gjatë vitit 2019 përrreth 55.5% e tyre janë jashtë afatit ligjor të përcaktuar, pra jashtë afatit prej 30 ditësh nga shpallja e vendimit. Nga kjo përqindje, 23% e vendimeve të zbardhura/arsyetuara janë jashtë afatit deri në dy javë nga mbarimi i afatit prej 30 ditësh, 19% janë jashtë afatit prej një muaj, 9.52% janë jashtë afatit prej dy muaj, 4% jashtë afatit prej tre muaj, një vendim zbardhur jashtë afatit prej 3.5 muaj dhe 2 vendime janë jashtë afatit prej 6 muaj. Neni 55/7 e ligjit 84/2016, përcakton: *“Vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit”*. Kjo presupozon që vendimi të jetë i arsyetuar në mënyrë që IKP dhe vetë subjekti i rivlerësimit të njihen me konkludimet e komisionit, në mënyrë që të vlerësohet mbi mundësinë e ankimit dhe shkaqet e ankimit. Janë konstatuar raste ku arsyetimi i vendimeve nga komisioni dhe publikimi i tyre është bërë përtej afatit prej 6 muajve, afat ky përtej arsyes ligjore. Arsyetimi dhe njoftimi i


vendimve tej afateve ligjore sjell zvarritjen e vetë procesit të rivlerësimit. Ndërkohë, duhet evidentuar fakti se gjatë seancave dëgjimore, janë konstatuar raste kur trupat gjykuese e kanë konsideruar si shkelje arsyetimin e vendimeve tej afateve ligjore nga subjektet e rivlerësimit (gjyqtarët). Ndërkohë, institucionet e rivlerësimit duhet të ishin shembull i mirë dhe perfeksioni përballë subjekteve të rivlerësimit, në mënyrë që vlerësimi s'i në aspektin moral dhe atë ligjor të tyre të përballej me seriozitet.

- Lidhur me arsyetimin e vendimeve nga komisioni, megjithëse ka pasur një përmirësim të dukshëm të tyre mendojmë se mund të ketë ende në raste të caktuara nevojë për përmirësim pa hyrë në asnjë rast në thelbin e vendimmarrjeve.


Mirëarsyetimi i vendimeve ka si qëllim tju tregojë palëve pjesëmarrëse në proces se ato janë dëgjuar dhe pretendimet e tyre janë vlerësuar objektivisht, si dhe vetëm përmes një vendimi të arsyetuar mirë mund të realizohet kontrolli publik, pra nëpërmjet transparencës në paraqitjen e provave dhe fakteve. Arsyetimi i vendimeve është një prej elementeve thelbësorë të një vendimi të drejtë. Ai duhet të tregojë qartësisht dhe në mënyrë të detajuar faktet mbi të cilat mbështetet dhe që kanë çuar në një vendimmarrje të tillë. Edhe GJEDNJ i ka dhënë rëndësi të veçantë arsyetimit të vendimeve, duke i konsideruar atë element thelbësor të një vendimmarrje të drejtë, ndësa Neni 6 i KEDNJ detyron gjykatat në arsyetimin e vendimeve të tyre. Elementë të arsyetimit të vendimeve duhet të jenë qartësia e tyre, kuptueshmëria, struktura e qëndrueshme, cilësia e analizës ligjore si dhe të jetë argumentuar mire dhe logjikisht çdo rrethanë e fakt. Elementë këto që duhet të qëndrojnë në mënyrë kumulative në arsyetimin e një vendimi, por që konstatohet se mungojnë në mjaft vendime të komisionit. Kjo merr rëndësi shumë të madhe përse ligji nuk ka parashikuar mundësinë e publikimit të ankimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit, por vetëm ato të bëra nga Komisioneri Publik. Në gjykimin e Avokatit të Popullit një gjë e tillë cënon transparencën e procesit. Është e kuptueshme që publikimi do të duhej të ishte bërë me miratimin e subjektit të rivlerësimit, por mendojmë se do të rriste ndjeshëm krijimin e vlerësimit të drejtë si për vendimmarrjet e KPK ashtu edhe ato të KPA për sa seancat në atë kolegji bëhen në Dhomë Këshillimi në rastet e ankimeve të paraqitura nga subjektet e rivlerësimit, pavarësisht kërkesës së tyre për të zhvilluar seancë të hapur e publike. Kujtojmë këtu se shqyrtimi i ankimeve të bëra nga Komisioneri Publik bëhet gjithnjë me seancë publike dhe ankimet janë të aksesueshme nga publiku.

➤ **Lidhur me vendimmarrjet e IKP mbi ankimet apo mosankimet e vendimeve të KPK**

Lidhur me veprimtarinë e IKP, Avokati i Popullit konstaton se për vitin 2019 janë regjistruar 127 vendime të njoftuara nga KPK, për të cilat ka vendosur ankimin e 13 vendimeve të konfirmimit të marra nga KPK, si dhe ka 114 mosankimime konfirmimi dhe këto. Janë shqyrtuar 127 çështjet e regjistruara, 4 prej tyre janë në proces, si dhe janë regjistruar 361 denoncime nga publiku.



- Nëse i ndajmë mbi bazë gjinore, për efekt studimi, rezulton se gjatë viti 2019 janë regjistruar 127 çështje në total, nga të cilat 87 janë subjekte meshkuj dhe 40 subjekte femra. Ajo që bie në sy, si tek KPK dhe IKP është fakti se nga rastet e konfirmimit në detyrë, rezulton që ky institucion të ketë ankimuar më shumë raste meshkuj, pasi nga 13 ankime 9 prej tyre janë meshkuj dhe 4 femra, e përkthyer në përqindje 30.8% femra dhe 69.2 % meshkuj.




- Gjithashtu rezulton se nga ky institucion nuk bëhen publike arsyet e mosankimit të vendimeve të KPK-së duke mos botuar të plotë vendimet apo aktet përkatëse dhe njohjen e publikut me një vendimmarrje të tillë.

Mos bërja publike e shkaqeve të mosankimit të vendimeve i mohon publikut të drejtën për tu njohur me fatin e denoncimit/ankimit të tij, si dhe nuk bëhet e qartë për publikun pse për disa subjekte vendimi është ankimuar dhe për të tjerë jo.

-Nga monitorimi i seancave publike të zhvilluara në KPA ka pasur pretendime mbi mbajtjen e standardeve të dyfishta, në lidhje me ankimin e vendimeve të KPK-së nga IKP. Gjithashtu referuar vendimeve të arsyetuara të KPK-së dhe KPA-së, si dhe relativitetit të ankimeve gjatë seancave, rezulton se IKP nuk ka qenë rigoroz në vlerësimin e të njëjtave prova e fakte, pasi për raste në njëjtë ka vendosur në mënyra të ndryshme mbi ankimin apo jo të vendimeve. Kjo ka sjellë pasiguri në lidhje me standartin e vlerësimit të ankimit apo të vendimit, si dhe lëkundjen e besimit ndaj institucioneve të krijuara për zbatimin e reformës në drejtësi.

➤ Në lidhje me zhvillimin e seancave publike dhe transparencën në KPA

KPA për vitin 2019 ka regjistruar 60 çështje, nga të cilat, 13 çështje janë ankimuar nga IKP, 47 çështje të ankimuara nga subjektet e rivlerësimit dhe nga këto duhet theksuar se një çështje është ankimuar nga të dy palët. Nga këto çështje, përrreth 24% i përkasin subjekteve femra dhe përrreth 76% subjekteve meshkuj. Gjatë vitit 2019 KPA ka marrë 34 vendime, nga të cilat 23 vendime shkarkimi të KPK-së janë lënë fuqi nga KPA, 8 vendime konfirmimi të KPK-së janë ndryshuar dhe KPA ka vendosur shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit, 2 vendime të KPK-së për konfirmimin në detyrë të subjekteve të rivlerësimit, të ankimuara nga IKP, janë lënë në fuqi nga KPA vetëm pas kërkesës së komisionerit publik për lënien në fuqi të vendimit, si dhe për një vendim është vendosur pushimi i gjykimit. Ndërkohë nuk rezulton të ketë asnjë vendim shkarkimi nga KPK, i ankimuar nga subjektet rivlerësimit që të jetë ndryshuar dhe KPA të ketë vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Nga të dhënat statistikore që disponojmë duket se dhe ky institucion rivlerësimi ka ritëm mjaft të ulët, në procesin e rivlerësimit të subjekteve dhe nëse ecën me këto ritme do të duhej kohë shumë më e gjatë se ajo e parashikuar në ligjin 84/2016 , për përfundimin e procesit.



Është e vështirë në fakt të bëhet një parashikim në këtë rast, se sa do të zgjaste procesi i rivlerësimit, nëse procedohet me këto ritme, pasi nuk mund të parashikohet numri i vendimeve të konfirmimit të KPK-së të cilat nuk do të ankimohen nga IKP apo ato të shkarkimit të subjekteve që mund të ankimohen nga vetë subjektet. Por një gjë është e sigurtë, që procesi në këtë institucion po ecën me ritme shumë të ngadalta. Duke ju referuar çështjeve të regjistruara për vitin 2019 (60 çështje) dhe vendimmarrjes prej 34 vendime, duket se jemi shumë larg ritmeve me të cilat ky institucion duhet të ecë. Ndërsa në total, që nga fillimi i procesit, janë regjistruar pranë KPA 100 çështje dhe janë dhënë 51 vendime, pra përrreth gjysma e çështjeve të regjistruara janë përfunduar, e shprehur në përqindje 51% e tyre janë përfunduar.

Edhe ky institucion ashtu sikurse edhe KPK nuk ka bërë publike metodologjinë e përdorur për realizimin e analizës financiare të subjekteve të rivlerësimit lidhur me kriterin e pasurisë, s'i dhe ka refuzuar tua vendosë në dispozicion subjekteve të rivlerësimit analizën e hollësishme të pasqyrës financiare me pretendimin se ishte konfidenciale dhe se ishte për përdorim të brendshëm vetëm nga KPA.

Ne vlerësojmë se KPA e cila është vlerësuar si gjykatë në rastet e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga ana e subjekteve të rivlerësimit duhet të zbatojë në mënyrë rigoroze kërkesat e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke i garantuar për këtë qëllim subjekteve të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe në përputhje me standartet e vendosura nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

- Gjatë seancave publike të zhvilluara nga KPA, disa subjekte kanë paraqitur kërkesë për depozitimin e një akt ekspertimi që pasqyrojnë të dhëna të ndryshme nga analiza financiare e hartuar nga ky institucion, si dhe është kërkuar thirrja e ekspertëve të pavarur për vlerësimin e përfundimeve të arritura nga ana e punonjësve të KPA – së të cilët kanë hartuar pasqyrat financiare lidhur me kriterin e pasurisë. Këto kërkesa nuk janë pranuar me arsyetimin se analiza financiare ishte realizuar nga ana e punonjësve të kësaj të fundit dhe kjo mjaftonte. Ne vlerësojmë se një vendimmarrje e tillë vjen në kundërshtim me parimet për zhvillimin e një procesi gjyqësor të drejtë dhe të rregullt. Vetë ligji 84/2016 parashikon mundësinë e marrjes dhe pranimin të provave me ekspertë.

Gjithashtu nga ana e KPA – së në veprimtarinë e saj janë konstatuar mangësi lidhur me unifikimin e kriterëve bazë dhe metodologjisë mbi të cilat do të bëhet vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit nga ana e KPK – së si organ më i ulët. Ne vlerësojmë se përmbushja e detyrës nga ana e KPA – së, në përputhje kjo me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016, për unifikimin e kriterëve bazë dhe metodologjisë që duhet të zbatohet për vlerësimin e subjekteve të rivlerësimit do të evitonte zbatimin e standarteve të shumëfishta si nga ana e KPK – së ashtu edhe nga ana e IKP – së.

Ashtu sikurse KPK edhe KPA paraqitet problematike në lidhje me vendimet të cilat janë arsyetuar dhe publikuar tej çdo afati të arsyeshëm ligjor. Vërtetë ligji nuk ka parashikuar afat ligjor për arsyetimin dhe publikimin e vendimeve të KPA-së, por kjo gjë është rregulluar nga rregullorja e

brendshme “Për veprimtarinë e KPA të Gjykatës Kushtetuese”, e cila parashikon se kryesuesi i trupit gjykues merr masa për të garantuar zbardhjen e vendimit, brenda një afati prej 60 ditësh.

Arsyetimi dhe shpallja me vonesë e vendimeve gjyqësore ka qenë shpesh objekt trajtimi nga Gjykata Kushtetuese në vite, e cila është shprehur se shpallja e vendimeve të arsyetuara me vonesë bie ndesh me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor/gjyqësor.

Edhe GEDNJ është shprehur lidhur me këtë çështje, duke e konsideruar kohëzgjatjen e arsyetimit të vendimit si pjesë e të gjithë procesit gjyqësor, që nga fillimi i tij e deri në arsyetimin përfundimtar të vendimit. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar con në cënimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e ngritura pikërisht për këtë qëllim, rikthimin e besimit të tyre tek institucionet e drejtësisë. Magna Carta, deklarata e të drejtave të njeriut parashihte se një drejtësi e vonuar është e barabartë me një drejtësi të mohuar.

➤ *Solemniteti i seancave dëgjimore dhe atyre publike*

Seancat dëgjimore dhe publike, të zhvilluara pranë KPK dhe KPA paraqesin nivel optimal solemniteti përse i përket aspektit logjistik, komunikimit dhe menaxhimit të punës mes koordinatorëve për mediat në këto institucione dhe subjekteve të rivlerësimit, medias dhe publikut të pranishëm.

Seancat janë publike në të dy institucionet e rivlerësimit. Gjithashtu dhe trupat gjykuese paraqesin etikë profesionale dhe komunikim në nivele të kënaqshme me subjektet e rivlerësimit, median dhe publikun e pranishëm. Drejtimi i procesit administrativ dhe atij gjyqësor ka qenë në nivele të kënaqshme përse i përket drejtimit të sallave, por ka vend për tu përmirësuar në drejtim të orientimit drejt debatit gjyqësor dhe atij publik. Në mjaft raste kryesuesit e seancave duket se nuk kanë arritur të mbajnë brenda natyrës së seancës qëndrimet e disa prej vëzhguesve, që në disa raste kanë qenë dukshëm në kapërcim të kompetencave që ligji përcakton. Sigurisht rregullat për të pasur një seancë publike që të garantojë faktin se vendimmarrja do të jetë objektive dhe se seanca dëgjimore është efektive janë të vlefshme për çdo pjesëmarrës me të drejtë fjale në seancë.

Ndërsa, përse i përket ambjenteve ku zhvillohen seancat dëgjimore pranë KPK është në nivele të kënaqshme dhe e pranueshme. Ndërsa ambjenti pranë KPA nuk përmbush standartet e një ambjenti normal pasi hapësira është shumë e vogël dhe për pasojë mund të kufizojë numrin e pjesëmarrësve dhe shpesh është e tejmbushur.

Paraqitja e këtij raportimi konçiz si pjesë e raportit vjetor të punës së Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2019 erdhi si nevojë e faktit se reforma në drejtësi tashmë është në fazën e realizimit konkret të qëllimeve të saj. Ndërsa 90 përqind e organeve të reja të sistemit të drejtësisë u ngritën, me emërimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka nisur faza e vlerësimit konkret të funksionimit të kësaj ngrehine të re, pra të një drejtësie që duhet të përmbushë kriteret e paanësisë, përgjegjshmërisë, llogaridhënies, transparencës e të shërbejë si model i mirëfunksionimit të

mekanizmave shtetërore. Përprojekta dhe investimi i të gjithë shoqërisë sonë duhet të justifikojë maksimalisht besimin e qytetarëve. Ky besim duhet të garantohet në çdo ditë të veprimtarisë të organeve të reja të sistemit të drejtësisë në përgjithësi, por edhe të organeve të procesit kalimtar të verifikimit si organe që mund të konsiderohen të konsoliduara në ushtrimin e mandatit të tyre, çka edhe e kanë treguar me një nivel të lartë përgjegjeshmërie dhe duke krijuar tashmë qartësisht besimin se hetimi do të jetë i thellë dhe i gjithanshëm, pa lënë asnjë aspekt të jetës së subjektve të procesit të verifikimit pa vlerësuar. Është e kuptueshme që kjo është një punë e vështirë dhe me shumë përgjegjësi por që duhet të vijojë, të tregojë e garantojë se llogaridhenia nuk është vetëm detyrë e subjekteve të rivlerësimit; përgjegjshmeria e zbatimi i standarteve të njëjta tashmë duhet të kthehet në kulturën e çdo organi të sistemit të drejtësisë në vend.

Këto gjetje paraprake dhe të dhëna statistikore po i paraqesim në këtë raport me qëllimin e paraqitjes dhe mbledhjes së sa më shumë të dhënave dhe mendimeve për të siguruar rigorozitetin e zbatimit të Reformës në Drejtësi dhe për të ruajtur qëllimin e saj madhor, kthimin e besimit të qytetareve tek sistemi i drejtësië por edhe ruajtjen e entuziasmit për këtë reformë e cila ka pasur në vend një konsensus tepër të gjërë.

Standardi kaq i lartë i zbatimit të ligjit, i vendosur nga organet e rivlerësimit kalimtar për cënimin apo jo të besimit të publikut duhet në mënyrë të pashmangshme të tregohet se është i vërtetë edhe për vetë anëtarët e këtyre organeve e jo vetëm për të tretët. Ky standard përse u përqaftua me entuziazëm nga i tërë opinioni publik kombëtar e ndërkombëtar duhet të përbëjë mënyrë jetese për të tërë shoqërinë shqiptare por edhe ushtruesit e mandateve të monitorimit në vend. Nga ana tjetër, niveli profesional dhe njohuritë e thelluara në fushën përkatëse të pjesës dërmuese të subjekteve të kualifikimit e bëjnë edhe më të vështirë këtë sfidë që mund të fitohet vetëm me integritet të lartë e të pacënuar. Kjo është një reformë tepër komplekse, shumë e thellë, e për këtë shkak dhe me jo pak debate. Ajo që duket ka ardhur koha të bëjmë, është vlerësimi në praktikë i rezultateve të saj, duke analizuar se a kemi sot një drejtësi më të mirë dhe një garanci më të lartë për të luftuar pandëshkueshmërinë e garantuar të drejtat e liritë e individit, apo thjeshtë kemi eroduar pavarësinë e sistemit gjyqësor.

Puna e institucionit do të vijojë e rezultatet do të paraqiten në vijim te ju në formën e një raporti të veçantë.

4.6. Raporte sintezë për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit në fushën e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijës ka hartuar disa raporte sintezë si vijon:

- Fëmijët në emigracion në këndvështrimin e Shqipërisë si vend tranziti/destinacioni.
- Procedurat e ndjekura nga institucionet gjithëpërfshirëse në nivel qendror dhe vendor për trajtimin e fëmijës viktimë të abuzimit seksual.

- Trajtimi i të miturve në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitar nga institucionet përgjegjëse të administrimit të drejtësisë penale për të mitur.

Raporti sintezë për fëmijët migrantë

Institucioni i Avokatit të Popullit është pjesë e Rrjetit të Europës Juglindore të Ombudspersonit për të Drejtat e Fëmijës (CRONSEE). Misioni i rrjetit është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në zbatim të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve¹⁰⁰. Për vitin 2019, tema e përbashkët e punës ishte “Të drejtat e fëmijëve migrantë”. Përzgjedhja e temës nga rrjeti ka ardhur si rezultat i vulnerabilitetit të këtij *target* grupi sot në Europë. Ky grupim përballet me procedura sfiduese dhe komplekse në përputhje me vlerësimin e kërkesave të tyre për t’u garantuar mbrojtje, mbështetur në legjislacionin vendas dhe atë të huaj.

Avokati i Popullit ndërmori disa inspektime në qendrat e azilkërkuesve, (pjesë e grupit të inspektimeve ishin edhe burimet njerëzore të siguruar nga marrëveshja e bashkëpunimit, ndërmjet Avokatit të Popullit dhe UNICEF-it në përfundim të të cilave, institucioni ynë adresoi edhe rekomandimet për institucionet e administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor¹⁰¹.

Theksojmë, se përafrimi i legjislacionit të migracionit me *acquis* të BE-së dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria vazhdon. Vendi ynë ka një nivel shumë të lartë të ratifikimit të konventave ndërkombëtare¹⁰² në fushën e migracionit, megjithatë statusi i zbatimit të tyre dhe ndikimi në të drejtat e migrantëve mbetet ende në nivele të vagëta.

Ndër gjetjet më kryesore të këtij raporti përmendim:

- sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri vazhdon të funksionojë i fragmentizuar¹⁰³, çka zvogëlon rezultatet për mbrojtjen e fëmijëve në mënyrë të qëndrueshme, sistematike dhe gjithëpërfshirëse;
- mungesës së shërbimeve të veçanta për këtë kategori;

¹⁰⁰Miratur me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”.

¹⁰¹Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Gjirokastër dhe në pikën kufitare pritëse të emigrantëve në Kakavijë, Gjirokastër.

¹⁰² Shqipëria ka ratifikuar Konventat e mëposhtme në fushën e migracionit:

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjes së Tyre (ICRMÉ)- 2007;

Konventa në lidhje me statusin e refugjatit- 1992;

Konventa për të drejtat e fëmijës (CRC)- 1992;

Konventa e ILO-s për Migracionin për Punësim (Rishikuar), 1949 (nr.97)-2005;

Konventa e ILO për Punëtorët Migrantë (Dispozita Plotësuese), 1975 (nr.143)- 2006;

Konventat për Pashtetësi- 2003;

Konventa Europiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë-2007;

Konventa Europiane për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal-2005

¹⁰³Sistemi bazohet në dy mekanizma shumë të rëndësishëm në atë të mbrojtjes së fëmijëve me në qendër fëmijët që janë abuzuar ose në rrezik për t’u abuzuar dhe në mekanizmin kombëtar të referimit, i cili ka në qendër fëmijët viktimat/viktima të mundshme të trafikimit. Këta mekanizma nuk bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- shërbimet ekzistuese nuk ju përgjigjen nevojave të fëmijëve migrantë të pashoqëruar dhe nuk janë të përshtatura sipas nevojave individuale të tyre;
- mungesa e kapaciteteve të burimeve njerëzore që punojnë në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, sipas përcaktimeve në legjislacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e fëmijës në interesin më të lartë të tij;
- mungesa e veprimtarive të edukimit në vazhdimësi për ngritjen profesionale të profesionistëve që punojnë me fëmijët në sistemin e mbrojtjes së fëmijës.

Avokati i Popullit në rekomandimet kryesore, adresuar për institucionet shtetërore përgjegjëse, lidhur me situatën e fëmijëve migrantë, i ka kushtuar rëndësi të veçantë dhe ka kërkuar marrjen e masave për:

- përcaktimin e strukturës përgjegjëse në legjislacionin vendas që do të mundësojë rolin e kujdestarit ligjor si garanci për zbatimin e të drejtave të fëmijëve migrantë të pashoqëruar;
- zbatimin korrekt dhe “*de facto*” në praktikë të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” për ofrimin e ndihmës juridike në institucionet e administratës shtetërore për azilkërkuesit;
- garantimin e së drejtës për arsim për fëmijët migrantë;
- hartimin dhe miratimin e Procedurave Standarde Operative për Veprim të fëmijëve të huaj të pashoqëruar;
- ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve;
- ngritjen e shërbimeve të specializuara për fëmijët migrantë të pashoqëruar në nivel kombëtar;
- përfshirjen në strukturat e personelit në Drejtoritë Vendore të Kufirit dhe Migracionit specialist të shkencave shoqërore (psikolog, punonjës socialë);
- protokolle të standardizuara gjatë pritjes fillestare të fëmijëve të pashoqëruar për referimin e tyre drejt shërbimeve gjithëpërfshirëse në interesin më të lartë për ta.

Raporti për monitorimin e punës së organeve kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit për vitin 2019, ndërmjet Avokatit të Popullit dhe UNICEF

Në përputhje me standardet ndërkombëtare për administrimin e drejtësisë penale për të mitur në funksion të garantimit dhe të respektimit të interesit më të lartë të fëmijës në procesin penal është miratuar një ligj i veçantë, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregullat procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ka hyrë në fuqi në 1 janar 2018 dhe afati kohor, i parashikuar në ligj për miratimin e paketës së akteve nënligjore në zbatim të tij është konstatuar një problematikë e shtuar për mungesën e zbatimit korrekt në praktikë të Kodit. Ky shqetësim i yni është prezantuar në mënyrë të vazhduar, qoftë në raportinvjetor për vitin 2018 të institucionit të Avokatit të Popullit, qoftë në takimet e tryezat e punës, organizuar nga institucionet shtetërore, shoqëria civile apo organizatat ndërkombëtare. Tash, ky shqetësim është i qenësishëm edhe për vitin 2019 por në një tjetër këndvështrim, atë të miratimit “de jure” të shumicës së akteve në zbatim të Kodit dhe mungesës “de facto” të aplikueshmërisë e zbatimit të tyre në praktikë.”

Në vijim¹⁰⁴ janë inspektuar disa prej institucioneve që trajtojnë të mitur në kushtet e privimit të lirisë si: Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe 6 komisiaritet që përfshin kjo drejtori në nivel vendor si dhe IEVP Shën Koll (Lezhë) dhe IEVP Kavajë në nivel kombëtar.

Ndër gjetjet kryesore që rezultojnë nga monitorimi janë si vijon:

- gjatë muajve maj-qershor 2019 ka rezultuar, se janë gjithsej 33 të mitur të shoqëruar në këto institucione, 27 të mitur të privuar nga liria, saktësisht, 24 të mitur janë nën masën “Arrest me burg” dhe 3 të dënuar me vendim përfundimtar të dhënë nga gjykata e rrethit gjyqësor;
- nuk është konstatuar e afishuar lista e përfaqësuesve proceduralë për të miturit në konflikt me ligjin¹⁰⁵;
- periudha e ndalimit/shoqërimit është e shkurtër, varion 3-4 orë;
- kohëzgjatja e paraburgimit është zakonisht më e gjatë (duke filluar nga 3 muaj deri në një vit), duke bërë që shumë të mitur në konflikt me ligjin të përfundojnë dënimin, ndërkohë që janë në paraburgim në pritje të dënimit përfundimtar;
- ka ndarje të plotë nga të rriturit;
- në disa prej komisiariateve përdoren zyra të administratës ose zgjidhje të çastit për të siguruar ndarjen;
- në IEVP Shën Koll (Lezhë) është mbyllur seksioni për të miturit e privuar nga liria në zbatim të rekomandimit të AP në vitin 2016¹⁰⁶;
- IEVP Kavajë siguron një ndarje të plotë, madje edhe ndarje gjinore;
- sipas të dhënave të punonjësve të intervistuar të miturve u lejohet të kontaktojnë familjarët¹⁰⁷;
- mungesa e një regjistri të posaçëm, ku mbahen të dhënat vetëm për të mitur¹⁰⁸;
- sigurimi i vakteve ushqimore apo uji i pijshëm;

Në intervistat e realizuara me stafin e IEVP Kavajë dhe kontrollit të dokumentacionit, rezulton se të miturit e privuar nga liria kanë patur një sjellje të mirë. Gjatë kësaj kohe nuk ka patur raste të

¹⁰⁴Në zbatim të marrëveshjes e bashkëpunimit me UNICEF, nr.276 prot, datë 31.5.2019, me qëllim realizimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve 2019-2020, gjatë periudhës maj-qershor 2019.

¹⁰⁵ Siç parashikohet në nenin 49, pika 4 të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e Fëmijës”.

¹⁰⁶Raporti i AP-së “Me zërin e të miturve të privuar nga liria”, faqja 61, dhjetor 2016.

¹⁰⁷Në IEVP Kavajë, psh fëmijëve u lejohet dhe biseda përmes aplikacionit “Skype”.

¹⁰⁸Në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të punës në shtetet anëtare të BE-së.

sjelljeve agresive të të miturve me njëri-tjetrin apo drejt punonjësve të IEPV Kavajë, situata të cilat do të çonin në marrjen e masave të ndryshme disiplinore¹⁰⁹. Gjithashtu, mbështetur në legjislacionin në fuqi¹¹⁰ për garantimin e arsimimit të të miturve në konflikt me ligjin në IEPV Kavajë në mënyrë specifike për nivelin e mesëm arsimor, ky proces nuk është realizuar. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së burimeve njerëzore të IEPV Kavajë për të bërë të mundur shoqërimin e këtyre të miturve në institucionet e edukimit si dhe marrëdhënieve jo të konsoliduara me zyrën arsimore, Kavajë.

Avokati i Popullit konstaton me shqetësim, se ende edhe sot nuk është ngritur “*de facto*” dhe nuk ka filluar nga funksionimi “Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”¹¹¹. Po kështu nuk ka filluar të funksionojë as institucioni i Edukimit dhe Rehabilitimit të të Miturve¹¹², sikundër edhe Sistemi Elektronik i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur¹¹³.

Duhet pranuar se privimi i lirisë, duhet të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për periudhën më të shkurtër. Qëllimi përfundimtar i paraburgimit është rehabilitimi, riedukimi dhe integrimi i të miturit në shoqëri. Ndaj, duhet të punohet më shumë drejt realizimit të këtij procesi të rëndësishëm.

Në përfundim në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës dhe administrimit të drejtësisë penale për të mitur, drejt një qasjeje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor për zbatimin korrekt të këtij legjislacioni, insititucioni i Avokatit të Popullit, adresoi organeve kompetente të administrimit të drejtësisë penale për të mitur rekomandimet si vijon:

- Komisaritet e policisë nuk kanë lehtësira specifike të nevojshme për intervistimin dhe qëndrimin e fëmijëve në përputhje me procedurat standarde ndërkombëtare¹¹⁴. Këto lehtësira duhet të sigurojnë standardet e kërkuara të ndriçimit natyror të ajrimit natyror, higjenës dhe ngrohjes si dhe kushte të veçanta për shkak të cenueshmërisë dhe nevojave të fëmijëve, sidomos vajzave.
- Komisaritet e policisë të pajisen me një regjistër të posaçëm vetëm për të miturit në konflikt me ligjin.
- Të miturit duhet të kenë më shumë akses në materiale të shkruara ose vizive për rritjen e vetvlerësimit dhe materiale informuese për institucionet që mbrojnë të drejtat e tyre.

¹⁰⁹ Neni 125, i ligjit nr.37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

¹¹⁰ Urdhëri nr.3348/1, datë 18.4.2018, i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

¹¹¹ Në mbështetje të pikës 4 të nenit 133, ligjit nr.37/2017 “Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur” është miratuar vendimi nr.314, datë 15.5.2019, i Këshillit të Ministrave, i cili ende nuk ka gjetur zbatim në praktikë.

¹¹² Vendimi nr.233, datë 17.4.2019, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit e të rehabilitimit në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve”.

¹¹³ Shih nenin 136 të ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

¹¹⁴ Kjo procedurë duhet të kryhet në bashkëpunim dhe bashkërendim të punës në përputhje edhe me përcaktimet e bëra në nenin 35 të ligjit nr.37/2017.

- Vënien në funksionim të “Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”¹¹⁵ të institucionit të Edukimit dhe Rehabilitimit të të Miturve¹¹⁶, sikundër edhe të Sistemit Elektronik të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Ndërkohë që në zbatim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Drejtësisë¹¹⁷ dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të garantuar arsimimin e nivelit të ulët të mesëm dhe/apo të lartë për të miturit në konflikt me ligj si dhe miratimin e udhëzimit¹¹⁸ të përbashkët, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal¹¹⁹, këto rekomandime janë zbatuar plotësisht nga organet shtetërore përgjegjëse.

Ajo që kërkohet në mënyrë të vijueshme nga AP në të gjitha rekomandimet e tij, jo vetëm në kuadër të zbatimit të legjislacionit të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, është, se shteti duhet të dedikojë buxhete të mjaftueshme e të veçanta për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës. Gjithashtu edhe për sa i takon bashkëpunimit, koordinimit dhe bashkërendimit institucional, profesionistët në sistemin e drejtësisë në shërbimet sociale, ata që kujdesen për shërbimet e akomodimit dhe shërbimet e shëndetësisë, duhet të punojnë bashkë dhe të përpiqen të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për të miturit në konflikt me ligjin.

Dënimi me burgim si masë e fundit për të miturit në konflikt me ligjin nuk duhet parë si qasje ndëshkuese apo penalizuese. Programet e rehabilitimit e riintegrit, duhet të jenë pjesë e punës së profesionistëve që punojnë me këta fëmijë, me qëllim krijimin e konsolidimit të një sistemi që i rrit dhe i zhvillon si qytetarë të përgjegjshëm e me norma.

4.7. Raporti i monitorimit për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe respektimin e të drejtave të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar

Hartimi i “Raportit të monitorimit për shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe respektimin e të drejtave të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar”, përbën një nga risitë e punës së

¹¹⁵ Mbështetur në vendimin nr.314, datë 15.5.2019 Këshillit të Ministrave dhe të nenit 6 të ligjit 90/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”

¹¹⁶ Vendimi nr.233, datë 17.4.2019, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit e të rehabilitimit në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve”.

¹¹⁷ Miratuar me urdhër të përbashkët nr. 3348/1 datë 18.4.2018 të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

¹¹⁸ Mbështetur në pikën 4, nenin 49 të ligjit nr.18.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

¹¹⁹ Ky rekomandim i AP, konstatohet se është miratuar së fundmi, konkretisht udhëzimi nr.650, datë 13.9.2019, i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky udhëzim duhet t’u bëhet i njohur dhe strukturave vendore të policisë së shtetit, prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të apelit përkatës.

Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe konsiderohet si një e dhënë, e cila evidenton konsolidimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile¹²⁰ për vitin 2019.

Në kontekstin e monitorimit, se si ofrohen shërbimet sociale për grupet në nevojë në nivel vendor për bashkitë Kukës, Elbasan, Librazhd, Fier, Berat dhe Pogradec, raporti përmban gjetje konkrete, evidenton problematikat me të cilat ballafaqohen qytetarët në ofrimin dhe shpërndarjen e ndihmës ekonomike nga organet e pushtetit vendor dhe përfshin në përmbajtjen e tij, rekomandime konkrete, përkatësisht për organet e qeverisjes qendrore dhe vendore për adresimin adekuat dhe tejkalimin e problematikave të konstatuara.

Rekomandimet drejtuar organeve të qeverisjes vendore konsistojnë në sa më poshtë vijon:

- Rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve për kriteret, procedurat dhe plotësimin e dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike.
- Lehtësimin e procesit të aplikimit për të qenë pjesë e skemës së përfitimit të ndihmës ekonomike, përmes rritjes së bashkëpunimit të strukturave vendore me grupet në nevojë.
- Marrjen e të gjithë hapave dhe procedurave të nevojshme për përfitimin/ofrimin në kohë nga organet e pushtetit vendor të ndihmës ekonomike.
- Përmirësimin e instrumenteve informues për mekanizmat e ankimimit për të denoncuar problemet në lidhje me ofrimin e ndihmës ekonomike.
- Marrjen e masave për të adresuar në kohë dhe në mënyrën e duhur të ankesave të qytetarëve për përfitimin e ndihmës ekonomike.
- Forcimin dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për të verifikuar fizikisht banesat dhe kushtet e jetesës të përfituesve një apo dy herë në vit, siç parashikohet në ligj.
- Shmangien e rasteve të përjashtimit nga përfitimi i ndihmës ekonomike të familjeve pretenduese, kur familja ka në përbërjen e saj anëtar, person me aftësi të kufizuara.
- Shpërndarja në kohë e pagesës së ndihmës ekonomike të përfituesve nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në masën 6%.
- Ofrimin e shërbimeve shoqërore të cilat do të rrisin cilësinë e jetës të qytetarëve, përfitues të ndihmës ekonomike dhe familjeve të tyre.
- Mbështetjen dhe orientimin e qytetarëve që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike për të aplikuar në programet sociale, ku përfituesit e ndihmës ekonomike të përfshihen, duke dhënë kontribut me punën e tyre dhe kjo të influencojë në rritjen e të ardhurave të familjeve të tyre.

Rekomandimet drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes, kujdesit dhe integritetit të individëve dhe grupeve në nevojë janë renditur si më poshtë:

¹²⁰Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (ALTRI) bashkëpunoi me Avokatin e Popullit, në zbatim të projektit “Monitorimi dhe promovimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale të grupeve në nevojë në nivel kombëtar dhe lokal”. Ky bashkëpunim synonte përmirësimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë në nivel lokal, përmes forcimit të rolit monitorues të institucionit të Avokatit të Popullit dhe përfshirjes së grupeve në nevojë në këtë proces.

- Rishikimin në tërësi të formularit të aplikimit, sipas sistemit të pikëzimit, specifikisht për kategorinë e personave që janë mbi moshë pune dhe nuk janë përfitues të asnjë lloj pensioni pleqërie (mosha 60-70 vjeç).
- Rritjen e transparencës, barazisë dhe përcaktimin e kritereve objektive të përzgjedhjes për individët që përfitojnë ndihmë ekonomike.
- Rritjen e shumës së përfituar të ndihmës ekonomike për të përballuar shpenzimet mujore më të domosdoshme që i duhen familjes, ose një individ të vetëm për të mbijetuar.
- Nevojën për ofrimin e kurseve të formimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës për personat që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike dhe përmirësimi i cilësisë së tyre¹²¹.

Sjellim në vëmendje se rekomandimet e sipërcituara janë marrë në konsideratë nga organet e administratës shtetërore në nivel lokal, ndërsa në nivel qendror evidentohet mungesa e angazhimit të këtyre të fundit për zbatimin e tyre.

4.8 Konferenca vjetore

Konferenca Vjetore e Avokatit të Popullit për vitin 2019 u organizua në datën 20 dhjetor, me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë në kuadër të programit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Europës- “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2020”.

Duke qenë se në kohët e sotme është vërejtur një rritje e përdorimit të "gjuhës së urrejtjes" e cila mund të kërkojë veprim që nënkupton zbatueshmërinë e përgjegjësisë sipas legjislacionit civil dhe administrativ apo edhe të drejtës penale por edhe nismave të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerësoi që në Konferencën vjetore të vitit 2019 të trajtojë temën: *“Liri pa urrejtje, Liria e shprehjes përballë të drejtave të tjera të njeriut”*.

Fjala e lirë nuk është thjesht një rëndësi themelore për shoqëritë demokratike por është një nga të drejtat më themelore të një individ që mundëson atë të formojë dhe zhvillojë mendimet dhe nëkëtë mënyrë të shprehë vetveten. Megjithatë, liria e shprehjes nuk është absolute, ajo mund të jetë subjekt i kufizimeve të caktuara. Shumica e shteteve demokratike vendosin kufizime për disa forma të caktuara të shprehjes në varësi të kontekstit politik dhe historik. Ndonëse neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut përcaktojnë, se *“çdo kush ka të drejtën e shprehjes”* të njëjtat nene parashikojnë mundësinë e ndërhyrjeve të caktuara në këtë të drejtë në mënyrë që shtetet mund të vendosin në mënyrë të ligjshme kufizime për shembull për të mbrojtur të drejtat e tjera ose interesa më thelbësore.

¹²¹Kjo pikë rekomandohet për Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

Në këtë kontekst, çështja që shtrohet për diskutim është se në çfarë forme e në çfarë mase mund të ushtrohet liria e shprehjes pa arritur kufijtë e asaj që njihet si gjuha e urrejtjes? Cilat janë kufizimet në lirinë e shprehjes? Në lidhje me këto dhe çështje të tjera të mprehta, personalitete, ekspertët e fushës të ftuar dhe studiues të tjerë, ndanë mendimet dhe eksperiencat e tyre në Konferencën Vjetore të Avokatit të Popullit.

Konferenca u hap nga Avokatja e Popullit znj. *Erinda Ballanca* e cila vuri theksin në rëndësinë që ka liria e shprehjes për një shoqëri demokratike dhe rreziqet e kontrollit të saj. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. *Ilir Meta* gjatë fjalës së tij theksoi se “*Liria e shprehjes dhe e drejta e informimit përveç se janë të drejta themelore kushtetuese janë të lidhura ngushtësisht edhe me ndërtimin e një shteti demokratik. Ndaj liria e shprehjes është tregues i nivelit të demokracisë, qeverisjes së mirë dhe përgjegjësisë publike në vend*”. Në fjalën e tij Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. *Gramoz Ruçi*, theksoi ndërmjet të tjerash se “*Masivizimi dhe demokratizimi i medias i cili nxitet e mbështetet edhe nga teknologjitë e avancuara është ndër arritjet më të mëdha të qytetërimit të sotëm, por demokratizimi i medias dhe i teknologjisë, përveç vlerave dhe dobisë së pallogaritshme për shoqërinë dhe zhvillimin, përmbajnë në vetvete edhe disa rreziqe që mund t’i sjellin shoqërisë dhe qytetarëve përdorimi i papërgjegjshëm i këtyre të mirave publike*.” Në këtë kuadër, z. *Ruçi* theksoi “*...rëndësinë e vetërregullimit të tregut të medias, një vetërregullim, i cili nuk mund të garantojë mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe dinjitetit të qytetarëve pa plotësimin prej rregullimit prej shtetit... ”*.

Kreu i Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, znj. *Jutta Gützkow* përshëndeti të pranishmit dhe u ndal në iniciativën më të fundit të paketës ligjore mbi mediat duke theksuar se “*Pavarësisht racionale pas kësaj iniciative, instrumentet e prezantuara në këtë paketë ngrejnë shqetësim mbi përputhshmërinë me standardet e Këshillit të Europës apo praktikat Europiane...*” si dhe ritheksoi se Këshilli i Europës është i gatshëm të mundësojë opinion legal mbi kornizën ligjore në kuadër të “Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”.

Z. *Brian Williams*, Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri u fokusua në fjalën e tij tek rreziku i gjuhës së urrejtjes ndaj minoriteteve duke sjellë një këndvështrim tejet interesant të konceptit të lirisë së shprehjes. “*Një tjetër dukuri që haset dendur në Shqipëri është dhuna ndaj grave. Gjuha e urrejtjes karshi grave është dhunë ndaj tyre. Gjuha e urrejtjes është drejtpërdrejt dëmtuese ndaj grave që shënjestron, ndoshta duke shkaktuar dëm psikologjik, ndoshta duke frenuar mundësitë e tyre, ndoshta duke shkaktuar një ndjenjë vetë-censurimi të veprimeve, gjë që është dekurajuese. Po ashtu gjuha e urrejtjes krijon një mjedis ku mund të ndodhë dhuna e vërtetë. Në Shqipëri kemi të dhëna të pamjaftueshme rreth gjuhës së urrejtjes drejtuar ndaj grave. Do të donim që të shikonim Qeverinë, zyrën e Avokatit të Popullit, shoqërinë civile dhe të tjerët, që të ndërmerrnin më shumë veprime*”, u shpreh ai.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga i Ngarkuari me Punë i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, z. *Daniel Koski*, i cili theksoi se “*...liria e shprehjes nuk është një licencë që të flasim çfarë të duam pavarësisht pasojave. Nuk është e lehtë që të vendosim kufirin midis gjuhës së*

pranueshme dhe gjuhës që provokon dhunë, ndaj jemi sot këtu për tëurvejuar kufijtë e lirisë së shprehjes...”.

Aktiviteti vazhdoi me diskutime në dy sesione që kishin qëllim të analizonin dhe mundësonin qasje të thelluara rreth nocionit të luftës ndaj gjuhës së urrejtjes në perspektivën e anti-diskriminimit. Sesiioni i parë i Konferencës u hap nga z. Dorian Pavli, Gjyqtar në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut, ndërkohë që ky panel përbëhej dhe nga znj. Klotilda Bushka, Sekretare e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, z. Sami Neza, Zëvendës/Kryetar në Autoritetin e Mediave Audiovizive si dhe z. Kloreto Cukali, drejtues i Këshillit Shqiptar të Medias. Në këtë kontekst, pjesëmarrësit prekën çështje të rëndësishme që lidhen me lirinë e shprehjes si dhe mekanizmat rregullues dhe vetërregullues të medias duke ju referuar kështu edhe jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut mbi këtë çështje. Një nga çështjet e prekura nga panelistët ishte dhe paketa antishpifje, e cila u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë pavarësisht debateve dhe kundërshtive të shumta nga shoqatat e gazetarëve, shoqëria civile dhe organizatave ndërkombëtare

Sesiioni i dytë u fokusua në luftën kundër gjuhës së urrejtjes ku diskutimi u hap nga znj. Vasilika Hysi, Nënkyetare e Kuvendit të Shqipërisë/anëtare e Shqipërisë në Komisionin Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), ndërkohë që në këtë sesiion referuan edhe z. Hilmi Jashari, Avokati i Popullit të Republikës së Kosovës, z. Robert Gajda, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Pablo Zapata, Përfaqësues i UNHCR-së si dhe znj. Mirela Arqimandriti, drejtuese e Aleancës Gjimore për Zhvillim.

Në kuadër të programit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Europës- “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2020” në fund të Konferencës unëshkrua *Marrëveshja e Bashkëpunimit për krijimin e “Aleancës kundër urrejtjes”* ndërmjet:

Institucionit të Avokatit të Popullit, përfaqësuar nga Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca; Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësuar nga Komisioneri, z. Robert Gajda; Autoritetit të Mediave Audiovizive, përfaqësuar nga Nënkyetari z. Sami Neza dhe Shoqatës “Këshilli Shqiptar i Medias” përfaqësuar nga kryetari, z. Kloreto Cukali.

Ky bashkëpunim do të ketë si qëllim angazhimin e aktorëve kryesorë të përfshirë në aspekte të ndryshme të parandalimit të gjuhës së urrejtjes për të koordinuar dhe bashkuar përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të advokuar si një front kundër këtij fenomeni.

Konkretisht objekti kryesor i kësaj Marrëveshjeje është ngritja e vetëdijes, informimi dhe kontributi në nxitjen e dialogut midis të rinjve në mënyrë të veçantë për luftën ndaj gjuhës së urrejtjes, bashkëveprimi me shoqërinë civile dhe organet publike. Në veprimtarinë e saj Aleanca do përfshihet si në promovimin e lirisë së shprehjes në shoqërinë demokratike duke lehtësuar një debat të hapur dhe sensibilizues për publikun për promovimin e lajmit në mënyrë korrekte dhe të drejtë, ashtu dhe në kryerjen e studimeve dhe dhënien e rekomandimeve në bashkëpunim edhe me aktorë të tjerë vendas ose ndërkombëtar për të zbuluar ndikimin që ka gjuha e urrejtjes te individit dhe grupet sociale.

Synohet që përmes kësaj Aleance të arrihet sigurimi i një harmonizimi më të plotë ndërmjet legjislacionit civil dhe atij penal kundër diskriminimit, rritja e ndërgjegjësimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve si në sektorin publik ashtu dhe atë privat, rritja e aftësive profesionale të mësuesve sidhe forcimi i përpjekjeve në mjedisin arsimor në të gjitha nivelet ndaj fenomeneve negative të gjuhës së urrejtjes.

Aleanca kundër urrejtjes do të drejtohet me rotacion për një periudhë kohore gjashtë mujore nga secila palë e nënshkrimit të Marrëveshjes.

KREU 5

Bashkëpunimi

5.1. Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së

Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e administratës publike ka qenë dhe mbetet një shqetësim i vazhdueshëm për institucionin e Avokatit të Popullit. Përtej hapave dhe iniciativave pozitive të konstatuara ndër vite, mbetet shumë për tu bërë në këtë drejtim, jo vetëm nga organet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor (sidomos sa i përket zbatimit të rekomandimeve) por dhe nga Kuvendi i Shqipërisë si organi legjislativ ku paraqiten dhe diskutohen raportet e hartuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Është kjo arsyeja që në mënyrë të vazhdueshme, Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar dhe monitoron nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike nëpërmjet përgatitjes së informacioneve të përditësuara të cilat bëhen pjesë e raportimeve periodike apo vjetore. Përpos të dhënave të paraqitura më poshtë duam të evidentojmë faktin se puna e institucionit pengohet jo pak herë nga qëndrime jo bashkepunuese të institucionave të ndryshme shtetërore të cilat dërgojnë informacione të cunguara, të paqarta apo vonojnë kthimin e përgjigjeve duke e zgjatur kështu në kohë afatet e hetimeve tona administrative dhe duke eroduar kështu edhe besimin e qytetarëve tek institucioni ynë për veprimtari me efikasitet. Duke e konsideruar shume të rëndësishëm rolin e institucionit ne kemi thelluar punën për të rritur cilësinë e rekomandimeve dhe arsyetime të rekomandimeve tona si edhe të kthimit të përgjigjeve për qytetarët për rastet ku nuk konstatohen shkelje apo çështja zgjidhet pa rekomandim. Fatkeqësisht nuk kemi pasur të njëjten përgjigje nga institucionet në rastin e refuzimit të rekomandimeve të bera nga ne.

Për periudhën **janar-dhjetor 2019**, Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total **213 rekomandime**¹²² drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Niveli i pranueshmërisë dhe zbatueshmërisë të këtyre rekomandimeve pasqyrohet më poshtë:

Ø **134** rekomandime ose 63% e tyre janë pranuar;

Ø **21** rekomandime ose 10% e tyre janë refuzuar;


¹²² Më shumë informacion rreth objektit të rekomandimeve, statusit të tyre si dhe institucioneve të cilat u janë drejtuar gjendet në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimet%20e%20derguara%20nga%20institucioni%20i%20AP%20per%20vitin%202019.pdf>

Ø 8 rekomandime ose 4% e tyre janë pa përgjigje;

Ø 50 rekomandime ose 23% e tyre në proces.

Në formë grafike, këto të dhëna paraqiten si më poshtë:



Siç rezulton nga të dhënat e mësipërme numri i rekomandimeve të dërguara për vitin 2019 është 213 por 50 prej tyre janë në proces që do të thotë se *për këto rekomandime ende nuk kanë kaluar afatet procedurale* për të konsideruar nëse janë pranuar apo refuzuar, zbatuar apo pa zbatuar, me apo pa përgjigje, duke qënë se janë dërguar në fund të vitit 2019 apo në fillim të vitit 2020 për inspektime të kryera në 2019.

Në këto kushte për të mundësuar raportimin e të dhënave sa më të sakta, përllogaritja e nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve do të realizohet në dy forma: (1) edhe mbi bazën e rekomandimeve faktike (**163 rekomandime**) të cilët efektivisht u janë dërguar subjekteve përkatëse dhe janë ezauruar afatet proceduale brenda periudhës raportuese për të konkluduar lidhur me pranimin apo zbatimin e tyre nga institucionet, (2) edhe mbi bazën e totalit të rekomandimeve të adresuara (**213 rekomandime**)

(1) Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total për të cilat kanë kaluar afatet procedurale për kthimin e një përgjigje (163), rezulton se:

- 134 ose rreth 82% e rekomandimeve janë pranuar
 - 33 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 25% e tyre, kanë gjetur zbatim të plotë;
 - 89 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 66% e tyre kanë gjetur zbatim të pjesshëm.
 - 12 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 9% e tyre nuk janë zbatuar
- 21 prej rekomandimeve, ose rreth 13% e tyre janë refuzuar
- 8 rekomandime, ose rreth 5% e tyre nuk kanë marrë asnjë përgjigje

(2) Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total, duke përfshirë edhe rekomandimet për të cilat nuk kanë kaluar afatet procedurale për kthimin e një përgjigje (213), rezulton se:

- 134 ose rreth 63% e rekomandimeve janë pranuar
 - 33 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 25 % e tyre, kanë gjetur zbatim të plotë;
 - 89 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 66% e tyre kanë gjetur zbatim të pjesshëm;
 - 12 prej rekomandimeve të pranuar, ose rreth 9% e tyre nuk janë zbatuar.
- 21 prej rekomandimeve, ose rreth 10% e tyre janë refuzuar
- 8 rekomandime, ose rreth 4% e tyre nuk kanë marrë asnjë përgjigje
- 50 rekomandime, ose rreth 23% e tyre janë në proces.

Arsyet e mospërbushjes së rekomandimeve ose të mospranimit të tyre janë të ndryshme. Këto arsye lidhen në gjykimin tonë, me mungesën e vullnetit administrativ për të bashkëpunuar me Institucionin e Avokatin e Popullit nga organet të cilave iu është drejtuar rekomandimi; konsiderimin jo të drejtë dhe vlerësimin jo të thelluar të gjetjeve dhe konstatimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit përmes rekomandimeve të parashtruara; mungesë e profesionalizimit nga ana e punonjësve të organit përkatës të administratës publike.

Në shumë raste moszbatimi i rekomandimeve apo zbatimi i pjesshëm i tij vjen edhe për shkak të mungesës së fondeve të nevojshme buxhetore, sidomos në rastet e rekomandimeve që lidhen me përmirësimin e infrastrukturës apo që kanë efekte të drejtpërdrejtë financiare (përmirësimi i kushteve në burgjeve, ambjenteve të paraburgimit, qendrave rezidenciale etj).

Bashkëpunimi në dhënien e mendimeve/komenteve për projekt-akte

Në veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, përgjatë vitit 2019, vëmendje të posaçme ka marrë edhe angazhimi i tij institucional i përfshirjes në fazën e konsultimit të jashtëm për projektakte të propozuara nga ministritë e linjës si dhe përfshirja në procesin legjislativ për dhënien e mendimeve apo sugjerimeve për projektligje të ndryshme. Konkretisht, institucioni ka qenë kontribues në dhënien e mendimeve/komenteve për:

- ✓ Projektligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
- ✓ Projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pranë private për interes publik” të ndryshuar.
- ✓ Projektligjin “Për rininë”;
- ✓ Projektligjin “Për asistencën sociale në RSH”;
- ✓ Projektligjin “Për nxitjen e punësimit”

- ✓ Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet”.
- ✓ Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare”;

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit¹²³ në ushtrim të së drejtës së tij për rekomandime legjislative, i ka adresuar rekomandimin përkatës Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përmirësimin e legjislacionit të mbrojtjes sociale, më konkretisht, përfshirjen e kësaj kategorie në ligjin nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim garantimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ndihmësive personale në veçanti ndihmësive personale të fëmijëve, bazuar në interesin më të lartë të tyre¹²⁴.

Bashkëpunimi në kuadër të procesit të integritit evropian

Bashkimi Evropian bazohet dhe zhvillohet mbi një angazhim real për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Garantimi i të drejtave themelore është një nga parimet bazë të këtij organizmi. Zhvillimi të drejtave të njeriut është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga interpretimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë e deri në dokumentet më të rëndësishme që trajtojnë këto çështje.

Në përputhje me mandatin e tij kushtetues, Institucioni i Avokatit të Popullit si një nga aktorët kyç në sistemin kombëtar të mbrojtjes të të drejtave të njeriut e ka vlerësuar maksimalisht këtë proces duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat shtetërore që janë të ngarkuar me ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, përmes ofrimit të kontributeve domethënëse që luajnë një rol të rëndësishëm në respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës, si premisa për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të kontribuojë në gjithë këtë proces përmes pjesëmarrjes direkte në Grupet Ndërinstitucionale të Punës (GNP) të ngritura në përputhje me kapitujt e acquis, për të përmendur veçanërisht angazhimin dhe kontributin e ofruar në kuadër të Kapitulli 23, i cili mbulon disa fusha të cilat janë në ombrellën e përgjithshme të *Gjyqësorit dhe të Drejtave Themelore*. Është një kapitull thelbësor për përpjekjet e para aderimit dhe ka një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim, ku vendosen kushtëzime strikte dhe etapa të caktuara së bashku me monitorimin nga Bashkimi Evropian. Gjithashtu, pjesëmarrje dhe kontribute konkrete janë ofruar dhe për kapitujt 19 (Politikat Sociale dhe Punësimi) dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria).

¹²³ Shkronjës “a”, e nenit 24 të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avoaktin e Popullit” të ndryshuar, e cila shprehimisht parashikon se: “...t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve...”.

¹²⁴ Nga informacioni zyrtar i dërguar nga ky institucion në zbatim të këtij rekomandimi, institucioni i Avokatit të Popullit është informuar që çështja e garantimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore për ndihmësit personale, do të rregullohet me akte nënligjore në zbatim të ligjit të sipërpërmendur.

Me Urdhër të Avokatit të Popullit është ngritur dhe funksionon Grupi i Punës për ndjekjen dhe monitorimin e çështjeve që lidhen me procesin e integritetit evropian, në përbërje të të cilit janë përfaqësues nga struktura të ndryshme të institucionit. Ky grup pune drejtohet nga një prej Komisionereve dhe është përgjegjës për të koordinuar të gjithë veprimtarinë dhe kontributet e institucionit për këtë proces si dhe për të informuar, orientuar dhe këshilluar Avokaten e Popullit për çdo vendimmarrje. Gjatë vitit 2019, janë ofruar kontribute konkrete dhe pjesëmarrje aktive në takimet e zhvilluara në kuadër të këtij procesi të tilla si; Nënkomiteti BE-Shqipëri, për Drejtësi, Liri dhe Siguri; Komiteti i Stabilizim-Asociimit; Progres Raportet; Grupi i Posaçëm për Reformën në Administratën Publike etj.

Avokati i Popullit ka qenë aktiv dhe në kuadër të mbledhjeve dhe raportimeve të zhvilluara nga Këshillit Kombëtar i Integritetit Evropian (KKIE) si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integritetin evropian që funksionon pranë Kuvendit, me qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritetit. Gjatë muajit Shtator 2019, Avokati i Popullit ka raportuar në Këshillin Kombëtar të Integritetit Evropian mbi progresin e realizuar për adresimin e rekomandimeve të Komisionit Europian në Raportin e vitit 2019 për Shqipërinë si dhe Nënkomitetin BE-Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2018-2019.

Një tjetër çështje e rëndësishme që duhet të përmendet në këtë raport është edhe anëtarësimi i Shqipërisë në Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA). Avokati i Popullit ka rekomanduar në vazhdimësi anëtarësimin në këtë agjenci dhe ka përshëndetur ratifikimin nga Kuvendi i Shqipërisë të Marrëveshjes¹²⁵. Sipas nenit 2 të ligjit nr. 66/2019 me të cilin Parlamenti ratifikoi këtë marrëveshje: *“Përfaqësuesi i Republikës së Shqipërisë në Bordin Drejtues të Agjencisë së Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore emërohet nga Ministri i Drejtësisë, sipas parashikimeve të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 168/2007”*.

Nisur nga objekti i punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe duke pasur parasysh praktikatat e institucioneve tona homologe (si në rajon, ashtu edhe me gjerë), ku rezulton se shtete të tjera kanë zgjedhur të caktojnë institucionin e Ombudsmanit si përfaqësues të tyre në Agjencinë e Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore, iu propozua zyrtarisht Ministrit të Drejtësisë, që të merrte në konsideratë caktimin e Avokatit të Popullit si *përfaqësues i Republikës së Shqipërisë në Bordin Drejtues të Agjencisë së Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore*.¹²⁶

Një zgjedhje e tillë jo vetëm përputhet me frymën dhe gërmën e Rregullores së Këshillit nr. 168/2007 për mënyrën e pjesëmarrjes, por mbi të gjitha përputhet plotësisht me objektin e punës dhe objektivat e institucionit të Institucionit të Avokatit të Popullit, si një institucion i pavarur, dhe vendimmarrës në fushën e të drejtave të njeriut me kompetencat e njohuritë më të gjëra të mundshme në vend.

¹²⁵ Marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Europian-Shqipëri për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 66/2019

¹²⁶ Shkresa nr. 494 prot. datë 18.11.2019, me objekt: *“Mbi caktimin e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë, në Bordin Drejtues të Agjencisë së Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore”*

Pavarësisht ripërsëritjes së kësaj kërkesë edhe në fillim të vitit 2020¹²⁷, deri më sot nuk kemi asnjë përgjigje zyrtare nga ky institucion.

5.2 Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Në nenin 30 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar, përcaktohet se *“Për të realizuar funksionet e tij, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me organizatat jo-qeveritare për të marrë periodikisht opinionet e tyre mbi situatën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Avokati i Popullit në bashkëpunimin me organizatat jo-qeveritare, organizon të paktën një herë në vit një aktivitet kombëtar mbi situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri”*.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të luajë një rol proaktiv në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile. Fokusi ka qënë zhvillimi i takimeve jo vetëm me përfaqësuesit e shoqërisë civile që veprojnë në Tiranë por sidomos organizimi i tryezave dhe forcimi i kontakteve me shoqërinë civile në qarqe të ndryshme të vendit.

Jo vetëm Avokatja e Popullit ka marrë pjesë në shumë aktivitete të organizuara nga shoqëria civile por shumë përfaqësues të këtyre shoqateve janë pritur vazhdimisht në zyrën e Avokates së Popullit për të diskutuar çështjet të ndryshme që lidhen me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut duke qënë në kontakt të vazhdueshëm për problemet që shqetësojnë qytetarët dhe kauzat me rëndësi publike.

Organizatat e shoqërisë civile kanë qënë gjithmonë pjesë e aktiviteteve që ka zhvilluar institucioni i Avokatit të Popullit në Tiranë por dhe në qytete të tjera të vendit, përfshirë këtu dhe Konferencën Kombëtare të zhvilluar në muajin dhjetor 2019.

Si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi është mundësuar monitorimi dhe hartimi i raporteve të përbashkëta në fusha të ndryshme, Këtu mund të përmendet veçanërisht:

- ❖ Bashkëpunimi me Institutin Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (ALTRI) në zbatim të projektit “Monitorimi dhe promovimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale të grupeve në nevojë në nivel kombëtar dhe lokal”. Ky bashkëpunim synonte përmirësimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë në nivel lokal, përmes forcimit të rolit monitorues të institucionit të Avokatit të Popullit dhe përfshirjes së grupeve në nevojë në këtë proces.
- ❖ Bashkëpunimi dhe aktivitetet e organizuara me shoqatën “Together for Life” si dhe “Shërbimi ligjor falas” (TLAS), organizata të cilat operojnë në mbrojtje të të drejtave të pacientit. Pjesëmarrja dhe organizimi i shumë tryezave, seminareve dhe konferencave ka ndikuar

¹²⁷ Shkresa nr. 30 prot, datë 16.02.2020, me objekt: “Mbi mungesën e kthimit të përgjigjes për dy shkresa tona”

pozitivisht numrin e ankesave për shqyrtimin e rasteve të përbashkëta me këto shoqata në respektim të të drejtave të pacientëve dhe adresimit të shqetësimit të tyre në institucionet shëndetësore përgjegjëse.

- ❖ Organizimi i tryezës të konsultimit për hartimin e ligjit të integruar kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, sipas rekomandimeve të GREVIO-s. Kjo tryezë u realizua me mbështetjen e UNDP-së dhe me pjesëmarrjen e 38 pjesëmarrësve, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të cilat operojnë në fushën e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore. Diskutimi në këtë tryezë u fokusua mbi nevojën e hartimit të një ligji të integruar kundër dhunës ndaj grave e vajzave, sipas standardeve të Konventës së Stambollit, duke siguruar që masat e marra në përputhje me këtë konventë të adresojnë të gjitha format e dhunës kundër grave në mënyrë tërësore dhe gjithëpërfshirëse si edhe masat përkatëse që duhet të merren nga të gjithë institucionet shtetërore, institucionet e pavarura që monitorojnë të drejtat e njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile në vijim të punës së tyre të përbashkët për përmirësimin e masave legislative kundër dhunës me bazë gjinore.

Gjithashtu në zbatim të rekomandimit të GREVIO-s për forcimin e rolit të institucionit të Avokatit të Popullit si mbrojtës i viktimave të dhunës ndaj grave, me mbështetjen e UNDP-së, u zhvillua një tryezë konsultimi me 32 përfaqësues të administratës publike, sektorit privat, shoqërisë civile dhe sindikatave me temë “Parimet, politikat dhe standardet e një mjedisi të sigurt pune”. Diskutimi në këtë tryezë u orientua mbi domosdoshmërinë e hartimit të dokumenteve politikë dhe proceduralë nga ana e institucioneve të ndryshme publike dhe entiteteve private kundër ngacmimit seksual në funksion të sigurimit të një mjedisi të sigurt pune.

- ❖ Tryeza e diskutimit me organizata të shoqërisë civile për çështje që duhet të trajtohen në raportimin për Raportimin Periodik Universal të Shqipërise (UPR),
- ❖ Bashkëpunimi me disa organizata të shoqërisë civile për hartimin e Planit të Veprimit të institucionit të Avokatit të Popullit në kuadër të Planit Strategjik 2019-2022.
- ❖ Bashkëpunimi me Strehën LGBTI, me të cilën ka zhvilluar 5 (pesë) sesione informuese/ndërgjegjësuere në bashkitë: Tiranë, Shkodër, Korçë, Durrës dhe Gjirokastrë në periudhën shtator – nëntor 2019 të cilat kishin në fokus të tyre, ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat e parashikuara në legjislacionin përkatës, institucionet ku mund të drejtohen në rastet kur këto të drejta nuk respektohen apo mohohen, parashikimet e legjislacionit në fuqi në mbrojtje të tyre, etj.

Në vazhden e sa më sipër, ishte edhe organizmi nga institucioni i një ditë të hapur, “Të drejtat e LGBTI janë të drejta të njeriut”, me përfaqësues nga të gjitha organizatat e fushës të ftuar nga ambasadat e huaja si dhe organizatat ndërkombëtare që operojnë në fushën e mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të komunitetit LGBTI.

- ❖ Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit (Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës) me Organizatat e Shoqërisë Civile si me Komitetin Shqiptar të Helsinkit etj, ku është arritur që të realizohen inspektime të përbashkëta, me karakter multidisiplinar dhe të thelluar si dhe janë zhvilluar auditoriume, konferenca e seminare me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave të konstatuara në burgje e komisariate si dhe diskutimin e gjetjen e zgjidhjeve për to.

Gjithashtu në funksion të mandatit të tij promovues, gjatë vitit 2019, institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh promovuese e fushatash ndërgjegjësuere në fushën e respektimit të të drejtave të grave, minoriteteve etj por në të njëjtën kohë edhe njohjen me standardet më të larta të këtyre të drejtave të cilat parashikohen në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë.

Ndër aktivitetet më të spikatura mund të përmenden:

- ❖ Forumi i diskutimit me organizatat e shoqërisë civile në Vlorë, me objekt legjislacionin dhe të drejtat e parashikuara në të lidhje me parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave e dhunës në familje dhe zbatimin në praktikë të tyre si dhe evidentimi i problematikave për sa i përket funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar Kundër Dhunës, (MKR) të Bashkisë Vlorë;
- ❖ Forumi i diskutimit me studentët në kuadër të fushatës kombëtare të 16 ditëve kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në bashkëpunim me UN EOMEN, zhvilluar në mjediset e Qytetit Studenti, i cili kishte në fokus të tij dhunën me bazë gjinore e atë seksuale, njohjen e legjislacionit vendas dhe atij ndërkombëtar në këtë fushë.
- ❖ Forumi i diskutimit me rrjetin e organizatave joqeveritare Rome dhe Egjiptiane që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Qarkun Korçë për të njohur të drejtat e minoriteteve në kuadër të drejtave të njeriut.

5.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Qasja ndërkombëtare e Institucionit të Avokatit të Popullit në bashkëpunim me faktorët brenda dhe jashtë vendit, përbën një nga aspektet më të rëndësishme të angazhimit institucional në përmbushje të misionit kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Gjatë vitit 2019, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në një sërë aktivitetesh ndërkombëtare në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh të renditura si vijon:

1. Bashkëpunimi në kuadër të Rrjetit Global të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI-t) dhe Rrjetit European të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut(ENNHRI-t)

Ky vit raportues ka qenë i rëndësishëm në aspektin e angazhimeve dhe veprimtarive ndërkombëtare të institucionit të Avokatit të Popullit. Për shkak të zgjedhjes së Avokates së Popullit, znj.Erinda Ballanca si anëtare e Bordit të ENNHRI-t si dhe anëtare e Byrosë së GANHRI-t janë ndjekur aktivitetet dhe takimet e rëndësishme më të lartë të këtyre organizmave si vijon:

- Pjesëmarrja e Avokatessë Popullit në takimin e përvitshëm të GANHRI-t, zhvilluar në **datat 4-6 Mars 2019 në** Gjenevë, Zvicër.Në kuadër të sesionit 63-të të Komisionit mbi Statusin e Grave, GANHRI përgatiti një raport mbi rolin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Avokatja e Popullit, znj.Ballanca në këtë kontekst adresoi çështje të cilat lidhen me avancimin

e të drejtave të grave në Shqipëri dhe luftën për barazi që institucionet dhe aktivistët e kësaj kauze kanë zhvilluar në vendin tonë.

- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit në seminarin e organizuar nga ENNHRI, zhvilluar në **datat 25-29 Mars 2019** në Mostar, Bosnje Hercegovinë për rritjen e kapaciteteve në fushën e ekonomisë dhe të drejtave sociale. Në këtë kuadër u organizua dhe një takim rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor duke u fokusuar në të drejtat ekonomike dhe sociale kryesisht në vendet post konflikt.
- Pjesëmarrja e Avokatessë Popullit, znj. Ballanca në cilësinë e anëtares së bordit në mbledhjen e parë të Bordit të ENNHRI-t, zhvilluar në **datat 15-16 Maj 2019** në Bruksel, Belgjikë, me fokus kryesor shqyrtimin e planit për vitin 2020, raportin financiar etj.
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit në takimin e organizuar nga ENNHRI dhe Equinet, zhvilluar në **datat 14-15 Maj 2019** në Bratislavë, Slloveni, me fokus kryesor “Sistemin e arsimit dhe rolin e të drejtave të njeriut, trajtimin e barabartë dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunitetin rom për një arsimim cilësor”.
- Pjesëmarrja e Avokatessë Popullit, znj. Ballanca në cilësinë e anëtares së bordit në mbledhjen e dytë të Bordit të ENNHRI-t, zhvilluar në **datat 1-3 Korrik 2019** në Dublin, Irlandë e Veriut.
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit në seminarin e organizuar nga ENNHRI, zhvilluar në **datat 29-31 Tetor 2019** në Zagreb, Kroaci, me temë: “Eksplorimi i NHRI-ve në ndërtimin e paqes”.
- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca dhe Komisioneres znj. Erjona Canaj në Konferencën Vjetore të ENNHRI-t, zhvilluar në **datat 12-15 Nëntor 2019** në Bruksel, Belgjikë, me fokus kryesor të drejtat ekonomike dhe sociale, rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me rolin dhe rëndësinë e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) për realizimin e të drejtave ekonomike dhe sociale në Europë etj. Avokatja e Popullit, znj. Ballanca, *drejtoi panelin mbi sfidat e këtyre institucioneve në rrafshin social dhe ekonomik.*
- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca në mbledhjen e Bordit të GANHRI-t dhe Seminarin për Mobilitetin Human organizuar nga ENNHRI, zhvilluar në **datat 20-22 Nëntor 2019** në Medelin, Kolumbi, me fokus të veçantë çështjet e migracionit si një nga dukuritë më shqetësuese globale.

2. Bashkëpunim në kuadër të Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)

Viti 2019 shënoi dhe përmbylljen e Presidencës 3-vjeçare të AOM-it të kryesuar nga Avokati i Popullit të Shqipërisë, znj. Ballanca. Më datë **12 Mars 2019**, u zhvillua në Tiranë mbledhja e rradhës e instancave drejtuese të AOM-it organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me AOM, takim i cili shërbeu gjithashtu për kalimin e kryesimit të Presidencës Ombudsmanit të Greqisë. Avokati i Popullit i Shqipërisë vijon të jetë Zv.President i kësaj Organizate. Në kuadër të kësaj shoqate, vlen të përmenden edhe aktivitetet e mëposhtme:

- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca në seminarin rajonal, zhvilluar në datat **17-19 Qershor 2019** në Kajro, Egjipt, me temë: “Roli i Institucioneve të të Drejtave të Njeriut (NHRI-të) në ndihmën ligjore dhe trajtimin e ankesave”.

- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit në seminarin e organizuar nga AOM, zhvilluar në **datat 9-11 Dhjetor 2019** në Nikosia, Qipro, fokusuar në “Parimet e Venecias”.
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Institucionit të Avokatit të Popullit në trajnimin e organizuar nga AOM, zhvilluar në **datat 26-27 Nëntor 2019** në Rabat, Marok, fokusuar në bashkëpunimin ndërmjet përfaqësuesve të Institucioneve të Mbrojtjes të Drejtave të Njeriut dhe marrjen e eksperiencës në nivel teknik nga ekspertët më të mirë të Rrjetit të AOM.

3. Aktivitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit në Rolin e Mekanizmit Parandalues

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Pjesëmarrja e Komisioneres së Seksionit të MKPT-së, znj. Ermonela Xhafa dhe Komisioneres së Seksionit të Veçantë, znj. Ermonela Ruspi në Konferencën, e zhvilluar në **datën 5 Qershor 2019**, Vienë, Austri, me temë “Multilateralizmi efektiv në luftën kundër torturës: Trendet në rajonin e OSBE-së si dhe rruga përpara”.
- Pjesëmarrja e Komisioneres së Seksionit të MKPT-së, znj. Ermonela Xhafa në takimin e 1-rë të Nafplion Group, zhvilluar në **datat 8-9 Tetor 2019**, me temë “Sistemet e monitorimit të kthimit të detyruar në BE”. Ky takim u organizua nga Garantuesi Kombëtar i të drejtave të burgosurve ose personave të privuar nga liria të Italisë, me mbështetjen e Këshillit të Europës.
- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca dhe Komisioneres së Seksionit të MKPT-së, znj. Ermonela Xhafa në takimin ndërkombëtar të Mekanizmave të Parandalimit të Torturës të vendeve anëtare të Këshillit të Europës, zhvilluar në **datat 4- 5 Nëntor 2019** në Strasburg, Francë. Organizimi i këtij takimi përkonte me 70-vjetorin e Këshillit të Europës si dhe 30 vjetorin e Komisionit European për Parandalimin e Torturës. Objektivat specifike të këtij takimi përfshinë identifikimin e sfidave dhe praktikave më të mira nga vendet pjesëmarrëse për monitorimin dhe zbatimin e masave në rastet kur qytetarët shoqërohen nga policia si dhe promovimin e shkëmbimit të përvojave mes mekanizmave të vendeve të ndryshme në mbikëqyrjen efektive të këtyre masave.

4. Aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve

- Pjesëmarrja e Komisioneres së Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, znj. Neila Peka në seminarin e organizuar nga ENOC dhe BBC, zhvilluar në **datat 9-10 Maj 2019** në Manchester, Angli, me temë “Të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital”. Kjo veprimtari kishte si qëllim rritjen e kapaciteteve lidhur me politikat e mbrojtjes së fëmijëve në mjedisin digjital. Fokusi kryesor ishte fuqizimi dhe përmirësimi i punës të institucioneve të pavaruara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, lidhur me garantimin dhe respektimin e të drejtave të tyre në një mjedis të sigurtë digjital si dhe përmirësimi i politikave të përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve që lidhen me Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave, median dhe të rinjtë nga institucionet anëtare të ENOC.

- Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në forumin e ENYA, zhvilluar **në datat 25 - 26 Qershor 2019** në Bruksel, Belgjikë, ku u diskutua lidhur me sfidat që përballen të rinjtë në mjedisin digjital. ENYA është një projekt i mbështetur nga Rrjeti European i Ombudsmanëve për Fëmijë.
- Institucioni i Avokatit të Popullit organizoi në **datën 17 Tetor 2019** në Tiranë, takimin e rradhës së Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Europës Juglindore (CRONSEE), takim i cili u fokusua në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve emigrant. Gjatë takimit, bazuar në të dhënat cilësore dhe sasore të mbledhura nga vendet pjesëmarrëse të këtij rrjeti si dhe mbështetur në eksperiencat e tyre, u përgatitën 15 rekomandime të institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve, pjesë e Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Europës Juglindore, (CRONSEE)¹²⁸
- Pjesëmarrja e Komisioneres së Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, znj. Neila Peka në Konferencën Këshillit të Europës “Për fuqinë e përfshirjes së fëmijëve: Si të luftojmë varfërinë e fëmijëve dhe përjashtimin social si dhe të promovojmë shanse të barabarta për të gjithë fëmijët”, zhvilluar në **datat 13- 14 Nëntor 2019** në Strasbourg, Francë.
- Pjesëmarrja e Komisioneres së Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, znj. Neila Peka në Konferencën Ndërkombëtare, zhvilluar në **datat 26-27 Nëntor 2019** në Kiev, Ukrainë, me temë “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në konfliktet e armatosura”, organizuar nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Ukrainës.

5. Aktivitetet e tjera ndërkombëtare

- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca në Konferencën e organizuar me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Ombudsmanit Grek, zhvilluar në **datat 21-22 Shkurt 2019** në Athinë, Greqi. Në këtë Konferencë u diskutua lidhur me objektivat si dhe kontributin e të gjitha palëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës. Me këtë rast, Avokatja e Popullit mbajti një fjalë për “Lirinë e shprehjes në kohën e internetit”.
- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca në takimin e zhvilluar nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën (UNECE), zhvilluar në **datat 21-22 Mars 2019** në Gjenevë, Zvicër në kuadër të mbështetjes që UNECE iu jep vendeve në Europë për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Agjenda 2030). Avokatja e Popullit, znj. Ballanca mbajti një fjalë në kuadër të temës: “Lidhja e paqes, drejtësisë dhe zhvillimit përmes qeverisjes së mirë në SDG16”.
- Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën e Rrjetit European të Ombudsmanëve, zhvilluar në **datat 8-9 Prill 2019** në Bruksel, Belgjikë, organizuar në Parlamentin European me qëllim përfshirjen e qytetarëve në politikbërje.
- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca në takimin e parë të “Komitetit rajonal për rritjen e qasjes së grave në punësim”, zhvilluar në **datën 28 Maj 2019** në Prishtinë, Kosovë,

¹²⁸ Shkresa zyrtare me nr.63 prot. datë 7.2.2020, dërguar Kuvendit të RSH-së, për rekomandimet e miratuara në Konferencën Rajonale të rrjetit CRONSEE, organizuar nga AP dhe KMPDF në Tiranë.

organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Zhvillim (D4D) dhe Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC).

- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca në Konferencën me rastin e 25 vjetorit të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), zhvilluar në **datat 25-26 Shtator 2019** në Strasburg, Francë, me temë "Në rrugën drejt barazisë efektive - përgjigje të reja ndaj racizmit dhe intolerancës". Kjo veprimtari u organizua nga Këshilli i Europës nën Presidencën Franceze të Komitetit të Ministrave.
- Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në seminarin "Peer Review", zhvilluar në datën 23 Shtator 2019 në Londër, Angli, organizuar nga Ombudsmeni Parlamentar i Mbretërisë së Bashkuar dhe IOI.
- Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në seminarin mbi Komunikimin, zhvilluar në **datat 3-4 Tetor 2019** në Vienë, Austri, organizuar nga Agjencia Europiane për të Drejtat Themelore (FRA).
- Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën Rajonale, zhvilluar më **datë 9 Tetor 2019** në Shkup, Maqedoninë e Veriut në kuadër të programit të përbashkët "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë".
- Pjesëmarrja e Komisioneres së Seksionit të Veçantë, znj. Ermonela Ruspi në Konferencën e 11-të Ndërkombëtare të Institucioneve të Ombudsmenit për Forcat e Armatosura (ICOAF), zhvilluar në **datat 27-30 Tetor 2019** në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë.
- Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën e 2-të Ndërkombëtare të organizuar nga Ombudsmeni i Turqisë, zhvilluar në **datat 18-19 Nëntor 2019**, me temë "Ndihma teknike për fuqizimin e rolit të Ombudsmenit në Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut".
- Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Ballanca në Konferencën e Nivelit të Lartë me rastin e 15-të vjetorit të Institucionit të Mbrojtës të të Drejtave të Njeriut të Armenisë, zhvilluar në **datat 26 - 27 Nëntor 2019** në Jerevan, Armeni.
- Avokatja e Popullit, znj. Ballanca në datën 7 Shtator 2019, adresoi me një videomesazh Drejtuar Këshilli të të Drejtave të Njeriut në Kombet e Bashkuara në kuadrin e raportit periodik universal (UPR), një pasqyrë mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Gjithashtu, gjatë vitit raportues, institucioni i Avokatit të Popullit ka intensifikuar bashkëpunimin me Ombudsmenët e rajonit. Duke konsideruar nevojën e angazhimit të përbashkët për veprime konkrete në dobi të qytetarëve të vendeve përkatëse në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, më **datë 31 Tetor 2019** në Vlorë, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit e lidhur midis Avokatit të Popullit të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut si dhe Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Ky Memorandum Bashkëpunimi shënon një moment të rëndësishëm në marrëdhëniet bilaterale ndër-institucionale dhe do të shërbejë si një bazë solide për bashkërendimin e aktiviteteve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve shqiptarë dhe jo vetëm në vendet respektive. Palët nënshkruese u dakortësuan që të intensifikojnë bashkëpunimin, shkëmbimin e përvojës dhe ndihmën reciproke dhe të kërkojnë bashkërisht që gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare në takimet rajonale ku marrin pjesë institucionet respektive.

5.4. Bashkëpunimi në kuadër të projekteve

Avokati i Popullit ka vijuar zbatimin e **Marrëveshjes së Bashkëpunimit me UNHCR** për monitorimin e pikave të kalimit të migrantëve dhe forcimin e respektimit të të drejtave të tyre. Në këtë kuadër, përveç vendosjes së dy përfaqësuesve të Avokatit të Popullit në Gjirokastrë dhe Shkodër, gjatë vitit 2019 u vendos shtimi i një përfaqësuesi të AP edhe në pikën e kalimit kufitar në Kapshticë, Korçë. Shuma totale e përfituar nga kjo marrëveshje për vitin raportues shkon në 5.597 mijë lek.

Në maj 2019, Avokati i Popullit nënshkroi një **Marrëveshje Bashkëpunimi me UNICEF** me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Fokusi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi ka të bëjë me zhvillimin e aktiviteteve promovuese në shkolla dhe komunitete, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, me qëllim rritjen e numrit të rasteve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit; fillimin e dialogut me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve për të përfshirë në kurrikulat dhe tekset shkollore informacione mbi Avokatin e Popullit dhe institucionet e të drejtave të njeriut; vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të nxjerra nga Avokati i Popullit lidhur me monitorimin e kushteve dhe trajtimin e fëmijëve të privuar nga liria si dhe nxitjen e dialogut publik mbi zbatimin e Kodit të Fëmijëve nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Shuma totale e përfituar nga kjo marrëveshje është 2.213 mijë lek nga të cilat për realizimin e aktiviteteve dhe pagat e dy ekspertëve të jashtëm gjatë vitit 2019 janë harxhuar 1.489 mijë lek.

Në kuadër të Marrëveshjes së **Grantit midis Ambasadës të Republikës së Bullgarisë në Tiranë dhe Avokatit të Popullit të Shqipërisë (Fond prej 30 mijë euro)**, Avokati i Popullit ishte përfitues i një projekti për forcimin e kapaciteteve administrative. Projekti parashikoi forcimin e kapaciteteve të stafit, ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve për rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të AP si dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të ankesave në institucion. Kohëzgjatja e tij ishte për periudhën janar 2018-gusht 2019. Gjatë vitit raportues nga ky projekt është përdorur një shumë rreth 2,251 mijë lek kryesisht në fushën e promovimit, përmirësimit të teknologjisë së informacionit dhe trajnimit të stafit.

Në Shtator 2019, Avokati i Popullit është bërë pjesë e projektit **të financuar nga Programi i Drejtësisë së Bashkimit European me titull “Komponenti B – Forcimi i kompetencave të stafit penitenciar në Europë”**, i cili do të zbatohet në koordinim me gjashtë institucione të tjera europiane. Ky projekt ka një kohëzgjatje prej 24 (njëzetë e katër muaj) dhe vlera e tij për institucionin e Avokatit të Popullit është 3.728 mijë lek. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafit civil në burgje lidhur me një çështje të rëndësishme së veçantë për Bashkimin European: përballimi i diversitetit kulturor në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe standardet e të drejtave të të burgosurve të huaj. Ky qëllim do të arrihet nëpërmjet programit trajno-trajnerët, ndarjes dhe kombinimit të praktikave më të mira, veprimeve ndërgjegjëse dhe mjeteve praktike multi-gjuhësore.

Në dhjetor 2016, Avokati i Popullit nënshkroi një **Marrëveshje Bashkëpunimi me Organizatën Ndërkombëtare “Save the Children” në Shqipëri për zbatimin e projektit “Children Keeping Children Safe”** me mbështetjen financiare të Ambasadës Suedeze. Qëllimi kryesor i Marrëveshjes është mbështetja dhe fuqizimi i Seksionit të Promovimit dhe Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Institucionin e Avokatit të Popullit për të rritur efikasitetin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në monitorimin e të drejtave të tyre si dhe për të siguruar iniciativat për ngritjen e kapaciteteve në monitorimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe dhuna, politikat e mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimin e një baze të dhënash në lidhje me dokumentimin e ankesave të fëmijëve. Për vitin 2019, aktivitetet e kryera nga Avokati i Popullit janë në shumën 568 mijë lek.

KREU 6

Shërbimet mbështetëse

6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Menaxhimi i burimeve njerëzore përmes krijimit të një administrate civile profesionale të qëndrueshme, efektive dhe të përgjegjshme është një nga sfidat më të rëndësishme për çdo institucion publik, duke synuar përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Kjo nënkupton në rradhë të parë përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit civil, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, rritjen e mobilitetit dhe zhvillimit të karrierës brenda shërbimit civil si dhe përmirësimin të sistemit të trajnimit.

Caktimi i strukturës administrative nga vetë institucioni konsiderohet një faktor rëndësishëm i pavarësisë së tij. Aftësia e institucionit për të krijuar strukturat e veta dhe fleksibiliteti i përshtatjes së tyre në mënyrë që t'u përgjigjen sa më mirë funksioneve e detyrave të institucionit është mjaft e rëndësishme për funksionimin efikas të një institucioni të pavarur kushtetues, siç është Avokati i Popullit.

Pasja e një strukture eficiente për realizimin e objektivave dhe angazhimeve institucionale dhe ligjore ka qenë dhe mbetet një nga qëllimet kryesore të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit. Që nga krijimi i institucionit (viti 2000), struktura dhe organika e tij ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime që kanë synuar rritjen e efikasitetit dhe përshtatjen me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga kuadri ligjor në fushën e shërbimit civil.

Gjatë vitit 2019, Avokati i Popullit miratoi Urdhërin nr.252/40, datë 05.04.2019 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”, i ndryshuar. Në tërësinë e saj, struktura e re e miratuar respekton të njëjtat parime dhe standarde që duhet të ndiqen gjatë hartimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës shtetërore dhe është në përputhje të plotë me vendimin nr.893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

Struktura e miratuar akomodoi nevojën për forcimin e zyrës së pritjes së qytetarëve për dhënien e informacionit dhe përpunimin e të dhënave statistikore të cilat kërkohen periodikisht nga bashkëpunëtorë të ndryshëm por edhe për efekt të raportimeve brenda institucionit në shkallë hierarkike si dhe pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Me urdhërin e të Avokatit të Popullit, nr.222, datë 31.08.2019 është miratuar *Manuali i Mekanizmit të Trajtimit të Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit*. Përgatitja e këtij manuali nisi si një nevojë për të përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të ankesave që i drejtohen Institucionit të Avokatit të Popullit nga individë, grupe individësh ose organizata joqeveritare që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

Objektivi kryesor i këtij manuali është të përcaktojë procedura të brendshme të standardizuara për adresimin eficient të ankesave të drejtuara për institucionin e Avokatit të Popullit dhe të ofrojë zgjidhje praktike për sfidat që hasen për të patur një proces të suksesshëm dhe efikas të ankesave që adresohen nga publiku. Ky manual ofron një udhëzues të shkruar, përshtetës dhe një sërë instrumentash praktikë për të ndihmuar procesin e kryer nga stafi i Avokatit të Popullit, me qëllim rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë gjatë gjithë procesit të trajtimit të ankesës.

Siç kemi informuar edhe më parë, Institucioni i Avokatit të Popullit, me mbështetjen e Zyrës së Ombudsmanit Danez dhe Institutit Danez për të Drejtat e Njeriut, nisi punën për hartimin e Planit Strategjik të institucionit që përfshin periudhën 2019-2022. Nëpërmjet këtij Plani Strategjik, Avokati i Popullit synon krijimin dhe zhvillimin e një kulture të qeverisjes së mirë, e cila nënkupton administrim të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve të Shqipërisë si dhe forcim të përgjithshëm të sundimit të ligjit, elementë të domosdoshëm për funksionimin e demokracisë dhe integrimin në Bashkimin Europian. Me urdhërin nr.184, datë 24.06.2019, Avokati i Popullit miratoi “*Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitet 2019-2022*”¹²⁹. Zbatimi i Planit Strategjik në të gjithë komponentët e tij do të kërkonte domosdoshmërisht një mbështetje më të madhe financiare nga buxheti i shtetit në burime njerëzore dhe financiare.


Gjatë vitit 2019, me urdhërin nr.224, datë 31.08.2019, Avokati i Popullit miratoi *Strategjinë e re të Menaxhimit të Riskut* për institucionin e Avokatit të Popullit. Qëllimi i kësaj strategjie është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative nëpërmjet filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimin e tij për çdo veprimtari që kryen institucioni i Avokatit të Popullit. Strategjia e Menaxhimit të Riskut jep një qasje gjithë përfshirëse dhe të strukturuar për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar riskun e institucionit si dhe synon të ndërtojë dhe të nxisë zhvillimin duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve.

Me qëllim përmirësimit të përcaktimit të fushave të përgjegjësisë dhe të drejtave specifike që do të mbulohen nga ndihmëskomisionerët, duke pasur në konsideratë mandatin e gjërë si një institucion kombëtar për parandalimin, mbrojtjen dhe promovimin të drejtave të njeriut si dhe tipologjinë dhe natyrën e ankesave, Avokati i Popullit miratoi *Urdhërin nr.110, datë 16.04.2019 “Për përcaktimin e fushës të përgjegjësisë dhe të drejtave specifike që do të mbulohen nga ndihmëskomisionerët e Seksioneve në Institucionin e Avokatit të Popullit”*.

¹²⁹ Plani Strategjik i institucionit të Avokatit të Popullit është i aksesueshëm në linkun www.avokatipopullit.gov.al/botime

Struktura dhe Organigrama

Me ndryshimet e bëra me Urdhrin nr.252/40, datë 05.04.2019 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”, i ndryshuar, struktura dhe organika e institucionit është si më poshtë:



Emërtimi i funksionit	Numri i punonjësve (56)	Kategoria/Klasa
Avokati i Popullit	1	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
Kabineti (7)		
Drejtor Kabineti	1	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
Këshilltar	5	I-b
Sekretar	1	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
Sekretar i Përgjithshëm	1	I-a
Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre (7)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner	4	II-a
	2	II-b
Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor (5)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar

Ndihmëskomisioner	2	II-a
	2	II-b
Seksioni i Përgjithshëm (5)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner	3	II-a
	1	II-b
Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve (4)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner	2	II-a
	1	II-b
Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues (5)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner	2	II-a
	2	II-b
Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (18)		
Drejtor	1	II-b
Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (10)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Specialist për Burimet Njerëzore	1	III-b
Specialist Protokolli	1	III-b
Arkivist/Bibliotekar	1	Klasa VIII
Shofer i titullarit	1	Klasa VI
Shofer	2	Klasa IV
Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme	1	Klasa VI
Punëtor pastrimi	2	Klasa I
Sektori i Financës dhe Prokurimeve (3)		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist i Financës	1	III-b
Specialist i Prokurimeve	1	III-b
Sektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve (4)		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit	3	III-b

Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian (3)		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist	2	III-b

6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

Në mbështetje të ligjit nr. 99/2018, datë 03.12.2018, "Për Buxhetin e shtetit të vitit 2019", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2 datë 06.02.2012 "Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 1, datë 17.01.2019, "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2019", i ndryshuar, performanca e produktit të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2019, paraqitet si më poshtë:

Programi "Shërbimi Avokatisë"

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2019-2021 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2019-2021).

Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve për vitin 2019

Me ligjin nr. 99/2018, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2019", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve


Tabela nr. 1

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa & Pakësimi	Plani i ndryshuar	Fakti
600	Paga	90,800,000	(6,000,000)	84,800,000	80,492,112
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	13,700,000	0	13,700,000	11,157,532
602	Mallra dhe shërbime të tjera	16,500,000	6,000,000	22,500,000	17,978,717
605	Transferta Korente të Huaja	1,600,000	10,000	1.610,000	1,605,206
606	Transferta për buxhetet familjare	500.000	938,908	1,438,908	1,438,908
231	Investimet	2,000,000		2,000,000	870,000
	TOTALI	125,100,000	948,908	126,048,908	113,542,475

Raporti vjetor i realizimeve të shpenzimeve për vitin 2019

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
1	Paga	84,800,000	80,492,112	4,307,888	94.90
2	Sig. shoqërore e shëndetësore	13,700,000	11,157,532	2,542,468	81.44
3	Mallra dhe shërbime të tjera	22,500,000	17,978,717	4,521,283	79.91
4	Transferta. korente të huaja	1,610,000	1,605,206	4,794	99.70
5	Transf për buxhetet familjare	1,438,908	1,438,908	0	100
6	Investimet	2,000,000	870,000	1,130,000	43.50
	Totali	126,048,908	113,542,475	12,506,433	90.10



Paraqitja grafike e shpenzimeve për vitin 2019

Realizimi i zërit tëshpenzimeve operative dhe veçanërisht i investimeve do të ishte në një nivel më të lartë por për shkak të fatkeqësisë natyrore (tërmetit të 26 Nëntorit), me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” si dhe shkresës së Ministrit të Financave nr. 21920, datë 02.12.2019, “Mbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore”, u konfirmua pezullimi i të gjitha procedurave të prokurimit publik për vitin 2019. Kjo çoi në mosrealizmin e disa proçedurave të prokurimit të parashikuara nga institucioni e që lidheshin me përmirësimin e infrastrukturës së kushteve të punës (pajisje zyre, riparim/blerje pajisje elektronike).

1. Shpenzime personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikën, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ky fondi i akorduar për vitin 2019 për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli ishte 90,800,000 lekë, i ndryshuar me shkresat nr. 3845/1 Prot., datë 20.03.2019, “Transferim fonde për vitin 2019” në 84,800,000 lekë, ndërsa **realizimi është 80,492,112 lekë ose 94,90%**, i buxhetit të ndryshuar si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ishin në plan 13,700,000 lekë, ndërsa **realizimi është 11,157,532 lekë ose në masën 81.40% i buxhetit**. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (**600 dhe 601**) për vitin 2019 janë **realizuar në masën 93% i buxhetit të ndryshuar**. Gjatë vitit 2019, numri mesatar i punonjësve ka qenë 52,80 punonjës nga 56 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të komisionerëve si dhe të lëvizjeve të punonjësve të institucionit tonë në detyra të tjera, të krijuara në fund të vitit 2018 dhe gjatë vitit 2019.

Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2019 nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë këtyre periudhave.

- Gjatë katër/mujorit të parë, institucioni ka patur mungesa në personel si më poshtë:
 - ✓ 1 Komisioner në “Seksionin për organet e administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre”;
 - ✓ 1 Këshilltar;
 - ✓ 1 Ndhmëskomisioner në “Seksionin për organet e administratës qendrore të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre”;
 - ✓ 1 Ndhmëskomisioner në “Seksionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve”;
 - ✓ 1 Specialist në “Sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve”;
 - ✓ 1 Specialist në “Sektorin e financës dhe prokurimeve”;
 - ✓ 1 Specialist në “Sektorin për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin European”.
- Gjatë katër/mujorit të dytë institucioni ka patur mungesa në personel si më poshtë:
 - ✓ 1 Përgjegjës IT^{së} në “Sektorin e IT dhe pritjes së qytetarëve”,
 - ✓ 1 Specialist i “Shërbimeve ndaj qytetarëve”,
 - ✓ 1 Specialist në “Sektorin për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin European”.
- Gjatë katër/mujorit të tretë institucioni ka patur këto mungesa:
 - ✓ 1 Ndhmëskomisioner në “Mekanizmin e Parandalimit Kombëtar të Torturës”;
 - ✓ 1 Specialist në “Sektorin e financës dhe prokurimeve” (pjesërisht);
 - ✓ 1 Specialist në “Sektorin për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin European” (pjesërisht)

2. Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera

Fondi i akorduar për periudhën Janar – Dhjetor 2019 për shpenzime mallra dhe shërbime (**zëri 602**) ishte 16,500,000 lekë, i ndryshuar me shkresë nr. 3845/1 Prot., datë 23.03.2019, “Transferim fonde për vitin 2019” në 22,500,000 lekë, ndërsa realizimi është **17,978,717 lekë ose 79.90% e buxhetit** të ndryshuar.

Për vitit 2019 shpenzimet operative janë përdorur për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, furnizime me materiale të tjera zyre, njoftime publikime në gazeta dhe botime, shpenzime për energjinë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafone, shërbimi postar, siguracion automjesh, blerje karburant, shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve të institucionit, dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime për mirëmbajtje ndërtimore, shpenzime për mirëmbajtje aparatura e pajisje teknike, shpenzime pritje-përcjellje të huajve, shpenzime për ekzekutim vendimeve gjyqësore, shpenzime për pjesëmarrje në evente, shpenzime për taksa të paguara.

Fondi për transfertat korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2019, ishte 1,600,000 lekë, i ndryshuar me shkresë nr. 3078/1 Prot., datë 28.02.2019, “Transferim fonde për vitin 2019” në 1,610,000 lekë ndërsa realizimi është **1,605,206 lekë ose 97.70% i buxhetit** të ndryshuar.

Nr.	Emërtimi i Organizatës	Kuotacionet në vite						
		Monedha	Vlera në vite					
			2014	2015	2016	2017	2018	2019
1.	Shoqata e Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM)	Euro	750	750	750	750	750	1.000
2.	Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF)	Euro	650	650	650	750	900	900
3.	Rrjeti European i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI)	Euro	3.000	3.000	3.000	3.000	4.000	4.000
4.	Rrjeti European të Ombudsmanit për Fëmijë (ENOC)	Euro	0	0	1.100	1.100	1.100	1.100
5.	Instituti European i Ombudsmanit (EOI)	Euro	350	350	350	350	350	350
6.	Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI)	CHF	5.000	5.000	5.000	5.000	5.000	5.000
7.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI)	Euro	750	750	750	750	750	750

Për vitin 2019 këto fonde janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve në kohë të kuotave të anëtarësimit ku Institucioni i Avokatit të Popullit është anëtarë në organizata ndërkombëtare si Association des Ombudsmans et Mediateurs del a Francophonie (AOMF), European Ombudsman Institute (EOI), Association of Mediterranean Ombudsman (AOM), International Ombudsman Institute (IOI), Global Alliance of National Human Rights Institutions (GANHRI), European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI) si dhe European Network of Ombudspersons for Children (ENOC).

Fondi për transferta buxhetore familjare dhe individë (zëri 606) për periudhën Janar - Dhjetor 2019, ishte 500.000 lekë, i ndryshuar me shkresat nr. 3078/1, datë 28.02.2019, “Transferim fonde për vitin 2019” si dhe “Akordim fondi për pagesën pas ndërprerjes së funksionit të fundit” nr. 4422/1, datë 01.04.2019 në 1,438,908 lekë, ndërsa realizimi është **1,438,908 lekë ose 100% i buxhetit** të ndryshuar.

3. Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2019 është 2,000,000 lekë, ndërsa realizimi është **870,000 lekë ose 43.50% i buxhetit**. Për përmirësimin e kushteve të punës në institucionit të Avokatit të Popullit janë bërë këto investime (shiko tabelën e mëposhtme).

në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
1. Blerje kondicionerësh	M660001	1,000	870	87
2. Blerje orendi zyre ¹³⁰	M660001	1,000	0	0
TOTALI		2,000	870	43.5

6.2.4 Miratimi i Buxhetit të institucionit për vitin 2020

Institucionit të Avokatit të Popullit në përputhje standardet ndërkombëtare, i është përcaktuar një mandat i gjerë si institucion kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Me një staturë të tillë institucionale, pritshmëritë e ligjshme të publikut janë të larta karshi veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit.

Për ushtrimin e veprimtarisë në pritshmëritë e publikut por edhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të përcaktuara përkatësisht në Parimet e Parisit dhe ato të Komisionit të Venecias, Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të mbështetet financiarisht nga buxheti i shtetit në një masë të përshtatshme që t’i mundësojë realizimin në mënyrë të plotë të mandatit të tij kushtetues.

¹³⁰Siç është theksuar dhe më lart ky zë nuk u realizua për shkak të situatës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore (tërmetit) dhe pezullimit të procedurave të prokurimit

Është kjo arsyeja që edhe projekt-buxheti i vitit 2020 u projektua nga ana e institucionit duke marrë në konsideratë misionin për mbrojtjen e të drejtave, liritë dhe interesat e ligjshmetë individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, rekomandimet dhe standardet e institucioneve ndërkombëtare, rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë si dhe në analizën dhe menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare në një terren shumë të ngjeshur me aktivitete të zhvilluar nga Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2019.

Në përputhje me procedurën ligjore përkatëse për shqyrtimin e projektligjit “Per buxhetin e vitit 2020”, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit në seancën dëgjimore të datës **19 Nëntor 2019**, prezantuan para Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut një analizë tërësore të faktorëve ndikues duke argumentuar propozime konkrete për ndryshime në buxhetin e Institucionit për vitin 2020, ndryshime këto që konsistojnë në shtesa financiare dhe në burime njerëzore. Në përfundim të analizës shtruese të parashtruar përpara Komisionit për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ky i fundit u dakortësua që institucionit t’i akordohej një fond shtesë në zërin 602 (shpenzime operative) dhe zërin 231 (investime).

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr.88/2019, datë 18.12.2019, “Për buxhetin e vitit 2020“, Institucioni i Avokatit të Popullit u njoh me buxhetin përfundimtar të vitit 2020. Paradoksalisht me atë çfarë ishte komunikuar verbalisht dhe miratuar në seancën dëgjimore të datës 19 Nëntor 2019 nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në trajtën e shtesave në fonde, u konstatua një reduktim i mëtijshëm i buxhetit të këtij institucioni.

Sjellim në vëmendje se buxheti i miratuar për vitin 2020 për Institucionin e Avokatit të Popullit, rezulton të jetë buxheti i parë në historinë e funksionimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili reduktohet nën tavanet përfundimtare të shpenzimeve të miratuara nga VKM-të përkatëse. Ky buxhet rezulton të jetë *reduktuar në masën 2.23% krahasuar me atë të miratuar në VKM-në nr.523, datë 25.07.2019, “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve për PBA 2020-2022” dhe 7.5% krahasuar me një vit më parë.*

Ky buxhet do të gjenerojë një impakt negativ edhe në procesin e ri-akreditimit të Statusit “A” (i cili pritët të përmbyllet gjatë vitit 2020), pasi një ndër kriteret vlerësuese që udhëheq procesin e akreditimit është edhe mbështetja e përshtatshme financiare nga buxheti i shtetit në një shkallë të tillë që të mundësojë realizimin gradual dhe progresiv të aktiviteteve të këtyre institucioneve kombëtare në funksion të përmbushjes së mandatit të tyre. Theksojmë se *sipas Parimeve të Parisit financimet e ndryshme nga burime të jashtme (donatorët) nuk mundet kursesi të zëvendësojnë fondet që vijnë nga buxheti i shtetit, pasi është përgjegjësi e këtij të fundit të sigurojë buxhetin minimal të aktivitetit të një Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut në mënyrë që të lejojë që ai të funksionojë normalisht drejt përmbushjes së mandatit të tij.*

Buxheti i miratuar jo vetëm që nuk mbështet vizionin tonë si institucion kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin të drejtave të njeriut por është në kundërshtim flagrant dhe me rekomandimet e përfshira në të gjitha raportet e organizatave ndërkombëtare (përfshirë edhe raportet e Komisionit Europian, raportin e Komitetit të Nën-Akreditimit, viti 2014 dhe rekomandimet e lëna në kuadër të Rishikimit Period Universal (UPR), viti 2014,) të cilat më vehte e së bashku në vlerësimet e tyre kanë përsëritur dhe përsërisin në mënyrë të vazhdueshme faktin që institucioni i Avokatit të Popullit disponon kapacitete të kufizuara njerëzore dhe financiare për të ushtruar në mënyrë të plotë mandatin e tij kushtetues dhe se kërkohet një mbështetje më e madhe nga buxheti i shtetit në këtë drejtim.

Nisur nga qasja krahasimore, buxheti i institucionit për periudhën 2014-2020 ka qenë si më poshtë:
Në mijë lek

Nr.	Vitet	Miratuara					
		600-601	602-606	231	Nr. i Punonjësve		Totali
		Paga+sig	Shp. Operative	Investime	Nd/Komisioner	Gjithsej	
1	2014	75.500	16.000	4.000	45	50	95.500
2	2015	75.500	16.000	4.000	46	51	95.500
3	2016	84.500	17.000	4.000	48	55	105.500
4	2017	84.500	18.000	4.000	48	56	106.500
5	2018	94.500	17.500	4.000	48	56	116.000
6	2019	104.500	18.600	2.000	48	56	125.100
7	2020	98.500	17.000	1.000	48	56	116.500

6.3. Funksionimi i zyrave rajonale

Siç është theksuar edhe më parë në nenin 32 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar është përcaktuar ndërmjet të tjerash, e drejta që ka Avokati i Popullit për të emëruar një përfaqësues të tij vendor si dhe detyrimin e organeve të pushtetit vendor për të ofruar akomodimin me zyrë si dhe krijimin e kushteve të nevojshme të punës për zbatimin e gjithë kërkesave të këtij ligji.


Zyrat rajonale kanë vijuar të forcojnë një prani të vlerësueshme të Institucionit të Avokatit të Popullit më afër qytetarëve në këto rajone, nëpërmjet një pune të vazhdueshme të përfaqësuesve në terren, duke u mundësuar qytetarëve informacione të nevojshme mbi rolin dhe funksionin e Institucionit të Avokatit të Popullit, marrjen e ankesave dhe dërgimin në kohë për shqyrtim nga ekspertët sipas seksioneve si dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brenda një kohe të shkurtër dhe optimale. Fushatat promovuese dhe puna në terren e përfaqësuesve rajonale kanë qenë pjesë erëndësishme e aktivitetit të përditshëm të punës së tyre, duke synuar në vazhdim rritjen dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek Avokati i Popullit jo vetëm si një objektiv për t'u arritur por edhe si sodisfaksion dhe përgjegjësi. Përperiudhën Janar-Dhjetor 2019, numri i ankesave/kërkesave të paraqitura kane qenë *1844 ose 44% e totalit për vitin 2019.*

Gjatë vitit 2019 në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është dakortësuar përdorimi e zyrave vendore në ato hapësira gjeografike ku ato janë ngritur dhe funksionojnë për të mbështetur njëri-tjetrin në marrjen e kërkesave/ankesave të subjekteve ankues dhe përcjelljen e tyre me qëllim trajtimin dhe adresimin e tyre sipas të drejtave të shkelura. Të dy institucionet do të angazhohen në realizimin e trajnimeve të përbashkëta për ngritjen profesionale të përfaqësuesve të zyrave vendore me qëllim zhvillimin e një kulture të re dhe standardeve më të larta në ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve.


Në kuadër të vlerësimit dhe analizës serioze të bërë në lidhje me funksionimin dhe riorganizimin e zyrave vendore të institucionit të Avokatit të Popullit, përmirësimin e funksionimit dhe performancës së tyre, shtrirjes gjeografike, nivelin aktual të bashkëpunimit dhe problematikat e krijuara nga njësitë e pushtetit vendor, nivelin dhe standardin që këto struktura duhet të kenë si pjesë e një institucioni kombëtar të të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit e gjykoi të arsyeshme mbylljen dhe mosfunksionimin e metejshëm të Zyrës Rajonale Fier duke e zhvendosur atë në Bashkinë Vlorë me Kryetarin e Bashkisë të të cilit është nënshkruar tashmë edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit.

Ashtu siç është theksuar edhe më parë, vlerësojmë se nëse zyrat vendore të Avokatit të Popullit do të ndodheshin brenda godinave të bashkive respektive apo pranë tyre, aksesueshmëria e qytetarëve drejt këtyre zyrave do të ishte shumë më e lehtë, vizibiliteti shumë më i lartë dhe do të ndikonte në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe të imazhit e besimit të qytetarëve tek ky institucion. Ky shqetësim është ngritur edhe gjatë diskutimeve në Kuvend të raporteve të mëparshme por situata e zyrave rajonale në disa bashki ku ato operojnë vazhdon të mbetet e njëjtë (Zyra Vendore Pogradec, Berat dhe Sarandë).

Më poshtë jepet një vështrim krahasimor të ankesave të ardhura nga Zyrat vendore për vitin 2018 dhe për vitin 2019.



Paraqitja grafike e numrit të ankesave dhe këshillimeve për vitin 2018 dhe 2019



Paraqitja grafike e përqindjes së ankesave/këshillimeve në Zyrën Qëndrore të institucionit të Avokatit të Popullit dhe në Zyrat Rajonale

KREU 7

Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre


Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2019 ka shqyrtuar **4171 ankesa**. Nga këto, **1384 ankesa** pas vlerësimit nga ekspertët e institucionit janë cilësuar si ankesa “brenda juridiksionit dhe kompetencës” së Avokatit të Popullit, ndërsa **2327 ankesa** janë trajtuar në formën e këshillimeve dhe orientimeve mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të problemit të tyre.

Depozitimi i ankesave ka ardhur si rezultat i paraqitjes fizike të qytetarëve pranë zyrës qendrore të pritjes së Avokatit të Popullit apo Zyrave Rajonale si dhe nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit të tilla si; shërbimi postar, rrjeteve sociale, postës elektronike, aplikacionit mobile, telefon etj.

Këshillimet verbale dhe shkresore të paraqitura pranë zyrës qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit janë si më poshtë:

- 617 ankesa/këshillime në Zyrën Qendrore të Pritjes
- 861 ankesa me postë
- 349 ankesa/këshillime me telefon
- 111 ankesa me email
- 118 ankesa/këshillime nëpërmjet aplikacionit
- 271 ankesa/këshillime nëpërmjet rrjeteve sociale


Pranë 7-të Zyrave Rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2019 janë depozituar 1844 ankesa dhe këshillime të paraqitura si në grafikun e mëposhtëm:




Paraqitja grafike e shpërndarjes së ankesave/këshillimeve në 7-të Zyrat Rajonale

Totali i 1384 ankesave të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit sipas seksioneve përkatëse janë sipas tabelës në vijim:

Seksioni	Numri i ankesave në shqyrtim
Seksioni i Përgjithshëm	255
Seksioni i Veçantë	519
Seksioni i Administratës	537
Seksioni i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ¹³¹	8
Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve	65



Paraqitja grafike e trajtimit të ankesave sipas seksioneve përkatës




¹³¹Për shkak të natyrës dhe specifikës së punës, Seksioni i MKPT-së nuk merret me trajtimin e ankesave individuale


Shpërndarja e ankesave drejt institucioneve shtetërore dhe institucioneve në varësi të tyre është si më poshtë:

Institucionet	Numri i ankesave
Këshilli i Ministrave	56
Ministria e Drejtësisë	330
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	149
Ministria e Brendshme	119
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	49
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	47
Ministria e Financës dhe Ekonomisë	23
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	23
Ministria e Mbrojtjes	9
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	4
Ministria e Kulturës	3
Pushteti Vendor	297
Gjykatat	47
Prokuroria	75
Institucionet e Pavarura	19
Institucione të tjera	134

Paraqitja grafike e shpërndarjes së ankesave drejt institucioneve shtetërore dhe institucioneve në varësi të tyre.



Paraqitja grafike e shpërndarjes së ankesave sipas institucioneve



Paraqitja grafike e ankesave të depozituara ndër vite pranë Institucionit të Avokatit të Popullit



Paraqitja grafike e trajtimit të ankesave në vitin 2019


Ankesat e trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2019, sipas të drejtës së shkelur janë si më poshtë:

Kufizime të lirisë së personit	357
E drejta e pronës	225
E drejta e mbr. shoq. të punës	104
E drejta për sigurimet shoqërore	77
Ndihma ekonomike	67
Procedurat Gjyqësore	59
Mbrojtja e konsumatorit	56
E drejta për strehim	43
E drejta për informim	35
E drejta për kujdes shëndetësor	35
E drejta për arsim	53
Të tjera	273



Paraqitja grafike e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2019 sipas të drejtës së shkelur

Përsa i përket rasteve me iniciativë për vitin 2019, Institucioni i Avokatit të Popullit ka shqyrtuar 178 raste, raste këto të marra nga mediat, emisionet investigative, rrjetet sociale etj. Në të gjitha rastet e trajtuara Institucioni i Avokatit të Popullit është ndeshur me shkelje të të drejtave të qytetarëve.



Paraqitja grafike e trajtimit të rasteve me iniciativë sipas seksioneve për vitin 2019




Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve me iniciativë sipas seksioneve në vitet 2018 – 2019

Përsa i përket monitorimeve dhe inspektimeve në vitin 2019 Institucioni i Avokatit të Popullit ka rritur numrin e përgjithshëm me **77%** në krahasim me vitin e mëparshëm. Kështu monitorimet dhe inspektimet e realizuar kanë qënë kryesisht:


- Monitorim dhe inspektim të operacioneve të riatdhesimit

- Monitorim i protestave¹³²
- Monitorim në Drejtoritë e Policisë
- Inspektim të IEVP-ve
- Inspektim të Komisariateve të Policisë
- Inspektim të Reparteve Ushtarake
- Inspektim në Stacionet e Policisë Kufitare
- Inspektim në Qëndrat e Zhvillimit për personat me aftësi të kufizuar
- Inspektim në Urgjencën Kombëtare QSUT për autoambulancat
- Inspektim në Institutin e të Miturve
- Inspektim në Spitalet Psikiatrike në vend
- Inspektim në Qendrën e Azilkërkuesve
- Inspektim në Qëndrat e Viktimave të Trafikut
- Inspektim në Qendrën e Mbyllur për të Huajt
- Inspektim në Shtëpitë e të Moshuarve



Paraqitja grafike e inspektimeve dhe monitorimeve sipas seksioneve

¹³²Monitorimi i protestave për shkak të burimeve të kufizuara është realizuar me pjesëmarrjen e të gjithë seksioneve të institucionit




Paraqitja grafike e inspektimeve dhe monitorimeve të realizuara në vitin 2018 dhe 2019

Në vitin 2019 institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar 213 rekomandime, ndërsa në vitin 2018 ky numër ka qënë 185. E thënë ndryshe 28 rekomandime ose 15.1% më shumë se në vitin 2018.


Shpërndarja në numra e rekomandimeve për vitin 2019 sipas seksioneve:

Seksioni i Përgjithshëm	35
Seksioni i Veçantë	32
Seksionii MKPT-së	80
Seksioni i Administratës	40
Seksioni i Fëmijëve	26




Paraqitja grafike e rekomandimeve sipas seksioneve për vitet 2018 - 2019

SHPËRNDARJA GRAFIKE ME % SIPAS SEKSIONEVE - 2019




Paraqitja grafike e shpërndarjes me % të rekomandimeve sipas seksioneve për vitin 2019

Rekomandimeve të trajtuara nga seksionet sipas ndarjes gjinore



¹³³ Paraqitja grafike e rekomandimeve të trajtuara nga seksionet me të dhënat sipas gjinisë

REKOMANDIMET SIPAS GJINISË



Paraqitja grafike e rekomandimeve të trajtuara nga institucioni në vitin 2019 sipas ndajes gjinore

¹³³ Të tjera përfaqësojnë rekomandime për grupe të ndryshme interesi ku përfitojnë të dyja gjinitë.